

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

BH-32

H 48



# Heroina

## TREGIME

814-33

449.

# HEROINA

Tregime për gruan



1149

## VISHNJA PIKONTE GJAK

Sa shumë i kam dashur ata! I doja aq shumë, sa nuk kishte ditë që të mos hyja në shtëpinë e tyre, një shtëpi e vogël, si gjithë shtëpitë e tjera tiranase të lagjeve të vjetra. Jetonin vetëm, burrë e grua, pa fëmijë, pa të afërm, përveç një vëllai të gruas, që vinte hera-herës dhe qëndronte disa ditë me ta.

Burri, rreth 45-vjeç, i kishte flokët krejt të zbardhur. Thoshin se ishte thinjur shumë shpejt nga dëshpërimi: gruaja kishte lindur dy fëmijë njërin pas tjetrit, po të dy të vdekur. Askush nuk e kishte dëgjuar të ankohej ndonjëherë. Por në sytë e kaltër dhe në buzëqeshjen i vihej re gjithmonë një trishtim i përmbajtur.

E shoqja ishte nja tre gisht më e gjatë se ai. Fytyra e saj e dobët, me gropëzat e faqeve të thelluara dhe me mollëzat pak të dala, tregonte se ishte e ftohtë, autoritare, gati-gati përbuzëse.

Pranë burrit ndihesha i qetë, kurse pranë saj përherë ndieja që dashuria ime prej fëmije përzihej me druajtjen dhe me një farë ankthi të çuditshëm e të pashpjegueshëm, që më mbante në tension. Por, ndoshta, kjo ndjenjë e ndërlikuar e bënte më të thellë dashurinë për të. Së më shikonte, më thoshte:

— Erdhe? Ec, ec. Pse rri aty?... Bajram, erdhi Luli!  
— e më zinte për dore duke më tërhequr pranë vetes.

— Ku je, more pehlivan! Pa hajde këtu, more, kolo-  
puç, hajde te xhaxhi!

Bajrami qëndronte nën vishnjen dhe fytyra i mbushej gjithë dritë.

— Rri këtu! — më thoshte gruaja. — Rri këtu! Nuk shikon që ai po krasit?

— Bajram, silli Lulit ca luleshtrydhe dhe shiko mos janë pjekur pjeshkët.

Burri i thinjur i bindej gruas në heshtje. Pata vënë re se gjithnjë, kur gruaja kërkonte diçka, ai ia plotësonte dëshirën pikë për pikë, në heshtje, me një farë kënaqësie.

Unë ulesha dhe haja frutat, kurse ata të dy, në këmbë, pranë e pranë, më shikonin të lumtur. Këto kanë qenë rastet më të bukura të jetës sime dhe do të më përsëriteshin dita-ditës, sikur lumturinë tonë kaq të thjeshtë e të pakuptueshme nga të tjerët të mos e turbullonte në të rrallë një njeri tjetër.

Njeriu që dua të përshkruaj tani, banonte përballë shtëpisë së Bajramit. Ishte beqar, me një moshë të papërcaktuar, me një fytyrë të rrumbullakët si rreth, të mbushur dhe pa rrudha. Dilte në ballkonin ku kishte vënë disa saks me lule, i ujiste, fuste gishtat e mëdhenj në tirantat e pantallonave dhe fishkëllente me gëzim. Herë-herë fliste nga ballkoni, herë-herë vinte për vizitë. Por, sa herë që vinte për vizitë, në shtëpinë e fqinjit binte një hije e zymtë. Mezi shkëmbeheshin disa fjalë. Dëgjoheshin vetëm e qeshura dhe zëri i tij. Bajrami e përmbante mërzitjen, ndërsa e shoqja, Bihania, e shfaqte fare hapur. Po burri i botës qëndronte mospërfillës ndaj përbuzjes së saj. Ndoshta nuk e kuptonte, ose ndoshta bënte sikur nuk e kuptonte. Dhe kjo ishte gjëja që e zemëronte më shumë Bihanen. Unë ulja kokën, përtypja me mundim vishnjat dhe nga çasti në çast prisja i tronditur shpërthimin e Bihanes.

Kur ai largohej, Bihania shfrynte me gjithë mushkëritë, i varte krahët si t'i kishte të këputur dhe ulej në stolin e vogël, e lodhur dhe e rraskapitur.

— Qelbësira! — thoshte ajo dhe fytyra i shprehte një neveri të madhe. — Sillet rrotull e rrotull... Nuhat si qen...

— Ndoshta nuk është i atillë, — përgjigjej Bajrami me një zë të pasigurtë.

— I atillë është, qen është! Kush do ta mbante gazetar në «Tomori», po të mos ishte i atillë?

Burri tundte kokën e thinjur dhe thoshte me një zë të mbytur:

— Ç't'i bësh... Nuk kemi ç'të bëjmë, veçse të ruhem. . .

Duart e mia qenë lyer me lëngun e kuq të vishnjave.

\* \* \*

S'është për t'u çuditur përse e sjell ndër mend kopshtin me një gjelbërim aq të dendur dhe të fortë. Atëherë ishte luftë. Qetësinë e rrugëve tona e shtypte dhe e gërvishte çizmja e fashistëve, ajri qe mbushur me fishkëllima bilbilash e plumbash, plagët tona të mëdha i mbulonte vezullimi i yjeve, i yjeve. . . A thua vërtet kopshti ka pasur aq shumë gjelbërim, sa nuk e kam parë në asnjë vend tjetër? Apo ndoshta ndjenja e dashurisë sime fëmijnore për këta njerëz të mirë, ndjenja e dhembjes, e mallit, e vesh kujtimin për ta me këtë dritë? Vezullimi i yjeve. . .

Ka qenë mëngjes qershori. Unë hapa derën, po në oborr nuk e pashë, si zakonisht, Bihanen. Vura re Bajramin, që lëvizte i shqetësuar poshtë vishnjës së mbushur gjithë fruta. Lëvizte pa pushim, para e prapa dhe nuk e di a më pa e nuk më foli, apo nuk më pa fare.

— Xhaxhi! — i thirra, por ai nuk m'u përgjigj. — Xhaxhi! — i thirra më fort.

Përsëri ai nuk më dha përgjigje. Vazhdonte të ecte, sikur donte të lodhte veten.

Siç duket, Bihania e dëgjoji zërin tim dhe doli nga dhoma.

— Bajram, nuk e shikon që ka ardhur Luli?

Bajrami vazhdonte të ecte. Zëri nuk arrinte deri në ndërgjegjen e tij. Papritur gruaja ma lëshoi dorën dhe, sikur ta shtynte dikush nga pas, shkoi pranë të shoqit. Nuk i foli, por qëndroi si e shtangur dhe priti që ai ta ndiente praninë e saj. Kur u kthye përballë Bihanes, ai u drodh si të ishte trembur. Sytë e gruas vështronin me ngulm. Buza e Bajramit lëvizi padashur, shkoi shtrembër, u duk se donte të thoshte diçka, përpiqej të fliste, kapërdinte pështymën, por zë nuk nxirrte.

— Aliu! — tha gruaja dhe priti me ankth.

Ajo kishte përmendur emrin e të vëllait dhe kuptohej se kishte ndodhur një fatkeqësi.

Burri uli kokën e thinjur në shenjë pohimi. Ajo u afrua edhe ca, si të donte të mbështeste kokën në supin e tij. Qëndroi fare pranë tij dhe befasi dhe ngriti kokën lart. Sytë i qenë hapur aq shumë, sa në fytyrën e saj, të zbardhur papritur, dukej sikur i mbetën vetëm këta sy.

Në këtë çast kishte dalë në ballkon burri me fytyrë të rrumbullakët si rreth, që ujiste lulet, fishkëllente me gëzim dhe shikonte poshtë, nga kopshti.

— U poqën vishnjat, Bajram, — foli ai.

Bajrami nuk u përgjigj.

— U poqën, — u përgjigj Bihania.

Këputi një kokërr, e shtrydhi midis gishtave dhe tha:

— Ja, shikoji, t'i lyen duart me gjak. . .

Pasdite erdhën fqinjët ta ngushëllonin. Të gjithë e dinin sa e kishte dashur të vëllanë. Ajo qëndronte në krye të dhomës, e heshtur, veshur me të zeza. I shoqi kishte varur kokën e bardhë dhe vazhdimisht kapërdihej, sikur t'i kishte mbetur diçka në fyt. Kushedi pse njerëzit flisnin për kohën, pemët, për gjëra që nuk kishin të bënin me vëllanë e saj të vvarë. Ajo dëgjonte dhe as nuk qante, as nuk rënkonte. Hapësirat e gjera midis bisedave të kota i mbushte një heshtje e ftohtë. Dhe unë prisja që nga çasti në çast Bihania t'ia shkrepte të qarit. Por ajo nuk qante. Pastaj njerëzit u çuan njëri pas tjetrit e dolën jashtë. Në prag të derës ajo e ndali njërin dhe e pyeti:

— E kapën?

— Jo. E qëlluan kur po ikte me vrap, pas atentatit.

Goja e Bihanes u hap, supet iu çuan lart, po britmen që po i dilte nga thellësia e shpirtit, e mbajti me tërë forcat. Në rrugicë atë çast u dëgjua fishkëllima e burrit me fytyrë si rreth.

\* \* \*

Katër muaj më vonë, në vjeshtë, ndodhi një fatkeqësi akoma më e madhe: një mesnatë Bajramin e arrestuan,

pasi i gjetën të fshehura në fund të kopshtit disa municione. E torturuan dy javë me radhë, bënë çmos të tregonte lidhjet me shokët e Qarkorit, por ai nuk e hapi gojën. Vetëm kur panë se po mbaronte, e nxorën jashtë dhe e pushkatuan.

Dhe përsëri erdhën fqinjët ta ngushëllonin. Midis tyre ishte edhe burri me fytyrë të rrumbullakët si rreth. Bihania qëndronte në krye të dhomës, pa gjak në fytyrë, dhe i dëgjonte bisedat, sikur të mos kishte ndodhur gjë. Vështrimi i saj qe ngulur diku, në boshllëk, dhe ajo ngjante sikur flinte me sy hapur, sikur nuk i interesonte asgjë përreth. A thua nuk e besonte të vërtetën e tmerrshme? Papritur m'u bë se e gjithë kjo ishte një ëndërr. Pashë derën e dhomës tjetër të mbyllur dhe më shkoi ndër mend që Bajrami ishte gjallë, se qëndronte fshehur në dhomë dhe, pas një çasti, do të hapte derën e do të dilte para nesh, me kokën e tij të bardhë e me buzëqeshjen e trishtuar.

Bihania pa nga dritarja e hapur pjergullën e mbushur me rrush dhe tha:

— Bajrami i hante shumë rrushtë.

Askush nuk foli. Prisinin.

Ajo u kthye nga burri me fytyrë të rrumbullakët si rreth dhe i foli atij me sytë gjysmë të mbyllur, me një zë të shtruar, të akullt, sikur i përgjigjej ndonjë pyetjeje.

— Kështu... po të tregoj ç'i ndodhi tim shoqi, që i donte aq shumë pemët, të cilat i shikoje me kujdes orë e çast nga ballkoni. E nxorën nga biruca kur akoma nuk ishte zbardhur. Meqenëse nuk ishte as i gjallë as i vdekur, e tërhoqën zvarë nëpër korridor. E mbështetën në murin e obrisit të burgut dhe e pyetën për të fundit herë në do të tregonte. Ai përmbloodhi forcat dhe tha se do të fliste. Do t'ia tregonte Xhelal Staraveckës. Ju e njihni atë, apo jo? Kështu tha im shoq, dhe Xhelali i shkoi pranë. «Afrohu edhe ca», — i tha im shoq dhe, kur ai i shkoi pranë, burri im, që i donte aq shumë pemët, e pështyu në fytyrë dhe u rrëzua i vdekur përtokë. Kaq kishte mundësi të bënte. Pastaj e qëlluan katër herë në kraharor. Nën sisën e majtë ai kishite një nishan. Nga nishani rrodhi gjaku i kuq si lëngu i vishnjave.

Gruaja heshti një çast dhe fytyra e saj mbeti gjithnjë e ftohtë.

— Në gazetën «Tomori» mund të shkruash diçka për... trimat e tu, që i hapën plagë në nishanin nën sisë burrit tim. Dhe mund të flasësh për gjakun si lëng vishnjeje.

Fytyra e rrumbullakët i qe zverdhur dhe mjekra e mishtë po i dridhej.

— Zonjë, zonjë!... Ju gaboheni, unë...

— Ju gaboheni, zotëri, ju... Erdhe këtu që të shikoje si do të qaja unë, si do të mposhtesha, si do të ulërija nga dhembja...

Gruaja qe ngritur tani në këmbë, dhe fytyra e saj shprehte urrejtje.

— Këtë nuk do ta shohësh kurrë, qelbësirë! Shporru këtej!

Kur të gjithë njerëzit qenë larguar, ajo i vuri llozin portës, shkoi në këndin më të largët, u ul në gjunjë dhe filloi të qante. Qante në heshtje, pa zë, por në vajtimin e saj kishte kaq dhembje, sa edhe muret rrëqetheshin. Pastaj, befas, pa e përmbajtur veten, shpërtheu në dënesa të forta, që të mbysnin zërin dhe e ngjeshi kokën në jastëk.

I shkova pranë, e preka në sup dhe, që ta ngushëlloja, i fola me zë të dridhur:

— Bihane, nuk je vetëm, më ke edhe mua këtu pranë. Edhe unë do të marr hak. Do të marr hak! — dhe shpërtheva në vaj.

1972



## GRUAJA ME NISHAN NË MJEKËR

Do të qe më bukur sikur të shkruanim se atë mëngjes kryeqytetasit shkonin në punë të gëzuar, duke e zgjedhur trotuarin sipas qejfit, ndërsa altoparlantet përhapnin në efir ato nota, që tashmë janë përcaktuar si ushqim i domosdoshëm i shpirtit tonë! Jo, atë mëngjes, në qoftë se ndonjë piktor do të qe ngulur në një qoshe rruge për t'u frymëzuar drejtpërsëdrejti e për të qenë kështu «më i lidhur me jetën» (siç është zakoni të flitet midis artistëve!), sikur ai të riprodhonte në pëlhurë atë që i shihnin sytë, tabloja e tij do t'i ngjante një plake të sflitur, gungaçe, që ecën, dridhet, kollitet e psherëtin!... Një tablo e tillë do t'u pëlqente vetëm natyralistëve! ose vetëm atyre që e quajnë veten «tmerrësisht» realistë! Por, le ta themi hapur, shpesh, ajo që s'është e denjë për penelin, është e përshtatshme dhe e zakonshme për penën. Pra... atë mëngjes njerëzit shpejtonin çapin të kërrusur, si të kishin mbi supë një barrë të rëndë. S'mjaftonte cikma, s'mjaftonte era, por ja edhe pikat e ftohta të shiut të imtë që të «gudulisnin» fytyrën. Të gjithë ecnin tatëpjetë, sulmonin drejt qendrës së qytetit, burra, gra, nxënës e studentë me libra nën sqetull, plaka e pleq me bidona e shishe qumështi në duar, tringëllinin zilet e biçikletave, tek-tuk dëgjohej buria e një makine që rrëshqiste me shpejtësi, duke ngritur stërkala uji. Rruga «Qemal Stafa» është një rrugë e gjatë dhe e drejtë. Në të dy anët e saj, si dhe në rrugicat e vogla banojnë njerëz të ndryshëm: punëtorë të të gjitha zanateve, bile edhe të Kombinatit «Stalin», që ndodhet në anën tjetër të qytetit,

nëpunës të ministrive, të ndërmarrjeve, rrobaqepës, gra që njohin modën, që hedhin këmbëkat e tyre nazike mbi trotuaret, duke pëshpëritur fjalë jo të mira për komunalen, që nuk kujdeset për një rrugë kaq të populluar e kaq të nderuar! Oficerë, policë e profesorë, e më në fund tregtarë e matrapazë, që kanë lëshuar rrënjë në Pazarin e Vjetër e s'duan të shkulen prej andej; tek ecin, fytyrat e tyre duket sikur pyesin: «Vërtet do ta shembin Pazarin e Vjetër!? Oj, çudi, s'paska vend tjetër për pallat kulture?!

Dhe turma ecën e ecën, shiu bie, era fryn, cikma të than veshët, lagështira e qiellit të zymtë të Tiranës të shpon si me gjilpërë. Vetëm një njeri çan përballë turmës, përpjetë rrugës. Ai është akoma i ri, i veshur me xhakëtë të zezë shajaku, me benevrekë, çorape leshi e me opinga, që janë mbushur me ujë e këndojnë çap pas çapi: «plluq-plluq-plluq!» Flokët, që i kanë dalë nëpër çipat e dyshes, i nxijnë si katrani; fytyrën e ka të rrumbullakët, faqet muskuloze, të parruara, sytë të zinj, që të shikojnë egër. Mbi njërin sup ka hedhur një sëpatë, mbi tjetrin një sharrë, e s'do t'ia dijë fare, as për opingat që notojnë në ujë, as për sqotën që i përplasat në fytyrë. I shikon njerëzit që vijnë përballë tij, herë me një tek sy, herë me tjetrin. Kur ndonjë kalimtar që shpejton, ndeshet pothuaj ballë për ballë me të, ai ngadalëson pak çapin dhe i thërret në timpan të veshit:

— Ha-a-a-jde dru me pre!

Dhe fytyra i ngërdheshet mu sikur përqesh gjithë sa shikon përpara, gjithë turmën larushe.

Njerëzit u rralluan; rruga mbeti e shkretë, me pemët e zhveshura në të dyja anët. Por djali me sëpatë e me sharrë thërret pas çdo dhjetë çapësh, pas çdo pesë çapësh:

— Ha-a-ajde dru me pre!

Shiu rrjedh litarë-litarë.

— O druvar! druvaro-o-o!

Pas djalit qëndroi një grua e mbledhur me shall mëndafshi, me çadër të vogël ngjyrë trëndafili në dorë.

— Eja pas meje, — i tha ajo, siç duket e gëzuar që gjeti druvar me mëngjes herët.

Druvari ia nguli sytë e zinj. Gruaja nuk ishte as e re,

as e vjetër, me një pallto të gjerë, me fytyrë të bardhë e me një palë sy të kaltër, të mëdhenj e të shkruar, nga ata sy që duket sikur qeshin orë e çast. Era tallej me çipat e shallit të saj të mëndafshhtë, të lidhur nyjë nën mjekrën e bukur e të rrumbullakët. Dhe mu aty, në gropën e vogël të mjekrës, ku nxinte një nishan i vogël sa një kokërr gruri, ishte ngulur vështrimi i syve të druvarit.

— Sa dru ke, moj zonjë? — pyeti ai, pa u tundur nga vendi.

Nga telat e çadrës së gruas pikonin currila të vegjël uji, njëri nga të cilët binte mbi hundën e druvarit. Gruaja largoi çadrën.

— Tre metra.

Ai pyeti:

— Ku?

— Atje! — i tregoi ajo me gisht dhe vrapoi gur më gur, e bindur se druvari po e ndiqte pas.

Nën strehën e ngushtë të shkollës, gruaja e druvari ishin aq afër, sa dy shtëllungat e frymës që u dilnin nga goja, të holla e të kaltra, si tym cigareje, bashkoheshin për një çast e pastaj treteshin në mugëtirën e mëngjesit.

Gruaja pyeti:

— Sa?

Druvari vështroi me ngulm nishanin e zi të gruas. Dukej i mallëngjyer. Sytë e tij u veshën me një perde të hollë.

— Njëqind e pesëdhjetë lekë për metër, zonjë.

— Oh! — klithi gruaja dhe u zbraps. Ajo u zbraps jo vetëm nga çmimi i lartë, por edhe nga vështrimi ngulmues i djaloshit.

— Po deshe! — ia preu ai pa ia ndarë sytë.

Gruaja u tërhoq, hipi shkallët, mbylli çadrën e vogël ngjyrë trëndafili dhe, para se të futej në korridor, tha:

— Njëqind lekë! Drutë janë të shkollës. Financa nuk na lejon të paguajmë më tepër.

Druvari u përtyp dhe i vuri krahët murit, duke shikuar herë drutë rrzë murit, herë fëmijët e vegjël, që, duke klithur e qeshur lëshoheshin në pikë të vrapit përmes oborrit dhe futeshin në korridor, ku hyri pak më parë gruaja.

...Ra zilja, shkollën e mbuloi heshtja, shiu kërciste në çati, ullukët rridhnin e uji vërshonte nëpër oborr. Druvari ngjiti shkallët dhe mbajti vesh se mos dëgjonte zërin tingëlloes të gruas. Por më kot: herë pas here deri në veshët e tij arrinin tinguj të shkëputur:

— Zoi, zoi, ta them unë!

Hapi një derë. Një burrë i thyer në moshë, i veshur me kostum të zi, e shikoi përmbi syze. Disa nxënës të ulur në bangat e para qeshën. Druvari u zbraps. Hapi një derë tjetër. Një mësues i ri kishte mbyllur sytë dhe vërtiste duart e gjata para fytyrës së vet, si të qe duke zënë një mizë. Nxënësit e vështruan gojëhapur. Druvari u zbraps përsëri pa u vënë re dhe hapi një derë tjetër. Ah, ja, më në fund, zonja që kërkonte! Mezi e njohu. Në vend të palltos së madhe i ndriste ngjyra e kuqe e një fustani prej leshi. Shallin e kishte hequr, flokët e zinj i kishin rënë mbi supe. Mbi tavolinë dukej një deng me fletore, dhe ajo diç po u shpjegonte nxënësve. Druvari s'e ndaloi fare çapin. Eci përmes klasës dhe qëndroi, si më parë, fare pranë saj.

— A do t'i presësh drutë? — pyeti me zërin e tij të fortë, që gjëmoi në klasën e heshtur.

Fëmijët kukurisën. Gruaja vuri buzën në gaz.

— Të thashë, njëqind lekë.

— Oj, po dëgjo këtu, njëqind e tridhjetë lekë metrin.

— Jo.

Druvari tundi kokën i dëshpëruar dhe doli në korridor, i shoqëruar nga klithmat e gëzuara të fëmijëve. Në klasë u vendos qetësia.

*Djali mbështeti sëpatën dhe sharrën pas murit, u ul në buzë të shkallëve dhe ra në mendime. Qielli rridhte pa pushim, era frynte si më parë, telat e rrugës fishkëllenin, të ftohtët dhe lagështia të mbështillnin trupin si çarçaf i lagur. Druvari shikonte drutë në mes të oborrit dhe mendonte jo vetëm për lekët që do të fitonte, por edhe për krahët që do t'i punonin dhe për trupin që do t'i ngrohej. Brofi në këmbë, hodhi sharrën e sëpatën pas supit dhe, si pa të keq, u fut përsëri në klasë. Kësaj radhe mësuesja nuk buzëqeshi. Ngriti sytë e kaltër dhe e shikoi me qortim, si t'i thoshte: «Po ti, a nuk e kupton se nuk është mirë të fu-*

tesh në klasë në orën e mësimit?!» Djali u step, jo vetëm nga vështrimi qortues, por edhe nga bukuria e atyre syve, që i ndillnin një kujtim të ëmbël e të dashur.

— Zonjë, njëqind e tridhjetë metrin.

— Të thashë, — ia priti shkurt mësuesja, — nuk jap më tepër se njëqind lekë. Edhe drutë, edhe paratë janë të shtetit.

Druvari u çapit në vend.

— Njëqind e njëzet pra.

— Jo! — foli ajo dhe u kthye nga nxënësit.

Djali diç murmuriti më vete, shikoi për herë të fundit nishanin që nxinte në mjekrën e mësueses dhe doli.

Pas pak nën strehën e çatisë së shkollës u dëgjua së-pata e parë.

Nxënësit u gëzuan: së shpejti stufat do të ndizeshin!

Tri orë më vonë, i lodhur dhe i djersitur, druvari u fut në korridor, u ul këmbëkryq, i vuri shpatullat murit dhe mbylli sytë për t'u çlodhur pak. Në heshtjen e thellë të shkollës arrinin herë pas here deri në veshët e tij klithmat e nxënësve:

— Zoi!... Zoi!... Ta them unë!

Pak më tej:

— Zushë!... Zushë!...

Dhe djali dëgjonte me vëmendje zërin e lartë dhe tingëllues të mësueses. «Ah, ç'zë që paska! Tamam... Tamam... — dhe sytë e tij picërroheshin dhe bëheshin ëndërrimtarë.

Më në fund «zusha» filloi t'u lexonte nxënësve diçka... diçka... që e ngriti djalin në këmbë; si i tërhequr nga një fuqi e padukshme, shkoi dhe u ngul pas derës...

... Posa u shua dasma e Tapive, që tundi Jogodinën tri ditë me radhë, në fshat zuri të flitej sërish për kooperativën. Të nesërmen Musai shkoi në mbledhje, siç qe, me rrobat e dhëndrit. Burrat u shtruan në hije të gorricës, pranë xhamisë, dhe e thurën fjalën tërkuzë nga dreka në mbrëmje, derisa dielli puthi malet e Xherijes e skuqi prozhmet e zallishtet e Shkumbinit. Tërë atë ditë, pas le-dheve e gjerdhishteve bënin majë lëveret e bardha të grave, që shikonin të merakosura kuvendin e burrave. Bile

edhe Hyria e Musa Tapisë, katër ditësh nuse, kaloi pahinë dhe u ngul e menduar majë shkëmbit, prej nga dukej tërë fshati.

Me t'u kthyer Musai në mbrëmje, iu derdh së shoqes:  
— Po ti, ç'më rrije majë shkëmbit?

Nusja uli kokën e turpëruar dhe u fut si hije në konakun e grave.

Pas tërë asaj dasme, ku vallja tundi konaqet e rrëzoi gëlqeren e mureve, ku gërneta e dajrja jehuan si në «ato vakte», saqë edhe Murroja e Kazili poshtë në katua pëllitën të shastisur, befas pas asaj mbledhjeje që u bë te gorrica, shtëpinë e Tapillarëve e mbuloi një heshtje e rëndë, si t'u kishte ndodhur një zi e një gjëmë e papritur. Edhe Baloja shikonte të zotërit në heshtje, me ata sytë e tij të lagur e të veshur si me perde të hollë. Vëllai i madh, Shaqiri, ishte ulur këmbëkryq në qoshe të konakut e po mprihte kosën në grihë. Vetullat kaleshe i kishte rrëzuar mbi sytë e çelur dhe diç bluante e mprihte me vete, ashtu si kosa pas grihës. Megjithëse i kishte kapërcyer të tridhjetat e megjithëse ishte tepër i ngrysur, prapëseprapë ai dukej shumë më i ri e më i paqëm në fytyrë. Në qoshen tjetër ishte ulur Musai, sytë e zinj të të cilit lëviznin përbrenda nga rrëmbimi e nervozizmi. Rrobat e reja e të pastra të dhëndërrisë nuk i shkonin fare tek rrinte ashtu i kërrusur e i menduar. Ndonjë nga fëmijët e Shaqirit shkelte në prag të konakut e zhdukej përsëri. Gratë hynin e dilnin si hije, duke shkelur me majë të gishtave. Ato e kishin marrë vesh se në mbledhjen e sotme dy vëllezërit ishin grindur midis tyre. Fshati qe ndarë në dy tarafe. Shaqiri qe bërë me ata që donin kooperativën. Musai rropatej me palën tjetër, që thoshte: «Mirë jemi kështu!».

Tërë mbrëmjen nuk nxorën një fjalë nga goja. U shtrua sofa: burra, gra e kalamanj u ulën kokë më kokë dhe hëngrën në heshtje të plotë. E po ashtu u ngritën dhe secili u fut në konakun e vet, pa i uruar njëri-tjetrit «natën e mirë».

— Jo, pa më huaj, të kam rixha, — foli më në fund Musai, duke iu drejtuar së shoqes, që kishte rënë në shtrat me fytyrë nga muri, — llaf është ai, të futemi në koopera-

tivë? Një pendë që na e ka dhënë perëndia, Murrone e Kazilin. Krahët, shyqyr zotit, i kemi, si unë, si Shaqiri, sa për dhjetë burra! Tokat vërtet s'i kemi të shumta, por janë të majme, ama, nën ujë. Kur vjen seneja e mbarë, kalliri rritet për sevda. Jo, më thuaj ti, — i drejtohej ai sërish së shoqes, — a s'e kam mirë unë?!

Hyria s'i bënte zë fare. Shikonte me sy të lodhur hijen e të shoqit tek rrëshqiste pas murit, që herë zgjatej, herë zvogëlohej e dridhej, siç dridhej flaka e zbetë e kandilit mbi oxhak. Musai shkelle mbi dyshtemenë e vjetër që rënkonte lehtë-lehtë dhe ia niste:

— S'ke faj, ti s'e ke parë akoma fshatin. Dy ditë e dy net u ngurose në buxhak, dy ditët e tjera u fshehe pas kurrizit të grave. . . Në fshatin tuaj vërtet është ngritur kooperativa, paçka, atje është ndarë puna me kandinin e perëndisë. Kurse këtu. . . Jo, more-e! Ç'më thua, — ndizej Musai, si të kishte të vëllanë përpara, — të heq gardhin e të bashkoj tokat me ato të Lipe Qerosit? Atje është strall e gur i thatë. Hë, pra, — ngulte këmbë Musai, — jo, pa më thuaj, të kam rixha, a s'flas drejt?

Hyries i kapiteshin sytë për gjumë. Kur hija e të shoqit i mbulonte fytyrën, ajo dremiste e përpiquej të largonte çdo mendim, por ja, drita e kandilit i dridhej sërish përmbi qepallat e hollë dhe e mjera grua kujtohej se i shoqi ishte aty, i gjatë, i fortë, i egër, i zemëruar. Hapte sytë e dëgjonte, por kokën s'e kthente asnjëherë nga ai. Atje larg, majë xhamisë, këndonte kukumjaçka. Akoma më larg dëgjohej qoku i natës tek ia thoshte: fiu-fi-i-i! Baloja lehte.

— Plaç! — i bërtiste plaka në konakun tjetër.

Musai ec e jakë e fol me vete, e fol me nusen, e nusja hesht, si të mos ishte fare aty.

— E di unë ku e ka hallin im vëlla. Ja ka qejfi të bëhet kryetar kooperative. Posi, i erdhi radha t'i shpërblehen plagët që mori në Luftë.

Me të dëgjuar fjalët e fundit, Hyria ktheu kokën nga i shoqi. Por vështrimi i lodhur dhe i fjetur i saj nuk tregonte as zemërim, as gëzim.

— Jo, more! Më mirë të jap kokën, se të heq gardhin!  
Ai më vete, unë më vete. Ai është komunist, le të futet në

kooperativë e le të bëhet kryetar e mbret po desh. Mua s'më detyron njeri. Apo jo? ... Do të jetojmë bashkë, ohu, punë e madhe! Se ç'më dërdëllisin: të vjen traktori në derë, të vjen makina shirëse në lëmë e t'i gëlltit njërin pas tjetrit pirgjet me grurë e më ta hedhka kashtën të butë si mënda-fshi! Phu! Si kemi bërë deri më sot? Hë pra, thuaje të shkretën një fjalë, se më plase! — i briti ai më në fund së shoqes.

Hyria e shikoi të shoqin në sy dhe foli me zërin e saj tingëllues:

— A ta them një fjalë, se unë vij nga kooperativa!

— Jo, s'dua! — briti e tundi këmbët pas dyshemesë dhëndri dhe sytë i nxorën xixa.

Të nesërmen e ditët e tjera gazi u tret nga shtëpia e Tapillarëve. Asnjëri s'të shihte në sy, asnjëri s'të thoshte një fjalë. Vetëm Murroja dhe Kazili pëllisnin si më parë. Baloja lehte. Plaka mallëkonte:

— Plaç!

Hyria, pasi bënte punët e shtëpisë, ulëj mbi kapakun e pusit, në mes të oborrit, dhe i vinte syrin qiellit. Fytyra e saj, e re dhe e freskët, sikur merrte gjallëri nga rrezet e diellit pranveror. Era i shpupuriste flokët, sytë e kaltër e të thellë vagëlloheshin, mjekra e fortë me nishan të zi dri-dhej e përpëlitej, siç u dridhet fëmijëve kur e kanë vajin në majë të buzëve. Kushedi, ndoshta Hyria mallëkonte veten që ra në dashuri me Musanë. Ja, tek ai zabeli, ku tani ngulej vështrimi i saj, ishte kufiri i dy fshatrave. Atje ata u panë dhe u dashuruan. Asaj i ërdhi keq të largohej nga të afërmit, nga kooperativa e nga shoqet e skuadrës, por dashuria dhe shpresa se një ditë edhe fshati i Musait do të ndiqte po atë rrugë, e ngritën dhe e sollën në këtë shtëpi të heshtur e të zymtë. Po Musanë ajo e donte, dhe Musai s'ishte aq kokëfortë sa dukej!

— Nuse! — i thërriste vjehrra. — Mblidhi flokët, se të morën ballin!

— Ah, nënë! — vinte në vete Hyria dhe lidhte lëveren e bardhë, rrethuar me temina e bedena të kuq.

Mbrëmjeve Hyria kthente fytyrën nga muri dhe e dëgjonte të shoqin, e lodhur dhe e kapitur. Ai gjithë po ato



fjalë, gjithë po ato britma. Hija e trupit të tij dridhej, zmadhohej, zvogëlohej, rrëshqiste nga muri mbi fytyrën e saj e nga fytyra e saj te muri. Dhëndri tundte këmbët mbi dysHEME dhe i drejtohej së shoqes:

— Hë pra, thuaje të shkretën një fjalë, se më plase!

Hyria heshte e më në fund kthehej e thoshte:

— A ta them një fjalë, se vij nga kooperativa...

— Jo, s'dua! — e dysHEMEJA rënkonte nën peshën e rëndë të trupit të Musait.

Dita e shënuar për ngritjen e kooperativës erdhi. Me mëngjes herët, te gorrice në mes të fshatit gjëmoi daullja dhe piskati gërneta. Njëpër oborret e pas gardheve zbardhën takijet e burrave e lëveret e grave. Fëmijët u nisën me dhen e me dhi tatëpjetë varosheve të mbuluara akoma në mjegull.

Vetëm pahia e Tapillarëve nuk krikëlliu. Fqinjët hidhnin vështrimin herë pas here dhe prisnin. Ata prisnin Shaqirin t'i printe në kuvend. Por atje s'dukej asgjë përveç Balos që hipte e zbriste njëpër shkallët e drunjtat me një të kuisur plot vajtim. Ishte e qartë: diçka po ndodhte aty atë mëngjes.

Befas u dëgjua një britmë. Ky ishte zëri i Musait. Pastaj u hap një kanat dhe në oborr u hodhën disa bohçe me plaçka. Piskati klithma e plakës. Dera e shkallëve u hap prapë dhe arka e bukur e nusërisë, që kishte sjellë me vete Hyria, u rrokullis tatëpjetë.

— Bir! — klithi plaka. — Na fëlliqe! Nuk përzihet nusia që s'ka mbushur as shtatë ditë te burri!

— Ajo cipëplatur të punojë fshehurazi për ngritjen e kooperativës! A? Po kësaj, ç'i thua ti, nënoke!


— Bir!

— Lëshomë! Nuk më lipset një grua e tillë!

— Mos fol kështu! Vetë e more, me dashuri! — u dëgjua një zë tjetër brenda konaqeve.

— Dijeni, pra, se paskam futur gjarprin në gji, — përplasi këmbët Musai dhe u lëshua pas arkës, që rrokullisej e çartallosur njëpër oborr.

— Ik! Ik! Shporru në kooperativën tënde! Unë do të jetoj siç ma do qejfi!



Në majë të shkallëve u duk Hyria, me duar pas belit, si t'i thoshte të shoqit: «Eja, në ta mban!»

Musai u shkërrit dhe klithi duke rrahur shojet e opin-gave pas dërrasave të vjetra të shkallëve.

— Shporru, të them, se të copëtova!

— Shporru ti, nga sytë këmbët, — ia priti ajo. — Unë s'luaj prej këtej.

— Dhe kooperativën do ta ngremë! — gjëmoi zëri i Shaqirit, që u lëshua tatëpjetë shkallëve dhe qëndroi pranë të vëllait.

Musai përpëliti sytë, u zverdh e diç deshi të fliste, por i vëllai e la me fjalë në gojë, u hodh te dera e katoit, nxori qetë dhe i vuri përpara.

Musai klithi, rrëmbeu sëpatën nën qoshk dhe u lëshua pas të vëllait. I ndjekur nga Musai, zuri vend pas qeve, të cilat mbllaçiteshin duke vështruar në qetësi, me sytë e tyre të vagëlluar, dy vëllezërit që u vinin rrotull.

— Lëshoje sëpatën, se do të pendohesh!

— Hiq dorë nga kooperativa!

— Mos e gënje veten. Unë nuk e kthej mendjen nga frika e sëpatës sate.

Dy vëllezërit bërtisnin e vraponin duke marrë nëpër këmbë ç'të gjenin: kosha, kanistra, squkën me gjithë zogj, kovën e pusit. Musai dridhej i tëri: i zverdhur, me sytë e skuqur e të çakërritur, tundte sëpatën mbi kokë dhe vraponte pas të vëllait, sa i hanin këmbët. Baloja lehte duke vrapuar edhe ai pas të zotërve, pa kuptuar gjë.

Plaka u mek në mes të oborrit.

Fëmijët e Shaqirit u varën pas shallvareve të t'et. Musai u lëshua përpara, ndërsa Shaqiri, i penguar nga fëmijët, u gozhdua në vend. Deshi të mbrohej, shikoi mos i zinte syri gjëkafshë, u përpoq të shkulte çikrikun e pusit por tashmë ishte tepër vonë. Teju i sëpatës iu ngrit mbi kokë. Instinktivisht mbylli sytë dhe mbuloi fëmijët me trup.

Atë çast u dëgjua një zë gruaje:

— Qëndro, se të vrava!

Shaqiri hapi sytë dhe shikoi para vetes trupin e gjatë të Hyries, tek dridhej e tëra, dhe grykën e çiftes në gjoksin

e të shoqit. Musai shtangu. Nishani i zi në mjekrën e Hyries ishte zbardhur si një kokërr rruazë e madhe.

— Hidhe sëpatën, — e urdhëroi ajo. — Mos kujton se për hatrin tënd do të shkel gjakun e dy vëllezërve që m'u vranë në Luftë! A?... Po s'të pëlqeu kooperativa, s'të detyron njeri: merr pjesën tënde dhe këput qafën! Vendi im është këtu!

Musai zhgërryejti këmbët, shikoi prapa gardhit, ku njerëzia po vraponin, briti:

— Ah, më fëlliqi gruaja! — dhe shpejtoi drejt pahisë. Me një të goditur e hodhi llozin përtej dhe u lëshua tatë-pjetë kodrës, duke kafshuar bishtin e sëpatës e duke lëshuar klithma dëshpërimi nga turpi që i ngrehu e shoqja.

Hyria hodhi çiften dhe u lëshua pas të shoqit.

— Musa, xhan, Musa, shpirt, kthehu!

Por Musai u bë erë: kaloi përruan dhe u fut në pyll. Lëverja e Hyries zbardhi në mes të dushqeve dhe zëri i saj jehoi:

— Musa! Kthehu, Musa-a-a! Xhan!

... Hyria u kthye pas një ore, e lodhur dhe e shkalafitur. Oborri i Tapillarëve ishte mbushur me burra e me gra, që nduknin faqet. Hyria qëndroi një çast për t'u mbushur me frymë, pastaj mblodhi plaçkat e nusërisë dhe ngjiti shkallët në heshtje. Pas pak u duk te dera, e krehur dhe e ndërruar. Foli:

— Gra, ejani pas meje!

Të parat që zunë hijen e gorricës atë mëngjes, qenë gratë.

Daullja dhe gërneta jehuan përsëri.

... Shokët e Musait zbritën disa herë në qytet dhe e takuan. Njëherë i thanë se në kooperativë ishin futur më se gjysma e fshatit. Njëherë tjetër i numëruan me gisht ata që kishin mbetur jashtë. Në krye të vitit i thanë se i tërë fshati që futur në kooperativë, se e shoqja punonte si brigadiere dhe i vëllai kryetar.

— Nderi e kërkon të kthehesh pranë shtëpisë. Djali t'u bë tre muajsh, Hyria të pret.

Musai:

— Jo, s'kthehem!

E megjithëse ai dëgjonte dita-ditës se të tërë qenë futur në kooperativë, se jeta ishte zbukuruar, e megjithëse ishte i bindur se e shoqja bëri shumë mirë që i vuri çiften në gjoks e s'la ta vriste të vëllanë, prapëseprapë s'i bënin këmbët të merrte të përpjetën e të kthehej në fshat.

— Jo, s'kthehem! Nuk e dua as kooperativën, as gruan! — murmuriste dhe sytë i visheshin nga malli për të parë Hyrien, nga dëshira për të parë djalin, që, siç i thanë, i kishte prerë kokën të atit.

— Jo, s'kthehem! — përgjigjej plot dyzime për kooperativën dhe i leckosur, i përmalluar bredh edhe sot e kësaj dite me sëpatën në njërin sup e me sharrën në supin tjetër.

Mësuesja tha:

— Këtu shkrintari i jep fund tregimit. Tani të gjykojmë Hyrien dhe Musanë.

Druvari u shkund, si të zgjohej nga një ëndërr e keqe dhe u platit më shumë pas derës. Për gjithë sa dëgjoi, diç i qe dukur e saktë, diç jo. Edhe ai vetë bile s'ishte në gjendje të krijonte gjithçka, ashtu si kishte ngjarë. Po, megjithatë, ndonëse emrat ishin ndryshuar, ai u bind se mësuesja kishte lexuar për të dhe se ai kishte parë vetveten-si në pasqyrë.

— Çfarë nxjerrim nga ky tregim? — pyeti mësuesja.

— Zushë!

— Zushë, ta them unë! — nisën fëmijët t'ia merrnin fjalën njëri-tjetrit.

— Unë, zushë, them kështu... Musai është fshatar i prapambetur, kurse e shoqja, Hyria, është grua përparimtare... — Nxënësi foli një copë herë, ai shau dhe përbuzi Musanë, Musanë që la fshat e grua dhe u bë druvar; dhe druvarit që rrinte pas derës fjala e çunakut iu duk tërkuzë, një tërkuzë e gjatë, shumë e gjatë, që i mbështillej vazhdimisht rreth trupit e grykës.

— Medet, ç'më paska gjetur! — murmuriti me zë. — Punën time e ditka një botë e tërë! Bah!

Një mëngjes, kur turma larushe vërshonte tatëpjetë rrugës «Qemal Stafa» për të shkuar në zyrë, druvari ynë

ishte futur në mes të saj dhe ecte bashkë me të, si i shtyrë nga një fuqi e padukshme. Mbi sup mbante, si zakonisht, sharrën dhe sëpatën.

Pranë qendrës turma u pakësua, njerëzit u futën në ministritë, disa shkuan më tej. Druvari, i rruar dhe i larë çau përmes bulevardit të gjerë me çapin drejt stacionit të trenit...

— O druvar! Druvar-o-o! — u dëgjua zëri tingëllues i një gruaje.

Kësaj radhe druvari nuk kërceu si zakonisht ndanë rrugës, po foli rëndë, pa e kthyer fare kokën:

— S'jam druvar, moj, shoqe!

— Po ç'je? — u çudit e panjohura.

— Kooperativist.

— Kooperativist i orës së fundit! — u tall një çunak që u ndodh aty pranë.

— Jo, nga të parët fare! — e gënjeu ai dhe vazhdoi rrugën...

1963

**ALQI KRISTO**

## HEROINA

E deleguara mbajti një fjalim të gjatë. Pastaj diskutuan të rinjtë, Foli dhe Mrica, një nuse e zgjuar dhe energjike. Fjalët e saj, që dukej se dilnin nga thellësia e shpirtit, kishin një forcë të madhe dhe një sinqeritet që të bënte për vetë. Ajo fliste lirisht, me një intuitë politike të qartë e të përpiktë. E deleguara u habit me shkathtësinë dhe zgjuarsinë e saj.

Bëhej mbledhje për të zgjedhur sekretarin e organizatës së rinisë. U bënë shumë propozime e debate, po emri i Mricës qëndroi në krye të listës. Kur u hodh në votë, të rinjtë e zgjodhën atë sekretare, me porosi që të mëson-te shkrim e këndim.

Kjo bëri bujë në fshat. Ai fshat nuk kishte shumë kohë që ishte çliruar dhe njerëzit jetonin ende me zakonet e vjetra të së kaluarës. Ata mezi i lejonin të rejtat të merrnin pjesë në mbledhje dhe nuk u bëri përshtypje të mirë zgjedhja e një nuseje në krye të organizatës së rinisë.

Kur u kthye Mrica në shtëpi, e gjeti të vjehrrën që po gërricte faqet. I erdhi keq për atë grua të urtë dhe të dashur dhe u mundua ta merrte me të mirë. Po ajo ishte bërë pikë e vrer.

— Na korite, hej, të vraftë shën Ndou, — i tha.

Ajo nuk i ishte drejtuar kurrë së resë me të tilla fjalë.

— Dëgjomë njëherë, — u lut nusja, — vetëm dëgjomë, pastaj vramë, po deshe.

Po plaka nuk e dëgjonte. Ajo qante dhe çirte faqet.

Mendonte se ishte bërë një turp i madh, që kishte përmbysur gjithë nderin dhe harmoninë e familjes.

Në mbrëmje u bë sherr i madh në familjen e Mricës. Plaku i shtëpisë, Gjoka, një fanatik që pinte gjithë ditën duhan dhe mbante kokën lidhur me shami, nuk do ta duronte kurrë të renë të përzihej me djemtë dhe burrat e fshatit për ca punë që binin në kundërshtim të hapur me botëkuptimin e tij. Po ai nuk u zu me të renë. Asaj nuk i foli fare, dhe kjo gjë e trembi më shumë Mricën. Ai i ra së shoqes me shkop në mënyrë të pamëshirshme, sikur ia kishte fajin ajo, dhe plaka e shkretë nuk bëri gëk, po kafshoi buzën e shkoi në dhomën tjetër. Pastaj ai ndenji gjithë ditën këmbëkryq mbi postiqe, duke pirë duhan e duke lëvizur buzët, sikur fjalosej me vete. Priste me padurim të birin që të kthehej nga ara.

Prenga u kthye në të errur. Ai ishte një burrë i ngrysur e i egër, që nuk i qeshte buza kurrë, me ca vetulla të trasha dhe mustaqe të zeza. Ai nxehej shpejt e reagoonte me ashpërsi. Plaku e thirri veçan dhe seç i tha me zë të ulët. Mrica u mundua të merrte vesh se çfarë biseduan e çfarë vendosën ata të dy, po nuk kuptoi asgjë. Sidoqoftë ajo e kuptoi se i vjehri kërkonte ta kryente punën me dorën e të birit.

Atë natë nuk hëngrën darkë. Shkuan për të fjetur pa folur, sikur u kishte vdekur njeri. Prenga hyri në dhomë duke përpjekur derën. Ai shfryu si buall dhe përplasi përdehe një gjë të rëndë. Mrica e vështroi me frikë. Ai kishte sjellë me vete litarin e mushkës.

- Përse e ke sjellë atë?, — pyeti ajo.
- Për ty, — u përgjigj Prenga, ballëvrenjtur.
- Ç'do të më bësh?
- Pse vajte në mbledhje pa lejën time?
- Ti ishe në fushë, ku të të gjeja?
- Po pse u zgjodhe ti?
- Më zgjodhën ata. Ç'faj kam unë?
- Unë të mbys, — tha Prenga, duke treguar hallkën me të dy çipirokët.

Mrica iu përgjigj atij kërcënimi me qëndrim krenar. Ajo nuk u tremb e nuk e uli kokën. Ishte e bindur se nuk ki-

shte bërë asgjë të keqe. Bile ajo i mbante mend mirë fjalët që kishte thënë e deleguara, se zhdukja e zakoneve prapanike do të bëhej me përpjekje e lufë. Dhe ja, ajo e kishte filluar këtë luftë me pjesëtarët e familjes së vet.

Prenga mori litarin dhe e kapi gruan nga krahët për ta lidhur. E shoqja kërceu përpjetë dhe thirri:

— Mos më prek!

— Si? Guxon të kundërshtosh dhe burrin?

Ai po i afrohej me fytyrë të ngërdheshur dhe me ca hapa të shkurtrë e të ngadalshëm, si ata të egërsirës që bëhet gati të vërvitet mbi prenë e vet. Mrica e pa keq; mendoi se ai, me atë zemërim që kishte, mund ta mbyste me të vërtetë dhe iu drodh zemra. Ajo ishte grua dhe nuk do t'i bënte dot ballë forcës së burrit. Instinkti i vetëmbrojtjes e mësoi në çast se si të shpëtonte nga ai rrezik dhe vendosi t'i fliste me të urtë. Mendoi t'u bënte thirrje ndjenjave të bashkëshortit dhe të prindit të ardhshëm.

— Oh, Prengë!, — tha ajo me zë të dredhur. — Përse më afrohesh kështu? Ç'ke në mend të bësh?

— Shtrigë!

— Unë jam gruaja jote, — vazhdoi ajo. — Jam njeriu yt më i afërt, Ne jemi një trup e një shpirt, o i mjerë.

— Mjaft!

— Unë jam shtatzënë dhe po rris në trupin tim pinjollin tënd, gjakun tënd. Po të më prekësh mua, ke prekur tët bir, ke prekur veten tënde. Ne duhet të merremi vesh me të mirë.

— Pse nuk më bindesh mua?

— Të bindem, kur të kesh të drejtë.

Ajo iu afrua me guxim t'i hidhte duart në qafë, po ai e shtyu. Megjithatë ajo shtytje ishte e dobët dhe e lehtë. Prengës iu prenë fuqitë për ta zbatuar atë që kishte nisur. Muskulatura e tij u zbut dhe tiparet e fytyrës iu qetësuan. Ai uli kokën, i ra litarit me shqelm dhe tha:

— Kam mbi krye gjithë katundin.

— E di, — u përgjigj Mrica.

— Atëherë pse nuk më pyete?

— Ti nuk ishe këtu.

— Mos shko herë tjetër në mbledhje!



— Pse ke frikë nga mbledhja?, — pyeti ajo. — Atje fliten gjëra të bukura. Eja t'i dëgjosh, po deshe.

— Ç'gjëra?  
— Për kurset kundër analfabetizmit, për hapjen e shkollës, për pastërtinë e trupit, për jetën e re...

— Mjaft!, — bërtiti Prenga, duke u kthyer nga ajo. — Unë nuk e dua kooperativën.

— Thonë se është e mirë, — tha ajo.

— Pusho! Ti je gruaja ime dhe do të bësh si të them unë. Nuk e koris unë këtë faqe, — dhe i ra faqes së tij me shpullë aq fort, sa Mrica u drodh e ndjeu dhembje si në faqen e saj.

Ajo e kuptoi se ai vuante, dhe qëndrimi i tij nuk ishte një tekë e rastit, po një bindje e ndërgjegjshme, një forcë e zakonit të vjetër të asaj shoqërie të prapambetur, që i kishte hyrë thellë në shpirt dhe e kishte bërë skllav. Prandaj ajo iu kthye përsëri me të urtë.

— Kjo është çështje jete, — tha ajo. — Partia po na tregon një rrugë të re, dhe ne duhet ta ndjekim për të mirën tonë. Ne duhet të luftojmë të dy bashkë për një jetë më të mirë, për vete dhe për fëmijët tanë, — dhe vuri dorën në bark për të treguar fëmijën.

— Ti do të bësh si them unë, — turfulloi Prenga, — se, ndryshe, të mbys!

Gruaja heshti. Ajo ishte e kënaqur që neutralizoi egërsinë e të shoqit, paçka se nuk e bindi. Lisi nuk mund të pritej me një sëpatë. Ajo do të bisedonte me të përsëri e përsëri, derisa t'i mbushte mendjen.

Prenga hoqi rripin e gjatë që kishte mbështjellë rreth belit, zbathi tirqtë dhe hyri në dyshek. Pas tij filloi të zhvishej dhe Mrica. Ata pranuan të dy që problemi të mbetej i pazgjidhur.

Muajt kaluan me luftë opinionesh dhe Mrica u bë nënë. Lindi një vajzë, të bardhë e të bukur si veten. Kjo lindje i gëzoi të dyja palët. Mrica mendoi se pozita e saj në familje do të forcohej dhe ajo do të ishte më e lirë të punonte për organizatën e rinisë. Familja mendoi të kundërtën, se ajo do t'i kishte këmbët të lidhura dhe nuk do të kishte kohë të merrej me punët e fshatit.

Kur bënë pagëzimin e vajzës dhe i vunë një emër të bukur, Gjeta, ata shtruan një drekë të madhe, ku mori pjesë edhe prifti i Shënandout, dom Pjetri. Në këtë gosti familjare binin në sy disa pleq të fisit, me mendje të mykur, dhe disa burra të pushkës që kishin marrë pjesë, përpara Çlirimit, në çetat e bajraktarëve. Në krye të sofrës rrinte dom Pjetri, i dalluar nga uniforma e tij fetare, nga fytyra gjysmë e rruar dhe e ngjallur, nga autoriteti i padiskutueshëm dhe nga fjalët e mençura e të prera që thoshte, sikur i kishte dekretuar vetë zoti.

Ata flisnin lirshëm për punët e fshatit, për ligjet e reja të Partisë, bile edhe për «Komitetin e Maleve», që përmblihte të gjitha forcat reaksionare që ishin shpartalluar nga partizanët dhe ishin strukur nëpër male. Prifti bëri si bëri dhe e solli fjalën atje ku donte.

— Shqiptari s'bëhet kurrë komunist, — tha ai.

— Nuk bëhet, — pohoi një plak i dobët, që pinte duhan me llullë.

— Na thonë se do të bashkojmë tokat, kafshët dhe të punojmë së bashku, — tha i zoti i shtëpisë, Gjoka, që dukej si dele e bardhë, se ishte thinjur, me vetulla, me mustaqe, më mjekër.

— Mirë që s'na thonë të bashkojmë dhe gratë, — shtoi një kapadai me revole në brez që e thërrisnin Dodë.

Ata u shkulën së qeshuri duke vështruar priftin që zgërdhihej sikur qante dhe i mbante të dyja duart në ije.

— Duan të na i prishin të gjitha, — tha dom Pjetri, pasi mbaroi së qeshuri dhe pasi kapërdui një llokmë mishi të pjekur. — Edhe ekonominë, edhe familjen, edhe zakonet, edhe fenë. Po zoti nuk thotë ashtu. Shqiptari nuk mund të rrojë pa fe e pa familje, se ato i ka të shtrenjta si atdheun.

Mrica, që hynte e dilte në dhomën e burrave duke u shërbyer, i dëgjonte këto biseda copa-copa dhe i lidhte me mendje duke nxjerrë kuptimin e tyre të plotë. Nganjëherë qëndronte me tabaka në dorë për t'i dëgjuar më mirë, ose për të gjetur rast të ndërhynte në ndonjë mënyrë, megjithëse këtë e kishte të vështirë. I shoqi, që rrinte më gjunjë andej nga fundi për t'u shërbyer më të mëdhenjve, i ndi-

ente këto fjalë dhe vriste mendjen se si do t'ia mblidhte rripat së shoqes që ishte lidhur me komunistët.

— Fenë nuk na e shkuli dot turku, — tha Gjoka.

— Hej, ty të lumtë, — u përgjigj prifti. — Do të rrosh më shumë zotnia jote, se ma more fjalën nga goja.

— Na janë qepur keq, — tha i zoti i shtëpisë.

— Se u kenë hapur dyert, — u përgjigj dom Pjetri.

— Ç'dyer, ne?

— Po, po, ju. Këtu flisni bukur, po përpara komunistëve i vini kyçin gojës.

— Unë jo, — tha Gjoka duke ngrënë një copë hallvë.

Priftit i erdhi lepuri në shteg. Ai donte ta nxirrte fjalën te Mrica dhe tha:

— Po ti je plak, more i shkretë, dhe nuk shikon se ç'bëhet rreth e rrotull teje.

— Unë?, — tha Gjoka, që nuk e kuptoi se ku qëllonte prifti.

— Ti, ti.

— Ku e ke hallin?

— Kam dëgjuar se do të hysh në organizatën e rinisë, — tha prifti dhe qeshi me djallëzi.

Gjoka e kuptoi dhe u nxi në fytyrë. Prengës iu përpëliti zemra. Pothuajse të gjithë ata që ndodheshin në sofër e kuptuan se ku e kishte fjalën prifti. Mrica, që atë kohë i solli priftit një gotë me ujë, priti sa e piu dhe tha:

— Organizata e rinisë lufton për një jetë të re, dom Pjetër, prandaj mos hyr në punët e saj, se bie në gjynah.

Kjo ishte një ndërhyrje e papritur. Të gjithë ngritën kryet drejt saj dhe e vështruan me habi se ku e gjeti ajo atë guxim për të marrë pjesë në kuvendin e burrave e për t'i kthyer fjalën më të madhit të tyre. Mrica nuk u tremb nga ato vështrime dhe vazhdoi:

— Përfaqësuesi i zotit le të shikojë punët e fesë. Në goftë se nuk i pëlqejnë punët tona, atëherë le ta kundërshtojë vetë vijën e Partisë e jo të shtyjë të tjerët t'ia nxjerrin gështenjat nga zjarri. Mos i gënje robt e zotit...

— Mjaft!, — bërtiti plaku i shtëpisë, Gjoka, duke u ngritur në këmbë.

Prifti mbeti si i ngurrosur. Të gjithë shtangën në vend

së nuk kishin dëgjuar ndonjëherë një grua që t'u kundërshtonte burrave. Mrica u largua pa u ngutur, me gotat e ujit, dhe hyri në dhomën tjetër. I shoqi e ndoqi prapa.

— Mos!, — bërtiti plaku, që nuk donte të prishej qetësia e miqve.

— Kanë ardhur kohë të këqija, bre burra, — tha Doda, që u tërhoq nga sofrë e nxori deshpiket.

— Na u tërbuan gratë, — tha një tjetër.

— Grave u duhet treguar vendi që u ka caktuar zoti, — shtoi dom Pjetri.

Në mbrëmje plaku pinte duhan e mendohej. Nuk donte të hante darkë. Rrinte i pikëlluar e i mërzhitur sikur i kishte rënë gjëma mbi krye. Prenga u ngrit për të fjetur. Plaku tha:

— Ti s'passe qenë burrë, more edepsëz!

Prenga as që kishte nevojë për atë nxitje. Ai ishte bërë si i xhindosur dhe e kishte menduar më parë se si do të vepronte. Hyri në dhomë duke folur me vete, gjë që e bente gjithmonë kur ishte i zemëruar. Mrica i jepte gjë fëmijës.

— Ngrehu!, — urdhëroi ai.

— Prit, — tha nusja, — nuk e shikon ç'po bëj?

— Ngrehu, po të them!, — ulëriti Prenga me zë të egër dhe e ngriti të shoqen me të dyja duart, sikur do ta shqyente.

Fëmija, që e lëshoi gjirin para kohe, filloi të qante.

— Ç'bën kështu, more Prengë, nuk të vjen keq për fëmijën?

— Më ke koritë në mes të burrave, — tha Prenga.

— Burri nuk koritet nga fjalët e Partisë, — ia priti Mrica me qortim.

— Më ke koritë, — përsëriti ai, duke thirrur edhe më fort. — A e dëgjovë se ç'tha dom Pjetri?

— Dom Pjetri është armik, — tha Mrica.

Prenga hapi krahun e gjatë dhe me dorën që e kishte si shputë ariu, e goditi aq fort, sa e rrëzoi përdhe. Pastaj u hodh mbi të si shqiponjë dhe, duke e sharë me fjalë të ndyra, e rrahu sa u ngop, me grushta dhe me shqelma, pa vënë re se ku i binte, në trup, në kokë, në fytyrë. Ajo e

duroi pa bërë gëk. Po, kur pa gjakun që i lagu duart, instinkti i vetëmbrojtjes e çoi peshë dhe i dha të shoqit një të shtyrë, sa u shkëput prej tij dhe rrëmbeu fëmijën për t'u mbrojtur.

Prenga mezi mbante zemërimin, kurse Mrica mudohej të pushonte gjakun që i rridhte nga hundët. Pasi kaluan disa minuta, ai tha:

— E kuptove tani se ç'të bën burri?

— S'ke turp!, — tha Mrica. — I tregon forcën gruas!

— Mjaft, gjarpër!

— Nuk ke të drejtë të më rrahësh.

— Mjaft, se do të të rrah prapë!

— Tani nuk është koha e parë. Druri është i ndaluar me ligj.

— Me ligjet e komunistëve.

— Nuk e di ti se, po të të padis, të fusin në burg?

— Padit, padit, po deshe!

Kaluan disa ditë që Mrica nuk doli nga shtëpia, se kishte në fytyrë shenjat e rrahjes.

Pasi mbaronte punët e shtëpisë, mbyllej në dhomën e vet, përpara dritares me drurë të kryqëzuar e të gdhendur dhe mendohej për fatin e saj. Jeta i dukej e rëndë dhe e paduruar në atë familje patriarkale. Ajo kishte një pasion të zjarrtë për të punuar me rininë, dhe kjo e shtynte të mos i përfillte rreziqet e jetës familjare. Ajo ishte lidhur me punën e rinisë që kur ishte në fshatin e saj, përpara se të martohej. Ishte e vogël atëherë dhe i kujtonte me mall ato shoqet partizane që e kishin tërhequr në punën me rininë.

Asaj i kujtohej fare mirë beteja e përgjakshme që ishte zhvilluar ato ditë midis Brigadës së Parë dhe forcave gjermane e mercenare që sundonin krahinën. Pas kësaj beteje kishin vërshuar partizanët. Vajza kishte marrë pjesë në një mbledhje të gjerë, në festën e çlirimit të kësaj tundi, me fjalime dhe këngë. Ajo nuk kishte parë ndonjëherë aq shumë njerëz dhe ishte çuditur me forcën e partizanëve, me armët e tyre, me veshjen, me yjet dhe ca më shumë me dy vajza të reja, që ishin armatosur me automatikë e ishin veshur me pantallona, si djemtë.

Mricën e kishin tërhequr si magnet ato vajza dhe i kishte marrë e i kishte strehuar në shtëpinë e vet. Atje ishte bërë si motër me Lulen, nga e cila dëgjonte përditë fjalë të bukura e të çuditshme, që nuk i kishte dëgjuar ndonjëherë. Ajo i kishte folur për Partinë, për organizatën e rinisë dhe për një jetë më të bukur, e kishte tërhequr në punët shoqërore dhe Mrica ishte bërë aktiviste e dalluar.

Tani ajo nuk shkëputej dot nga puna e rinisë dhe mendohej t'i kapërcente pengesat me durim e këmbëngulje.

Një ditë atë e thirrën në mbledhje. Kishte ardhur Lulja si e deleguar e komitetit të rinisë për një punë shumë të rëndësishme. Mrica rrinte si gjithmonë në dhomën e saj, përpëra dritares me drurë të kryqëzuar e të gdhendur. Ajo e dëgjoi të vjehrrën kur tha: «Mrica nuk është këtu», — dhe donte të përgjigjej vetë, po nuk u përgjigj. I vinte rëndë të dilte ashtu, me fytyrë të nxirë nga goditjet, po dëshira për të vajtur në mbledhje e kapërcente këtë druajtje. Hoqi pasqyrën e llampës dhe pa fytyrën. Në nofullën e djathtë kishte ende një shenjë të zezë.

«Do të dal», — tha me vete. Nxori fustanin nga sënduku dhe e hodhi përsëri brenda. «Po Prenga ç'do të bëjë? Oh, Prenga! Ai do të tërbohohet që dola me shenjat e rrahjes», — E mori përsëri fustanin dhe e veshi me nxitim. «Le të tërbohohet!» — Vajza flinte e qetë, e lidhur në djep. Mrica hodhi sytë nga dritarja dhe vuri re natyrën, që kishte veshur pëtkun e pranverës. Dielli i prillit ishte i ngrohtë. Disa shqerra bridhnin të gëzuara në një lëndinë të mbuluar me bar.

Një zë i njohur i thirri nga ana e përtejme:

— Mrica! Mrica!

Asaj ia përshkoi trupin një rrëqethje si korent. Ajo ishte sekretare e organizatës së rinisë dhe duhej të kishte vajtur në mbledhje e para. Si mund të rrinte ajo në shtëpi e mbyllur si në kafaz? Ajo nuk ishte skllavë. Le të tërbohohet Prenga! Le ta rrihte, le të bënte ç'të donte! Ajo duhej të vinte në mbledhje. Dhe u ngrit, mbathi këpucët e doli jashtë. Në oborr gjeti plakun, që ngrohej në diell i shtruar këmbëkryq mbi një postiqe prej dhie. Ai pinte duhan dhe numëronte trespiket.

— Ku do të shkosh?, — e pyeti.

— Në mbledhje, — u përgjigj Mrica me ton të vendosur, që nuk pranonte ndërhyrje.

— Mos shko, — tha plaku.

— Do të vete!

— Do të të rrahë Prenga.

— Le të më rrahë.

Çeli trinën e ndërtuar me kopaçe lisi të çara dhe u zhduk në rrugën plot pluhur.

Kur u kthye në shtëpi, Mrica ishte e gëzuar dhe e tronditur. Në mbledhje e kishin ngarkuar të formonte grupin e të rinjve dhe të rejave vullnetare që do të merrnin pjesë në ndërtimin e hekurudhës. Ajo ishte krenare që i kishin besuar atë detyrë, po mendonte dhe vështirësitë. Ajo duhej të jepte vetë shembullin personal dhe të vinte emrin e saj në krye të listës. Dëshironte me gjithë zemër të shkonte në hekurudhë, të zinte shoqëri të re, të shikonte një botë tjetër, të takohej me njerëz të krahinave të ndryshme dhe të njihje jetën, mendimet, sjelljet, veshjet e tyre dhe të mësonte gjëra të reja e të panjohura. Ajo do të shikonte atje trena, makina, radio, detin, fushat që nuk i kishte parë kurrë, se kurrë nuk ishte larguar ndonjëherë përtej kufijve të atyre fshatrave malore, ku nuk kishte shkelur as rrota e qerres. E deleguara i kishte thënë se në hekurudhë do të mësonin edhe shkrim e lexim dhe kjo ia kishte ngritur mendjen më shumë, se ishte e djegur për të mësuar ato shkronja të çuditshme, të cilat do t'i jepnin mundësi të lexonte gazetën, që tani vinte çdo ditë në fshat. Kjo do të punonte atje, do të punonte më shumë se të gjitha, vetëm të shkonte në hekurudhë dhe të ndahej për disa kohë nga ai ambient i rëndë e i paduruar i asaj jete familjare. Ajo e dinte se Prenga nuk do ta lejonte kurrë të shkonte në hekurudhë. Ai do ta rrihte, do ta kërcënonte, po ajo do të shkonte pa dëshirën e tij. Papritur i shkrepri një ide e frikshme. Po sikur ta vriste? Ishte i egër Prenga dhe pa shpirt. Po, po, mund ta vriste. Ajo kujtoi fëmijën dhe iu drodh zemra. Kush do ta rriste Gjetën e vogël sikur të vdiste ajo? Shqyrtoi dhe mundësinë tjetër, që t'i bindej Prengës.

Po iu duk më e rëndë të tradhtonte shoqet dhe Partinë, sesa të vdiste.

Kishte vendosur të përballonte çdo pengesë, po mënyrën se si do ta përballonte forcën e burrit, nuk e kishte gjetur. Mendoi se nuk duhej ta lejonte të shoqin ta rrihte. Do ta denonconte në polici, që të çuditej e tërë krahina. Le ta ndante, po të mos e donte, po jo ta rrihte.

Padashur iu kujtua një bisedë intime që kishte bërë një ditë me Lulen dhe me atë shoqen tjetër, Besën, që kishte qenë më parë e martuar, po ishte ndarë, se nuk shkonte mirë me burrin. Çudi e madhe! Ajo ishte vajzë e mirë dhe, megjithatë, ishte ndarë nga burri.

— Të rrihtë?, — e kishte pyetur Mrica.

— Jo, — i ishte përgjigjur ajo.

— Po atëherë?

— Nuk shkonim mirë, pra, ziheshim.

— Për këtë u ndatë?

— Sigurisht. Nuk kalohet jeta kur s'merresh vesh me burrin.

Këto fjalë i kumbonin në vesh si një thirrje e largët, që i tregonin një rrugë të re e të çuditshme. Edhe ajo nuk shkonte mirë me burrin, edhe ajo donte ta ndante, bile për arsye më të forta. Po si ta ndante? Si mund të shkëputej prej tij?

U ul te vendi i saj i preferuar, përpara dritares me kangjella druri të gdhendurë e të kryqëzuara. Gjeta e vogël, lidhur në djep, guiste e belbëzonte dhe Mricës i këputej shpirti që do të ndahej prej saj. Në faqen e kodrës, përtej përroit, në sheshet e mbuluara me bar të njomë, duke-shin dhentë e fshatit që kullosnin dhe shqerrat që luanin e blegërinin duke kërkuar nënat.

Mrica mendohej e mërzitur. Një lëmsh që i ishte mbledhur në grykë nuk e linte të merrte frymë dhe i vinte për të qarë. Tani e kuptonte se nuk e kishte gjetur shokun e përshtatshëm, me të cilin kishte lidhur jetën dhe mallëkonite ditën që ishte martuar me Prengën.

Kush ia kishte gjetur atë burrë? Ajo nuk dinte asgjë. Ajo nuk e kishte njohur kurrë Prengën përpara se të martohej. Atë ia kishte lëvduar nëna dhe ajo e kishte pra-



nuar. Jo, nuk e kishte pranuar. Ajo nuk e kishte kuptuar fare se si ishte zhvilluar ai proces i çuditshëm që e transformoi jetën e një vajze nga një fëmijë e qetë, e përkëdhelur e naive, në një grua shtëpiake me detyra të mëdha. Ajo nuk kishte bërë asgjë në këtë proces, bile nuk kishte marrë pjesë fare. Çdo gjë e kishin bërë duart dhe mendjet e të tjerëve dhe ajo vetëm sa kishte lëvizur këmbët në mënyrë të pavetëdijshme andej nga e kishin shtyrë ata, si ato kukullat e skenës që i lëviz aktori me spango.

Një ditë ajo kishte parë si u mbush oborri me krushq. E kishin veshur me rroba të reja dhe e kishin mbuluar me duvak të kuq. E nxorën për krahu nga shtëpia si me pahir dhe e hipën në një kalë të bardhë. Të gjithë këndonin e kërcenin dhe zbraznin pushkë nga gëzimi, kurse asaj i vinte për të qarë. Kali eci disa orë dhe e shpuri në shtëpinë e burrit, të cilin nuk e njihte. Ajo eci përsëri si kukull andej nga e shtynë dhe bënte siç i thoshin. Kur erdhi prifti e i vuri kurorë, ajo nuk guxoi ta vështronte të shoqin se çfarë njeriu ishte, po e ndjeu, kur rrinte pranë tij, se ai ishte një pëllëmbë më i gjatë.

Mrica e shikonte të kaluarën e saj si në film. Sikur të kishte pasur atëherë këtë mendje që kishte tani, ajo nuk do të kishte pranuar kurrë ta mernte burrin si derrin në thes. Po atëherë ajo nuk dinte si të sillej dhe nuk kishte guxim t'i kundërshtonte zakonet e vjetra të martesës.

Mrica nuk i tregoi të shoqit që kishte vendosur të shkonte në hekurudhë. U mat shumë herë t'ia thoshte, po nuk guxoi. Pas dy ditësh Prenga u zhduk nga shtëpia. Tha se do të shkonte në dasmë, në një fshat të largët. Po java kaloi dhe ai nuk u kthye. Nusja u bë merak, kurse prindët ishin të qetë. Atëherë ajo e kuptoi se Prenga e kishte gënjyer. Ai nuk kishte vajtur në dasmë. Ku kishte vajtur, vallë?

Sido që të ishte, në mungesë të Prengës ajo e ndiente veten të lirë dhe një pjesë të ditës e kalonte nëpër fshat, duke punuar me ata që duhej të shkonin në hekurudhë. Këtë punë e bënte me shpirt dhe bisedonte jo vetëm me të rinjtë, po edhe me prindët e tyre.

Kur u kthye Prenga, ajo e kishte formuar grupin e

vullnetarëve që do të shkonin në hekurudhë. Ai u kthye në fshat pas përfundimit të diellit. Ishte i lodhur dhe, kur ishte i lodhur, Prenga bëhej më shumë nervoz.

Mrica merrej me fëmijën në odën e gjumit. Ajo ishte kureshtarë të dinte se çfarë do t'i thoshte plaku Prengës dhe mbajti vesh. Ata bisedonin në oborr me zë të ulët.

— Rrihe, — thoshte plaku, — po mos i lër shenjë.

Mrica e dëgjoi, doli te dera dhe tha:

— Nuk po e mëson mirë atë djalë, o baba. Partia e ka ndaluar rrahjen e grave. Po të më prekë, do të vete në polici!

— Rrihe!, — thirri plaku me zemërim.

— Në qoftë se nuk më doni, unë mund të kthehem te nëna.

— E gjallë jo, — tha Gjoka, duke këputur qimet e postiqes nga nervozizmi.

— Ti je gruaja ime, — shtoi Prenga. — Do të bëj ç'të dua me ty!

— Unë nuk jam skllave, — u përgjigj Mrica.

— Ti nuk do të shkosh në hekurudhë!

— Unë nuk ndahem nga shoqet, — tha ajo.

Prenga ngjiti shkallët kokulur e me fytyrë të nxirë. Ai mendohej e dukej i frikshëm. E shoqja e ndoqi me sy hetues. Ai hyri në odë dhe belbëzoi si nëpër dhëmbë:

— Eja brenda!

Nusja ngurroi e nuk vajti. Prenga i hodhi kthetrat në sup dhe e tërhoqi pas vetes.

— Mos më rrih, — tha gruaja, — se do ta pësosh!

— Ti nuk do të shkosh në hekurudhë!

— Çfarë e pandeh hekurudhën ti? Atje kanë shkuar të rinj e të reja nga të gjitha anët e Shqipërisë. Ajo bëhet për të mirën tonë.

— Mjaft! Ti nuk do të shkosh sa të jetë Prenga gjallë!

Mrica nuk foli.

— Kemi urdhër, — tha Prenga.

— Urdhër? — Nga kush?

— Nga «Komiteti i Maleve».

— Ku e di ti?

— Mbrëmë janë shpërndarë trakte.

— Ç'punë kemi ne me «Komitetin e Maleve»?

— Ata do të djegin shtëpitë dhe do të vrasin robt e atyre që do të shkojnë në hekurudhë.

— Këto janë kërcënime, more Prengë, për të sabotuar hekurudhën. Unë do të shkoj me të gjithë të rinjtë e të rejat e katundit.

— Kurrë!, — bërtiti Prenga me sa zë pati dhe e kapi të shoqen për flokësh, e solli rrotull nëpër dhomë dhe e përplasi pas murit. Pastaj e goditi me grushta dhe me shqelma, siç e kishte zakon, derisa e rrëzoi përdhe të alivanosur. Gruaja qëndroi një kohë të gjatë pa ndjenja, dhe Prenga i hodhi ujë për ta përmendur. Pastaj e rrahu prapë, po Mrica qëndroi e paepur.

— Ti mund të më vrasësh, — i tha, — po nga hekurudha nuk më kthen dot!

Atëherë Prenga nxori nga milli një thikë të hollë e të gjatë që e mbante gjithmonë me vete.

— E shikon?, — i tha. — Kjo të pret, po të shkosh në hekurudhë!

Mrica u drodh kur ndjeu majën e thikës që iu mbështet në ije. Ajo nuk mund të hahej me të dhe mendoi t'i dredhonte. Duhej të gjente rrugë tjetër për të zbatuar vendimin e saj.

— Foll!, — tha Prenga.

— Për se?

— Do të heqësh dorë nga hekurudha?

— Sigurisht, derisa është puna kështu...

— Dhe policinë mos ma zër në gojë herë tjetër!

— As ti mos më rrih.

— Po të shkosh në polici, unë arratisem në mal dhe pastaj mjerë ti!

Kur ranë për të fjetur, Mrica mbylli sytë dhe bëri sikur e zuri gjumi. Zemra i punonte me rrahje të shpejta e të forta, po ajo e mbajti veten e u tregua e nënshtruar. Qëndroi në dyshek për një kohë të gjatë, pa lëvizur, me mendje të ngritur e nerva të tendosur. Ai vendim që kishte marrë, kishte të bënte me jetën e saj e të fëmijës. A do të shpëtonte e gjallë? A do t'i dilte gjithçka ashtu siç e kishte parashikuar?

Priti me ankth sa e zuri gjumi të shoqin. Ai kishte gjumë të rëndë. Gërhiste si derr. Mrica lëvizi ngadalë. Mbuloi një jastëk në vend të trupit të vet dhe u ngrit e u vesh me rrobat e reja. Pastaj mori në njëren dorë vajzën e vogël, me zemër të ngrirë se mos i zgjohej e qante dhe në dorën tjetër këpucët, hapi derën ngadalë dhe u zhduk në errësirën e natës.

Arriti në shtëpinë e saj përpara se të gdhihej dhe trokiti në dritare. Nëna mezi u zuri besë veshëve, kur dëgjoi zërin e saj. U ngrit nga shtrati me mundim, se ia kishte mbërthyer gjunjët reumatizmi dhe u tremb tek pa të bijën me fytyrë të prishur.

— Ç'ka ndodhur kështu?, — pyeti me shqetësim.

— Ika, — u përgjigj Mrica.

— Pa lejë?

— Pa lejë.

— Pse?

— Më trajtonte keq.

— Të rrihte?

— Po.

Nëna mori nga duart e së bijës fëmijën, i hoqi shamën në që i mbulonte fytyrën dhe e vështroi me admirim. Pastaj e puthi në ballë e tha:

— Tamam si ti, kur ke qenë e vogël.

E vuri çupëzën mbi minder e i hodhi një mbulesë. Pastaj u kthye nga e bija dhe i tha me ton të butë:

— Ulu, moj bijë, të të bëj një kafe.

Mrica u ul pranë fëmijës dhe filloi të qante.

— Unë nuk të thashë gjë, — tha nëna, — pse qan?

— Qaj për atë që ka ndodhur.

— Po ti nuk ke ikur prej tij përgjithmonë.

— Më duket se nuk jetoj dot me atë njeri.

— E le?

— Nuk e di.

— Nuk lihet burri për rrahje, — tha nëna. — Ashtu rrahin burrat. Edhe mua më ka rrahur yt atë. Eh, ta dish ti si më ka rrahur mua! E shikon këtë? — Ajo ngriti fustanin dhe i tregoi kofshën, atje ku i mungonte një copë mish. — Ai ma ka bërë. Më ka goditur me plor.

— Atëherë ishin kohë të këqija, nënë. Tani nuk rrahin burrat, se nuk i lejon Partia. Ajo na ka dhënë të drejta të barabarta.

— Nuk lihet burri se i godet dora, — ngulte këmbë nëna. — Nganjëherë, ata që i rrahin gratë, i duan më shumë. Rri disa ditë këtu dhe dërgoi fjalë të vijë të të marrë.

— Unë do të shkoj në hekurudhë, — tha Mrica.

— Ku?

— Në hekurudhë.

— Pse?

— Vullnetare, për të punuar. Atje po shkojnë të reja nga gjithë Shqipëria.

— Po Prenga, ç'thotë?

— Ai nuk më lejon, po unë do të vete.

— Hë, hë, për këtë qenke prishur!

— Për këtë.

Mrica nuk i tregoi se Prenga e kishte kërcënuar me thikë, kështu që çështja e tyre, në sy të nënës, mori një pamje të lehtë. Nëna i shtiu kafënë dhe ajo e piu me ëndje se ishte e lodhur dhe e mërzitur. Kafëja sikur e lehtësoi. Përfundimisht zbardhi dita dhe fshatarët filluan të lëshonin bagëtitë, zilet e të cilave tringëllinin nëpër rrugë. Nëna filloi të shkoqte bukë misri për përshesh.

— Si i keni dhënë?, — pyeti Mrica.

— Mirë.

— Kanë qumësht?

— Kanë. Kecat na ngordhën nga të ftohtët.

— Vërtet?

— Vetëm dy më kanë ngelur. Njërin do ta shes për të paguar bariun dhe tjetrin do ta ther kur të vijë Prenga.

Këtu Mrica ishte e lirë. Dilte përditë, takohej me shoqet e u fliste për hekurudhën. Pas disa ditësh ajo krijoi një tjetër grup me vullnetarë dhe u bë gati për t'u nisur edhe vetë.

\*  
\*  
\*

Atë mbrëma ajo mblodhi teshat dhe i futi në bohçe bashkë me disa lëmshe leshi për t'i bërë triko vajzës, të

cilën do ta linte të nëna. Pastaj filloi të gatuante një kulaç për rrugës. Ishte natë. Jashtë binte shi, i cili pikonte me zhurmë në një kazan bakri ku mbledhnin ujë për të larë rroba. Nëna thurte çorape mbi minder dhe e bija detyrohej t'ia përsëriste fjalët nga dy herë, se kishin filluar ta linin veshët. Ajo nuk e dinte sa ishte ora, po këndesin e parë e kishte dëgjuar qëkur.

— Ku do të flini, atje moj bijë, përjashta?, — pyeti nëna.

— Atje do të flemë në krevat, si qytetarët, — u përgjigj Mrica.

— Ku?

— Në krevat.

— Po në ardh të Prenga, ç't'i them?

— Mos ia hap derën.

— Si the?

— Thirr komshinjtë, pastaj t'ia hapësh derën.

— Pse?

— Se mos të të marrë çikën.

— E mjera unë, ç'thua kështu?

Mrica hyri në dhomën e zjarrit për të pjekur kulaçin. Nënës iu rënduan qepallat dhe, sa u ngrit t'i vinte shulin derës, dëgjoi një trokitje nga jashtë. U tremb nga ajo e papritur dhe pyeti me zë të dredhur.

— Kush është?

— Të deleguar të rinisë.

Mrica, sa dëgjoi zhurmë, doli me vrap e thirri:

— Mos e hap!

Ishte tepër vonë. Nëna e kishte hapur. Katër banditë nga çetat e «Komitetit të Maleve» vërshuan brenda si bisha duke shtyrë plakën me bërryla dhe me qyta. Ata hynë në dhomë dhe kërkuan Mricën. Ajo shtangu e tmerruar, me llërët përveshur e me duart me brumë. I pari iu afrua një bandit i gjatë, me mustaqe të zeza e sy të egër. Gruaja e njohu atë fytyrë të urryer. Ishte i shoqi, Prenga.

— Gjarpër!, — tha ai, — ku do të futesh tani?

Ajo i hodhi një vështrim plot urrejtje e krenari dhe tha:

— Unë nuk kam frikë nga vdekja.

— Të shikojmë.

— Mos, Prengë, se do të të varin!

— Ti nuk je grua, je djall!, — tha Prenga.

Ata iu hodhën përsipër, e kapën nga krahët, i lidhën duart prapa dhe i zunë gojën me shami. Pastaj e vunë përpara nën grykat e pushkëve.

— Ku e shpini?, — pyeti plaka.

— Largohu, shtrigë!

— Nuk ju lë, — tha ajo dhe u doli përpara.

Prenga e goditi me qytën e pushkës dhe ajo u rrëzua përdhé pa ndjenja e nuk u ndie e gjallë.

Ata dolën pa zhurmë dhe humbën në errësirën e natës me Mricën në mes. Gjatë rrugës e shtynin, e godisnin dhe e shanin me fjalë të ndyra. Shiu binte me bubullima. Ishte aq errët, sa ata nuk shikonin ku hidhnin këmbët. Vetëm vetëtimat e ndriçonin atë monopat të ngushtë si rrugë dhish që i shpinte në pyll, ku ecën ndonjë gjysmë ore mi-dis lisave, si hije të zeza që ndillnin vdekje.

Mricës i erdhi në mend një pyetje e çuditshme: «Me se do të më vrasin?». Dëshironte ta vrisnin me plumb e jo me thikë. Kujtoi jetën që kishte kaluar me të shoqin, qëndrimin e saj dhe mendoi se nuk kishte asgjë për të korrigjuar. Ajo nuk do të prante kurrë të mbyllej në shtëpi. Do të punonte për Partinë. Anë, le ta vrisnin! Kur sollli në mend shoqet që do të shkonin të nesërmen në hekurudhë, u ëmbëlsua nga një ndjenjë gëzimi, po i erdhi aq keq që nuk do të shkonte vetë, sa harroi dhe vdekjen. Ndarja nga shoqet dhe shkëputja nga puna e rinisë i dukeshin më të rënda se vdekja.

Ata udhëtuan deri te Strofka e Ariut. Atje i prisnin disa njerëz të tjerë. Ajo nuk i pa se cilët ishin ata, po e mori me mend se ishin kriminelë të arratisur.

— E prutë?, — pyeti një zë i egër.

— Po, — u përgjigj Prenga.

— Atëherë filloni!

— Ta mundojmë, apo ta vrasim?

— Mundojeni.

Mrica ndjeu një dorë të ashpër që e kapi për flokësh. Dora tjetër i vuri gërshtëren dhe ia preu deri në rrëzë. Kjo ishte shenja më poshtëruese që mund t'i bëhej një femre. Asaj i doli nga thellësia e shpirtit një mallëkim:

- Gjaksorë!
- Dikush e goditi dhe asaj iu pre fjala përgjysmë.
- Mos shko në hekurudhë, të të falim jetën, — tha ai zëri i egër që foli pak më parë.
- Vetëm vdekja mund të më shkëpusë nga kjo rrugë, — u përgjigj Mrica.
- Atëherë do të vdesësh, — tha zëri.
- Le të vdes. Do të dalin qindra të tjera, si në kohën e Luftës.
- Ti ke vajzë të vogël, moj Mricë, s'të vjen keq?, — u dëgjua zëri i njohur i të shoqit. — Ç'të duhet ty hekurudha, ç'të duhet Partia? Hiq dorë dhe kthehu në shtëpi.
- Gjaksor! Unë jam e Partisë, nuk jam jotja, — u përgjigj Mrica.
- Partia do të zhduket, — tha Prenga.
- Partia nuk zhduket, se është e madhe, sa populli. Do të zhdukeni ju!
- Kjo është komuniste, — tha zëri që komandonte, — nuk duhet vrarë me plumb, po duhet therur me thikë. Hajde, veproni!
- Mricës iu afrua nga prapa i shoqi dhe i mbështeti një gjë të ftohtë në duart e lidhura.
- E shikon?, — e pyeti.
- E shikoj. Ma ke treguar dhe në shtëpi. I poshtër!
- Hiq dorë nga Partia, se nuk shpëton!
- Kurrë!
- Ai ia ngjeshi thikën me forcë atje ku bie veshka.
- Oh, vrasës!
- Do të heqësh dorë?
- Kurrë!
- Prenga, si bishë e etur për gjak, ia nguli përsëri thikën më sipër, më poshtë, prapa e përpara. Pastaj u sulën dy hije të tjera mbi trupin e gruas dhe e zhalavitën me thika. Ajo u rrëzua përdhe ngadalë, sikur nuk donte të vdiste, pa pasur fuqi të bërtiste. Megjithatë i mblodhi të gjitha fuqitë për herë të fundit dhe ua tha disa fjalë që i habiti të gjithë:
- Bini, bini, gjaksorë, të shikoni si vdesin komunistët!



## GRATË E FSHATIT

Në fshatin tonë kishin pllakosur gjermanët dhe mercenarët e Xhaferr Devës. Ishte mesi i janarit të vitit 1944. Dimër si atë vit nuk mbahej mend.

Fshati ynë është buzë detit dhe vërtet që e rreh traumundana në kohë të ligë, po fort më të rrallë, një herë në njëzet vjet e mbase më shumë i qëllon një brezi njerësisht të shohë borë në bokërrinat dhe shtëpitë e fshatit.

Këtu rriten portokallet, ullinjtë dhe fiqtë, ata fiqtë e Kallamatës, që në daç për behar i ke, ashtu të freskët, tek i këput herët në mëngjes me vesën si pika loti, në daç i ke dhe për dimër çepella apo bukëfiqe të hojme, që, në paç fat të kesh dhe arra apo bajame, nuk ke ç'i do fare rehatllokumet e gegës.

Në fshatin tonë rriten portokallet, ullinjtë dhe fiqtë. Veçse gruri nuk rritet te ne, se s'ka fusha për ara, po vetëm bokërrina dhe ledhe me gurë, për të mbajtur e për të ruajtur tokën e paktë që rrëshqet e do të zërë vend përrenjve. Po, kur s'ka fusha, s'ka dhe vend për derrin, sado i butë qoftë, se dhe ai do misër të ngopet dhe llucë e baltë të zhytet e të lyhet.

Kështu edhe fshati ynë. Por atë vit as fiqtë u mblodhën dot në behar, se gjermanët zunë me vrap vendin e italianëve të mundur e nuk i lanë njerëzit të mblidhnin fiqtë. Atë dimër të paparë, kur fillon tregimi ynë, Operationi i egër i Dimrit i gjermanëve mbërtheu fshatarët brenda katër mureve të shtëpisë dhe ullinjtë (ashtu dhe fiqtë në behar) piqeshin e breshëronin përtokë e kalbeshin

shpejt, pa arritur t'i mblidhnim. Kurse për portokallet, nerënxat e mandarinat as bëhej fjalë atë dimër të poshtër; me to ëmbëlsheshin e dendeshin gjermanët dhe mercenarët e Xhaferr Devës.

Unë isha i vogël, s'kisha mbushur as dhjetë vjeç dhe as fjalën «operacion» nuk e kuptoja dhe as mercenarët e Xhaferrit nuk i merrja vesh tek kërkonin petulla me gjalpë. Ata donin petulla me gjalpë, kurse ne as miell të grunj-të nuk kishim dhe as gjalpë nuk ia mbanim mend se si e kishte erën atë dimër. Bagëtia na kishte ngordhur me kohë. Ishte luftë. Sos i kërkonin me vaj, por i donin me gjalpë. Le që atë dimër, me atë cërë vaj që kishim, nuk i kungonim dot gjithë mercenarët e Xhaferrit dhe ushtarët e gjermanit. Ky Xhaferrit mua atëherë më dukej se do të ishte kushëriri i Hitlerit, mbase dhe vëllai i tij i vogël, se dhe emrat u mbaronin njësoj dhe të bëmet i kishin njësoj. Ne, dhe atë pikë vaj që kishim, e ruanim si ujë e bekuar të gjyshes, se me të mund të shtyje lakrat e egra, përkalidhet dhe ndonjë të diel, gjyshja ime e mirë, hallë Mara, mund të bënte bullanë me një grusht miell misri që vetëm ajo e dinte se ku e fshihte. Kurse mercenarët donin petulla dhe gjermanët proshuta me mish derri. Ne proshutën e dëgjonim për herë të parë. Gjyshja u thoshte: «Ju jeni vetë derra», — po gjermanët nuk dinin shqip që ta merrnin vesh fjalën e saj. Natyrisht që kështu u thoshte gjyshja gjermanëve kur nuk kishin me vete ndonjë mercenar të Xhaferrit.

Dimri ishte i egër shumë. Unë rrija të shumtën e kohës shtrirë në dërrasa, tok me mëmën time. Mëma ishte e re, po, që kur doli babai partizan, ajo u sëmur. Mbase!... Kush e di të vërtetën! Unë e dija mirë se, po të mos ishte luftë dhe babai të ishte me ne, nëna ime domosdo do të shërohej më shpejt, se ai patjetër do të çante malin, mor, po dhe detin do të çante, vetëm që të gjente doktor ta shëronte. Po babai duhej të luftonte që të shpëtonte gjithë Shqipëria, more, po gjithë bota nga kjo murtajë e zezë naziste. Ndaj babai gjendej maleve. Kushedi, në Bogonicë, në Çipin. Unë kisha dashur gjithmonë të mësoja se ku ishte babai atë dimër, kur na pllakosën të ligjtë e gjithë

botës dhe mëma ime nuk kishte këllqe të ngrihej, kur gju-  
njët nuk i punonin fare. Po babai nuk u kthye më në fshat.  
Ai mbeti maleve, si çoban i mirë që kishte qenë; ai mbeti  
maleve, i vrarë nga gjermanët, jo atë dimër që s'do ta ha-  
rojmë kurrë, po në behar, kur kishte dalë bari i ri dhe  
kur kishin filluar kopetë të ngjiteshin përpjetë maleve, që  
kundërmonin erë trendeline dhe çaji. Mbase ndaj dhe u  
vra babai në behar, që të rrinte gjithmonë me bagëtinë  
dhe trendelinën. . .

Me siguri atë dimër, babai, atje në malet me borë,  
ashtu siç e kujtoja unë, ashtu më ka kujtuar dhe ai mua.  
Ashtu siç e kujtonte ime më, ashtu e kujtonte dhe ai. Më-  
ma thoshte: «I ziu ai, ç'heq atje!» Ajo as emrin nuk ia  
thoshte babait, se ishte turp sa s'bëhej më që të zinte në  
gojë emrin e atij para meje e, ca më keq, përpara gjyshes,  
vjehrrës së saj.

Babai kishte emër të bukur. Nase, i thoshin, njëlloj si  
atij trimit që i këndohej kënga. Për Nase labin e kam fja-  
lën, ndoshta nuk ju kujtohet, është ai që i tha mareshalit  
të Italisë:

*Mua s'më lidhi Turqia,  
jo do më lidhë Italia!*

Dhe, gjithmonë si atëherë kur akoma s'kisha mbushur  
dhjetë vjeç, edhe sot që jam burrë, emri Nase më duket se  
është emër për trima, për kapedanë e partizanë. Dhe atë  
dimër, tek rrija e ngroheshja në shtrojat e mëmës së së-  
murë, unë mendoja që babait tim duhej t'i këndohej  
kështu:

*Mua s'më lidhi Italia,  
jo të më lidhë Gjermania!*

Se italianin e kishin mundur partizanët, tani ishte ra-  
dha e gjermanit. Kurse, ngandonjëherë, kur vinin merce-  
narët e Xhaferr Devës në shtëpinë tonë, më shkante me-  
ndja dhe kështu:

*Mua s'më lidhi dot Hitleri,  
jo të më lidhë Xhaferr!*

Dhe kështu ishte vërtet, babanë me shokët e tij, atje në male, nuk i lidhnin dot as Hitleri dhe as Xhaferri, por ama gjermanët e Hitlerit dhe mercenarët na kishin zënë shtëpitë e ishin bërë si zotër të tyre, sikur kishin lindur ata në fshatin tonë dhe jo ne.

Gjermanët erdhën e na i morën edhe ato dy shkorsa të leshta dhe tri korrele që i kishte punuar mëma kur kishite qenë me shëndet. Tani as ergalinë nuk e kishim më. Mercenarët e Xhaferrit na e dogjën për dru, që të ngroheshin. Atyre nuk u mjaftonin as batanijet e Italisë, as shkorrsat e gjyshes dhe as korrelet e mëmës sime të sëmurë. Uh, sa të babëzitur që ishin!

Fshati po hiqte të zitë e ullirit atë dimër. As gjyshja ime, që qe grua e vuajtur dhe e munduar shumë, nuk dinte si ta quante atë dimër. Herë-herë ajo thoshte që erdhi fundi i botës, kataklizmoi. Unë e dija që ky nuk ishte as fundi, as fillimi i botës, sepse në male ishin partizanët, paqka që ne në shtëpitë tona na kishin pllakosur të ligjtë e gjithë botës.

Po, kur ne hiqnim të zitë e ullirit që, në fund të fundit, ishim brenda në shtëpi dhe më të rrallë çoku e ngjyenim krocën e misërt me lakra të egra, po partizanët atje, në malet e Gurrës, ç'bënin? Si i bënin ballë këtij dimri? «Bora atje në Gurrë, — thoshte gjyshja, — arrin deri dy bojë njeriu.» Për të ngrënë, partizanët nuk kishin, se as lakrat e as bari nuk gjendeshin dot në atë shtresë të trashë bore, po dhe as ujk e derr i egër e as dru që të ngroheshin nuk gjendeshin. Majat e maleve tona në këtë anë të bregut janë të zhveshura fare. Thonë që dikur ka pasur pyje me pisha si në Llogora, po njerëzit i kanë djegur për të fituar kullota dhe tani ato ishin si male të nëmura, pa asnjë dru.

— Orëzëztë djem! — thoshte gjyshja për partizanët.  
— Po karkallosin nga të ftohtët e do të vdesin nga uria.

— Pse të vdesin nga uria? Ata kanë pushkë, le të vrasin derra të egër e bisha të malit! — ndërhyja unë.

— Ç'derra të egër, o xhan! As ujk nuk ka tashti në male e jo derra. Janë fshehur të uruarat kafshë nëpër zgëqe e guca, që të mos i presë dimri si me cekure.

Unë nuk isha aq i vogël, sa të mos e kuptoja pse nuk ngjiteshin gjermanët maleve të vrisnin derra të egër, po na kërkonin neve derra të butë; unë nuk isha aq i vogël, andaj dhe e dija që gjermanët, edhe sikur derrat e egër të hidhnin valle maleve, atë dimër nuk ngjiteshin, se kishin frikën e partizanëve, se malet ishin shtëpitë e partizanëve tani, kurse shtëpitë tona ishin bërë të gjermanëve dhe të mercenarëve.

... Atë ditë, kur gjermanët dhe mercenarët kishin pllakosur fshatin tonë dhe kishin rrethuar gjithë fshatrat e tjera të Bregut, që të mos u shkonte dot asnjë ndihmë partizanëve në mal, ato ditë kur ata e kishin vënë ndër mend të shuanin partizanët në malet e Gurrës me uri e me të ftohtë, jo vetëm gjyshja, mëma ime dhe unë mendonim për partizanët, po për ta mendonin të gjithë fshatarët, që kishin partizanë djemtë e vëllezërit, motrat dhe baballarët në male. Të gjithë mendonin se si të ndihmonin, që të mos shuheshin nga uria e të mos i priste të ftohtët.

Në ato ditë të gjata dimri e shumë të hidhura, qoftë nga të ftohtët e ca më tepër nga armiqtë, gratë e fshatit, vajzat, motrat, nënat dhe gjyshet i ngisnin gjilpërat e telta e bënin çorape e fanella të leshta për djemtë e malit.

Gjyshja ime tirte leshin me furkën e gjatë sa unë, kurse mëma bënte kumbisur çorapet e sojme prej leshi të butë, që të mos u mërdhinin këmbët e të mos i vriste opinga partizanët.

Gratë e fshatit tonë bënë atë dimër atë që asnjë nuk e kishte menduar, atë për të cilën me siguri ai dimër nuk do të harrohet kurrë në anët tona.

Atë ditë janari, çdo grua kishte gatuar bukën e misërt në magje, kishte nxjerrë ullinjtë e fundit nga talëret e katoqit dhe kishte mbaruar çorapet e fanellat e leshta. Partizanët e kompanisë së dytë të batalionit të parë atje në Gurrë, për t'i bërë ballë këtij dimri dhe këtij operacioni armik, kishin shumë nevojë për atë bukë, ata ullinj dhe për çorapet e fanellat e leshta.

Në i shkon ndonjërit në mend që të pyesë pse nuk sulmonin ato ditë partizanët e malit tonë gjermanët e mercenarët, ashtu siç i sulmuan në malet e tjera, unë i them

se partizanët e Gurrës nuk qenë më pak trima se shokët e tyre, por ama gjermanët e mercenarët ishin mbledhur në fshat, nja njëqind vetë, kurse partizanët atje në mal gjithë-gjithë ishin vetëm dyzet e tre burra dhe katër shoqe. Dhe të mos harrojmë se gjermanët ishin brenda në shtëpitë tona, që janë kulla e shkuar kullave, ku dhe me disa dhjetëra njerëz mbrohesh bukur fort. Pastaj edhe fishekët do të duheshin me qerre për të nxjerrë gjermanët nga shtëpitë, kurse partizanët kishin vetëm nga dhjetë fishekë secili. Atëherë, kur ishte kështu puna, pse nuk sulmonin gjermanët, apo jo? Nuk sulmonin, se shkonin me shpresë se s'do të ishte nevoja të vritej asnjë gjerman, kur partizanët ose do të vdisnin nga uria e nga të ftohtët, ose, kështu i gënjente mendja mercenarët e Xhaferrit, ata mund të dorëzoheshin vetë si dashi te kasapi.

Gratë i kishin bërë gati të gjitha.

Në shtëpinë e Zahajve, që ishte bërë me kohë si depo e partizanëve, qenë grumbulluar njëqind e tridhjetë e katër palë çorape dhe tetëdhjetë e një fanella të leshta, hem të buta e hem të sërta. Me këto çorape mund të mbathje gati një batalion e me fanella mund të vishje nja dy kompani të mira partizane. Malli ishte siguroar, po si t'ua dërgoje partizanëve këtë mall, asnjë nuk e dinte.

Një pasdite te ne, si për të takuar mëmën time të sëmurë, erdhën Takja e Mitrushajve, që ishte mëmë e dy djemve partizanë, Liloja e Zahajve, që kishte tre vëllezër partizanë, Dhoksia e Thanajve që kishte dy motra e vëllanë partizan dhe një vajzë e re, që mbase donte të dilte vetë partizane.

Në shtëpinë tonë drutë kishin mbaruar dhe vaj nuk gjetën më as gjermanët e as mercenarët, andaj te ne atë pasdite nuk kishte më nga ata. Ishin larguar nga ne e qenë ngulur në shtëpi të tjera. Nëna kujtonte se ata ishin trembur se mos u ngjitej veremi i saj, ndaj qenë larguar. Kurse gjyshja thoshte që as kolera nuk i zë ata e jo veremi, vetëm plumbi i partizanëve bën punë në ta.

Ato gratë erdhën te ne e, si pyetën për shëndetin e mëmës, filluan pastaj të llafoseshin për punën e çorapeve dhe të fanellave që duhej t'i merrnin partizanët.

— Është mall shumë. Një barrë e mirë mushke, — tha e para Takja e Mitrushajve.

— Sikur të nisnim ndonjë nga pleqtë e fortë të fshatit, gjoja si për në Kallarati. Ai ta ngarkojë kafshën me mallin e djemve, t'ia kuçundrisim me ullinj që të mos duken çorapet e fanellat e, po ta takojnë të paudhët më të dalë të fshatit, t'u thotë që vetë të këmbejë ullinj të miell të grunj të Kallarati. Mbase gënjehen këta të ligjtë e Xhaferrit, se për petulla këta shesin dhe mëmën e tyre, — dha mendimin e saj Liloja e Zahajve.

— Punë që s'bëhet ajo, o jetë! — tha menjëherë gjyshja ime. — Gjermanët, sa të marrin vesh që kafsha e ngarkuar me ullinj po ngjitet malit te partizanët, do ta vrasin në vend kafsharin, edhe malli nuk do t'u vejë djemve në mal. «Pse, me ullinj do t'i ushqejnë partizanët?» — do thonë gjermanët. Duhet menduar diçka tjetër, se kjo nuk vete fare, — shtoi ajo.

— O hallë Mara, po sikur të nisësh ndonjë nga burrat që ka mbetur në fshat, ndonjë nga ata të territorialit, natën, pa e diktuar njeri? — pyeti Dhoksia e Thanajve gjyshen.

— Mirë do të ishte, po të mos e diktonin, ama, — ndërhyri në vend të gjyshes Takja e Mitrushajve. — Po kush na siguron që do të mundë të ikë ai pa u rënë në sy e në vesh koshadheve të gjermanit? Mirë po iku, po në mos ikte dot, edhe njeriu vete dëm, edhe mallin e merr dreqi e djemtë do të na mbeten brinjave të malit si Shëndëlli.

— Jo, nuk e kam menduar kaq thellë, — u shfaqësua Dhoksia.

Mua po më vinte keq për gratë, për gjyshet dhe mëmat tonë. Ato po e pleksnin dhe e shpleksnin bisedën për t'u shpënë gjënë partizanëve në mal, në gjithfarë mënyrash, edhe kështu, edhe ashtu, e nuk po ia dilnin dot mbanë. Mua më dukej se këtë punë më mirë se kushdo mund ta zgjidhnin burrat, por ato nuk kishin grishur asnjë burrë. Dhe ca më shumë më vinte keq për to, se ma thoshte mendja që ato ishin bërë mendjemëdha, përderisa nuk i ftonin dhe as u thoshin burrave e pleqve për këtë punë. Nuk e dija unë që burrat, ata pak burra që kishin mbetur në fshat,

ua kishin besuar këtë shërbesë grave dhe vajzave, se, për të çarë rrethimin e gjermanëve dhe të mercenarëve të Xhafferit, më lehtë do ta kishin gratë.

Dhe gratë në shtëpinë tonë vazhdonin të shkëmbenin mendime për çorapet dhe fanellat e partizanëve...

Deri tani, ajo vajza e re, që mbase donte të dilte partizane, nuk kishte folur fare. Dhe atëherë, kur u duk që atë pasdite nuk do t'i gjendej filli kësaj pune, ajo hapi gojën me turp (se u skuq shumë, më keq se ata dy kongjij prushi që digjeshin në vatër) dhe tha:

— O mëmani, o motrani, po sikur të na e linit neve, vajzërisë së fshatit, t'ua shpiem mallin partizanëve në mal?

— Fol më shkoqur, — tha Takja e Mitrushajve. — Nga-je llafin më drejt.

— Ja, neve, vajzave, na ka vajtur mendja kështu: T'u themi mercenarëve dhe gjermanëve që do të ngjitemi deri në Mblerës për dru. Se drutë na duhen dhe neve, edhe atyre të ligjve, që na kanë zënë shtëpitë. Zjarri në vatër është i mirë për të gjithë. Dimri do të vijë dhe më i egër, kurse dru s'kemi fare. Kështu nisemi për në Mblerës, po vrapin do ta mbajmë më tej, në majë të Çikës; në Gurrë. U shpiem partizanëve fanellat, çorapet, bukën e ullinjte që do të kemi me vete. Pastaj më të kthyer rrët e fët një vrap në Mblerës bëjmë shqopa e marishte dhe mbrëmanet, në darkë, kthehemi në fshat me barrën e druve ngarkuar. Veç për këtë duhen gra të forta, ndaj them të na e lini neve, vajzërisë, të çajmë malin, — tha vajza e re. Ndoshta kjo ishte ligjërata më e gjatë në jetën e saj. U duk sikur ajo u lodh që foli aq shumë.

Gjyshja ime e shoqet e saj nuk po e kuptonin se si do ta çonin këto vajza mallin në majë të Çikës. Kurse malli ishte kryesori këtu. Ndaj dhe Liloja e Zahajve e pyeti vajzën:

— Mirë, o xhane, ta zëmë se na lanë këta të paudhët të nisemi në mal për shqopa, se mirë e the, zjarri është i mirë për të gjithë. Po si kujton ti, se nuk do të na kontrollojnë trastat apo futat se mos u shpiem bukë apo veshmbathje partizanëve?

Problemi u shtrua tani thjesht, pa asnjë mëdyshje.



Dhe mua m'u duk se ajo vajza mbeti ligisht. Vallë si do përgjigjej? Dhe u habita kur dëgjova:

— Jo. Nuk kujtojmë se nuk do të na i kontrollojnë trastat e futat. Po ne mendojmë të bëhemi nja tridhjetë-dyzet vajza, nga më të fortat e fshatit, që do ta ngjitim majën e Çikës jo për shtatë-tetë orë, por e shumta për pesë orë dhe më të zbritur do të profitasim të bëjmë dhe shqopa e kucura për zjarr.

Ajo e ndjeu që përsëriti atë që kishte thënë pak më parë dhe që kështu akoma nuk i kishte dhënë përgjigje pyetjes së Lilos së Zahajve. Ajo shtoi:

— Kurse çorapet dhe fanellat ne themi t'i veshim vetë. Të mbathim nga tri-katër palë çorape edhe të veshim nga dy-tri fanella në mish. Sado të zgjuar të jenë merce-narët dhe gjermanët, nuk besojmë se do t'u vejë mendja të na numërojnë se sa çorape kemi mbathur e sa fanella kemi veshur.

Gratë qeshën. Ndoshta i bëri për të qeshur ideja se si mund të ndodhte që gjermanët të numëronin sa çorape kanë më të vajtur në mal e sa kanë më të zbritur. Mua kështu m'u duk. Ato qeshën.

Unë u çudita me zgjuarsinë e vajzës. Gjyshja dhe Tackja e Mitrushajve buzëqeshën të lumtura dhe atëherë pashë që dhe gratë e tjera e miratuan këtë mendim të vajzave. Megjithatë Dhoksia tha:

— Po për bukën e partizanëve si do t'ia bëjmë? Karvelet me bukë nuk i vesh e as i mbath dot si fanellat e çorapet.

— Ne kemi menduar dhe për këtë, — tha vajza. — Them i të marrim për udhë nga një gjysmë karvele bukë a gjysmë kulaç dhe një çanak me ullinj sa për vete. Për dhjetë orë rrugë në mal dhe tri-katër orë punë për të prerë drutë mbase dhe gjermanët do të na lënë kaq bukë. Po na i lanë, ne kemi gjykuar që gjithë bukën dhe ullinjtë t'ua japim partizanëve, kurse për vete atë ditë të rrimë pa ngrënë...

— Ne mund të dëndemi me përvëlak mirë atë mëngjes që do nisemi, — tha Dhoksia.

— Po, — tha vajza dhe vazhdoi: — Do ta kemi vesh-tirë shumë. Ndaj themi që duhen vajza e gra të reja e të

forta se do të duhet të bëjmë mbi dhjetë orë rrugë, të ngjitemi e të zbresim malet në mes të borës dhe të suferinës, të bëjmë drutë e të kthehemi me to ngarkuar në fshat...

— Dhe të gjitha këto me bark thatë, — tha Dhoksia si për të plotësuar mendimin e vajzës.

Unë, që e kisha ngjitur një herë malin për të gjetur babanë në Valët e Bufit, e dija sa e vështirë ishte ajo rrugë. Prandaj prisja ç'do të thoshin gjyshja e shoqet e saj.

— Mirë e keni menduar, bija, — tha gjyshja ime. — Por të shkoni vetëm ju, vajzëria, nuk e keni drejt. Nuk është hiç e udhës.

— Pse, hallë Mara? — pyeti e çuditur vajza.

— Si pse! Ti vetë the që do mbathemi e do vishemi me çorapet dhe fanellat e djemve. Kjo do të thotë që sa më shumë gra e vajza të vemi në mal atë ditë, aq më pak mund t'i bjerë në sy gjermanit veshja jonë. E më anë tjetër, sa më shumë gra e vajza të jemi, aq më tepër shumohet buka e ullinjtë për djemtë. Kështu de, bija. Ndaj është e mbara e punës të nisemi të gjitha, jo vetëm ju, po dhe ne, gratë e plakat e forta të fshatit. Sos është e para herë që ngjitemi Çikës ne. Strallet e Çikës vërtet na i kanë ngrënë shollët, por ama dhe koskën na e kanë bërë më të fortë se stralli. Durojmë ne, o xhane, durojmë shumë ne, o zemër, — shtoi gjyshja për të forcuar një mendim që të gjitha e besonin dhe pa këtë sqarim.

Po atë mbrëmje Takja e Mitrushajve dhe gjyshja ime, që kishte nusen të sëmurë e i duhej zjarri, i thanë të madhit të mercenarëve të Xhaferrit se të nesërmen do të ishte mirë të ngjiteshin në mal për dru, jo deri në majë, se atje nuk kishte dru, po deri në Mblerës. Kështu i thanë të madhit të mercenarëve.

Zjarri u duhej dhe armiqve, ndaj ata i lanë të niseshin të nesërmen dyzet e tetë gratë dhe vajzat më të forta të fshatit për të ngjitur malin për dru.

Ato kishin mbathur kush dy palë e kush tri palë çorape e kishin veshur nga dy fanella. Ato dukeshin atë mëngjes të shëndosha si asnjëherë. Trastat e tyre, kur i kontrolluan koshadhet e gjermanit në të dalë të fshatit, kishin vetëm një gjysmë kulaç me miell misri e nga një

çanak me ullinj dhe në brez kishin lidhur tërkuzën dhe cekuren e druve. Dhe koshadhet i lanë të shkonin, se nuk kuptuan gjë.

Ato u nisën që me natë. Bënte të ftohtë i madh... Unë dëgjova gjyshen kur iku, sepse në të errët kërkonte nën jastëk rripin e brezit, të cilin e shtrëngoi fort si ushtarët, ndaj dhe malin e ngjiti si vajzë...

— Udha e mbarë! — i tha mëma. Atë nuk e morën në mal, se ishte dobësuar nga sëmundja.

— Ruaj veten, — i tha gjyshja, — ki kujdes djalin. — Kjo porosi ishte për mua. Unë bëra sikur nuk e dëgjova, po qejfi m'u bë shumë.

Atë mëngjes bënte ftohtë, por ato, gratë e vajzat që ngjitën malin, nuk mërddhinin, se ishin veshur e mbathur mirë si asnjëherë dhe se në zemër kishin dashurinë për partizanët edhe në gojë këngën e tyre:

### Lule, djemtë e nënave.

Kur ato ia morën këngës në majë të Mjeglloshit dhe ne i dëgjua në fshat, e kuptuam që e kishin kaluar rrezikun. Atë mëngjes shumica e fshatit u zgjua jo nga kokosharët, po nga kënga buçe e grave në majë të Mjeglloshit. Kurse i madhi i mercenarëve kujtoi se ato këndonin që të largonin të ftohtët... Dhe këngën e djemve të nënave ai nuk e dinte e ca më tepër gjermani, që nuk e merrte vesh hiç.

Ato ngjitën malet shkallë-shkallë, si ato shkallarët e stadiumeve dhe të anfiteatrove, ato kaptuan Mjeglloshin me mjegull, ndaj i thonë Mjegllosh, pa zbardhur akoma. Kapën majën e Mblerësit, pa u shuar akoma Ylli i Mëngjesit dhe ashtu, me dritën e yllit dhe të hënës, që ishte mbledhur e bërë sa një grusht, sa një mandarinë (se, si dukej, dhe ajo kishte të ftohtë), ato panë hilqet e buta, marishtet e shkurtra, dëllinjat gjembaçe, shqopën që digjet me bujë dhe mretet, që i duan aq shumë dhitë. Këto do të ishin drurët dhe shkurret që do të prisnin në të ardhur poshtë e që do t'i ngarkonin mbi vete.

Kur arritën në Gurrë, që ka ujë me emër në të gjitha

Malet e Vetëtimave; atyre nuk iu desh ta shuanin etjen, se bora, që kishte qenë mbi gjunjë e u kishte bërë qull këmbët e fundet e këmishëve, filloi atje të bëhej afër një bojë njeriu. Askujt nuk i vajti mendja për ujë.

Në majën e Mesimerit, 1800 metra mbi det, i preu era, dhe ato, që të mos i rrëmbente murlani, u lidhën varg njëra pas tjetrës, siç bëjnë sot ata çiliminjtë e çerdheve dhe të kopshteve kur shkojnë nëpër bulevardet.

Siç duket, atje në Mesimer, tek luftonin me erën e fortë, i panë dhe partizanët nga shpella karstike të majës së Çikës, sepse, kur ato ngjitnin majën e Çikës, drejt tyre po zbrisnin nja dhjetë partizanë, të zbathur e të lodhur. Ka të ngjarë që ata t'i kenë marrë gratë e vajzat e fshatit për gjermanë, ndaj dërguan për tek ato pararojën, atë skuadër prej dhjetë vetësh.

Gjyshja, që më tregoi më vonë se si e ngjitën malin, nuk e dinte pse zbritën partizanët në drejtim të tyre. Ajo kuptoi se ata zbritën që të mos lodheshin më shumë gratë. Sidoqoftë, puna është që partizanët e kompanisë së parë të batalionit të dytë atë ditë dimri u veshën dhe u ushqyen mirë.

Më vonë, kur edhe i gjithë batalioni u bashkua me kompaninë e parë dhe partizanët zbritën në fshat për të zbuar gjermanët dhe mercenarët e Xhaferrit, ne, çiliminjtë e fshatit, dallonim në gjalmët dhe brezat e çorapeve dhe në ojnata e fanellave të tyre mjeshtërinë e nënave, të motrave dhe të gjysheve tona...

1970.

DERA TROKET

Dikush tha njëherë me shaka se, kur vinte autobusi nga Tirana, në atë qytet bëhej festë. Njëri priste djalin, tjetri vajzën, dikush teton ose hallën që ishte shpërngulur tani dhe vinte vetëm të kalonte disa ditë në qytetin e lindjes. Kishte edhe nga ata që nuk prisnin njeri, po thoshin «dalim njëherë, të shohim kush ka ardhur» dhe, me hap të ngadaltë, pa u nxituar shkonin te autobusi, qëndronin atje një copë herë duke shikuar me sy mospërfillës. «U, paska ardhur djali i Beqos!» — i thotë ndonjëri shokut të tij. E takojnë atë, e pyesin si vete me punë, sa ditë do të rrijë dhe pastaj largohen po me atë hap të ngadaltë e pa u nxituar, ashtu siç vijnë. «E që the ti...», — kapnin përsëri fillin e muhabetit të lënë përgjysmë para se të vinte autobusi.

Kështu ndodh në atë qytet të vogël, të largët, ku njeriu do të dëgjojë se ç'bëhet, ç'të reja ka. Po me sa shqetësim, me ç'gëzim presin ata njerëzit e tyre, fëmijët, të afërmit, shokët, që nuk i kanë parë prej disa kohësh!...

— Erdhe, të keqen nëna!? — thirri Sanoja, një meso-grua, veshur me një fustan të zi me pika të bardha, me flokë gështenjë, aty-këtu të përthinjur. Prapa saj rrinte i shoqi, Maksuti, një burrë tanimë i shkuar, pak i kërrusur, veshur me një kostum bojë hiri, me xhakatë dopiopet të mbërthyer, që i qëndronte mirë pas trupit dhe më prapa i biri, Gëzimi, një djalë i gjatë.

— Mamaja! — briti duke dalë nga autobusi një vajzë e re. U përqaftuan të dyja dhe u puthën buzë më buzë.

Maksutit i qeshte fytyra.

— Mjaft u puthët, moj, — tha ai duke e marrë çupën në krahët e tij.

— Mirë se na erdhe, moj doktoreshë!

— Mirë se ju gjeta, baba!

Gëzimi rrinte pak larg me duar në xhepa. Nuk i pëlqenin shumë përqafimet e të puthurat. Ai e shikonte motrën, Teftën, dhe i dukej se qe rritur edhe më e qe zbukuruar. Menjëherë i vajtën sytë te flokët e prerë shkurt sipas modës dhe padashur vuri buzën në gaz, duke menduar se do të kishte për se të bënte shaka me Teftën.

— Gëzo, pse rri larg, mo? Eja te motra!

— E moj, erdhe? — ia pat me zë pak të vrazhdë e të trashë Gëzimi dhe zgjati dorën e tij të madhe. Tefta iu hodh në qafë dhe, nga dashuria e saj, nga vështrimi i syve, ku ishte ndezur një dritë e çiltër dhe gazmore, atij iu zhduk menjëherë ajo ftohtësi e jashtme, ndonëse i vinte turp që e shikonin të gjithë si e puthte e motra.

— Eja këtu, mos rri si i humbur, — iu drejtua pas pak mamaja Gëzimit. — Të shohim për valixhen se mos na ngatërrohet. Një valixhe ke, moj Teftë?

— Jo, dy, mama, dy.

Duke ngritur njërën prej tyre, Sanoja foli:

— Ç'e ke këtë të rëndë plumb, moj bijë, ç'ke futur brenda?

— E kam me libra, moj mama. Prandaj vjen e rëndë.

— Bjere, se e ngre unë, — e mori Gëzimi.

— Burrë, eja merr këtë tjetrën, se iku ajo kohë tani, që ngarkoheshin gratë.

— Mirë, moj, kush të tha...

Teftës i erdhi për të qeshur me fjalët e s'ëmës, që ishte gjithmonë e hedhur e e papërtuar.

Morën udhën për në shtëpi. Baba e djalë ecnin përpara, nënë e bijë prapa. Njerëzia i shikonin dhe ndonjëri thërriste:

— E mo, Maksut, të erdhi? Shyqyr, shyqyr!

— Si mo, doktoreshë i doli vajza?! — pyeste ndonjë tjetër, i çuditur. — Më vjen mirë për Maksutin e shkretë!

Rrugës nëna e mbuloi Teftën me fjalë: «Sa je rritur, moj vajzë e nënës. . . Pa le, po m'i ke prerë edhe flokët si djemtë (ajo shkoi dorën nëpër ta dhe i përkëdheli qafën). Të rrish ca ditë tani, të pushosh. . . E kemi lyer e pastruar edhe shtëpinë. . . Më ranë duart me ato gërmadha. . . Shtëpi e gjithë jetës. . . E more vesh, moj Teftë, për Lum-ton që u fejua? Ka marrë një deli djalë.

— Më dërgoi letër. E urova.

— Hë tani, të të gjejmë edhe ty ndonjë burrë të mirë, — tha ajo, ndërsa e shikonte të bijën e përmalluar.

U ndalën pak të çlodheshin, se valixhet ishin të rënda. U ulën në disa stola ndanë rrugës.

— Po dole mirë? — pyeste i ati. Ai kishte një vështrim të butë e të heshtur dhe gëzimin e kënaqësinë nuk i shfaqte kurrë me shumë fjalë. Këtë e dinte mirë Tefta dhe e kuptonte tani se sa i gëzuar ishte i ati, se ky nuk ishte një gëzim që shkrep e shuhet për disa çaste, po që do të hidhte dritë në zemrën e t'et për gjithë jetën. Shpesh, në netët e shqetësuarra përpara provimeve, e kërrusur përmbi librat e dispensat që s'kishin të mbaruar, ajo qëndronte një çast dhe mendonte për njerëzit e saj. I dilte përpara syve i ati me gjilpërë në dorë, duke qepur rroba. I kujtohej e ëma, pak e ashpër në fjalë, që lante e kruante shtëpinë nga mëngjesi në darkë. Me buzën në gaz ajo sillte ndër mend të vëllanë që zgjatej me ditë e që thoshte shpesh, kur ajo vinte me pushime: «Më dhemb pak këtu, moj doktoreshë, e gjen dot se ç'kam?» Ja, tani ishte midis tyre. Së shpejti do të fillonte nga puna në spitalin e qytetit të saj. A do t'i bënte dot ballë? Nuk do të turpërohej? A do t'i besonin njerëzit? Gëzimi dhe shqetësimi i lehtë përpara së ardhmes përziheshin në një ndjenjë të vetme, që i jepte hije fytyrës së saj, e turbullonte ëmbël vështrimin e syve, tani më të menduar e hetues.

— Ngruhuni! — u tha Sanoja dhe zuri udhën e para.

\* \* \*

Gëzimit i zinte dora çdo gjë dhe tani së fundi kishte rregulluar një krevat të thjeshtë prej dërrasash. Ata të dy

me Teftën flinin në një dhomë të madhe e të lartë (gjithësej familja e tyre zinte dy dhoma), ku dukej sikur të mban-te njeri në pëllëmbë të dorës dhe ku tringëllinin tarabatë nga era më e lehtë. Dhoma kishte mbetur ashtu siç e kish-te lënë Tefta vitin e kaluar. Një hartë e madhe e botës qëndronte varur mbi mur (Gëzimit i pëlqente shumë gjeo-grafia); pak më sipër — një fotografi e monumentit të Skënderbeut mbi kalë. Gjatë këtyre pesë vjetve që mungonte Tefta, dhoma kishte marrë një pamje pak të ashpër, të thatë dhe kishin humbur pak nga pak gjurmët e kujdesit dhe të delikatesës vajzërore, që kishte lënë atje dora e saj.

Si ikën ata që kishin ardhur për të uruar, si hëngrën darkë dhe biseduan një copë herë, ajo u përshëndet me prindët dhe hyri në dhomë. Gëzimi nuk kishte rënë ende; vështronte nga dritarja larg hapësirën e heshtur dhe kon-turet gjigante të maleve e të grykave që rrethonin qytetin. Ai shtroi për vete në shesh dhe në krevatin që kishte përgatitur vetë vendosi dyshekun e Teftës me çarçafët e bardhë që solli nëna. Vajza përfshiu me një të vështruar dhomën e saj dhe buzëqeshi me sy të ndritur e të përma-lluar, ndërsa iu zgjuan shumë kujtime të fëmijërisë. «Mba-rova, erdha në shtëpi», — i shkoi nëpër mend dhe mori frymë si e lehtësuar nga një peshë e rëndë.

Gëzimi iu afrua krevatit.

— Ti, Teftë, do të flesh këtu, — tha ai shkurt, pa i dhënë rëndësi fjalës. — Mua më pëlqen më mirë në shesh.

— Të keqen motra, s'ka gjë, edhe mua më pëlqen në shesh. — Tefta e shikoi të vëllanë me dashuri.

— Fli, fli. Unë për ty e kam bërë. Thashë se do të ishe mësuar butë andej nga Tirana.

— Epo mirë, vetëm ta shpiem te dritarja. Është më freskët.

Kur ranë, që të dy, pasi shuan dritën, qëndruan një copë herë pa folur. Tefta, e malluar për qytetin e lindjes, hodhi sytë nga dritarja dhe psherëtiu. Lart, shumë lart, sikur fluturonte në një aeroplan iu duk vetja. Sa të larta ishin shtëpitë e qytetit të saj, sa me mjeshtëri dhe mundim ishin ndërtuar e ruajtur brez pas brezi atje në këmbë të



malit, sipër kodrave! «Mjeshtër të zotë, me duart e tyre të regjura kanë ngritur me dashuri muret e këtyre shtëpive si kështjella!»

Po pas mbrëmjes së gëzuar e plot zhurmë, ajo ndiente tani një heshtje pak të trishtuar, të pazakontë. Për shumë vjet me radhë flinte midis shoqesh, shpeshherë me dritën nderur, duke dëgjuar radion, apo të qeshurën e ndonjëres prej tyre. Shpesh bënin mbrëmje, kërcenin gjer vonë, vinin pastaj të lodhura e gjumi i zinte menjëherë. Ishte jetë e gjallë, e potershme, plot shqetësime e gëzime, plot këngë dhe ëndrra... Ajo kuptoi tani më mirë, se të gjitha këto kishin mbetur prapa dhe e pushtoi një mallëngjim i lehtë, që iu ngjit dalngadalë nga kraharori dhe iu bë si një nyje në grykë.

— Teftë, të zuri gjumi? — pyeti Gëzimi.

— Jo, akoma.

— Po ç'mendon?

— Asgjë.

— Teftë...

— Fol, Gëzo!

— Po mirë, po ti, domethënë, u bërë tamam doktoreshë?

— Kur të filloj punën, atëherë do të bëhem tamam, — tha ajo me të qeshur.

Gëzimi u mendua pak.

— Po ti, çdo të sëmure mund të shërosh?

— Jo të gjithë. Disa.

— Po a është zor ta gjesh sëmurdjen?

— Zor është, sipas rastit...

— Po të vdekur ke parë prapë?

— Pusho tani, nesër të tregoj...

— Nuk ke frikë nga të vdekurit?

— Fli, të them...

Gëzimi bëri edhe disa pyetje po, si e pa që e motra i përgjigjej nëpër gjumë, u kthye nga krahu tjetër. Gjumi nuk e zinte. Ishte i gëzuar që nuk do të flinte më vetëm në dhomë, që do të tregonin historin me Teftën para se t'i merrte gjumi; ishte i gëzuar që e motra do të shëronte njerëz, sido që nuk i besohej shumë.

Të nesërmen erdhën shumë fqinj e kushërinj të tjerë të uronin për Teftën. Erdhi edhe teto Rezmoja, një plakë që banonte pranë shtëpisë së tyre e që e donte shumë Teftën. Kur ishte e vogël, Tefta humbiste për orë të tëra në kopshtin e plakës; nganjëherë qëndronte edhe për drekë tek ajo. Nëna e kërkonte nga të gjitha anët; e kishte zakon të thërriste: «Teftë, ku je, moj, që mos qofsh!» — Po, kur e gjente te teto Rezmoja, i dilte inati e vajza shpëronte nga shuplaka që e ëma, ndonëse më të rrallë, po ndodhte që edhe i jepte. Plakën e njihnin mirë në gjithë mëhallën. E thërrisnin shkurt «teto».

Ajo ngjiste kalldrëmin me një shkop në dorë, ia niste muhabetit me gratë që ndernin këmishët ose fshinin obo-rrin, pyeste për të gjithë me radhë, jepte këshilla: «Hë tani, t'i gjeni një burrë edhe Shazos. U bë goxha vajzë. . .» — Tetoja nuk ecte dot rrugës e qetë, po të shihte një gjë që s'i pëlqente, do të ndalej: «Fute brenda niseshtenë, moj nikoqire, se u tha! Ki mendjen, se vjen shi; ja, u vesh gryka e do të lagen këmishët». — Të gjithë e donin teto Rezmon, sado që nganjëherë u mërzitej me këshillat e saj. Fëmijët e nderonin, po edhe ia kishin frikën.

«Ikni, se erdhi tetoja», — bërtisnin.

Tani ajo ngjiti shkallët me shkopin në njërën dorë dhe me një pjatë me kumbulla në dorën tjetër.

— Ku jeni, moj?

Vuri pjatën mbi një tryezë dhe mori frymë thellë, se shkallët e kishin lodhür. Nga kuzhina doli Sanoja, pastaj edhe Tefta, të cilën tetoja e puthi disa herë me dashuri të madhe.

— Edhe me një burrë të mirë, ishallah! Shyqyr që të erdhi shëndoshë, moj Sano!

Plaka u ul mbi minder, edhe Tefta pranë saj. Sanoja vajti të bënte kafënë.

— Si ke qenë, teto?

— Si plakë, moj bijë. Si të jemi. . . Je zbukuruar dhe

të ka rënë një nur, të keqen tetoja... Na u bënë vajzat më mirë nga djemtë.

— Më paske prurë dhe kumbulla!

— E di që i ha keq, moj Teftë...

— Të falem nderit, — ajo mori pak kripë në dollap dhe filloi të hante.

— Po i mbarove të gjitha mësimet? Iu bërë nënës e babait...

Tefta e pyeti për Hënën, çupën e saj dhe për Reizin, të birin.

— S'e ke dëgjuar. E ku ta dëgjoje ti... Reizi me gjithë grua ka zënë shtëpi më vete. Tani unë rroj me dhëndrin. Është njeri i shkuar... U ka lindur edhe vajzë. Nuk jemi keq, moj bijë. Ata të zestë më vështrojnë; po e kam plagë në zemër për Reizin. Ia prishi mendjen ajo nazemadhja... Po të shkojnë mirë për vete të tyre, po edhe unë do të bëj si të bëj...

— Zotrote ke vajzë të dashur.

Për disa çaste plaka u trishtua dhe zuri të psherëtinte. Pastaj erdhi prapë në gjendjen e parë.

— E mban mend, moj Teftë, kur të merrja kaçe e kur më thoshe: «Teto Rezmo!» — Si ikin vjetët!... A do ta pyesësh teton, kur të martohesh, apo ke zënë ndonjë andej?

— Si nuk do të të pyes, moj teto, — qeshi Tefta.

— Çka, edhe fjalën e mirë, pa ku pyesni ju tani...

\*  
\* \* \*

Tefta shkoi në spital, u njoh me drejtorin e me mjekë të tjerë, të cilët e pritën me fjalë shumë të ngrohta. Ajo do të qëndronte tani 15 ditë pushim dhe pastaj do të fillonte nga puna. Kur u vesh me rrobat e bardha, kur ndjeu erën e spitalit, midis asaj heshtjeje të zakonshme tani për të — e ndjeu veten mirë, në vend të saj, ndonëse nuk i hiqej drojtja përpara punës së ardhshme. Këta të sëmurë që e shikonin tani, ndonjëri me simpati e ndonjë tjetër me mospërfillje, a do ta besonin, a do të mund t'i shëron-

te? Si do të bënte në rastet urgjente, kur të ishte rojë nate, pa ndonjë koleg pranë? Këto dyshime e shqetësime e brennin aq më tepër, sa më shumë afrohej dita e parë e punës. Kë do të shëronte për herë të parë me punën e saj të pavarur? Për këtë kishte menduar shumë herë dhe shumë çaste të përfytyruara i dilnin përpara. Herë i bëhej sikur i shpëtonte jetën një fëmije të vogël dhe e ëma qeshte midis lotësh dhe e përçafonte Teftën; herë sikur mjekonte një djalë: simpatik që, duke mos mundur dot të fliste, e shikonte me mirënjohje mjeken e re, tek e cila nuk kishte pasur besim. Po përfytyronte edhe skena të frikshme: sikur nuk përcaktonte dot sëmundjen, mbytej në djersë e sikur vinte pastaj një mjek i shkuar në moshë dhe e përcaktonte diagnozën me lehtësinë më të madhe. Kjo dilte e turpëruar, ndërsa të gjithë ulnin kokën. Nganjëherë i ndrydhej zemra, tmerrohej kur mendonte se mund të vdiste ndonjëri për paaftësinë e saj. Po praktika që kishte bërë në Tiranë, ku kishte pasur përfundime të mira, i jepte zemër; sido që ajo nuk i largonte dot krejtësisht shqetësimet.

Megjithëse nuk tha asnjë fjalë, asaj i erdhi keq kur në mëhallë, pranë shtëpisë së tyre, u sëmur një fëmijë e vogël dhe dëgjoi këtë bisedë të dy grave:

— E kemi keq djalin, me temperaturë. Do dërgoj njeri në poliambulancë.

— Pse, moj, nuk i thua Teftës së Sanos? Thonë se ka dalë doktoreshë e mirë...

— Teftës? Po ajo është e re, pastaj tani sapo mbaroi. Nuk lë unë të bëhen berberë në kokën time...

Kur dëgjoi këto fjalë, Tefta u largua e zemëruar dhe qëndroi për një kohë në dhomë. Po nuk qau si përpara. Në siptal kishte kaluar mjaft çaste mallëngjyese, të vështira, kur njerëzit qanin, kur të vdiste njeriu përpara syve. Në fillim ishte tronditur, ishte përlotur edhe ajo, nuk kishte ngrënë, po pak nga pak zemra i qe forcuar. Kjo shprehej edhe në vështrimin e saj të matur e më të qetë.

Ditët e pushimit Tefta i kalonte më shumë në shtëpi. Lidhte kokën me shaminë e bardhë të s'ëmës, fshinte dhomat, ndihmonte në kuzhinë; nganjëherë vinin gramafonin,

që e kishte blerë i ati para ca kohësh për t'u bërë qejfin fëmijëve dhe mësonte Gëzimin të kërcente. Ai i hidhte çapet të mëdha dhe gjithnjë i ngatërronte këmbët, gjë që i jepte shkas Teftës të qeshte e të bënte shaka me të vëllanë. Pastaj ajo vinte rrotull nëpër shtëpi e këndonte. E ëma, duke larë enët e duke gatuar, e dëgjone të bijën e kënaqej që më në fund shtëpia nuk ishte më e shurdhër, si disa vjet me radhë. Në këngët e Teftës plot gaz e mallëngjim ndihej një ëmbëlsi e dhembshuri vajzërore, dëshirë herë e drojtur dhe e dyshimtë, herë e zjarrtë dhe e fuqishme për të dashuruar. Ato ishin këngë të pritjes së dashurisë, të veshur me fantazi, ishin këngë shqetësimi...

I ati i Teftës, Maksuti, kthehej në shtëpi më i qeshur se zakonisht; sillte në dorë fruta. E ruante çupën në sy dhe herë pas here përsëriste:

— Edhe pak ditë të mbetën.

Nganjëherë, pasi mbaronin së ngrëni, thoshte:

— Vëreni njëherë atë gramafonin!

Kështu kalonte koha. Tefta ndiente gjithnjë se po i afrohej dita e parë e punës dhe shqetësimi i shtoej.

\*  
\*  
\*

Nga mesi i natës trokiti dera, një trokitje jo e fortë, po e shpejtë dhe e shqetësuar. Ajo zhurmë në fillim sikur mbeti pezull në heshtjen e plotë; askush nuk dëgjoi. Dora përsëri trokiti, tani më fort. I pari e dëgjoi Maksuti, zbriti shkallët shpejt e shpejt me xhakatë krahëve, doli në oborr dhe bërtiti:

— Kush është?

— Hapeni!

E njohu nga zëri: ishte dhëndri i teto Rezmos.

— Ç'ka ndodhur? — pyeti Maksuti, pasi e hapi.

— Na u sëmur aneja. Na falni se po ju biem më qafë, sikur të vijë e ta shohë Tefta.

— Ç'pati e shkreta? Mirë, ja' po e zgjoj.

Tefta u ngrit nga krevati, ashtu e papërmendur mirë,

veshi fustanin, rregulloi flokët me dorë, mori me të shpejtë stetoskopin.

— Do të vij edhe unë, — tha Gëzimi, duke u ngritur nga dysheku.

— Ç'do të bësh ti?

— Më mirë le të vijë. Kushedi, të duhet për ndonjë punë. Pastaj, — natë... — tha babai.

Dolën. Tefta pothuajse rendte. Asaj i rrihte zemra për vete të saj. Nuk kishte kohë të mendonte. Pyeste si iu shfaq sëmundja.

...Hëna, e-bija, i qëndronte s'ëmës mbi kokë. Teto Rezmjoja; shtrirë në dyshek mbi një minder, ishte bërë dyllë në fytyrë e rënkonte me zë të mekur. Kur hyri Tefta, në sytë e perënduar të plakës u ngjall një fije shprese.

— Eja, moj bijë e nënës! U bë keq tetoja.

— Ç'ke kështu, moj teto?

— Më merren mendtë, s'qëndroj dot në këmbë. Jam bërë ujë në djersë... Nuk e di si më vjen kështu. — Plaka merrte frymë me zor.

— Më mirë mos fol zotrote, — i tha Tefta dhe pyeti përsëri Hënë e të shoqin e saj. Plaka kishte qenë mirë me shëndet, të paktën nuk ishte ankuar; i çante nganjëherë trupi e i dhembte koka, epo, thoshin, pleqëri. Tani kishte disa orë që nuk e ndiente veten mirë. Kërkoi vetë të thërrisnin Teftën, po pandehën se do t'i kalonte shpejt e nuk deshën ta shqetësonin natën.

Ndërsa po flisnin kështu, tetoja mbylli sytë, pushoi së psherëtituri dhe varri kokën mënjanë.

— Ane, — bërtiti çupa e llahtaritur.

— Pusho, së s'ka gjë! — i dha zemër Tefta, ndërsa ishte zbehur për vete në fytyrë. I mori dorën për të dëgjuar pulsën: në fillim u frikësua, se nuk ndjeu gjë, pastaj mezi dëgjoi të rrahura të shpejta, po me një goditje të humbur.

— I ka rënë të fikët! Mos ka qëndruar shumë në diell?

— Po, brodhi sot.

— A e ka matur ndonjëherë tensionin?

— Jo, nuk e ka matur.

Ndonëse Teftës i vinin në kokë shumë emra sëmund-

jesh latinisht, që s'kishin të bënin fare me këtë rast, mendimi befasi iu kthjellua: duhej matur tensioni. Dhe, ndërsa askush nga ata që ishin në dhomë nuk e kuptonte shkakun, asaj i ndritën sytë, u gjallërua menjëherë dhe iu larguan disi drojtja dhe pasiguria e gjeratëhershme.

Plakës i vuri një leckë të lagur me ujë në ballë. Gëzimin Tefta e dërgoi në shtëpi të merrte aparatën e matjes së tensionit dhe shiringën. Ai iku me çape të mëdha, i shqetësuar për plakën e më tepër për të motrën.

Pas pak tetoja erdhi përsëri në vete dhe hodhi një vështrim të vagëlluar. Diç deshi të thoshte, po nuk fliste dot. Tefta kaloi dorën në flokët e saj të thinjur dhe buzëqeshi, duke i treguar kështu se nuk kishte ndonjë rrezik. Plaka filloi të rënkonte.

Gëzimi solli me të shpejtë ato që kërkoi Tefta.

Tensionin e kishte me të vërtetë të lartë: i kishte vajtur 22. Vendosi se duhej hequr gjak. Prgatiti shiringën dhe futi gjilpërën në venë. Në dhomë të gjithë heshtnin, duke shikuar me shpresë mjeken e re, duart e saj të shkathëta. Gëzimi, ndërsa shihte si grumbullohej pak nga pak në shiringë gjaku i zi i teto Rezmos, ndihej krenar për të motrën, ia hidhte sytë me adhurim dhe i dukej sikur ajo nuk ishte motra e tij, me të cilën luanin e grindeshin, po dikush tjetër, një mjeke e rreptë dhe e zonja. Pardashur ai vuri buzën në gaz, po u vrenjt menjëherë, duke menduar se s'ishte vendi për të qeshur.

Pasi mbaroi punë Tefta, qëndruan edhe pak. Plaka tani filloi të çelej, po përsëri rënkonte, ndonëse më të rrallë.

— A je më mirë, teto? — e pyeti Tefta.

— Sikur ma hoqe me dorë, moj bijë, — mezi foli plaka.

Tefta u shkrifërua nga këto fjalë; të gjithë buzëqeshën të lehtësuar dhe vështruan mjeken me dashuri dhe një farë habie. Tefta vuri buzën në gaz, pastaj qeshi duke marrë frymë thellë, gati si një fëmijë, që çuditet edhe vetë se sa i zoti është, ndonëse mundohet të mos e shfaqë këtë ndjenjë.

— Zotrote duhet të mbash pehriz dhe të mos shëtitësh nëpër diell, — tha Tefta.

— Si të më thuash ti, të keqen. . .  
 ... Në shtëpi prindët nuk po i zinte gjumi.  
 — E shëroi, — thirri që nga fundi i shkallëve Gëzimi.  
 Ata e kuptuan çupën në fytyrë dhe u qetësuan.  
 — Ç'pati tetoja?  
 — Nga tensioni. E kishte të lartë.  
 — Po ç'i bëre?  
 — I hoqa pak gjak. E lehtëson.  
 — Ia hoqe, ë!? — pyeti i ati, i kënaqur.  
 — Mirë që të vate në mendje, moj korbë! — foli nëna  
 dhe, duke mos e përmbajtur dot gëzimin, e puthi në të  
 dyja faqet.

— Shkoni flini tani, se u lodhët.

... As Teftën, as të vëllanë nuk i zinte gjumi. Teftën  
 e përkëdhelte një ndjenjë lumturie, që nuk e kishte pro-  
 vuar ndonjëherë. Ajo e dinte fare mirë se nuk qe e vështi-  
 rë: ta gjeje atë sëmundje dhe të merrje masat e duhura.  
 Po sidoqoftë, puna qe se nuk u turbullua, e përmirësoi  
 gjendjen e së sëmurës. Kushedi ç'mund të ndodhte me të.  
 Dhe mëhalla do të mbetej pa teton plakë, që ecte me shkop  
 në dorë dhe që u jepte të gjithëve këshilla. Çudi! Si kishte  
 menduar ajo e si doli në të vërtetë! Kurrë s'i kishte shku-  
 ar në mendje se do ta niste kështu punën e saj, se do të  
 shëronte teto Rezmon, që e njihte dhe e donte prej fëmijë-  
 risë, që e kishte pranë shtëpisë së saj. Një ndjenjë më e  
 madhe dashurie dhe mirënjohjeje i lindi për plakën që  
 trokiti e para në derën e saj. .

— Teftë, — pyeti nga qoshja tjetër e errët Gëzimi, —  
 pse e kishte gjakun aq të zi teto Rezmoja?

— Fli tani, ku të shkon mendja!

Kur po i mbylleshin sytë, Teftës iu bë sikur trokiti  
 përsëri dera. U përmend e trembur. Asgjë nuk ndihej.  
 Pataj e zuri gjumi dhe prapë ndjeu në ëndërr sikur një  
 dorë e madhe i binte derës me forcë. Po kjo nuk e zgjoi.  
 Ndonëse turbull, në gjumë, Tefta e ndiente se kjo ishte  
 trokitja e njerëzve në dyert e saj, trokitja e shpejtë, e  
 shqetësuar e plot besim që do ta shoqëronte gjithë jetën.



## DRITERO AÇOLLI

### PASHAKOJA DHE BIJTE E SAJ

Ky dy ditë që jam në Pirr të Korçës, në shtëpinë e Pashakos, një grua që po i afron të tetëdhjetat. Ditën, në odën përdhese, kur të gjithë shkojnë në ara e në kopshte, Pashakoja, që të mos mërzitem, më tregon historira me zërin e saj të ulët — të ulët... Unë rri pranë saj. Përballë nesh rri Naimi, i biri i Pashakos, një burrë nja gjashtëdhjetëvjeçar, mbështetur në mur, në një jastek të bardhë. Ndërsa në kuvendojmë, Nuria, gruaja e Naimit bën punët e shtëpisë dhe herë pas herë hyn në odë për të degjuar e për t'u kujdesur për të shoqin.

Në pime duhan dhe Pashakoja tregon për jetën e saj e të bijve të saj, tregon për mbesat e nipërit. Sa herë tregon, kthen kokën nga Naimi e thotë:

— Lodhet, — i ziu, gjithnjë në dyshek! Edhe Nuria lodhet.

Pastaj hesht e pyet Nuriën:

— Po ç'u bë Dajlani, moj nuse? — Dhe mua. — Dajlani punon në gjeologji. E kam të mirë, o bir! Komunist e kam. Eh, për këtë komunizmin, o bir!... Të prishim, o bir, të prishim... Më tha mua Dajlani kur ishte në Tiranë. «Do të vijë një që di të shkruajë historira». «Mirë, le të vijë», i thashë. Ka historia, o bir, ka! Sa e përçolla hipin në universitet në Tiranë, djalin e Naimit, Gurkën... Iku zogu. Po, le të ikë. I zgjuar do të vijë. Mërzitemi pa Gurkën... Po le të mërzitemi, do të vijë!... — më thotë Pashakoja e vështron Naimin të mbështetur në jastek dhe psherëtim.

— Të mesojë, të bëhet njeri... — thotë Naimi.

— Njeri! — thotë Pashakoja dhe më kthehet mua, duke bërë me kokë nga Naimi. — Ja, ky i gjorë s'mbahet mend që kur rri kështu i mbërthyer në dyshek, pa këmbë e pa duar. Këmbët i ka, por s'i punojnë, duart i ka, por s'i punojnë... Djalë e kam, më dhimbset. Po shyqyr iu rritën çupat e djali. Ja. Virgjinusha është mësuese. Ja, Skënderia punon në kooperativë, në pemët. E kanë bërë edhe komuniste. Komuniste, o bir, komuniste! Nëna ka hequr për komunizmin! S'tregohen të gjitha! Im bir, Naimi, ja ai atje në jastëk, ka hequr për komunizmin. Nuria, nusja e tij, ka hequr për komunizmin! Të kishin gojë këto mure, sa do të tregonin, o bir! Edhe kjo e zezë ç'ka vojtur! — Pashakoja tregon me kokë Nurien që rri pranë të shoqit. Ajo është një grua rreth të pesëdhjetave.

## 2:

Dalngadalë në odë bie mbrëmja dhe ndizet llamba elektrike. Ne rrimë e kuvendojmë. Radio-Tirana jep lajmet. Në Vietnam përpjekje. Në Kamboxhia përpjekje. Në Aman përpjekje. . .

— Vriten, o bir, vriten! Po ja edhe ne jemi vrarë, por e sheh si fituam? U vramë, o bir, për komunizmin, por prapë mirë na doli. . . — tund kokën Pashakoja duke dëgjuar radion. — Ja, unë kisha dy djem si diva, Tafilin dhe Mehdinë. U vranë partizanë djemtë e nënës! Tafili u vra më 1942, Mehdiu u vra më 1943. U vranë divat e nënës! Por ka djem nëna. Mbeti nëna me Naimin e me Dajlanin. Naimi ka këmbë por s'i urdhëron; ka duar, por s'i urdhëron. Rri Naimi e vështron nga dritarja. Bukuri shumë ka jashtë dritares, por s'vetë dot Naimi andej nga bukuritë. Rri në dyshek dhe çupat e gruaja i tregojnë për bukuritë që shohin. Dhe dëgjon Naimi. . . Edhe unë i tregoj Naimit për bukuritë. . . Eh, more bir! . . .

E vështroj këtë nënë të dashur dhe mendoj se si t'u tregoj njerëzve për jetën e saj dhe për jetën e djemve. Kjo është një dramë e madhe heroike. Fillon kjo dramë më 1942. Ishte gusht e toka përvëlonte. Çeta partizane kishte

zënë pritë në Grabovicë, buzë xhadesë automobilistike. Në këtë çetë të vogël ishte edhe djali i Pashakos, Tafil Rexhepi. Me urdhër të Qarkorit të Partisë, çeta duhej të priste një makinë që vinte nga Korça. Makina ishte plot me njerëz, që fashistët i kishin marrë për t'i internuar në ishujt e Italisë. Çeta duhej t'u binte italianëve për t'i liruar të internuarit. Por, tek partizanët prisnin, korija u mbush me italianë e xhandarë. Të dyja anët e rrugës automobilistike ishin zënë. Partizanët e kuptuan. Ishin tradhtuar. Dhe kështu kishte ndodhur. Pojaku i Petrushës, Shahini, kishte lajmëruar fashistët dhe u kishte thënë se në Grabovicë kishte zënë pritë çeta partizane. Filloi përpjekja. I pari që u vra ishte Tafil Rexhepi, djali i Pashakos. Fashistët e morën, e hoqën zvarë, i ranë me bajonetë në fytyrë e në gjoks... Pastaj e vunë në një makinë dhe të vdekur e shpunë në oborrin e postës së Çeravës.

Një partizan i dërguar nga çeta erdhi në shtëpi dhe u tha se Tafili ishte vranë. Gjithë shtëpia u trondit. Pashakoja me lotë në sy iu kthye të bijve dhe nuses:

— Mos qani. Nuk dua që kujën tonë ta dëgjojnë ata që mbajnë anën e italianëve. U bëhet qejfi. Mos qani.

I dërguari i çetës iu afrua nënës:

— Nënë, — tha ai, — ty të ka ndodhur një gjëmë e madhe. Por mua më porositën të të them se nuk duhet të tregosh se i vrari është djali yt.

— Si? — tha ajo.

— Nënë, ndonjë spiun mund ta njohë se i vrari është Tafili, po hjeri tjetër nuk e di. Po të tregosh ti se ai është djali yt, të tre djemtë do t'i internojnë. Fashistët atëherë do të gjurmojnë se me cilët kishte lidhje Tafili në fshat, ku hynte e dilte. Bashkë me djemtë e tu do të internojnë edhe djem të tjerë. Ti thuaju fashistëve se nuk e njeh. Nuk duhet të na i syrgjynosin djemtë, sepse ne duhet ta vazhdojmë luftën...

— Mirë, o bir, mirë, — tha Pashakoja me dhembje të thellë në shpirt.

Nuk vonuan shumë dhe në oborr erdhën fashistët e xhandarët. Në fund të fshatit, në rrugën automobilistike, priste një makinë e mbyllur. Ata e zunë Naimin, e zunë

Mehdinë, e zunë Dajlanin, e zunë Pashakon e thinjur, i lidhën dhe i morën përpara.

— Na thanë se ai partizani i vrarë që kemi atje në Çeravë është djali juaj, — tha më i madhi i fashistëve.

Pashakoja ngriti kokën lart.

— Nuk kam ndonjë djalë të vrarë, — tha.

— Ta shohësh njëherë, — i tha italianin në fillim me të mirë.

I hipën në makinën e mbyllur dhe u nisën. Naimin e kishin lidhur me Mehdinë, Pashakon e kishin lidhur me Dajlanin, djalin e saj, katërmbëdhjetëvjeçar. Nëna shikonte xhandarët e tundte kokën.

— Le këta, po edhe ju që flisni shqip, more djem, erdhët e më morët mua? — u tha ajo xhandarëve.

Ata heshtnin e ulnin kokën. Vështrimi dhe fjalët e nënës ishin të forta e të rrepta. Para saj ata ndienin frikë.

— Ti je nënë komuniste, — guxoi të thoshte njëri.

— Po ç'të jem, more djalë?

— Pa fjalë, — thirrri italianin tek i dëgjoi të flisnin shqip.

Makina ndali në oborrin e postës së Çeravës. Kur dolën prapa makinës, nëna u drodh por e përmbajti veten. Para saj shtrihej trupi i të birit, trupi i Tafilit. «Bir i nënës, — tha ajo me vete, — si të paskan bërë! Nëna të rriti e të bëri burrë dhe s'mendonte kurrë të të shihte në këtë ditë. Si të të njohë nëna, o bir! Sa vrima paskan hapur në fytyrën tënde të bukur, o bir!» — Asaj iu mblodh një lëmsh në paskan prishur, o bir!» — Asaj iu mblodh një lëmsh në grykë dhe gati sa s'bërtiti, por kujtoi porosinë e atyre të Partisë dhe e gëlltiti këtë lëmsh.

— Është djali yt? — pyeti fashisti.

— Nuk është imi. Ai është i gjithë Shqipërisë, — tha nëna.

— Nuk është yti?

— I gjithë Shqipërisë, — përsëriti Pashakoja.

Atëherë fashisti zgjati kamxhikun dhe i ra nënës në fytyrë në sy të djemve. Djemtë e saj, të lidhur, iu hodhën përsipër italianit, por i kapën të tjerët. Ishte e rëndë për djemtë ta shihnin nënën të poshtëruar.

Pastaj të katër i futën në postë dhe filluan t'i rrihnin. Djemve u fushin spica në thonjtë, nënën e godisnin me kamxhik. Tërë natën i rrahën. Tërë natën nuk i lanë të flinin. Mëngjesi u gdhi me të rrahura.

Sa zbardhi dielli, të katër i nxorën të torturuar në shesh të postës, ku ishte shtrirë Tafili. Pashakoja shikonte: «Këtu të lanë, o bir! Të paska mbuluar vesa, o bir! Pse nuk ia hapën këto plagë nënës, po ty, o bir! Nëna mbloodhi kothere buke në të pasurit që të të rriste, o bir! Ti je imi, je copa e shpirtit tim, o bir!»

— Yti, është ky? — pyeti italiani përsëri.

— Jo. I të gjithëve!

— Vëllai juaj është ky?

— Jo. I të gjithëve!

— Ç'njerëz qenkeni!

— Në s'është yti, kapërceje, atëherë, — tha italiani.

Nëna ishte lodhur e torturuar tërë natën. Po kjo ishte tortura më e madhe. Më mirë ta kishin vrarë sesa t'i thoshin ta kapërcente të birin, sepse kjo do të thoshte ta mohlonte...

— Nuk e kemi zakon ta kapërcejmë një të vrarë! — tha ajo.

— E sheh? Qenka yti, atëherë! — tha fashisti.

Pashakoja, e menduar dhe e vrarë shpirtërisht, i shkoi pranë të birit. Ajo mendoi të thërriste: «Është imi, është Tafili im!» — Por kujtoi porosinë e Partisë e heshti. Dhe...

Fashisti nuk u mjaftua me kaq.

— Po të mos jetë yti, — tha ai, — atëherë zëre për flokësh dhe përpiqja kokën për tokë.

Nëna u drodh si purtekë. Buzët iu nxinë dhe zemra filloi të godiste me rrëmbim dërrasën e kraharorit. Ajo nuk e priste që ata do të arrinin gjer në një kërkesë kaq çnjerëzore. Djemtë e saj, që mezi mbaheshin në këmbë, shtrënguan grushtet.

— E, u drodhe? — qeshi italiani.

— Po si ta zë për flokësh një të vdekur! — tha Pashakoja.

— Qenka biri yt, atëherë!

Pashakoja u ul në gjunjë dhe zuri me dorë flokët e të birit: «Flokët e nënës të bukur, o Tafil! Si të qenkan mbytur në gjak, o Tafil! Si t'i përkëdhelte nëna, o Tafil! Ç'i bëjnë kështu nënës këta të ligj, o Tafil! Unë të linda, po ti je i të gjithëve, o Tafil!»

### 3.

Përsëri i morën dhe i shpunë në postë dhe përsëri filluan torturat. Naimin e zhveshën dhe e vunë në mes të dy krevatëve, ia lidhën për hekurash duart e këmbët dhe filluan t'i binin në shtyllën kurrizore me një zinxhir të hollë hekuri. Nëna mbyllte sytë. Asaj i therte në zemër ky zinxhir. Naimi nuk tregonte...

Edhe fashistët u lodhën nga torturat. Ata, pas gjithë këtyre, u bindën se partizani i vrarë nuk do të ishte i biri i Pashakos, as vëllai i Naimit, Mehdiut e Dajlanit.

Pas disa ditësh nënën e dërguan në shtëpi dhe djemtë në spitalin e Pogradecit.

Naimi ishte nxirë e enjtur që nga thonjtë e këmbëve e gjer në flokët. Ai nuk lëvizte dot.

Në spital i mbajtën nja dy-tri ditë dhe i nxorën në oborr. Të tre, të shtrirë njëri pranë tjetrit, rrinin të palëvizur në diell. Atëherë erdhën fshatarët me tabute, i morën dhe i shpunë në fshat.

Nusja e Naimit atëherë ishte lehonë, tri-katër ditë kishte lindur çupën e parë, Myneverin (sot Myneveri jeton me burrin në Tiranë). Të tre i vunë në dyshekë, në odën ku ne bisedojmë. Naimi ishte krejt i nxirë dhe i enjtur, ngatë rrahurat. Nuria mezi e njohu. Ajo qante.

— Mos qaj, motër, ne do të shërohemi! Punë e madhe! Më të fortë do të bëhemi! — tha Mehdiu.

Ditët rridhnin. Në shtëpi vinin shpesh partizanët, për t'i vizituar djemtë e Pashakon dhe ia merrnin ndonjë këngë nga të malit. Mehdiu dhe Dajlani e ndienin veten më mirë, por Naimi ende s'lëvizte dot.

— Më duket se më lanë sakat, të poshtrit! — u thoshte ai partizanëve.

— Do të shërohesh! — i jepnin zemër ata.

— Kam frikë se nuk do të dal dot partizan! — thoshte Naimi.

Ai e ndiente se nga torturat i ishin paralizuar këmbët. Dy vëllezërit. Mehdiu dhe Dajlani, u përcollën me të, u përqaftuan dhe dolën malit partizanë.

— Do të vij edhe unë t'ju shoh. Do të hipë në mushkë e do të ngjitem përpjetë malit, — qeshi ai.

Dhe mbeti Pashakoja vëtëm me Naimin e zënë ulok. Ajo shkonte shtëpi më shtëpi e u fliste njerëzve për luftën partizane, mblihte çorape e fanella për ata që luftonin, thurte vetë me shtiza. Ata që mbanin anën e armiqve i thoshin:

— I more më qafë djemtë, Pashako! Njëri t'u vra, njëri të mbeti sakat. Edhe këta të dy të ikën në mal, do të të vriten.

— Djemtë e mi do ta bëjnë Shqipërinë lule, — thoshte ajo. — Po ju ku do të futeni kur të fitojmë?

Edhe Nuries i thoshin:

— Nurie, ti je e re. Lëre Naimin dhe martohu përsëri. Kush nuk të merr ty? Mos e mbyll jetën me një sakat.

Nuria i vështronte me përbuzje. Si guxonin t'i thoshin këto fjalë?! Naimi për lirinë humbi këmbët. Si ta linte?!

— Më vjen ndot kur ju dëgjoj, — u thoshte ajo.

Dhe Nuria, 28 vjet me radhë, ndenji pranë Naimit, të shoqit. Në kohën e luftës, kur vinin armiqtë e tradhtarët në fshat, ajo e hipte të shoqin në mushkë dhe ikte në mal. Njëzet e tetë vjet me radhë e ndërroi dhe e lau si fëmijë. U robtua pas tij, por nuk e la. E ç'mund të thuash për këtë grua?

Unë rri në mëngjes në odën e mirë, të cilën Pashakoja e quan oda e beharit dhe shkruaj. Nga dritarja vijnë hingëllima e një kali dhe kakaritja e pulave. Kjo më kujton fëmijëtime në fshat. Shkruaj për këtë shtëpi, për Pashakon dhe djemtë e saj, për Nurien trime. Ndërkohë dëgohen hapa e vjen Nuria.

— U zgjove? Të kam sjellë cigare. Shkruaj, bir, shkruaj!

Ajo ulet pranë meje e vështron në fletore.

— Kjo vjehrra jonë, Pashakoja, ka vuajtur shumë. Eh, sa ka vuajtur! Po ka qenë e fortë. Trimë ka qenë.

— Edhë ti je trimë... i them unë.

— Unë? E ç'trimë jam unë! Mua femijët m'u rritën në pushtetin popullor. Me shkollë e me punë m'u rritën. Asaj dy djem u vranë. Pas një viti nga vrasja e Tafilit, në dimër të 1943-së, u vra edhe Mehdiu. E sollën partizanët dhe ne e shtrimë në odën poshtë. Ja, nën këtë odë që fle ti. I gjatë, i pashëm, e kishtë zënë tej e tej odën. E rrinte Pashakoja pranë tij e ia lëmonte flokët dhe qante me ligje. Por e mbante veten e thoshte: «Djali për lirinë u vra, djali për Parfinë u vra!» Jo, jo Pashakoja ka qenë trimë. Djem-të i kishtë si luanë. Tafili ishte edhe i zgjuar, edhe trim. Edhe Mehdiu nuk mbetej pas Tafilit.

Nuria shikon në fletoren time e thotë:

— Do të shkruash për këto gjëra?

— Do të shkruaj, — i them, — por kam frikë se vallë i shkruaj mirë.

— Shkruaj, bir, shkruaj! Prit të të sjell ca mollë, se e ke gojën të hidhur nga duhani.

— Mos u mundo, se do të zbres poshtë! — i them.

Por ajo shpejton. Unë mendoj për këta njerëz të mirë.

Ajo vjen me një tepsi me mollë e kumbulla. I vë mbi një senduk të lashtë dhe ulet pranë meje.

— Po tani jemi mirë. Kooperativën e kemi të mbarë. Nuk e merrnim më mend se do të arrinim këtë ditë. E pe si është panxhari në ara? Po kopshtet e mollëve i pe? Grurë bëmë plot, misër do të bëjmë. U, harrova të të zieja ca misra, më rëntë pika! — dhe Nuria përsëri ngrihet.

Edhe unë ngrihem e zbres në odën përdhese. Naimin e gjej të mbështetur në jastek.

— U mërzite? — më thotë Pashakoja, që rri pranë të birit.

— Pse të mërzitem? — qesh unë.

— Kur të shkosh në Tiranë, thuaj atij djalit tim të mësojë, — më thotë Naimi.

— Ai duhet të mësojë, — i them.

— Jua kam zili... Por edhe ne u përpoqëm. Do të na



mbetej merak sikur të mos vinin këto ditë të bukura. Po erdhën, dhe ne gëzohemi, — thotë ai.

— Erdhën, o bir, erdhën! — thotë Pashakoja dhe tund kokën e saj të plakur.

Kështu kaluan ato ditë në shtëpinë e Pashako Selmanit... Para meje ngrihet figura e saj e pastër dhe e ndritur, siç është figura e nënave tona.

1970.

## DISPONDIA

Fani edhe asaj ditë kishte dalë në sheshin e 19 në  
qendër. Më kohën e mirë që u kthye shpejt në shtëpinë  
të tij, qamur dhe me veshje të shtrita.

Fani nuk ia përbeu për ishite që e përdorin shpesh  
për të shprehur fjalën e tij me një gjuhë të fort  
njohur, të cilëve duhej t'u jepte dritimel e t'u mposhte  
dokumentet. Dhe për të tjerët, me sa duket, sa më shpejt ngri-  
hej në këmbë dhe të paktuar bëhen sikur të mos e kanë  
qëndër nën këmbë. Njëri nga shokërit që kishte mbetur  
këtu mëngjes mëngjes të cilët në mënyrë të humbët po të  
nën ishite e dhanë. Njëra ditë as për post po u tha shpejt  
kështu.

— Ja dhe kjo na tregon një dispondia të fortë. Kjo  
na tregon se t'ia dalë kjo qëpo... të bëj meqenqse kjo  
na tregon se t'ia dalë kjo qëpo... të bëj meqenqse kjo  
na tregon se t'ia dalë kjo qëpo... të bëj meqenqse kjo

Ajo i kishte përveçuar ato u përveçuar të gjithëve  
po kishte vënë në se edhe të tjerët nuk dëshironin të bë-  
nin ndonjë gjë të tillë shokërit.

— Ajo na na givë xortit që na shokërit mori bekime!  
— Ajo na givë xortit që na shokërit mori bekime!

— Ajo na givë xortit që na shokërit mori bekime!  
— Ajo na givë xortit që na shokërit mori bekime!

— Ajo na givë xortit që na shokërit mori bekime!  
— Ajo na givë xortit që na shokërit mori bekime!

— Ajo na givë xortit që na shokërit mori bekime!  
— Ajo na givë xortit që na shokërit mori bekime!

## DISPEÇERJA

### 1.

Fani, edhe asaj dite, kishte dalë si zakonisht herët në punë. Me kohën e mirë, që u kthye shpejt atij mbarimi marsi, puna po vinte duke u shtuar.

Fani nuk ia përtonte, por ishte ca e pamësuar akoma. Ja, në zyrë ishin futur që tani, më ora pesë, katër vetë menjëherë, të cilëve duhej t'u jepte drejtimet e t'u mbushte dokumentet. Dhe njerëzit, me sa duket, sa më shpejt ngrihen, aq edhe më të paduruar bëhen, sikur të mos e kenë gjithë ditën përpara. Njëri nga shoferët që kishte ardhur këtë mëngjes, mund të ta sillte në majë të hundës, po të mos ishte e duruar. Ky s'ia pati as për pesë, po u tha shokëve:

— Ja dhe kjo na duhej, një dispeçere femër. Këtu s'ia doli Taçoja, do t'ia dalë kjo çupë... Po hë, moj çupë, ku e ke fletëshërbimin tim? E di për ku do të nisem unë sot? Për në Çinmaçin. E di ku bie Çinmaçini ti?

Ajo i kishte buzëqeshur, siç u buzëqeshte të gjithëve, po kishte vënë re se edhe tre të tjerët nuk dukeshin të kënaqur, ndonëse njëri prej tyre i tha shokut:

— Aman, se na grive zorrët që me sabah, mor i bekuar!

— Andaj e quajnë Bekim, — tha një tjetër.

— E bekoftë perëndia, që s'i besojmë, Bekimin tonë, — tha i treti.

Bekimi u nxeh edhe më shumë, se e vunë përpara në të tillë mënyrë.

— Unë ju griva zorrët, hë! Po kjo, more, që më ka këtë zë grifshë?

— Deshe zërin e Taqos ti me sabah, zë basi. Apo s'më kujtonte atë papa Sofronin e kishës sonë në fshat. Apo s'më kish edhe ato huqe. Papa Sofroni ka qenë lule para Taqos sonë. Po t'i lëmë llafet. Fletën time, moj shoqe, se po bëhemi vonë.

Vërtet si të grifshës e kishte zërin Fani? Vajzës nuk i dukej ta kishte zërin si të grifshës. Bile një shofer, që ditën e parë që ajo nisi punën si dispeçere në park, i kishte thënë:

— Po ti na ëmbëlsove mëngjesin me këtë zë, moj shoqe. Po bërtit një çikë, që të dukesh autoritare, se këtu, dëgjo mua ti, ca autoritet duhet dhe duhet shumë, dhe autoritetin, po nuk bërtite ca, dëgjo mua ti, zor se e arrin, të paktën këtu në parkun tonë. Pastaj, ne ishim mësuar me atë zërin e Taqos, që më bërtiste si një xhandar. Po ti s'e di se ç'kanë qenë xhandarët, moj bijë, që të të flas unë për ta. Ti je e kohës së Partisë.

Fani buzëqeshi me vete si zakonisht, edhe duke menduar se zërin nuk e kishte si të grifshës, edhe duke kujtuar ato që i tha ai shoferi, i cili ishte ndër më të vjetrit e parkut e që kishte një emër që vajza e dëgjonte për të parën herë: jo Zeqir, po Zeqirja.

— U bëmë vonë, nxito pak, — i tha me të fortë njëri nga të katër shoferët që prisnin në zyrë, kurse ajo i kishte mbaruar gjatë asaj kohe të katër dokumentet e tyre e ua dha shpejt e shpejt, me një shkathtësi të tillë, sa dhe ai shoferi që do të shkonte në Çinmaçin, bëri çudi, hapi sytë e tij të veckël e vërshëlleu i kënaqur.

Shoferët dolën e ajo bërtiti nga pas:

— Udhë të mbarë!

Ata u kthyen e futën që të katër kokën te dera, të katër me një si gëzim fëmijnor, e thanë: njëri «rri me shëndet», dy të tjerët «faleminderit», Bekimi «mirupafshim, shoqe e dashur», duke i shkelur edhe syrin.

«Tani e teproi», — tha me vete vajza, po asaj i duhej doemos të mësohej me shumë gjëra midis këtyre shofereve dhe, të ishte me kaq, faleminderit.

— Miremëngjes, — tha me zë të ulët një shofer i ri që hyri.

Ajo ishte duke folur me shefin e planit në telefon dhe i buzëqeshi të porsaardhurit e i bëri me kokë që të kuptonte se shpejt do të merrej me të.

Shoferi filloi të luante me duart e tij, të cilat i fërkonte e herë i ndrydhte, sikur të donte t'i nxehte e t'i shkathtë.

Ishte një djalë pak si i gjatë, lëshvërdhë, me fytyrë të skuqur nga dielli, ashtu siç i skuq ca fytyra dielli dhe nuk arrin t'i nxijë. Sytë i kishte shumë të çelur, iu duk Fanit. Ai e mbante trupin drejt, sikur të ishte kthyer atë kohë nga ushtria. S'kishte arritur të rruhej mirë në mëngjes, se aty-këtu i ndriçonte ndonjë tufë me qime të kuqërreme, që s'i kishte zënë brisku, ndërsa të nofulla i kishte hequr nja dy fasha lëkure dhe gjakū ishte piksur në to.

Fani fliste, shoferi hidhte nga vajza ndonjë sy të rrallë e të shpejtë dhe prapë merrej me duart e tij.

Shefi i planit vërshëllente nëpër telefon e dukej se ishte ngritur shumë mahmur atë mëngjes. Sigurisht, ai nuk telefononte që nga zyra, po që nga shtëpia, kushedi për çfarë halli. Vajza kishte rrudhur ballin e s'e dëgjonte me qejf, se ai i thoshtë edhe ndonjë fjalë të thartë, tani sa pa hapur mirë sytë. Shoferit të ri i zinte veshi diçka dhe e merrte me mend se shefi po grindëj matanë telefonit. Ishte i njohur shefi në park si njeri që grindëj.

Djalit i ërdhi keq për këtë vajzë që na ishte gjendur në zyrën e dispeçerit tani më të aguar, kushedi se si e për çfarë pune. Mos që vajza e Taqos kjo? Kishte vajzë Taqoja? Ai i buzëqeshi asaj, ashtu me një farë turpi, që e kishte të natyrës së vet, kur u drejtohej njerëzve. E pyeti:

— Të lutem, moj shoqe, mos e ke parë dispeçerin? S'ka ardhur apo ka dalë nga zyra?

Vajza u duk e çuditur dhe ia bëri me dorë se ja, po mbaronte, zëri i shefit të planit e forcoi vërshëllimën në telefon, u dëgjua kërcitja e aparatit, që u mbyll me inat përtej telit, vajza shfryu buzët, po gjithnjë e qeshur, me gjithë ato që kishte dëgjuar, dhe e pyeti shoferin lëshvërdhë:

— Për kë do niseni, ju lutem?

Djali ngeci pak e pyeti:

— Shoku Taço nuk është këtu?

— Vendiin e shokut Taço e zura unë, kam tri javë, — tha vajza.

Ai e tregoi vajzën me gisht, duke dashur t'i thotë «ti je dispeçer?», kurse ajo pohonte me të tundur kokën e veç e qeshur, «po unë», duke shpjeguar pastaj me zë:

— Tani më kenë mua dispeçere. Më quajnë Fani, Fani Dako. Ju lutem, për ku shkoni ju? Emrin si jua thonë? Mos është hera e parë që vini këtu këto tri javë? Apo tani jeni emëruar shofer në parkun tonë?

Atij i erdhi për të qeshur me ato fjalë, «jeni emëruar shofer», po nuk e kishte zakon të qeshte me zë. Ai dinte vetëm të ëmbëlsonte sytë e kaltër e të shtrëngonte pak buzët, kur buzëqeshte. I tha:

— Kam tre vjet në parkun tonë. Këtë muaj që shkoi, isha për ndihmë në transportin e hekurnikelit, Çervenakë-Elbasan. Mbrëmë jam kthyer që andej. Prandaj...

— Të më falni. Unë, të them të drejtën, ju mora më shumë për një shofer që sapo nis nga puna, — tha dispeçerja e se si bëri një gjest, që ai e kuptoi se deshi t'i thoshte që, me atë qëndrimin e tij pak të druajtur, vajzës iu duk ashtu vërtet. — Pastaj ju dukeni vërtet fare i ri, — tha dispeçerja.

Atij i hipi një të kuq edhe më i madh në fytyrë, gati ashtu si atë muaj, ku pluhuri i hekurnikelit e skuqte aq shumë, sa një shofer nga Korça i kishte thirrur «indian» dhe emri i kishte mbetur tërë atë muaj pune me hekurnikelin. Prit kur t'i mbetej nofkë, së e kishin thirrur me atë emër disa herë edhe nja dy shokë të tij.

— Për ku do niseni sot? — e pyeti vajza.

— Për Fan të Mirditës, — tha ai, që s'i kishte ikur akoma të kuqtë.

— Për Fan? Po, po, — vështroi ajo një hartë të madhe të Shqipërisë, mbi të cilën kishte ngulur disa flamurë të kuq, që shënonin vendet ku udhëtonin shoferët e parkut. — Ja ku bie Fani, — u ngrit e shkoi gishtin vajza mbi një vijë blu, që tregonte lumin prej derdhjes së tij në Mat e gjer te burimi pranë Kukësit.

Shoferi hapi sytë nga harta, e cilë s'kishte qenë aty

në kohën e Taqos. I pëlqeu kur e pa hartën me flamurët e vegjël të kuq, po dhe i erdhi për të qeshur, as ai nuk e kuptoi përse, dhe u përmbajt.

E kishte marrë seriozisht punën e dispençerit kjo çupë. Po vërtet, a mund ta bënte një femër punën e dispençerit, «midis shoferëve, në këtë gjurulldi të vërtetë lëvizjesh, midis shoferëve», — përsëriti ai me vete, — dhe që s'ishin shtatë apo dhjetë, po shtatëdhjetë e njëqind, e pastaj, tur-lisoj.

U vrenjt leshverdhi e shikoi vajzën si me drojtje. Ajo që dinte vetëm të buzëqeshte, me sa dukej, — i buzëqeshte edhe shefit të planit, bëj hesap ti, që të vërshellen në vesh që më ora pesë të mëngjesit, — ajo e pyeti:

— Si ju quajnë?

Atij i erdhi për të qeshur, se me «ju» s'i kishte folur njeri kurrë. Bile Taqoja e kishte bërë zakon t'i thoshte dhe «humbameno», — «e more humbameno, e solle kokën?» — Në të tillë mënyrë e kishte bërë zakon ta priste Taqoja, kurse kjo çupa, me siguri, edhe sikur tërë bota të nisin e ta thërrisnin «indian», kishte për t'i thënë «urdhëruat gjë, shoku Çlirim?»

— Më quajnë Çlirim, Çlirim Mëraja, — nxitoi më në fund të përgjigjet ai.

— Duket se keni lindur me Çlirimin e vendit, — komentoi vajza e tha: — E dini se kujt i themi ne mërajë andej nga Gramshi? I themi një luleje, që e preferojnë bletët e jep mjaltë të mirë.

— Gramshiote jeni ju? — e pyeti ai, duke u skuqur e duke dashur ta kapërcente atë punën e bletëve dhe të mjaltit, që se si i tingëlloi. («Ç'hyjnë bletët e mjalti këtu?» — tha me vete).

— Gramshiote, nga Kodovjati, — u përgjigj vajza. — Mos jeni dhe ju nga krahinat tona?

— Jo, — tha ai. — Po kam udhëtuar disa herë andej këta tre vjet. Ka pasur një rrugë shumë të keqe Gramshi. Tani po mbarojnë asfaltimin dhe diç e kanë edhe korrigjuar. Shpëtuan.

— Kam dëgjuar, — tha vajza. — Kur të kem pushimet, do vete. Edhe Gramshi ndryshoi shumë, u bë goxha qytet.

— Goxha.  
 — Po andej nga Fani, ku shkoni sot ju, vetëm pyje ka?  
 — pyeti vajza.  
 — Pyje, kantiere, kulla, kullota.  
 — Larg shumë, — tha ajo.  
 — Larg.  
 — Rrugë e keqe.  
 — Ashtu-kështu.  
 — Po s'jeni i lodhur shumë këtë muaj, që do bëni menjëherë atë udhë? — pyeti vajza me një si keqardhje për të.  
 Çlirimi rrudhi krahët.  
 — Po të doni, — tha dispeçerja, — mos u nisni sot.  
 Ajo kishte në zë një farë ngurrimi, se iu duk pak si e tepruar që ta kthente nga puna një shofer, tani që sapo ishin çelur mirë udhët e malësive, pas dimrit të madh që bëri.

— Më mirë të nisem, — tha Çlirimi.  
 — Sot mos e mundëni veten, — tha si pa dashje vajza.  
 — Ashtu do bëj, — tha djali. — Do qëndroj në Rubik apo tek Ura e Fanit, do bëj një sy gjumë dhe vetëm pas dymbëdhjetës ose pas dyshë do nisem.  
 — Po të jeni shumë i lodhur, mos u nisni sot, — mori guxim e i tha e vendosur dispeçerja.  
 Ai tregoi me kokë telefonin, duke dashur t'i thotë se shefi i planit ishte nevrrik njeri.  
 — Do nisem, — tha. — Të falem nderit.  
 — Urdhëroni fletëshërbimin, shoku Çlirim, — i zgjati dispeçerja dokumentin, të cilin e kishte mbushur gjatë bisedës, — Udhë e mbarë!

Ai përshëndeti me kokë, duke e parë vajzën si nga poshtë, me sytë e tij të druajtur, kurse ajo, edhe kur ai shefi i planit vërshëllente në telefon, nuk e hiqte nga fytyra buzëqeshjen.

Kur po vinte Çlirimi këmbën jashtë derës, vajza i foli prapë:

— Shoku Çlirim, ju lutem të më falni, po a mundem t'ju pyes për diçka? Unë jam e re këtu dhe s'jam e informuar për të gjitha. Mund të më thoni se ku bie ky Çinmacini, se nuk e gjej në hartë. Në Fan bie, apo gjetiu?

Djali hapi fort ata të dy sytë e tij të kaltër dhe mbërtheu më kot gojën me pëllëmbë, se nuk e mbajti dot gazin që i shpërtheu. Luajti dy-tri herë dorën tjetër, si për të thënë «lëre, lëre!», kurse vajza mbeti shtang, me buzëqeshjen e pashlyer në fytyrë, dhe mezi e pyeti:

— Shumë larg bie?

— Në fund të dynjasë, — tha ai, mbërtheu dhe një herë gojën me pëllëmbë dhe doli me nxitim.

— ...

— ...

## 2.

Çlirimi i hipi makinës e u nis.

Përpara tij ishte nisur një tjetër. I ra borisë në mënyrë që të kuptoheshin, tjetri iu përgjigj me borinë e vet dhe u siguruan të dy se për në Fan shkonin.

Boria e shokut përpara filloi tani të binte me shenja të tjera, kur ata dolën nga qyteti e morën udhën e Vorës. Ai s'po kuptonte ato shenja. Po mbase shoku donte të dinte se përse ishte vonuar, se Çlirimi kishte mbaruar punë përpara tij të dispeçerja. Mbese donte të thoshte gjë tjetër. Çlirimi s'po merrte vesh. Stopi i makinës së shokut nisi të çelej e të mbyllej shpesh prapa dhe ai kujtoi se shoku deshë t'i hapte rrugën, po shoku nuk e la të kalonte dhe e mërziti me atë dritë. E mërziti me dritën e verdhë nga e djathta, nisi ta mërziste edhe me të majtën.

— Kur arritën në Vorë dhe e gjetën të mbyllur kalensën mbi hekurudhë, shoku zbriti nga makina e tij dhe erdhi te Çlirimi.

— Ke ta ndezim? — e pyeti.

Çlirimi nxori e i dha një cigare, mori dhe një për vetë e e ndezën.

— E pe ç'kokonë na kanë sjellë dispeçere? — foli shoku.

— M'u duk vajzë e mirë, — tha Çlirimi.

— Se mos thashë që është e keqe. Të paska hyrë në sy, qerrata, — e shtyu me gisht në sup shoku.

— M'u duk vajzë e mirë, — u përgjigj Çlirimi.

— Mos të prishi mendjen e nuk m'i kuptove dritat fa-



re, që t'i shkela tërë udhës? Qerrata indian! — tundi ai koken e i shfryu tymin e duhanit në fytyrë. — Unë do ta shtie në dorë atë vajzë.

Çlirimi se si e pa dhe u vrenjt.

— E vë më bast? — e pyeti tjetri.

— I!k, more Qano, se u çel rruga, — e largoi me dorë ai.

Qanoja u largua, Çlirimi ndezi makinën e nuk priti, po e nisi menjëherë e e kaloi shokun.

Filloi midis tyre një si garë shpejtësie. Çlirimi e pa më në fund se e kishte tepruar, dhe me kë? më një të papërmbajtur si Qanoja. Ku drejtin i qëlloi rruga me të sot? Do ta linte ta kapërcente dhe do të përpiqej të qëndronte sa më pas tij, se, përndryshe, do t'i bëhej ferrë. Nuk do të flinte as në Rubik apo tek Ura e Fanit këtë. Rrëshenit, po më këtë, veç që të ndahej nga ky Qanoja.

Qanoja e kapërceu duke e çmendur me porinë e tij e duke i bërtitur:

— Indian i qerratit! Unë do ta shtie në dorë atë çupërlinë! Të më shohësh! — dhe nisi t'i celte e t'i mbyllte me nervozizëm dritat e verdha pas.

Jo, s'e kishte lehtë ajo vajzë si dispecere. Ç'drejtin kishte dashur në këtë punë? S'ka punë të tjera për vajzat? Vajzë dispecere! Dispecere duhej të ishte ndonjë Taqo. Sigurisht, të mos ishte batakçi e i poshtër si ai. Po Taqo të mirë gjenden. Një vajzë dispecere, ku ishte gjendur?

Ky drejtori i tyre, origjinal, njeri kishte qenë gjithmonë. Të tilla bënte herë pas here, Prit kur t'i mbushej mendja ndonjë ditë e të krijonte një brigadë shoferesh me kamiona dhe t'i niste për Fan, për Martanesh e për Bëshnicë. Nuk e kishte mbushur me femra shërbimin teknik të parkut? Kater-pesë vajza ishin atje, kush për tapicerinë, po kush edhe në torno dhe axhustatore. Tani na kishte emëruar një dispecere femër!

Po kjo, si kishte guxuar? Tuafe vajzë. Dhe sa e sjelle! Me sjelljet e saj, ndonjë djali të urtë, si Çlirimit vetë, mund edhe t'ia hante zemrën, po me Qanot, me Qanot duhej një Taqo, e jo vetëm me Qanot, se nevrinë ka, dhe zevzekë, të pabindur, pa dhe gojëleshuar, të paduruar e të prapë. Ka dhe të ligj.

Si thoshte drejtori? Që kur kishte futur këmbën në park, që atëherë i buçisnin veshët natë-ditë dhe kishte humbur gjumin. Po drejtori e kishte zakon të qajej pak si tepër, se shoferët, fundi i fundit, i donte, dhe Qanot e të tjerët, ta zëmë, ca si Dhosi apo Zisi, nuk qenë shumica. Prapë, dy-tre Qano e tre-katër Dhosë e pesë-gjashtë Zisë, çdo park i ka e mund të ketë edhe më shumë. Parku i tyre kishte ndoshta edhe më shumë. Po një dispeçer femër ç'kërkonte midis tyre?

Vërtet ai drejtori i tyre ishte njeri origjinal.

Po a kishte njerëz të saj kjo dispeçere? Kishte prindër, vëllezër, motra? Ai, sikur e motra të kërkonte jo dispeçere të bëhej, po dhe çdo punë që të ishte në një park, makar edhe tapiciere, makar edhe normiste, nuk dinte se ç'kishte për të bërë që t'ia hiqte nga mendja. Dispeçere? Kurrë! Mund edhe të kishte përdorur forcën, për besë, mendoi me vete dhe sikur iu turbullua gjaku i tij i butë.

Po ku ta dish? Mbase nuk kishte njeri fare ajo çupë, ishte ndonjë jetime, e dalë nga ndonjë befortrof, mendoi Çlirimi e i erdhi keq për vajzën. S'dinte ç'është kjo botë ajo. Si e pyeti? Ku bie Çinmaçini? Djali filloi të qeshte me zë në kabinën e tij. E pandehte Çinmaçinin në Fan! Hajde dispeçere, hajde! T'i thoshte «ja ku bie Çinmaçini, moj shoqe dispeçere, përtej Fanit të Vogël», ajo kishte për ta ngulur flamurkën e kuqe mbi atë vend të hartës dhe kishte për të shkruar aty «Çinmaçin»!

Tuafë dispeçere! Djali qeshi me zë, kur pa se makina e Qanos kishte qëndruar pas një kthese dhe po e priste. Qanoja mbyllte e çelte stopet e nisi ta çmendte me borinë e tij. Çlirimi pa surratin e tij ezmer, si prej arapi, me një palë mustaqe dy gisht të trasha e të varura, në pasqyrë, me lëshrat të paqethura prej muajsh, që të jetë i modës, i shkeli gazin makinës dhe nisi edhe një herë midis tyre gara e shpejtësisë, gjersa, matanë një kthese tjetër, i ndaloi policia rrugore dhe, për pak, desh-u hoqi nga një latë.

Qanoja u nis përsëri i pari, Çlirimi e la të largohej, po në mendje nuk i hiqej dot dispeçerja. Ndërtonte e çndërtonte jetën e saj, vriste mendjen se ishte apo s'ishte pa njeri, ç'njerëz mund të ishin ata lloj njerëzish që e kishin

lejuar të bëhej dispeçere, si kishte guxuar aq shumë drejtor i parkut, që t'u sillte për dispeçer një femër, vinte në dyshim plotësisht që një vajzë e ëmbël e e qeshur të mund të urdhëronte njëqind shoferë dhe t'i vinte puna mbarë parkut, dhe, pas çdo arsyetimi, që përfundonte kurdoherë në disfavor të vajzës e të parkut, qeshte dhe një herë, se përsëri i kujtohej ajo pyetja e saj për Çinmaçinin. Hajde dispeçere, hajde!

Ai, që s'kishte bërë shaka të tilla kurrë, me të arritur në Milot, e ndaloi makinën pranë librarisë; bleu një kartolinë dhe shkroi mbi të:

«Shoqes Dispeçere, në Parkun Nr. 3 të Kamionave, Tiranë. Të fala nga Çinmaçini, shofer Çlirim Mëraja».

Shkoi dhe e postoi me gjithë mend kartolinën dhe qeshte me vete me zë, duke ecur nëpër Milot, aq sa njerëzit kthenin kokën e e shihnin, kurse njëri lëvizti dorën e gishtat mbi kokë e tha:

— Ka luajtur.

Luajtur s'kishte, po dhe luajtur kishte!

U kthye prapë dhe iu lut postierës, së deshi ta tërhiqte një kartolinë që sapo e kishte hedhur në kutinë e letrave përjashta. Postierja kishte qenë e pasjellë, ajo e priti me këmbët e para, dhe në fund, kur e mërziiti djali, ajo i tha se çelësin e kutisë e mbante drejtorin, i cili na ishte në fshat e nuk kthehej veçse të nesërmen në punë. E pamundur.

I hipi makinës, e ndezi, u nis, i bërë vrer, nuk ndaloi as në Rubik, ku kishte qëndruar Qanoja, as tek Ura e Fanit, po mori të përpjetën për Shpal, i vendosur që as në Bulçar të Oroshit nuk do të ndalej, po, do të arrinte Fanin, do të ngarkonte, do ta bënte natën ditë dhe do të kthehej me mëngjes në Milot e do të priste drejtorin, që ky t'i dorëzonte domosdo kartolinën.

3.

Kur arriti ai të nesërmen në Milot, pasi kishte udhëtuar gjithë natën, ishte tamam ora 7.30, fillimi i orarit zyr-

tar. Në postë nuk gjeti atë gruan e ditës së shkuar, po gjeti një burrë.

— Mës jeni ju drejtori i postës? — e pyeti.

— Unë jam drejtori i postë-telegrafit, — u përgjigj ai.

Kam futur dje paradržekë një kartolinë në kutinë përjashta, po dëshja ta tërheq, se nuk e kam shkruar adresën të plotë.

— Shkruaj një kartolinë tjetër, djalë i mbarë, ajo është nisur që dje, me korrierin e drekës, — tha drejtori dhe shkoi punën e tij.

Ja ç'i kishte bërë ajo postierja nурсëze!

Çlirimi, pikë e vrer, i hipi makinës, po në vend që të merrte udhën e Tiranës, u kthye prapë, e futi makinën në ca plepa buzë Matit, i vendosur që tani të pushonte, se ishte i vdekur për gjumë dhe tërë xhind për atë që i ngjau. Të kishte ta gjente atë postiere ndonjë ditë!

Si do të dilte tani përpara dispeçeres në Tiranë? U turpërua me atë vajzë. Se mos e kishte lehtë ajo vajzë me shoferët, që të nište e ta tallte dhe ai? Pthu! Ç'kishte bërë! Po, si do, t'i dilte përpara? Kush ishte ajo çupë, që ai të tallej, me të? Drejtori, që e kishte zëvendësuar Taqon me një vajzë, sigurisht që të kjo kishte besim të madh, se ishte e zonja, kurse ky, Çlirimi, na bëri një shaka pa vend, ky, që s'dinte të bënte shaka, kurrë!

Ç'do të thoshte ajo kur të merrte kartolinën? Ç'do të thoshin në park, kur të arrinte kartolina e tij, — «të fala nga Çinmaçini, shofer Çlirim Mëraja!» — me emrin të shkruar të plotë, emër e mblëmër bashkë, që të plasnin sytë!

«Thëngjilli i mbuluar!» — do të thoshin. — Bota kanë vetëm llapën, Çlirimi nuk llap, po shkruan e dërgon kartolina, që nga... Çinmaçini! Ja ku e zbuluam edhe Çlirimin. A, qerrata indian, qerrata, që s'e kishin njohur!»

Dhe prit kur t'ia vinin kartolinën në gazetën e murit, që ta këndonte tërë bota! Dhe dëgjoi llafet e botës pastaj ti, dëgjo Qanot e Dhosët e Zisë! Apo nuk ishte dhe ajo normistja, Polikseni, që, pa futur mirë këmbën në park, kishte filluar me atë gjuhën e saj prej piperke dhe nja dy shoqe të vetat i kishte përfolur të gjorët, aq sa për pak,

desh u bë skandal e gurgule e madhe, e njëren prej tyre, të mos kishte qënë kolektivi, shefi i kuadrit do ta kishte dëbuar.

Po sekretari i organizatës-bazë ç'do të mendonte, që i kishte thënë Çlirimit të bënte lutjen e dokumentet gati për t'u pranuar në Parti?

Budallallëk, jo fjalë, kishte bërë! Ishte treguar go-mar i madh!

U vërtit më kot Çlirimi të mbyllte sytë në sediljen e tij. Era frynte dhe bënte të kërcësojnë degët e plepave. Uji i turbullt i lumit rridhte me një zhurmë të shurdhër. Një makinë nisi t'ia shponte veshin aty pranë me borinë e saj. Qanoja ishte ky. Ç'bela e gjeti me këtë të poshtër!

Qanoja i trokiti në kabinë.

— Kë ta nderim?

Çlirimi u ngrit, nxori paqetën, çeli xhamin dhe e nderzën.

— Ç'dreqin pate kështu sonte, more indian? — e pyeti shoku. — Më bëre merak. Nuk m'u qëndrua as në Rubik e as tek Ura, po ndiq ty e ti ik si i marri. As në Bulçar nuk të zura dot, as në Mal Shënjt. Nuk ma degjoje borinë?

— S'e kisha mendjen, — tha Çlirimi, i mërziur.

— Po ku e kishte mendjen ti, tek ajo kokona?

— Qano, mos e mbaj kështu neper gojë çupën e botës. Nuk më vjen mirë. Ti më njuh mua. Pastaj, e kemi shoqe punë.

— A, indian, i derratatit! S'të njihja, po nisa të të njoh. Po ti mos u ngatërro me Fani dispeçeren, degjon? Një çupë që bëhet dispeçerë, merre me mend ti vetë. Ne shoferë jemi, këto gjëra i kuptojmë. Do shohësh kur ta shtie në dorë unë atë bukuroshen dispeçerë.

— Qano, pusho, se po e tepron. Pastaj, pse vjen e më flet mua për këto ti? Të lutem!

— Ama dhe ti me «të lutem», si ajo bukuroshja! Ajo më «urdhëroni», më «ju lutem, shoku Qano». Të shohësh kur ta shtjerë Qanoja në dorë, më «ju lutem, shoqe», më «udhëroni, kokonkë Fani».

Grushti i Çlirimit ia befti kaq shpej nga xhami i çelur i kabinës dhe ra kaq i fortë mbi turinjte e Qanos, sa ky

nuk e mori vesh se si, po veç kur u gjend përtokë dhe ndjeu gjakun t'i rridhte, vuri mbi fytyrë pëllëmbën e i mbeti në gishta cigarja që i ishte shtypur në buzë. Ai rrëmbeu një gur të madh e deshi ta godiste Çlirim, po ky kishte kërcyer nga makina, me manivelon në dorë dhe e kishte përfshirë aq fort për gryke Qanon, sa këtij i shpëtoi guri.

— Çlirim, lësho hekurin! — i bërtiti ai si i çmendur. — Mos! Mos!

— Tjetër herë të mos llomotisësh më poshtërsi të tilla në sy tim për atë dispeçeren e për cilindo qoftë! — e shkundi ai Qanon.

— Po unë jam tallur, more vëlla! Ti s'kupon fare nga shakatë!

— Unë s'kuptoj nga shakatë, — e shtyu tutje Çlirimi. — Hajt, qërohu! — pështyu dhe kërcëu në makinë e u nis.

#### 4.

Çlirimi shkarkoi makinën dhe nuk e dërgoi në park atë natë, nuk vajti as në shtëpi, po fjëti në vendin e shkar-kimit, i vdekur si ishte për gjumë. Megjithatë, gjumi mezi e zuri dhe natën u zgjua dy-tri herë, me atë shqetësimin e madh që kishte për ato që kishin ngjarë.

Tani, jo vetëm që ndiente turp se i kishte dërguar atë kartolinë dispeçeres, — ç'emër i thoshin asaj? Si ia tha Qanoja? Fani. Si emri i Fanit të Mirditës. S'e kishte dëgjuar kurrë atë emër gruaje, — po i vinte inat i madh e turp, se e kishte bërë veten të godiste Qanon. Kishte ndotur dorën. Ta merrte vesh njeri, do të çuditej.

Ky Çlirim i urtë, që s'është dëgjuar kurrë për të keq, që nuk nget as një mizë, që edhe kur flet me njeri, sikur ka turp të flasë, jo më që i ka shkruar e dërguar një kartolinë të tillë asaj Fani dispeçeres, — vërtet, si ngatërrohet ky emri i saj me emrin e Fanit të Mirditës? — që bota do të shkulen në gaz kur ta dëgjojnë, «të fala nga Çinmaçini, shofer Çlirim Mëraja!» — po i ka futur edhe një grusht turinjve atij Qanos. E përse?

Ku ta dish përse? Po këto dy gjëra vallë, a mos i lidh diçka? Mos vallë ky Çlirimi, ky thëngjilli i mbuluar, që s'është ndier gjer tani fare, na u tërbua kaq shpejt pas një femre, pas kësaj dispeçeres sonë Fani, — more vërtet emër të çuditshëm ka kjo vajzë, — dhe bën marifete të tilla, dërgon kartolina me shakaçka, jep edhe grushte pa shaka fare, ngre edhe manivelon e mund ta lërë tjetrin top në vend?

Ai Qanoja i ndyrë nuk do të rrinte pa folur. E merrte me mend Çlirimi se ç'kishte për të thënë e si kishte për t'i qëndisur ato që do të llotoste nëpër shokë.

«S'e njihni Çlirimin ju. Don Zhuan e shkuar Don Zhuanit. Po marroset dispeçerja Fani për Çlirimin dhe na i janë ndezur llambat keq atij vetë për kokonkën. Një fjalë i thashë: «kujdes, ti, Çlirim vëllai, me atë kokonkën, se, fundi i fundit, çupë është dhe, që të ketë marrë atë guxim e të jetë futur dispeçere në parkun tonë, midis njëqind shoferësh, kjo nuk tregon gjë të mirë», një fjalë unë, kurse ai katër grushte, dy me të djathtin, dy me të majtin, apo nuk i ka grushtet topuz, tërë ai Çlirim! Dhe bereqaves me kaq, se më rrëmbeu manivelon e desh ma përsheshi kokën fare, se hundët ja si m'i ka bërë e kam pështyrë dy dhëmbë. Po kur një thëngjill i mbuluar si Çlirimi merr zjarr, larg tij, se djeg dynjanë. Ka për të kërcitur në parkun tonë tani. Lëre ç'ka për të kërcitur!»

I merrte me mend këto të gjitha Çlirimi, merrte me mend edhe të tjera, keq e më keq.

Ta zëmë, që për dispeçeren të nisnin një mijë fjalë, siç e kishte frikën e madhe ai, të merrej vajza nëpër gojë kot, siç e mendoj që në fillim ai, menjëherë pasi bëri atë budallallëkun e kartolinës: — Mor po dhe ajo postierja, ç'grua kishte qenë ajo? — Dispeçeres kishte për t'iu bërë parku ferr, kurse atij po sé po. Ai, domosdo, do të thyente qafën nga parku, mor edhe nga Tirana do të ikte, po të që nevoja, po e shkreta Fani, — mor po i pëlqente ky emër, se gjithmonë i kishte pëlqyer emri i Fanit, Çlirimit, dhe ai vënd vetë, me ato pllaja të larta midis ahishteve, me ato pyje të thella ahu e bredhi, me ato gurra, pastaj me ata barinj e punëtorë të pyllit, me atë kantierin e Xhuxhës, ku gatuhej një bukë, që më të mirë as në Stravanj të Libra-

zhdit nuk e gjen, me atë shakaxhi kamerier që kishte, me atë banakierën e re mirditore, që s'e njihje se ishte mirditore fare, po sikur të ishte rritur në mes të Tiranës e që i kishte thënë njëherë:

— More Çlirim, ju shoferët jeni të mirë, le të ketë midis jush edhe djem jo për të qenë, se pyll pa derra nuk ka. Po ti, more Çlirim, ti sa i miri që je! Si s'je qarë një herë për bukën e për gjellën, si s'je qarë një herë për shërbimin, si s'je degjuar një herë të bërtasësh e të zemërosh, si s'ke pirë një herë më shumë se një dopio raki për darkë, si s'ke ke prishur fytyrën një herë, po më hyn e më del si një nuse dhe unë kam qejf të të shoh si ha e si pi, si rri atje midis shokesh e u gëzohesh lodrave të tyre, s'e prish gjakun e s'merr flakë kur ata e teprojnë, po shikon nga unë e mjeron sytë, sikur të kërkosh falje prej meje, e, unë them: . . . lere, ç'them unë! Ja, po ta them: «Të më thoshte ky Çlirimi një fjalë të mirë, unë do fluturoja!» — Po, unë fluturoj edhe vetëm kur të shoh. Pa më thuaj një fjalë të mirë, more Çlirim!

Ai kishte thënë Çlirimi? I kishte thënë, se Fani i pëlqente mbi gjithë viset e tjera nga ai shkante, se ky qe vërtet një vend pak i ashpër e njerëzia nuk ia dinin dhe kaq jetës si gjetiu, po këta njerëzit këtu, kishte thënë ai, sikur ishin «më safi».

— Po një fjalë të mirë mua, more Çlirim, si s'ma the? — i ishte përgjëruar banakierja.

Çlirimi ishte turpëruar e ishte ngritur.

— Ha, të kegen Mara! — e kishte ndalur mirditorja. — Mos e prish qejfin, mos e prish terezinë. Hiç mos ma thuaj atë fjalë. Ja, ika, vajta te banaku. Do ta pish edhe një dopio raki prej meje sonte? Mos ma kthe dorën.

Ai kishte pasur zor t'i thoshte jo, po e kishte parë me sytë e tij të kaltër e aq të pastër, kur ajo kishte ndier diçka si një mundim që nuk shprehej dot, ishte larguar e i kishte dërguar dopion bashkë me një meze, dhe ai këtë dipio të dytë e kishte pirë me një të kthyer, mezenë e kishte ngrënë me tri-katër kafshita, dhe ishte ngritur e kishte thënë «natën e mirë», pa shikuar njeri me sy, kishte vajtur e kishte fjetur në makinë.



Hëna kishte luajtur për një kohë të gjatë nëpër majat e pishave. Ai kishte ndjekur lodrat e saj majë me majë. Pishat kishin kercitur nga erërat dhe ai kishte renë në mendime. Kishte thënë me vetë se, pa dyshim, një ditë do të martohej. Kur? Akoma jo. Një grua si Mara i duhej, po, sigurisht, që ai ta donte. Po dashurinë ai s'e ndiente akoma, kurse Mara e gjorë, me sa dukej, që guxoi aq fort, kishte kohë që e donte. Si mund të ishte kjo dashuria? Një guxim, patjetër. Ja, si ai guximi i Marës, të klubi i Xhuxhës, në mos edhe më shumë.

C'domethënë më shumë? T'i dërgosh një kartolinë me një shaka të tillë një dispeçerëje, që një herë e ke parë? T'i fusësh një grusht turinjve një Qanojë dhe të rrëmbesh manivelon, që, po ta bëjë të gjatë, t'ia përseshësh kokën?

Iu ngatërruan mendimet Keq. Drëqo punë! Për një bisht dispeçerëje, për një shaka në Milot, për një grusht buzë lūmit të Matit! Mos ishte budallallepsur? Mos po këndonin këndesat e po vinte mëngjesi dhe ai s'kishte vënë gjumë në sy?

Hapi sytë fort. Qielli kishte nisur të çelej dhe yjet s'e ndienin vëten mirë me dritën që përhapej. Ata kleisnin sytë, se, sigurisht, po vinte çasti i perëndimit për ta, çasti i gjumit, kurse atij po i vinte çasti të nisëj përsëri për Fani, dhe s'kishte fjetur dot!

U ngrit, pa orën 4.37. Ndezi cigaren. Më ora pesë mund të shkonte në park. Do të shkonte si pa gjë të keq, le të ngjiste ç'të ngjiste. E ç'mund të ngjiste, fundi i fundit? Ç'ishte bërë? Ç'bëri Çlirimi? Po ta shihte punën se do të trazohej keq për të gjorën Fani, do t'i thoshte:

«Moj Fani, ja ku më ke. Djale i keq fuq jam, një normë e gjysmë e bëj zakonisht, ndonjëherë edhe më pak, ndonjëherë edhe më shumë, për të hyrë në Parti, dokumentet i kam gati. Vërtet, ti je dispeçerë dhe përmbi mua, ndoshta shkollën e mesme e ke mbaruar dhe ndjek uni-versitetin, kurse unë sivjet do jap maturën në degën me-kanike të teknikumit, po ja që kjo punë kështu doli. Në vërtet nuk njihemi dhe ndonjë gjë për shoqi-shoqin s'ke-mi ndier, po njerëzit e mirë merren vesh midis tyre dhe dashuria ka për të ardhur pas martesës, siç thonë babai im

dhe nëna vetë. Pastaj, meqë të fola për babanë e për nënën, të të them se i kam njerëz të mirë, punëtorë, ai shofer në pension, ajo në shtëpi; se dy vëllezër të martuar që kam, të dy në fabrikë i kam, me gjithë nuset; pa një motër e kam daktreshë në poliambulancën qendrore, me burrin, nuk do të të besohet, shofer si unë, — ja ata janë martuar me dashuri, — dhe një tjetër motër, që është më e vogël se unë, e kemi në ndërmarrjen artistike «Migjeni» dhe bën ca qëndizma, që do lësh mendtë pas tyre, se ju, gratë, e keni ca mendjen te qëndizmat. . .»

Po, po, do ta merrte këtë guxim. Nderi ia kërkonte. Dispeçerja, natyrisht, ishte e lirë; ajo le të bënte si të donte.

Po mos ishte e fejuar, në mos dhe e martuar? Ku ta dish? Lëre ç'belara mund të dilnin, sikur të ishte e fejuar apo e martuar! E kishte marrë më qafë! Po Qanoja s'tha një gjë të tillë dhe Qanoja do ta thoshte, po të ishte e fejuar ose e martuar dispeçerja, se Qanoja i di të tëra. S'duhej të ishte as e fejuar, as e martuar. Dhe ai do ta merrte atë guxim.

Ja ky ishte guxim e jo ajo kartolinë apo ai grusht. Me hajr mbase kishte për të qenë kartolina me gjithë grushtin, mendoi ai së fundi dhe ndjeu ta pushtonte një guxim i vërtetë, ndezi makinën e u nis për në park.

Sa ishte ora? Pesë pa njëzet. Bukuri. Dispeçerja do të dilte në punë më pesë, në mos kishte dalë. Ajo sigurisht kishte dalë, me kartolinën te dora, dhe e lexonte pranë dhe i qeshej, — se vetëm të qeshte dinte ajo, edhe kur shefi i planit i vërshtëllente në telefon pa gdhirë mirë, pastaj, për të qeshur që kjo histori e kartolinës, — dhe vajza do ta priste ashtu, pa e prishur fytyrën fare e do t'i thoshte:

«Po ju, more shoku Çlirim, ju ditkeni të bëni shaka, kurse unë ju pandehja djalë të mbyllur! Unë s'kisha dëgjuar kurrë për Çinmaçinin. Mirë ma bëtë. Ja fletëshërbimin, e keni gati. Udhë e mbarë. Mos jeni lodhur ndonjë çikë? Po të ndieni gjumë, ndaloni rrugës. Apo jeni lodhur shumë e s'doni të niseni sot? Mos u nisni, më mirë. Ju shoh, jeni lodhur. Mos udhëtoni sot. Ecni në shtëpi. Edhe makina vetë ka nevojë për pushim».

Ai kishte për t'i thënë:

«Jo, shoqe Fani, do nisem, faleminderit. Do fle rru-gës», — dhe ajo kishte për të buzëqeshur edhe më bukur, kur të dëgjonte se ai tani ia dinte emrin.

Emër të bukur kishte, me gjithë mend: Fani!

Dispeçeren e gjeti në zyrë, ashtu siç e kishte gjetur dhe të djeshmen, të buzëqeshur e që iu përgjigj mirëmë-ngjesit të tij ashtu si dhe një ditë më parë. Po, në çastin që ai hyri në zyrë, hynë edhe dy të tjerë. Ata të dy hynë gjithë zhurmë e mahmurllëk, nisën ta mërznisnin vajzën, të paduruar për të marrë fletëshërbimet, kurse ajo bënte punën shpejt e shpejt e nuk e prishte gjakun fare. Atyre mahmurllëku sikur u doli dhe njëri i tha Çlirimit:

— More indian, po kjo dispeçerja jonë ta ha shpirtin me të mirë!

Vajza qeshi e pyeti:

— Përse e quani indian Çlirimin? Ai është biond, indianët janë të kuq.

Të dy shoferët nisën të gajaseshin. Njëri tha:

— Në, shoferët, moj motër, kur vemi andej nga hekur-nikeli, të tërë si indianë bëhemi. Po këtij njeriu që mezi flet, vetëm këtij ia vunë emrin indian. Ndoshta sepse indianët e kanë gjuhën si ky, me nojma.

Të dy shoferët morën dokumentet e dolën me gaz. Fani i tha Çlirimit:

— Sot ju shoh me çehre shumë të prishur. Apo ju erdhi keq për fjalët që thanë ata shokët që shkuan? Sikur të vijá re unë sa thonë këtu, nuk do të kisha qëndruar jo tri javë, po as tri ditë. Ata të dy janë njerëz të mirë. Natën e bëjnë ditë, nuk pyesin se ku i shpie, po i qëndrojnë punës përsipër dhe, tri javë m'u bënë mua këtu, s'kam dëgjuar të kenë pasur ndonjë defekt të rëndë makine. Pastaj, po me shakanë te buza. Si ju shkon makina, s'ju pyeta?

— Nuk qahem dot, — tha Çlirimi.

— Më vjen mirë, — tha vajza. — Po sot të mos niseni për udhë. Jeni shumë i lodhur.

— Planin e kemi të madh, shoqe.

— Dëgjomëni mua, — tha si më të lutur vajza.

— Duhet të nisem, shoqja Fani, — nguli ai këmbë dhe e ndjeu se i hipi të kuqtë, se shqiptoi emrin e vajzës, duke

mos guxuar ta shihte akoma në sy, po duke luajtur me duart e tij ashtu siç e kishte zakon, sikur kërkonte t'i shkathte apo t'i nixehte.

— Mos ngulni këmbë, — tha vajza. — Unë këtë të drejtë s'e kam që t'ju ndaloj, Çlirim. Po njeriu për njeriun ka ca detyra. Si thoni ju?

— Kam marrë zotime të forta...

— ...dhe me zotimet jeni në ballë fare, — ia preu fjalën ajo.

— Duhet të nisem, — përsëriti ai.

— Unë fletën tuaj e kisha mbushur para se të vinit, — tha ajo. — Ja tek e kam. Po tani që ju pashë në ç'gjendje jeni, tani ja, po e gris, — e grisoi ajo fletën. — Ecni në shtëpi.

Ai kishte ngrirë në vend. Mor po kjo dinte dhe të urdhëronte! Vërtet e grisoi fletën! Po si guxoi? Ai mezi qëndronte në këmbë dhe këtë e ndiente fort, po që dhe ajo t'i griste fletën, kjo a shkonte? S'dinte ç'të bënte. Ndiente sytë e saj se si e vështronin me një mirësi që mund të thyente edhe gurin, e nuk arrinte të ngrinte sytë e ta shihte në sy.

— Ecni, Çlirim, — tha ajo me të butë, — Ecni. Bëni një gjumë të mirë njëherë. Futeni makinën për një kontroll të shpejtë, se s'është keq ta kontrolloni. Ecni, dëgjomëni mua.

Ai u thye fare, ktheu shpinën e u nis të dilte. Te porta ndaloi. Deshi t'i thoshte se, po të merrte një kartolinë, të mos ia vinte re, po s'i bëri goja.

— Mirëmengjes, indian, — dëgjoi zërin antipatik të Qanos, që u afrua të hynte në dispeçeri. — Pa shih ç'më ke bërë.

Çlirimi ngriti kokën e shtrëngoi grushtet, çati ta godiste prapë, po u përmbajt. Hunda e Qanos ishte fryrë e bërë mavi. Qanoja hapi gojën e tregoi një dhëmb që ai ia kishte thyer. I tha:

— S'ta kisha borxh, indian, — dhe u fut në dispeçeri, ku u dëgjua t'i thotë Fanit. Këtë ta kam borxh ty.

— Ç'të ka ngjarë kështu, mor i zi? — e pyeti Fani, e trembur.

— Hiç asgjë, — qeshi Qanoja. — U përmbysa mbrëmë në një hendek atje në Xhuxhë.

— Po makina? — pyeti ajo.

— S'u përmbysa me makinë, po isha bërë xurxull. Kur kthehesha nga klubi për të fjetur, moj kokonë.

Ra e thënë mirë këtë fjalë të fundit, ai ndjeu krahun e fortë të Çlirimit që e rrëmbeu dhe gati e ngriti në ajër, duke i bërë një rrotullim të plotë.

— Dëgjo! — i tha. — Në s'vure mend, ja ku po ta them për të fundit herë. Të dëgjova prapë të thuash të tilla fjalë, të kam për të vdekur! Qen e bir qeni!

— Po unë vdiqa me kaq, more shpirt! — deshi të qesh-te nga halli Qanoja.

Çlirimi e lëshoi dhe doli me rrëmbim.

— Ç'pati? — pyeti shumë e trembur dispeçerja.

— Mos ia vërë re, shoqe. Këta të urtët e kanë nga një damar prej të çmenduri. Është çmendur, çka që dije.

Fani ishte trembur vërtet shumë dhe doli shpejt të de-ra; që të shihte se nga po shkonte Çlirimi. E pa t'i hipte makinës, e të nisej për në garazh, siç e kishte porositur ajo, u lehtësua dhe erdhi u ul përpara tavolinës së vet, duke mos e marrë dot veten akoma, shumë e zbehur e si e shat-sistur.

— E ke gati fletën time, moj ko..., moj shoqe Fani, — u korrigjua në çast Qanoja, sikur të kishte kafshuar gjuhën.

— Urdhëroni, shoku Qano. Me planin jeni, çka prapa, më lejoni t'juaj them.

— Ç'është ajo fjalë, moj shoqe? Kjo është detyra jo-te, — tha ai, heshti pak e foli si me vetë. — Po hunda ime, ç'taksirat?

— Si, thatë? — e pyeti vajza.

Ai doli pa i dhënë përgjigje.

## 5.

Të nesërmen, Çlirimi hyri në dispeçeri po në atë orë dhe gjeti katër-pesë shokë brenda. Njëri prej tyre, që po bënte një shaka pak si të fortë me Fanin, kur pa kush po hynte, e preu shakanë dhe të tjerët heshtën.

— Mirëmëngjes, — tha djali.

— O! ju Çlirim jeni? — e priti e gëzuar dispeçerja. — Ju falem nderit për kartolinën. Mirë ma bëtë. Ku ta dija unë e varfra, se ku bie Çinmaçini? — qeshi ajo plot kraharorin dhe s'e mbajti as Çlirimi të qeshurën.

Ata të dy qeshnin, dhe shoferët shihnin shoqi-shoqin të hutuar. Njëri deshi të bënte hoka e foli:

— Ky Çlirimi i bekuar, ka nisur nga lodrat. Edhe atij Qanos ia kishte luajtur mirë.

— Ç'lojë i luajtët Qanos, more Çlirim? — pyeti Fani, duke mos e ngritur kokën nga shkresat.

Djali i tundi kokën me inat shokut.

— Lodër si çdo lodër. U nis i pari dhe, nxito Qanoja ta arrijë e s'e zuri e s'e zuri dot.

— Prandaj ishit lodhur aq shumë ju dje, Çlirim, — tha Fani, duke u shpërndarë shoferëve dokumentet. — Edhe sot më dukeni shumë i lodhur. Më mirë të mos udhëtoni dhe sot.

— E di ç'bën ti, shoqja dispeçere? — i tha asaj njëri nga shoferët. Nuk e merr e shkon në teatër me të sonte, se ky s'vete kurrë.

— Ç'lozin në teatër sonte? — pyeti si pa gjë të keq Fani.

— Të shohim gazetën, — futi dorën në xhep shoferi dhe nxori e hapi «Zërin e popullit». — «Dasmën» lozin.

— E kam parë, — tha vajza. — Vemi në kinema, Çlirim, po të doni.

Çlirimi ishte gati të lëshonte grushtet mbi sa koka njerëzish që të gjente përpara, po do të kishte dashur edhe më mirë të hapej dheu e të futej.

— Më jep, më jep atë fletëshërbimin, se jam vonë, — tha ai.

— Jeni i lodhur, — tha ajo. — Dukeni. Edhe sot mos udhëtoni. Dëgjomëni mua.

— Me planin je mirë, more Çlirim. Çlodhu dhe sot, — i shkeli syrin një shok. — Pastaj, kur të lutet vetë shoqja dispeçere, ç'kavalier je ti kështu?

— Më jep atë fletë, — zgjati dorën Çlirimi nga vajza dhe ajo i dha fletën, ai doli me vrap e përjashta u dëgjua

makina e tij që u ndez e rrotat e saj që ulërinë pas asfaltit.

— Njeri i çuditshëm, — tha vajza.

— Djalë xhevahir, — tha shoferi që e kishte ngacmuar i pari Çlirimin.

— Po se si është bërë këto ditë, — tha një tjetër.

— Pse, s'e keni parë tjetër herë kështu? — pyeti vajza, pa e fshehur dot një si shqetësim.

— Një herë vetëm, në Xhuxhë, — tha njëri, — kur piu një dopio më shumë.

— Pse, pi? — vrenjti vetullat vajza.

— Kurrë, — tha ai shoferi i parë. — Po kujtdo i qëllon të pijë një herë në jetë. Fajin e kishte një banakiere e klubit.

Fani uli kokën.

— Ishte vajzë e mirë, e varfra, moj dispeçere, po ky nuk e donte. Ajo, që të nesërmen e asaj dite, iku nga Xhuxha dhe vajti në një kantier të Kukësit. Atje mori shpejt një burrë. Ajo i tha se e donte, ky djali ynë u turpërua. Ndoshita dhe s'bëri mirë, se ku e gjen më një grua që ta dojë ashtu?

Fani dëgjonte me një interes që s'e fshihte më dot e përpiquej të zbulonte diçka më shumë në fjalët e shoferit e në vështrimet e njerëzve, po nuk iu duk se zbuloi gjë të madhe.

Mor, po ç'kishte ngjarë këto dy ditë? Vajza vështroi kartolinën «nga Çinmaçini» përmbi tryezë e u turbullua. Të ishte kështu? E pamundur! Po ai një herë e kishte parë. Ngjajnë gjëra të tilla, si nëpër romanet?

I dukej sikur po jetonte diçka krejt të re në jetën e saj dhe hetoi veten se ç'ndiente. Sikur i bëhej qejfi që ai djallë të kishte marrë flakë për të ashtu, me xixën e parë, po dhe më shumë i qeshej e i dukej si një lodër, e stisur ashtu prej vetiu, apo si diçka e pakonceptueshme. Po me një njeri si Çlirimi, ç'mund të mos ngjiste? Ky njeri po i dukej krejt i çuditshëm...

— Të ikim ne, shoqja Fani? — pyeti njëri nga shoferët.

...Dhe kjo situatë po i dukej edhe më e çuditshme.

— Të ikim ne, moj shoqe? — pyeti përsëri shoferi.

— Pse, unë ju mbajta? — u përmeqnd e u turpërua vajza. — Të më falni. Udhë e mbarë.

— Rri me shëndet, — i thanë shoferët.

— Mos të prishëm gjë qejfin? — e pyeti ai që kishte tërëguar historinë e asaj banakierës me Çlirimin në Xhuxhë. Fani bëri sikur nuk ë dëgjoj.

## 6.

Të nesërmen ishte e premte, të pasnesërmen e shtunë. Fani kishte bërë hesapet. Ajo, që i tha Çlirimit të shkonin në teatër apo në kinema, do t'ia thoshte përsëri. Përse të mos ia thoshte? Po të kishte gjë djali për të, do ta merrte vesh kështu edhe më mirë.

Ajo vetë s'kishte gjë për Çlirimin. Fani e dinte veten pak a shumë të prekshme, delikate në ndjenjë, aq të pastër, nga ana tjetër, sa nuk druhej se mund të qëndronte njolla përmbi të. Po dhe këto njollat është si t'i kuptosh. Ç'njollë mund të kishte, sepse një njeri si Çlirimi mundet edhe ta donte, ashtu menjëherë, me një të parë? Kjo nuk ishte punë e arsyeshme, se me rrëmbime të tilla njeriu nuk mund të angazhohet në jetë, mendonte vajza. Po ç'të keqe kishte kështu? Dhe që të mund ta njihte nga pranë atë njeri, i cili, me sa duket, vërtet e donte, përse të mos e njihte? Këto punë bëhen më të njohur, më të afruar. «Ai më do, unë do ta njoh, po ta dua, bëhemi të dy që e duam njëri-tjetrin; po të mos e dua...»

Iu duk se bëri një hesap të keq. Nuk duhej të provokonte asgjë me Çlirimin. Nuk do të ishte mirë. Ata punonin në një park, koha do të bënte të sajën në mënyrë të natyrshme, për këtëj ose për atëj.

— Mirëmëngjes, — tha Çlirimi duke hyrë.

— Mirë së erdhët, Çlirim, — e priti ajo me emocion.

Ai heshti, ajo bëri sikur po i mbushte dokumentin, të cilin e kishte gati.

— Të më falësh, — tha ai.

— Për se, ju lutem? — u emocionua dhe më shumë ajo.



— Për atë kartolinën. —

— Përkundrazi, — tha ajo dhe emocioni vetëm i shtohet. — Unë jam njeri që i ha shakatë.

— S'duhej ta kishâ bërë, — tha ai. — Pastaj, jam rrëmbyer ca...

— Për dije thoni? — pyeti vajza. —

— Për dije dhe për ndonjë ditë tjetër. —

— Për ç'ditë tjetër? — pyeti ajo dhe e shihte më sy, sikur po i lutej t'ia tregonte tërë ditë fshehtat.

— Po ja, për atë punën e Qanos. —

— Të Qanos? Pse, ju u bëtë shkak që ai ra në hendek? — u trishtua ajo.

— Unë, — ia bëri ai, duke kuptuar se vajza nuk dinte gjë.

— Po me pahir, sigurisht, — tha ajo me keqardhje.

— Sigurisht, — vazhdoi ai, duke mos guxuar të tregonte të vërtetën.

— Si ndiheni sot? — e pyeti Fani.

— Mirë ndihem.

— Kini kujdes veten, së prapë jurshohi me të gëhrë të vrarë, — tha ajo. — Mos doni t'jua këmbëjmë itinerarin? Mos nuk e keni qejf rrugën e Xhuxhës? — e pyeti ajo dhe së si e vështroi.

— Jo, e kam qejf, — tha Çlirimi.

— Thashë, — ia bëri vajza, duke e hetuar mirë me sy, po Çlirimi tani i mbante sytë në duart, që ishin të ndiente të ngathëta apo të ftohta. — Vend i bukûr Xhuxhâ, më kanë thënë, — vazhdoi, paq pak vajza.

— Shumë i bukûr, — tha djali.

— Do kisha qejf ta shoh, — ia bëri Fani.

— S'ka më lehtë, — tha ai. — Ne jemi kaq shokë që e bëjmë udhën e Xhuxhës.

— Pse, me Qanon do nisem unë? — i tha ajo këto fjale me një mënyrë si të çuditshme, sikur t'i kishte shpëtuar diçka që nuk duhej ta thoshte dhe kafshoi buzën.

— Djali e pa më një sy të rrëmbyer dhe ajo nuk e mbajti vështrimin e tij, por se nga vështroi e tha: —

— Do gjëj ndonjë ditë. Do t'indutem drejtorit. —

— Merr, ndonjë të shtunë lejë, qërta kesh të dielën.

përpara, — i tha ai duke luajtur me duart e veta. — Duhet dy ditë udhë, që të mos lodhesh.

— Do shoh, — tha vajza.

— Rri me shëndet, — u kthye ai e doli.

— Udhë e mbarë, — tha ajo. — Për atë çështjen e kartolinës, — u kujtua Fani, — mos u bëni merak. E dini sa kanë qeshur në shtëpi tek unë, kur ua tregova?

Ai u kthye e i buzëqeshi me një kënaqësi gjithë turp, ngriti dorën për të përshëndetur e doli.

Fani vështroi kartolinën mbi tryezë, tundi kokën e qeshi me zë.

## 7.

Shkoi një muaj dhe ata të dy nuk bënë dot një çap më tutje. Ajo e ndiente veten përditë e më pranë Çlirimit me zemër, por ai i qëndronte larg, nga frika se mos llototisinin bota, që sigurisht llototisinin. E vërteta ishte se Çlirimit i rrihte mendja vetëm për të.

Vajzën shoferët e ngacmonin si përherë dhe këto ngacmime e nervozonin fort e më fort. Prapë, ajo përpiquej ta mbante veten si gjithmonë. Në praninë e Çlirimit, njerëzit ruheshin të mos bënin shaka pa vend me dispeçeren.

Një ditë Fani i tha:

— Sot jemi e shtunë, Çlirim. Më merrni edhe mua për Xhuxhë? Lejën e kam nga drejtori.

Ai ngriti sytë dhe një gëzim që ajo nuk ia kishte njohur, ndriçoi në ta. Ajo e ndjeu këtë gëzim t'i gufonte gjirin.

— Kam makinë të vjetër, — tha ai dhe nisi të merrej me duart.

— Do më prisni ndonjë orë, ju lutem, — tha Fani, sikur të mos e kish dëgjuar.

Ai shkoi te makina dhe e priti.

Fani mbaroi punë shumë më parë. Çlirimi e vështroi si vinte gjithë e qeshur, serbese, me një çantë të madhe udhëtimi në dorë, e veshur me një pardesy të trashë bojë-kafe dhe me një shall leshi bezhë të hedhur përsipër. Era

ia ngatërronte flokët. Sytë, që shikonin tek ai, i thoshin: «Ja, nuk u vonova shumë, Çlirim».

Ata bënë disa kilometra udhë, të heshtur. Secili përpj-  
qej të mbante emocionet e veta. Çlirimi, nganjëherë, ia  
shkelte gazin pak si tepër makinës, Fani i prekte lehtë kra-  
hun me gishta dhe ai e mbante makinën me shpejtësinë  
e zakonshme.

Matanë Vorës ajo tha:

— S'e keni të vjetër makinën, Çlirim. Motori i punon  
mirë.

— Ti tani ke filluar të marrësh vesh edhe nga maki-  
nat, — qeshi ai.

— Jam bijë shoferi. Edhe një vëlla shofer e kam.

— E di, — tha Çlirimi.

— Edhe për ju, kështu kam dëgjuar, se shofer e keni  
babanë, — tha Fani.

— Jemi midis shoferësh, — qeshi ai.

— Është e bukur Xhuxha? — e ktheu pas pak bisedën  
ajo.

— Do ta shihni, — tha djali.

— Po ç'ka kaq të bukur Xhuxha? — pyeti ajo.

— Secili vend ka bukurinë e tij. Unë e ndiej veten  
mirë kudo që vete puna. Kur s'vete puna, mërzitem kudo.

— S'keni ndonjë preferencë? As për Xhuxhën? — de-  
shi ta ngacmonte ajo.

— Ju është bërë mendja Xhuxhë, më duket, — ktheu  
ai kokën dhe e vështroi me vëmendje.

— Ma kanë treguar vend shumë të bukur, — ia bëri  
vajza. — Babai me tim vëlla s'kanë qenë. «Do vete unë, u  
thashë. Kam një shok të mirë atje në park dhe sigurisht  
që do më marrë». S'donin të më linin, — ia bëri ajo.

— E marr me mend, — tha Çlirimi, duke e vështruar  
përsëri me shumë vëmendje, kurse Fani nuk e kthente  
kokën fare, po, me sytë e saj të zinj u buzëqeshte udhës,  
plepave, që kishin nisur të rrisnin gjethet me indriçime ba-  
kri, reve, që cirkosnin qiellin larg, sikur përmbi majat e  
bardha të maleve të pritej të binte borë.

— Po unë kam guxuar më shumë, — tha ajo, duke  
vazhduar mendimin që s'e kishte shprehur. — Jam bërë

dispeçere mbi njëqind shofërë. Dhe s'e kam lehtë, — e vazhdoi mendimin edhe më tej Fani.

— S'e ke të lehtë, — pohoi Çlirimi.

— Mos kë uri, Çlirim? — u kthye ajo nga djali dhe e pyeti.

— Ai heshti. Ndjeu nevojën të fërkonte duart, sikur t'i kishte të ngathëta, të ftohta, lëshoi timonin, i fërkoi dytri herë fort e fort dhe e zuri timonin prapë, duke ia shkëlur fort gazin makinës.

Fani i vuri gishtat te krahu, ai e ktheu makinën në shpejtësinë e zakonshme, ajo tha:

— Kam sjellë ca gjëra me vete, për sot e për nesër.

— Pse je munduar, — tha ai. — Kemi plot restorante rrugës.

— Ajo nxori byrek nga çanta, i vuri një thelë në dorë dhe nisën të hanin.

— Paskeni uri, — tha vajza.

— Byrek i mirë, — tha ai.

— Sa orë mban Xhuxha që nga Tirana, Çlirim? — pyeti Fani.

— Dhjetë. Po të nxitojmë pak, e arrijmë dhe për tetë.

Fani tha:

— Kam dërguar motrën të na blejë bileta për teatër. Dua të mbaj fjalën, — qeshi ajo. — Arrijmë dot para orës gjashtë nesër në Tiranë?

— Arrijmë, — tha Çlirimi dhe i shkeli përsëri gazin makinës.

— Motrën e kam më të vogël. Mbaron maturën sivjet, — tha Fani.

— Ti ndjek universitetin me korrespondencë, ekonomikun, — tha ai. — Unë jam me motrën tënde, në maturë. Kam mbetur pas. Histori më vete, — ktheu ai kokën nga vajza.

— Nesër duhet të vemi doemos në teatër, — tha ajo, pa e kthyer kokën, — se motrës do t'i shkënte mundimi huq. E di ç'më tha, kur e porositë për bileta? S'e merr me mend, sigurisht. «Më bëre kurioze për atë djalë».

Çlirimi, padashur, në vend që t'i shkëlte gazin makinës pas një kthëse, e frenoi dhe kamioni kërceu fort në

vend e qëndroi. Vajza u tremb e u mbloodh kruspull në vendin e saj. Çlirimi, i hutuar fare, i kërkoi falje dhe e nisi makinën.

Ata nuk këmbyen më dot asnjë fjalë, deri kur po bënin kthesën, ku fillojnë e duken oxhaqet e fabrikave të Rubikut, dhe Çlirimi tha se erdhën në këtë qytet.

— Do të qëndrojmë? — pyeti ai.

— Unë dua të ecim, Çlirim, — tha vajza.

— Ata kaluan Urën e Fanit, morën të përpjetat e Mirditës, përmes dushqerave të reja.

— Sa mban Xhuxha që këtu? — pyeti ajo, po nuk e pati mendjen fare të përgjigjja e tij, e vazhdoi: Duhet të mbajmë fjalën nesër. E di ç'më tha Shpresa, imë motër? «Dua ta shoh atë shokun tënd se ç'kokë ka. — Ç'kokë të ketë, moj? — i thashë. Po ja, është një djalë i gjatë, i fortë, pak si i skuqur në fytyrë e që i thërresin indian, — që shi Fani, dhe Çlirimi pas saj. — Është dhe shumë i turpshëm, i thashë unë. Muriq të mos na vijë as në teatër, po s'e besoj ta bëjë këtë. Është i urtë e i sjellë. I urtë është, po, kur merr zjarr, i thashë, ka një farë Qanoje atje në parkun tonë dhe ia bën hundët përsesh të ziut».

Ata nisën të qeshnin të dy fort, arritën Shpëlin pa e kuptuar dhe makina la asfaltin e mori tatëpjetën nga e djathta për Blinisht, duke nisur të lëkundej pak si tepër.

— Imë motër pandeh..., — tha papritur Fani.

Atij i dridhej timoni në duar dhe as ai nuk e kuptonte se si arrintë t'i merrte kthesat e forta tatëpjetë.

— E di si i thashë unë, more Çlirim?... Po ndalë, more, njëherë makinën, se nuk dëgjojmë dot njëri-tjetrin.

Ai e ndali makinën dhe një të frenuar të fortë, nën një carac të madh buzë xhadesë.

Çlirimi u kthye nga vajza dhe nisi të luante me duart e tij.

— Do një tjetër copë byrek? — e pyeti ajo.

Fani i vuri byrekun në duar, ai e vuri në gojë, ajo kafshoi dhe një copë tjetër vetë e tha.

— Po ne... si është mendimi yt, more Çlirim? — e pyeti ajo dhe i vuri gishtërinjtë te krahu, sikur ta ndalonte që

të mos ngutej. — Do dhe shumë gjer në Xhuxhë? — po i dridhej tani zëri asaj dhe trupi.

Ai ktheu kokën, futi pjesën që i kishte mbetur nga byneku, nisi të përçapej me gojën plot dhe i buzëqeshi me një gezim të parrëfyer. Ishte i tëri i larë në djersë.

— Do dhe një tjetër felë byrek? — e pyeti ajo. — E treta e vërteta.

Ai hoqi dorën nga timoni dhe i shtrëngoi krahun.

## 8

Të pasnesërmen, të hënë, në parkun e tyre ngjau diçka krejt e jashtëzakonshme, që bëri bujë të madhe e u bë shkak që edhe unë të vihem e ta tregoj këtë histori, se për ngjarjet që shkruan një tregimtar, ai nxitet shpesh nga fundi.

Kur vajti në dispeçeri, Çlirimi gjeti atje nja tridhjetë shoferë jashtë dhe brenda zyrës. Fani u thoshte:

— Ju lutem, ja dhe pak.

Kur erdhi Çlirimi, ajo u ngrit e u tha shoferëve:

— Ju lutem, të kalojmë këtu matanë, te këndi i kuq, se kam diçka me rëndësi për t'ju komunikuar.

Të çuditur, të gjithë nxituan te këndi i kuq, kush duke protestuar akoma se ishte vonuar, kush i mërzhitur.

— Uluni, shokë, të gjithë, ju lutem, — tha vajza e u hodhi një sy shoferëve, për t'i numëruar. — Jeni pak, tha, — diçka më pak se një e treta e efektivit. Po punën mund ta bëj edhe me kaq. Ja si është puna. Dua t'ju pyes njëherë: a keni ndonjë qarje kundër meje?

Të gjithë e vështruan të çuditur dhe nisën të vështronin shoqi-shoqin.

— S'ka njeri ndonjë qarje kundër meje në këtë sallë? — pyeti Fani.

— Kush të ketë, le ta thotë, — u ngrit një shofer e u ul prapë.

Tjetër njeri nuk foli.

— Po hë, more shokë, mos na mbani, — foli i njëjti shofer.

— Jo, jo, s'ka njeri qarje, — thanë disa vetë.

— Epo, dhe unë ju çmoj të gjithë, se ju shoh si punoni e sakrifikoni, — tha Fani. — Por ama, janë disa prej jush që më mërzisin nganjëherë, kurse unë bëj sikur s'është asgjë. S'është kështu? — pyeti ajo.

Shoferët ulën kokën e s'foli njeri.

— Ndonjëri dhe s'është në rregull fare, — vazhdoi vajza, — dhe mua kjo më mërzit shumë. Apo s'kam të drejtë?

Ata nuk e ngritën kokën e përsëri nuk folën.

— Tani unë kam zgjedhur, — tha ajo, — dhe besoj se nuk kam zgjedhur keq.

Shumica ngritën kokën e i buzëqeshën.

— Dasmën s'di kur do ta bëjmë, — tha ajo, — po unë e Çlirimi do t'ju thërresim.

— Trime vajzë! — u hodh njëri nga shoferët e vajti e përqafoi. — Bukur e bëre, ta thotë Zeqirja! ty. Tamam si dispeçere. I dhe fletëshërbimin secilit. Me trashëgim, moj dispeçerja jonë!

Salla gumëzhiti prej gazit dhe urimeve.

1972

...

## DHIMITËR XHUVANI

### BISHTUKU

Shumë njerëz i thonë kandil. Shumë të tjerë kanë filluar ta harrojnë këtë emër, kurse ka akoma që i thonë bishtuk. Unë do ta quaj bishtuk, sepse më pëlqen që ka si nënë fjalën bisht dhe sepse vetë Hasani plak, i biri i Demir Qurkut, e quante bishtuk. Të dy, si Hasani dhe bishtuku kanë kohë që rrinë karshi njëri-tjetrit, por si këtë natë ata s'kanë ndenjur kurrë. Dhe nata është shumë e gjatë. Filloi të ngrysej që sapo perëndoi dielli pas shkëmbinje të bardhë dhe s'ka të aguar. S'ka asnjë shenjë mëngjesi. Bishtuku rri në këmbë, si qiri i zi, e djeg një flakëz të vockël sa një gjuhë rabecke dhe ndriçon. Ndrriçon vetëm të zotin që ka përballë, duke ia zmadhuar hijen trefish në murin e bardhë të porsalyer. Tymi që lëshon bishtuku dhe era që lëshojnë ende muret e lyera me gëlqere e turbullojnë më shumë Hasanin dhe ia zbojnë nga trutë e lodhur edhe atë pikëz gjumë që mund t'i vijë. Hasani s'duron dot më. Ngrihet ngadalë, me zor hap dritaren e vogël dhe mundohet të vështrojë përjashta natën pa fund. Ajo shtrihet e plotë dhe si e përjetshme. Sytë e Hasanit nuk dallojnë asgjë përveç errësirës. Ai mbush bulçitë dhe, si nxjerr një gëlbazë nga goja, si gëlbazë bishtuku, pështyn gjithë inat përjashta, si të pështynte në surrat natën e zezë. Pastaj e fut kokën brenda dhe sheh bishtukun, tymin e tij të zi e të hollë, si bisht miu, që ngjitet përpjetë duke u luhatur. Ai luhetet sa herë që i zoti kollitet ose flet me zë, me veten e tij, apo me bishtukun.

...«Kjo është nata jote e fundit, o bishtuk», — foli pla-



ku dhe ngriti kokën përjetë, në tavan vështroi varur llambën elektrike që reflektonte sa një xixëllonjë dritën e bishtukut. Mëshqirëb (ndozura bëqirë) bë: i. f. g. e n. sh. b. r. «Nesër do të ndriçosh, moj llambë elektrike!» — i foli Hasani llambës duke e vështruar dhe përsëri u ngrit në këmbë; erdhi rrotull nëpër dhomë dhe shfryu dufin që e mundonte.

«Më turpërove, moj çupë. Unë të desha si dritën e syve, kurse ti më turpërove. O, ç'natë e keqe! Sonte do të ishte dasmë jote, sonte do të çmendej i tërë fish ynë. Sonte do të bëhej dasma e fundit e kësaj shtëpie. Të dije që plak u yt ty të kishte të vetme, apo nuk e dije?» — pyeti plak u, duke iu drejtuar bishtukut dhe heshti.

Dikush ecte në gur, përposh konakut, kur ai po fliste me vete. Plaku mbajti vesh dhe njohu hapat e së shoqes, që po ngjiste shkallët. Pas pak ajo hyri brenda duke mbajtur në dorë një bishtuk, që i ndriçonte vetëm fytyrën.

«Mjaft më, bjer e fli — tha plak u. Si bjerë e fli — S'më flihet. — Atëherë rri, po të paktën shuajë bishtukun. I tërë fshati të shih që rri e vuan. Drita e bishtukut duket gjer matanë lumit.»

— Le të duket, nesër ky s'do të ndriçojë më. Ata ç'po bëjnë. Po flenë? — pyeti plak u për të ndërruar bisedë.

— A flenë. U lodhën gjithë ditën eufashti flenë.

— Në mëngjes dua të flas me ta.

— E ç'punë ke ti me ta? Ata s'kane faj. Erdhën për të vënë dritat. S'i ke as krushtë, as dasmori. Ata janë punëtorë. I ka dërguar NISH, Elektriку i Elbasanit. Gjithë ditën majë shtyllave lidhin tela. Thonë se, portii zësh me dorë ata tela vdes në vend. As ciu, as miu s'bën.

— O, ç'vdekje e bukur! — psherëtiu plak u.

— Ptu, lanet! — mallëkoi gruajave — Kjo natë të paska çmendur fare!

— E si të mos më çmendë, kush e mban gjithë këtë turp!

— Turp, turp, vërtet, — tha nëpër dhembë plaka dhe zgjati dorën që mbante bishtukun, e zgjati përpara sa ndriçoi errësirën dhe hodhi një hap me kujdes, pastaj një tje-

tër, sepse bishtuku nuk ndriçonte më tej. Në çdo hap që bënte, lëkundej, dhe plaku shihte përtej derës se si në korridorin e gjatë të shtëpisë largohej dalngadalë e shoqja. Sa herë që ajo bënte një hap, lëkundej nga drita e bishtukut.

— Do të mundohem të fle, — tha plaku dhe u shtri, po bishtukun nuk e shoi. — Le të ndriçojë dhe sonte, e ka për të fundit herë.

Ndonëse i mbylli sytë dhe ndonëse mundohej të ndilte gjumin, plaku nuk fjeti. Atij i dilte gjithmonë para sysh e bija dhe padashje rikujtoi me radhë shtatëmbëdhjetë vjetët e Zafirës.

\* \* \*

Ajo erdhi në këtë botë më 1950 dhe u përshëndet gabimisht me një të shtënë dyfeku, që nga dritarja e vogël. Që kur lindi, ajo e turpëroi të atin. Gratë ia sollën gabim lajmin, dhe Hasani, që po i digjej shpirti për një djalë të pleqërisë, s'priti po dha kushtimin nga dritarja e vogël e konakut. Kur kyri në dhomë mamia e fshatit dhe e uroi për vajzën, Hasani u zbeh.

— Ç'u turpërova, — tha dhe flaku tej pushkën.

Mamia u mundua ta qetësonte, po ishte e kotë. Ai kishte shtënë me pushkë dhe të gjithë ata që e kishin dëgjuar atë krismë nga kulla e tij, e kishin marrë me mend se ç'kishte lindur në shtëpinë e Hasanit, kurse...

— Po ja, ku i ke dy djemtë, që mburresh? — ndërhyri përsëri mamia për ta qetësuar. — Njëri në Cërrik, tjetri në ushtri. As njërin e as tjetrin s'i ke në shtëpi. T'i morën edhe nusët dhe të vijnë rrallë e për mall.

— Ashtu është, moj bijë, ashtu është, edhe kjo do të ketë kësmetin e saj. Po e desha një djalë për pleqëri. Pastaj vajta dhe qita pushkë si i çmendur.

— Hajt, mos u turpëro kot. Kur të rritet, edhe ajo do të qesë pushkë, mbase edhe më mirë se ti...

...Zafira filloi të rritej. Të atit i dukej sikur ajo rritej e dobët dhe shëndetkeqe. Dalngadalë në shpirt të tij filloi

të rëndonte vështrimi i trembur i së bijës. Ajo ishte bërë katërmbëdhjetëvjeçe. Kishte mbaruar shtatëvjeçaren, kishte mësuar të bënte dhe punët e shtëpisë, po kokën kurrë s'e kishte ngritur. Tamam në moshën kur duhej të shpërthente, ishte vyshkur. Sytë e saj të kaltër dukeshin të fjetur, si një gjol i mbuluar me barishte e shkurre. I ati e shikonte dhe bënte çudi. Ai pandehte se e bija do të çelej dhe do të gëzohej kur t'i thoshin të bëhej gati për dasmën. Dhe i thanë një ditë. Ajo nuk u çudit. Sytë e saj s'le vizën fare. As u çelën, as u ngrysen. Ajo e dinte, bile e dinte me hollësi se si ishte lidhur fati i saj me të një fëmije që kishte qarë një natë të egër dimri, se qe trembur nga fjalët që thuheshin me zë të lartë prej miqve të largët në konakun e ndarë me gardh e baltë. Ajo, që kur e mësoi, ndjeu t'i hynte në gjoksin e njomë gjithë ai dimër i egër që e mbajti të mbyllur të atin dy ditë e dy net. Gjithë ai dimër me borë, i futur me zor në zemrën e saj nga zakoni i lashtë e thaū atë dhe gjithë uji i turbullt i lumit ia errësoi ndriçimin e syve të kaltër. Në çdo hap që bënte, Zafra ndiente se kishte përpara një lumë dhe rreth e qark një dimër. Këto ndjenja ia zvogëluan asaj botën e madhe dhe qiellin e gjerë me yje. Ajo u rrit e fejuar, e veçuar nga shoqët e shoqet e saj.

«Ti je grua, ti ke burrë, s'të ka lezet të lozësh rrugës», — këto fjalë ajo i dëgjonte shpesh. Këto fjalë përbënin botën e saj fëmijnore, e cila i kaloi pa lënë gjurmë. Dhe ja, tani ajo është vajzë e rritur, punon në arë me shat, mbush ujë në krua dhe vështron rreth e rrotull. Vështron se si përtëritet natyra buzë prillit, se si ndriçojnë yjet në netët e qershorit, kur kositet bari dhe se si këndojnë shokët e shoqet e shkollës. Shikon se si disa prej tyre ndahen dy e nga dy e humbin buzë lumit ku shushurojnë shëlgjet e ndriçojnë xixëllonjat. I shikon, po gjë nuk ndien. Zemra e saj sikur është tharë. Njëherë ajo guxoi dhe mendoj një minutë të vetme për Xhelon. Ai i kërkoi ujë dhe ajo i dha. Ai e ngriti shtambën drejt diellit, piu dhe u lag, pastaj e vuri vetë në krua dhe, kur ena u mbush, u ngrit dhe ia vuri asaj në kokë. Ia vuri me duart e tij dhe duke buzëqeshur, sikur t'i vinte një kurorë me lule thanë dhe jo një shtam-

bë dhjetëkilëshe. Zafira donte të ngrinte kokën, së paku të shihte edhe një herë buzëqeshjen e tij, po shtamba s'e la të lëvizte. Qafa e saj e hollë sikur i qe gozhduar në supin e brishtë. Natën ajo e pa në ëndërr. Të nesërmen sytë e saj u hapën dhe kishin në bebe një rreze drite.

— Mirëmëngjes! — i tha ajo të atit.

— Mirëmëngjes! — murmuriti ai dhe vuri re vajzën. Aty për aty u mat t'i thoshte së bijës diçka, po u zmbrops. Dontë të bënte me të një shaka, dontë t'i kujtonte të fejuarin, po si tha gjë.

Zafira u largua dhe gjithë atë ditë priste me padurim kohën e drekës, që të vinte në krua për ujë. Vajti mbushi shtambën dhe priti. Në krua s'kishte njeri. Mos vallë kishte ardhur shumë shpejt?

— Nuk po e ngre dot? — dëgjoi ajo t'i flisnin dhe si e trembur ktheu kokën, po s'u përgjigj. U skuq dhe uli sytë, ishte ai, Xheloja, shoku i saj.

— Pse s'flet; — vazhdoi ai, — ti sikur s'je nga kjo kooperativë!

Zafira ngriti kokën dhe e pa në sy. Një çast të vetëm Xheloja u hutua nga vështrimi i saj i etur dhe mbeti. Ajo iku.

— Mirëmbërma! — i tha ajo të atit, kur ai u kthye në shtëpi.

— Bushtër! — i shfryu i ati. — Të pashë edhe një herë me të, ta këputa kokën!

Dhe ajo s'guxoi më të mendonte për Xhelon. Ajo ishte e fejuar.

«Bushtër», — shfryu plaku, që kishte më se gjysmë orë që ishte ngritur e që iu kujtuan thashethemet për të bijën dhe Xhelon. «Bushtra», — shfryu përsëri dhe vuri re se si u luhat flaka e tymi, i bishtukut. U dëgjua një fishkëllimë.

Plaku hapi sytë, mbajti vesh dhe u bind. Ishte fishkëllima e largët e trenit të punës, që dilte nga tuneli.

Fyyyy! Fy, fy! Fyyyy!...

«Baba! — iu bë Hasanit sikur dëgjoi zërin e Zafirës. — Unë do të shkoj në hekurudhë. Dje e shkrova emrin...»

Dhe ajo qe nisur me shoqet e saj. Në radhë midis ty-

re, asaj i qe dukur sikur po shkonte përsëri në shkollë, sikur tani po hynte në botën e saj të perënduar të fëmijnisë

Treni fishkëlleu edhe një herë, dhe Hasani dëgjoji fare qartë, si një gjëzim, zhurmën e thellë të rrotave mbi shinat e hekurta. Pas saj, ajo u shua, veshi i plakut ndjeu zhurmën, e qetë e shekullorë të rrjedhjes së lumit dhe iu kujtua postieri i kooperativës që bënte katërqind ditë pune në vit duke shpërndarë gazetat e duke i rënë cyles. Postieri ecte që nga mëngjesi deri në darkë. Kalonte në të gjitha fshatrat e kooperativës dhe, që të mos mërzitej, i binte cyles.

...Atë ditë, sapo kishte hyrë shkurti, ai solli gazetën dhe iku pa qëndruar as edhe një minutë. Ishin në oborr. Sapo kishin mbyllur gjënë e gjallë, kur erdhi gazeta. Zafira e mori dhe nisi ta lexonte, në fillim me zë të lartë që ta dëgjonin dhe i ati bashkë me të ëmën, pastaj dalngadalë e uli zërin. Ai vuri re se si sytë e së bijës u zmadhuan dhe filluan të ndrisnin tamam si ndrisnin yjet. Ajo e uli edhe më zërin dhe u zbeh. I ati u tremb.

— Ç'është? — pyeti ai kureshtar.

— Asgjë, — pëshpëriti Zafira dhe u largua.

Ra nata, po këtë radhë jo si çdo natë e Zafira përsëri u largua dhe mori me yete bishtukun.

— Po kjo ç'ka? — pyeti Hasani të shoqen.

Plaka mbloodhi supet, kurse Zafira ulur në shkallën e fundit pranë derës së qurit dhe nën dritën e bishtukut, lexoi deri në fund gazetën.

Pas pak ajo ngriti kokën, e trembur. E ëma me një bishtuk në dorë po zbriste shkallët. Bishtuku i ndriçonte vetëm fytyrën dhe shaminë e kokës. Të dyja nënë e bijë, u ulën dhe qëndruan kokë më kokë.

Zafira nisi përsëri të lexonte.

Dy bishtukë pranë këmbëve digjeshin ngadalë. Përballë tyre, në qur, lëvizte gjëja e gjallë.

Pas pak, dy gratë kthyen kryet të trembura dhe panë sipër tyrë mbi shkallë bishtukun e tretë që kishte ajo shtëpi. Atë e mbante me dorën të shtrirë përpëra Hasan Qurku.

Plaku i shtëpisë qëndronte në shkallën e parë të çar-dhakut. Pak i përkulur përpëra dhe gjysmë i ndriçuar nga

bishtuku, ai dukej si një copë shkëmb që do të rrokullisej.

— Ngrehuni dhe bini të flini! — u foli ai grave.

Për çudi, në vënd të plakës, u përgjigj Zafira.

— Mirë, tatë, tashti do të biem.

Plaka shikoi çupën në sy dhe s'e njohu. Sytë e saj ndriçonin çuditërisht, si të kishin marrë dritë nga gjithë ato fjalë që kishte lexuar nën dritën e dobët të bishtukut, pranë derës së qurit.

Të dyja dëgjuan në heshtje se si u zvarisën këmbët e plakut gjersa ai hyri në konak.

— Lexoje, bijë, dhe u bëftë ashtu si thonë këto fjalë, që të hyjnë në zemër.

— Do të bëhet kështu siç thotë ky fjalim, po jo me frymën e shenjtë, po me luftën që do të bëjmë ne vetë, me përkrahjen që do të na japë organizata.

— Ashtu qoftë!

— Ah, moj nënë, si ke duruar ti? — psherëtiu Zafira dhe ndjeu t'i përloreshin sytë.

E ëma nuk foli. Dhe Zafira heshti dhe ndjeu se s'ishte vetëm bijë e saj, po shoqe e saj. Kjo ndjenjë e re i erdhi kaq papritur dhe e emocionoi kaq shumë, sa e shtrëngoi fort të ëmën pas vetes dhe qau.

— Jeta jonë s'do të jetë më siç ka qenë, unë këtë gjë tashti e ndiej në shpirt.

— Ashtu qoftë, veç ruaju, të pastë nëna! Ti je bija ime, po t'i s'na përket më neve. Ti e di që je e...

Zafira ia zuri gojën së ëmës me dorën e vet dhe u ngrit e ngjiti shkallët si flutur.

Të nesërmen, të pasnesërmen dhe gjer në ditën që ajo u nis për në hekurudhë, Hasan Qurku bënte çudi me të bijën dhe të shoqen. Në shtëpi nuk kishte qetësi. Gratë, që gjer dje kishin pasur secila mendjen dhe huqet e veta, tani ishin bërë një. Plaku nuk e duronte dot këtë unitet dhe shpesh xhindosej. Ai ndenji rehat dhe e ndjeu veten zot karshi gruas së tij vetëm sa kohë që e bija ndodhej në hekurudhë. Herë-herë ndiente një farë ankthi. Dhe këtë gjë e ndiente sa herë që kujtonte të bijën. «Kushedi se si do të kthehet ajo nga hekurudha», — thoshte me vete i shqetësuar.

Dhe më në fund ajo ditë erdhi. I tërë fshati që lajmëruar të dilte përpara për të pritur dhjetë vullnetaret, dhjetë çupat e reja që kishin ikur para dy muajsh. Në qendrën e kooperativës gratë kërcënin. Të gjitha ishin veshur me fundin e sëndukut. Nga rrobat e tyre vinte erë trëndelinë. Ato qeshnin dhe këndonin.

— Ç'është ky turp! — tha Hasan Qurku.

— S'është turp, po festë, — iu përgjigj e shoqja.

— Prit, se do t'ia dëgjosh avazin kësaj feste, — tha ai dhe ngriti kokën.

— Po vijnë, po vijnë! — thirri dikush, dhe të gjithë u sulën përpara si një lumë shumëngjyrash.

Të dhjetë vajzat, si të ishin dhjetë pranvera bashkë, erdhën të veshura me pantallona dhe mbushën me gëzim fshatin si dikur, kur vinin partizanët.

Plaku u mundua ta përmbante vetën, po s'mundi: më në fund ai e përqafoi të bijën. Atë natë ai deshi të fliste me të, po në shtëpi kishin ardhur miq, punëtorët e NISH: Elektrikut, dhe plaku u mor me ta, kurse të nesërmën ai nuk guxoi të hapte bisedë. Dhe të pasnesërmen gjithashtu. Plaku u bind se në shtëpinë e tij kishte ardhur një tjetër Zafirë. Ai e shikonte dhe bënte çudi. Sytë e saj, shtatëmbëdhjetë vjet, të fjetur e të mekur, ishin çelur si lulja buzë prillit. Edhe të ecurit ajo tani e kishte ndryshe, edhe të folurit ndryshe. Gjithçka kishte ndërruar tek ajo, sikur të kishte ndenjur në hekurudhë jo dy muaj, po dy mbëdhjetë.

Shpirti i saj i ndrydhur dhe i mbyllur, kishte shpërthyer, sapo kishin thënë «shpërthe», tamam si ajo kumbulla buzë pranverës, që shpërthen, sapo shëh një ditë me diell. Tani edhe dashurinë e saj ajo e shikonte ndryshe.

Ai, Xheloja, çdo ditë i dilte përpara dhe pinte ujë nga shtamba e saj, dhe duke e mbajur shtambën të dy, në dy vegje, ecnin ngadalë dhe heshtnin. Dhe fshati i shikonte që nga dritaret e vogla të kullave dhe heshte. Dhe e ëma e Zafirës, që dinte gjithçka dhe që shikonte gjithçka, s'fliste. Ajo ndiente në shpirt frikë për këtë dashuri të heshtur.

Pas disa ditësh, nga Sulova e largët erdhën dy miq në konakun e Hasanit, shkesi dhe daja i dhëndrit. Dhe

në heshtje në konak, ku ndriçonte bishtuku, u vendos që pas një jave të bëhej dasma, megjithëse pas një jave binte e përmete dhe jo e diel, dhe s'ishte as vjeshtë e as dimër, po maj.

Kaluan tri ditët e para, tri ditë të gjata maji me punë dhe diell. E katërta edhe Hasanit iu duk e gjatë. Të pestën Hasani e thirri të bëjnë në konak dhe i tha:

— Nesër do të bëhesh nusë. Do të vijnë të të marrin.

— E di, — u përgjigj Zafira.

— Si?

— E di gjithë fshati.

— Si?

— Po, baba.

«Krau», kërciti një shuplakë në konak si një shkrepëtimë. Sytë e Zafirës u mbushën me lotë dhe xixa.

Ajo nuk foli. Ktheu shpinën dhe e qetë zbriti shkallët, doli përjashta dhe humbi në fushë, midis grunjave të gjelbra.

Në darkë nuk u kthye. As të nesërmen, që ishte dita e dasmës së saj, dita kur do të vinin krushqit për ta marrë, nuk u kthye.

«O zot, po çmendem», — pat thirrur Hasani dhe ngaqë s'rrinte dot më në konak vetëm për vetëm me bishtukun, kishte dalë në çardhak.

Dielli po perëndonte i kuq e i madh.

«Tashti duhet të vijnë krushqit, tashti hapu dhe të futem», — kishte menduar plaku dhe s'kishte guxuar t'i hidhte sytë nga rruga. Rrinte si i ngrirë dhe vështronte vetëm diellin.

— Po vijnë! — dëgjoji zërin e trembur të gruas dhe zuri kokën me duar.

Në oborr hynë kuajt duke hingëllirë, sikur të kishte ndodhur një vdekje e kobshme.

— O i zoti i konakut! — dëgjoji fare qartë Hasani dhe zuri veshët me duar e u fut në dhomë.

— O i zoti i konakut! — iu bë sikur gjëmoi oxhaku. Pastaj dëgjoji fjalë në oborr: Zëra burrash. Pas pak u ndien hapat e kuajve, që ikën revan dhe më nuk dëgjoji asgjë.



Kur hyri e shoqja në konak, ai brofi në këmbë. Kurrë nuk e kishte pritur me kaq ankth fjalën e saj.

— Ikën të zemëruar. Thanë se do të hakmerren.

— Kush foli me ta? — pyeti Hasani.

— Punëtorët e NISH Elektrikut. Ata thanë se s'do të kishte ndodhur asgjë, në qoftë se ne do të kishim telefonuar mbrëmë në qendrën e lokalitetit të Sulovës; mund të telefononim që nga zyra e kryetarit të kooperativës dhe t'u thoshim që të mos niseshin.

Gruaja fliste dhe i shpjegonte së ç'i kishin thënë punëtorët, se vajza do të kthehej prapë, po Hasani nuk dëgjonte. Ai kishte zënë kokën me duar dhe heshte pranë oxhakut.

«Fy, fy, fyyy!»

— Treni, — pëshpëriti Hasani, — gjithë natën këtë avaz ka.

«Fy, fy, fyyy!» — futi përsëri oxhaku fishkëllimën e trenit, pastaj futi zhurmën e rrotavë të hekurta mbi shinat e hekurta.

Hasani mbajti vesh dhe iu duk sikur pikërisht kjo utërimë e llargët që përtej lumit ia kishte rrëmbyer vajzën dhe ia kishte turbulluar mendjen e shpirtin. Ngadalë ngri- ti kokën, të cilën e kishte mbajtur qekur të mbështetur mbi gjunjë dhe hodhi sytë përjashta. Dritarja e vogël e konakut fuste dritën e bardhë të mëngjesit, që kishte fek- sur. Pastaj pa bishtukun që u përpëliti. Flakëza e vogël u shkëput dhe u ngjit në çast. U përpëliti dhe një herë dhe u shua. Hasani zgjati dorën e tundi bishtukun dhe kuptoi se i qe mbaruar vajgufi.

1971

**ELENA KADARE**

## **VËLLAI I VOGËL**

Vajzat zbritën gjithë zhurmë nga shkallët e Pallatit të Kulturës. Një grup mori kthesën e rrugës «Bajram Curri». Grupi tjetër eci drejt rrugës «Kongresi i Përmetit».

— Natën e mirë, vajza!

— Natën e mirë!

— Natën e mirë!

Mira me shoqet e lagjes së saj kapërcyen sheshin «Skënderbej» dhe po ecnin gjatë bulevardit të madh.

Ishte errur. Takimi me aktorët dhe punonjësit e filmit të fundit të Kinostudios zgjati më shumë seç e mendonin. Kur iu afrova pallatit të saj, Mira vuri re se shumica e dritave të apartamenteve ishin ndezur. Shpejtoi hapin dhe, kur arriti te shkalla e saj, u nda nga shoqet.

— Mira, je përgatitur për referatin? — i tha njëra nga shoqet, tek po largohej.

— Kam edhe pak, po do ta mbaroj sonte. As detyrat e gjeometrisë nuk i kam zgjidhur. Ika, se u vonova shumë. — Dhe nisi t'i hipte shkallët nga dy e nga tri, duke murmuritur me zë të ulët melodinë e filmit.

— Thuaj mamasë se nesër në orën tre kemi mbledhjen e shkallës, — i tha një grua e bëshme që po zbriste nga kati i dytë. — Mos harro.

— Nuk harroj, teto Sanë, jo.

Derën ia hapi i vëllai.

— Pse i bie ziles si e marrë? — i tha ai.

Ajo i ra me gishtin e madh hundës së të vëllait si bori

dhe hyri brenda e shkujdesur. Nëna ishte afër shporetit dhe po gatunte darkën, ndërsa motra më e vogël bënte detyrat.

— Erdhe, Mira? — i tha e ëma. — Më shtyp pak piper të zi se i kam duart të lagura. Si kaloi takimi?

— Shumë bukur, mama. Ishte dhe ajo heroina e re që luante rolin kryesor.

— Tamam si në film ishte? — pyeti motra e vogël.

— Po, edhe flokët ashtu i mbante, — dhe Mira iu afërua ngadalë pasqyrës së vogël që ishte mbi lavaman, u pa një çast e menduar dhe me një lëvizje të qetë të dorës vuri një tufë flokësh prapa veshit. Vëllai, që kishte lënë librin dhe po ndiqte i ngrysur lëvizjet e motrës së madhe, tha me qesëndi:

— Mos ta ka qejfi të bëhesh edhe ti artiste? —

Mira i nxori gjuhën nga pasqyra, pa e kthyer kokën, dhe mori havanin të shtypte piperin.

— Dhe ata flokë s'ke për t'i mbajtur ashtu, — i tha i vëllai, i fyer, që motrës së madhe nuk i bëri përshtypje qesëndia e tij. — Dëgjon? S'ke për t'i mbajtur ashtu!

Mira ndali dorën që shtypte në havan dhe vështroi të vëllanë. Donte t'i thoshte diçka për të qeshur, por mbeti e habitur. Sytë e tij shprehnin një inat të heshtur. Ajo bëri një lëvizje të lehtë të kokës, duke nxjerrë pak buzën e poshtme dhe vazhdoi të rrihte çokun e havanit.

— Unë i mbaj flokët si gjithë shoqet e mia, — tha ajo e qetë.

Nëna qeshi e tha:

— Pika ty, më nxore mallin e gjyshit.

— Uf, u bë ky t'i flasë Mirës, — ia priti motra e vogël.

— Ti akoma s'ke shkuar në klasë të pestë.

— Do rrih ti? — iu kërcënua i vëllai.

Nëna dhe motra e vogël qeshën. Mira e vështroi edhe një herë të vëllanë, pa e prerë lëvizjen e dorës në havan dhe vrenjtë vetullat. Ku i kishte parë edhe një herë këta sy kështu të egërsuar? Nëna dhe motra e vogël kujtuan se ai tallej, por jo. Edhe një herë tjetër ajo e kishte parë të vëllanë të vështronte ashtu. Kjo kishte ndodhur disa ditë më parë, kur ajo po kthehej nga shkolla bashkë me tre sho-

kë të klasës. Ai e kishte parë, ja kështu, si tani, dhe s'i kishte folur fare, sikur të mos qenkej ajo motra e tij. Edhe në shtëpi atë ditë i kishte ndenjur ftohtë, pastaj ajo e kishte harruar këtë gjë. Dhe ja, tani prapë.

Ra zilja. Erdhi babai. Ai puthi vajzën e vogël që i hapi portën, dhe i mori pallton t'ia varte.

— Hë, i bëtë mësimet? — pyeti ai fëmijët.

— Mua më ka mbetur dhe një pjesë e referatit që kam nesër, — tha Mira.

Djali nuk u përgjigj, por kafshonte thonjtë me kërcitje të lehta të dhëmbëve, zakon ky që i kishte mbetur nga vogëlia.

— Hiqi gishtat nga goja, — i foli babai.

Nëna hodhi supën nëpër pjata dhe të gjithë filluan të hanin. Vetëm djali rrinte i heshtur dhe s'e ngriti lugën. Ai ishte nervoz dhe me njërën dorë shtypte me forcë tulen e bukës, duke bërë topa të vegjël, të rrumbullaktë.

— Pse s'ha, — i tha nëna. — Të skuq ca djathë?

— S'ha nga inati i Mirës, — ia priti motra e vogël, me gojën të mbushur plot, duke mbyllur njërin sy me dinakëri.

— Rri ti, se ty të kam në dorë, — i shfryu i vëllai me zë të ulët.

— Jo, s'më kanë në dorë? — tha me inat motra e vogël.

— Të kam.

— S'më kanë.

Vëllai ngriti bërrylin si të desh t'a qëllonte, por e uli përsëri.

— Ç'do të thotë kjo? — tha babai duke i përfshirë të vegjlit me një vështrim të rreptë?

Djali nuk e përmbajti dot më veten, i shtriu të dyja duart grusht mbi tavolinë dhe sytë iu mbushën me lot.

I vinte të pëlciste që lotët nuk i bindeshin, por dilnin njëri pas tjetrit e përplaseshin drejt e në mbulesën e pastër të tavolinës.

— Po ç'keni pra? — pyeti babai, i shqetësuar dhe pa nënën, po dhe ajo kishte mbetur e hutuar e s'kuptonte ç'po ndodhte. Duke parë lotët e të vëllait, motra e vogël u tremb

dhe i mbeti buka në gojë. Asaj i erdhi keq për të. Ç'gjë të keqe kishte thënë, sa ta bënte të qantë? oje

— Unë dua që Mira të mos i mbajë më flokët kështu, — thirri papritur vëllai duke fshehur fytyrën midis duarve. — Ti presë, ti presë, atë e shikojnë çunat kur... ecën! Unë e kam parë vetë si e shikojnë ata. Pse! Ta shikojnë?

Dënosa i mbyti kraharorin dhe ai filloi të qantë me zë, duke iu hedhur gjoksi përpjetë. Nëna dhe babai shkëmbyen një vështrim të shqetësuar.

Mira rrinte në anën tjetër të tavolinës, pak e izbitet. Ajo s'kuptonte se ç'qe kjo gjë e errët që qe futur në shpirtin e vëllait të vogël. Ashtu turbull ajo ndjeu atë diçka të neveritshme, por të paqartë, për të cilën kishte lexuar në për libra dhe që dëgjonte në konferencat. Duke dëgjuar për këtë gjë, ajo kishte ndier rrëqethje dhe frikë. Dhë ja, kjo gjë e keqe, e shëmtuar po shpërthente nga vëllai i saj në një formë që ajo s'e njhte, por e bënte të rrëqethteja. E vështrroi me bisht të syrit të vëllanë dhe vazhdoi të hante. Ai e ndjeu këtë vështrim dhe iu tërbua më keq. Duke qarë, filloi të përplaste këmbën në dysheme.

— Ti... e di ç'je ti? — i tha ajo. — Ti je si një gjel që fryhesh kot. Si ai gjeli që bleu teto Anë për Vit të Ri dhe që e mbante kokëposhtë kur po e sillte nga pazari.

— Mira, mjaft! — tha babai.

— Kur do hamë prapë mish gjeli? — pyeti motra e vogël.

Vëllai u tërbua fare, por s'arriti të bënte gjë tjetër. — Të jeta të jeta, ai nuk guxoi të shqiptonte atë që mendoi dhe u ngrit në këmbë e vajt i ul mbi menderë.

Prindërit vështruan njëri-tjetrin në sy. — Ai e ndiente veten të pafuqishëm për të qenë mbi motrën e madhe dhe kjo gjë e egërsonte akoma më shumë.

— Dëgjo, — i tha së motrës, duke fshirë sytë me mënjët e trikosë. — Sonte natën do ngrihem e do të t'ipres në gjumë. Ke për ta parë.

— Lëri budallalëqet, — tha mëna. — Mirë i ka flokët vajza.

— E shikon, thia hap synë asaj, — shpërtheu djali.

Mira vazhdonte të hante e qetë, pa e kthyer fare ko-

kën nga i vëllai. «Domethënë se kjo nuk ndodh vetëm në për malësira, apo nëpër skena teatroshe. Kjo punë erdhi papritur gjer në shtëpinë tonë», mendoj ajo.

Babai kishte mbaruar së ngrëni dhe po vështronte i hutuar të birin. Si kishte ndodhur kjo gjë? Ai e pa përsëri gruan, por dhe ajo ishte më e hutuar se ai.

— E shikon, baba?

Babai vuri re se i biri ishte shumë i tronditur dhe s'deshi ta acaronte më tepër. Ai ishte shëndetlig, dhe ata kujdeseshin gjithmonë që të mos ia prishnin qejfin për asgjë.

— E shikoj, — tha babai, — e shikoj, po shko tani të flesh.

Djali u gjallërua.

— Jo, më thuaj njëherë, do t'ia presim flokët sonte?

— Mirë tani, po ik, — shtoi babai, i mërzitur.

Mira e pa me përbuzje të vëllanë dhe u ngrit për të shkuar në dhomën tjetër të mbaronte detyrat, që kishte për të nesërmen.

Nga dëra e hapur e kuzhinës asaj i erdhën në vesh fjalët e shkëputura të të vëllait, që mezi shqiptonte nga tronditja:

— Natën, ë? Mos harro të më zgjosh natën.

Pastaj zëri i babait?

— Po, natën, diçka do të bëjmë natën...

— Mos harroni të më zgjoni...

— Budalla, — u dëgjua zëri i hollë i motrës së vogël.

Pastaj një britmë e shkurtër dhe hapat e saj të lehtë që vrapuan në sallon, si duket për t'i shpëtuar ndonjë shpulle të të vëllait. E vogla hapi derën e dhomës dhe iu afrua me të shpejtë së motrës.

— Do të t'i presin, Mira, — tha ajo, duke e vështruar me sy të zmadhuar, që i ndrisnin çuditërisht. — Ta mbyllem derën me çelës që mos kenë nga të hyjnë.

— Jo, — tha Mira, — Askush s'do të vijë.

Motra e vogël u qetësua pak, veshi këmishën e natës, që i varej deri poshtë këmbëve të zbathura dhe iu afrua përsëri të motrës që rrinte në tavolinë, me librat hapur.

— Ti mos ki frikë, — i tha ajo duke e vështruar me ngulm. — Ti më ke mua. Unë do t'u kafshoj atyre duart, po



**FATMIR GJATA** (për të cilin është hapur një dosje në gjykatën e shtetit të Kosovës) ka qenë një nga aktorët më të njohur të kinematografisë shqiptare. Ai ka qenë i bashkuar me kolegët e tij në krijimin e filmave të mëdhenj të kinematografisë shqiptare.

Si aktor, ai ka qenë i njohur për rolet e tij të ndryshme në filmat shqiptarë. Ai ka qenë i bashkuar me kolegët e tij në krijimin e filmave të mëdhenj të kinematografisë shqiptare.

**RINIA E PRINDËRVE** (1971) është një film shqiptar i regjistruar nga Ismail Kadare. Ai ka qenë i bashkuar me kolegët e tij në krijimin e filmave të mëdhenj të kinematografisë shqiptare.

Repartit ushtarak që merret pjesë në xhirimin e filmit «Furtuna», si gjithnjë, edhe atë mëngjes qershori, buzë Adriatikut, ishte bërë gati me kohë. Ushtarët dhe oficerët ishin veshur me uniformë gjermane, ishin armatosur gjer në dhëmbë me armë gjermane dhe prisnin urdhrat e regjisorit. Elektracistët, mekanikët dhe shoferët shtruan kabllo, vendosën digat e projektorët dhe ndezën motorët. Unë, që luaja në film rolin e një partizaneje të re, mbarova grimin, bëra provat e fundit me asistentregjisorin dhe u vendosa para aparatit. Operatori provoi për herë të fundit dritat e forta dhe tha se ishte gati për xhirim. Po, tamam në këtë kohë, ashtu siç ndodhte shpesh, era e fortë sollti nga perëndimi re të dendura, qielli u nxi përnjëherësh, dhe deti u errësua e u dallgëzua. Një kohë e tillë nuk vlen për xhirim, prandaj edhe puna u ndërpre. Njerëzit zunë nga një qoshe që të mos i hante era, filluan nga bisedat dhe shpesh vështronin retë nëse po dilte dielli!

Kureshtarët, që mblidheshin çdo ditë për të parë si bëhet filmi, pritën sa pritën, e morën me mend se s'kishin për të parë gjë dhe u shpërndanë.

Unë u shtriva mbi rërën e ngrohtë pranë një kaçubeje me bar të zverdhur para kohe. Si vështrova një copë herë qiellin, duke u munduar të gjeja me hamendje se në ç'vend mund të dilte dielli, ia ngula sytë kureshtarit të fundit që kishte mbetur midis nesh. Ishte një grua nja tridhjetë e pesë vjeç, në mos më shumë, e veshur me një fustan të kuq të errët e me një xhakëtë bojë hiri hedhur krahëve. E



kisha parë tri ditë me radhë atë grua. Ishte e imtë nga trupit e nga fytyra, me ca sy të mëdhenj të zinj, pa ndonjë shkëlqim e të venitur. Rrinte ulur mbi një kërcu të kalbur, e heshtur, e menduar, me krahët kryqëzuar në krahor, mbledhur shuk sikur mërdhintë.

«Kushedi ç'hall ka!» — thashë me vete dhe, si vajzë që jam, m'u ngjall kërsëria për të marrë vesh hallin e saj.

Më ishin mpirë këmbët, ngaqë kisha ndenjur keq. U ngrita, pashë edhe një herë retë se mos dukëj dielli dhe, çalë-çalë, shkova e qëndrova para saj. Tani që e kisha pranë, dallova midis flokëve të zinj që ia rrëmbente era, shumë fije të argjendta dhe, anash syve, në ballë e në qafë, ca rrudha të holla që e tregonin më shumë se tridhjetë e pesë vjeç. Ajo më pa me vërejtje që nga maja e opingave të grisura gjër të kapelja me yll të kuq që e kisha vënë pakëz mënjane mbi flokët e mi të dredhur. Për herë të parë u rraze në fytyrën e saj të hequr e zeshkane një nënqeshje që kaloi si një fillad i lehtë dhe që përnjëherësh u zhdruk prapa buzëve të saj të holla, të palyera e të përtharë nga era e dëtit.

— Të kanë shumë hije këto kostume partizane, — më tha me zë pakëz të ngjirur.

— Mi prenë pas trupit, prandaj më rrinë mirë, — iu përgjigja.

— Çfarë luan në film? — më pyeti.

— Rolin e një partizaneje të re që vritet në luftë me gjermanët.

— Më bëri shenjë më kokë duke më treguar trungunj u tërhoq pakëz mënjane dhe unë u ulë pranë saj.

— Kur do të filloni? — më pyeti duke më vështruar në sy.

— Si duket sot s'ka xhirim. Dielli s'duket asgjëkund.

Sikur të më kishte parë në shpirt, më pyeti përsëri: — Mërzitësh?

— Kur s'punon, mërzitësh, — iu përgjigja dhe përnjëherësh e ndërrova bisedën. — Mirë ne që jemi të detyruar të vimë këtu, po ju ç'doni? Ju kam vënë re! Keni tri ditë që rrinin të ky kërcu, sikur ju kanë mbërthyer.

— Ju shoh ju dhe kujtoj të kaluarën, — më tha dhe hodhi vështrimin tepër larg, në det, mbi kreshtat e bardha të dallgëve që shtynin njëra-tjetrën me rrapëllimë. — Vështitë e keni! Ka qenë luftë e madhe! — shtoi pas pak dhe ra në mendime. Balli i lartë me dy rrudha të holla sikur u mbështoll me mjegull.

Seç më nxiti ta pyesja:

— Keni qenë partizanë?

— Kam qenë, — më tha. — Dhe kam hequr shumë. Kanë kaluar pesëmbëdhjetë vjet dhe asgjë s'kam harruar. Më kujtohen të tëra, sikur i kam të shkruara në zemër e në mendje. Kujtimet më ndjekin pas në çdo hap që bëj, kur zbres shkallët, kur zbres nga trotuari, kur më del përpara ndonjë gropë, goftë edhe një pëllëmbë e thellë, kur zbres nga autobusi, nga pragu i shtëpisë, kudo ku hedh hapin tatëpjetë. Dhe a e di se shpeshherë më duket sikur, duke zbritur, do të bie në një hon të thellë? Po njerëzit më japin dorën, më mbajnë dhe, në vend që të bie në hon, zbres në tokën mëmë dhe shkoj në punën time.

Duke folur, gruaja fërkoj një copë herë kërcinjtë e këmbëve, mbuluar nga kindat e fustanit të kuq. Vura re se e bënte këtë pa e pasur mendjen aty.

Sytë e saj të butë shkëlqyen për një çast nga një mall i ëmbël për kohën e kaluar. Dhe tamam atëherë, sikur ta kisha pyetur, nisi të tregonte:

— Kur isha e re, kisha edhe unë gëzimet dhe ëndrrat e mia, si gjithë vajzat e asaj kohe. Por nga gjendja nuk ishim mirë, prandaj, si bëra dy klasë në qytetsen femërore, e lashë shkollën. Më hoqi babai. «U rrite, më tha, s'është më shkolla për ty». Më mbylli në shtëpi, jo me çarçaf, si bënë ca të tjerë, po sidoqoftë më mbylli. Dhe unë atëherë fillova të bëja pajën, sa të rritesha dhe ca e të shkoja ku e kisha fatin! Ja, kjo ishte ëndrra ime dhe e shoqeve të mia...

Më erdhi rëndë ta shihja në sy, prandaj vështrova dallgën e rrëmbyer që u përplas pas bregut, u thërrmua dhe erdhi e u shtri gjer te këmbët tona. Të dyja vështrova detin të heshtura, me zemër të ndrydhur, ajo në kujtimet e së kaluarës dhe unë në mendimet e mia për fatin

e zi të vajzës shqiptare në të kaluarën. U përmendëm, kur qielli u çka nga një shkrepimë e gjatë, fundi i së cilës u duk sikur u çik me detin, tej, në thellësi. Ende nuk na qe zhdukur nga sytë zigzagu i zjarritë, kur dëgjuam një gjë-mim shurdhues. Deti u bë më i egër e më i errët, Atëherë gruaja m'u drejtua me zërin e saj të zakonshëm, pak të ngjirur:

— Mos të mërzita?

— Jo, — i thashë menjëherë. — Unë jam një artiste e re dhe puna ma do që të njoh sa më shumë jetën dhe njerëzit.

Nuk më la ta mbaroja mendimin. Filloi menjëherë:

— Nuk i kisha mbushur të pesëmbëdhjetë vjetët, kur për herë të parë pashë nga dritarja e shtëpisë ushtarët e huaj. Dhe s'di se pse një brengë e madhe ma pushtoi shpirtin. I urreva menjëherë. Ndoshta pse im atë kishte luftuar kundër tyre në njëzetën. Kushedi sa herë e kisha dëgjuar babanë të tregonte për luftërat e atij viti, për shokët e tij që ishin vrarë duke kapërcyer telat me gjemba, për armikun që e kishin hedhur në det. Mirëpo, pas një viti, kur mora pjesë në një demonstratë, babai më tregoi grushtin: «T'i thyej hundët! — m'u kërcënuar. — Mos të të shoh më në rrugët e qytetit!» Unë u çudita me qëndrimin e tij, po nuk i fola. Isha mësuar të mos i kundërshtoja kurrë. Më vinte edhe keq t'ia prishja gjakun. Ai dërmohej në punë tërë javën, edhe ajo i duhej, që t'i kundërshtoja unë! Ishte ftues gjyqi. Bridhte në këmbë shtatëdhjetë e dy fshatra, duke shpërndarë ftesat e gjyqeve. Kur kthehej në fund të javës, tabanet e këmbëve i bëheshin pleh nga djersa. Atëherë, duke pirë raki, shante fatin e tij, mallëkonte jetën dhe tërë vrerin ia derdhte së shoqes. Po nëna ishte e urtë; s'ngrinte krye kurrë kundër tij. Asaj i kisha ngjarë edhe unë.

Një ditë, si bënë shoqet, bëra dhe unë, preva leshrat! Kur më pa, babai i hipën xhindët. «Pse i preve kocet?! Ç'je bërë kështu, si dhi e zgjebosur?!» — më shfryu. Shante rëndë i uruari, shumë rëndë. Po unë përsëri heshta. Kur të shajnë pa të drejtë, është më mirë të heshtësh. Heshtja e bën tjetrin të mendohet. Ajo e mund atë që të shan, me-

gjithëse ka njerëz që heshtja jote i tërbon. Po im atë s'ish-te riga ata. Po të mos i kundërshtojë e po të mos flisje, ai zbutej menjëherë. Kështu u zbut edhe kur unë preva le-shrat sipas modës që kishim nxjerrë ne vetë...

Vetëm një natë kjo heshtje u prish përgjithnjë. Atë natë unë isha caktuar së bashku me një shok për të shpër-ndarë traktet në lagjen tonë. Sa filluam nga puna, kur, do ti, na del përpara një spiun. Atëherë spiunët njiheshin me gisht. Çudi mënd të të duket, po unë i njihja tërë spiunët e qytetit. Më dukeshin sikur e kishin shkruar në ballë: «Jam spiun!» — Ja pra, na doli ai përpara dhe unë u shta-nga në vënd.

«Eh! Ç'na zuri me presh në dorë, i mallëkuari!» — thashë më vetë dhe shpejt e shpejt i futa traktet në gji. Budallaqja, kujtoja se, po të bija në dorë të tij, nuk do të më kuptonte se ku i kisha fshehur... Shoku më hodhi krahun dhe kaluam përpara tij. Po «grera» — kështu i qu-afim atëherë spiunët — na u vu pas. S'di së ku kam lexu-ar në një libër se dy të rinj, vajzë e djalë, shpërndanin trakte, ashtu si edhe ne atë natë. Papritur u doli roja gjer-mane dhe ata, për të humbur gjurmët e për të shpëtuar, u përqaftuan dhe u puthën për herë të parë buzë më buzë dhe shpëtuan. Mua as që m'u kujtua ta bëja një gjë të ti-lle, po, edhe sikur të më kishte rënë ndër mend, atë punë s'kisha për ta bërë kurrën e kurrës... Kthym rrugë dhe ecëm më shpejt, po edhe ai, me të dalë te qoshja, e shpej-toi hapin. «Prite kur të na thërresë: «Halt!» — mendova, duke dëgjuar trokun e hapit të tij në kalldrëmin e rrugës dhe më erdhi inat me shokun tim që s'kishte marrë armë me vetë... Po, për fatin tonë, në një shtëpi të asaj rruge bëhej një dasmë. Nga dera e çelur kat e kat dëgjoheshin sazet dhe këngët. Unë s'i rashë më të, po shoku më shtyu me bërryl drejt derës dhe hymë brenda, drejt e në dho-mën ku kërciste ahengu. Po, do ti, kur të ndjek e keqja! Sa hyra në dhomën tërë zhurmë e tym, më rrëshqitën trak-tet nga gjiri e më ranë rre dysheme. Nga habia ime, njerë-zit që s'më njihnin, e morën me mend se ç'ishin ato letra. U turrën sikur të kisha hedhur një grusht flori, i mblodhën shpejt e shpejt së bashku me mua dhe m'i dhanë. Më kujto-

het si tanë. U bë një heshtje kaq e madhe, sa s'pipërinte as miza. Pastaj se kush u kujtua dhe thirri: «Bjeruni sa-zeve!» Mirëpo në duhej të dilnim e të shpërdanim trak-tët/Po si të dilnim? Spiuni ishte mbështetur te parmakët e gurtë të derës së jashtme, pinte duhan dhe hidhte nga një vështrim nëpër oborr. Të hynte brënda, s'ia mbante. Po dhe ne kishim frikë të dilnim. Dhe ja, tamam në këtë ko-hë u ngrit një burrë që e kisha pasur mësues të gjjuhës shqipe në qytetse, u hodhi një vështrim dasmorëve dhe tha: «Epo ngrehuni të shkojmë krushq të nusja!» Dhe u ngritën të gjithë sikur të ishin porositur. Mësuesi m'u af-rua, më zuri fort për krahu e më pëshpëriti në vesh: «Ku t'ju shpiem?» — I thashë se ku. Më futi në mes të dasmo-rëve. Sazet buçitën dhe dolëm të gjithë në rrugë. Ishim shumë, nja pesëdhjetë a gjashtëdhjetë shpirt, burra, gra; të rinj, fëmijë. Qeshnin, thërrisnin, këndonin, kërcenin. Spiuni hodhi një vështrim të shpejtë, po këllë shihte më parë? Na përcolli gjer në një farë vendi dhe pastaj iku.

Ja, tamam atë natë, unë, për herë të parë, nuk hesh-ta, po i kundërshtova babait. U ktheva vonë në shtëpi, se s'kisha si të kthehesha shpejt. Babai kishte dy orë që më priste dhe, sa hyra, pa më thënë asnjë fjalë, ngriti dorën po nuk më goditi, se ia mbajti nëna. — Ku brendh natën, vonë, moj rrospi! Ku? Sa herë të kam thënë të mos dalësh nga shtëpia? Ku ishë? Foll, se të futa në dhe të gjallë, — më thirri sa u tund shtëpia. — «Më pua e zeza!» thashë dhe në fillim s'folja, së atë-herë e kishim të ndaluar t'i tregonim punët tonë. Po pata frikë se mos babai mendonte keq për mua dhe s'u për- mbajta dot. — Shpërndava traktë! — I thashë. Ai më pa vëngër nga koka gjer te këmbët dhe ulëriu: — Me këto punë mërresh ti?! — Dhe unë iu përgjigja flakë më flakë: — Pse të mos mërrem? Prej teje kam mësuar. Edhe ti në kohën tënde ke luftuar kundër tyre. — Ai u xhingos fare: — S'është për femrat lufta, — thirri, shtyu nënën, që mundohëj ta qetësonte, m'u vërsul dhe më goditi më për-

llëmbë në fytyrë. Ishte hera e parë që më qëllonte dhe nuk e dija se dora e tij, që ishte mësuar të mbante vetëm. letra, ishte aq e rëndë. Fytyra më përvëlooi, sytë më lëshuan xixa dhe gjaku më plasi nga hundët. Po nuk qava. Atëherë, edhe të qaje, ishte turp e dobësi. I gëlltita lotët.

— Kot e ke, baba! — i thashë e ngashëryer më tepër nga inati sesa nga dhembja. — Unë s'heq dorë nga kjo rrugë, vramë, po deshe, po kot e ke!»

Prisja të haja ndonjë dajak tjetër të shëndoshë, kur pashë një gjë që s'do ta harroj kurrë. Babai u drodh i tëri dhe ia nguli vështrimin dorës së tij të madhe, ku ishte piksur një pikë gjak. Edhe dora i dridhej. E pa me kujdes, sikur lexonte ndonjë ftesë me shkrim të keq dhe përnjëherësh e futi në xhep, e fshehu, për të mos e parë më atë pëllëmbë mëkatore që ishte ngritur kundër meje. Vura re se e fshinte dorën pas astarit të xhepit, fshinte pikën e gjakut tim. Ishte penduar që më goditi. Ishte penduar që deshi të më largonte nga lufta. Po të falur nuk më kërkoi...

Ah, moj motër! Le të më kishte goditur edhe një herë, se dora e atit ishte, veç të mos e kisha parë babanë atë natë aq të pikëlluar e të dërrmuar... Ku ta gjej tani atë dorë që më goditi veç një herë e që më përkëdheli vite të tëra?! Ku ta gjej e ta marr në pëllëmbët e mia, ta vë në flokët e mi që kanë filluar të thinjen e ta puth me mall?! S'kam ku e gjej....

Gruaja heshti një grimë, shtrëngoi fort buzët e holla e të përthara dhe u gëlltiti disa herë me radhë. M'u duk sikur gëlltiti lotët. Nga tregimi i saj m'u mblodh një lëmsh në fyt, fshiva me noçkën e gishtit tregues një pikë lot që më kishte dalë nga erë e detit dhe mbërtheva vështrimin në sytë e saj të butë. Ajo vazhdoi:

— Në qytet nuk mund të qëndroja më. Kisha rënë në sy dhe më ndiqnin, prandaj kërkova të shkoja në mal. Vësha, tamam kështu si ti, një xhaketë të zezë të shkurtër, një palë pantallona ngjyrë bari, vura kapelën me yll, ngjeshë armët dhe kështu u bëra partizane...

.. Mos kujto se në mal tregova ndonjë trimëri. E them hapur, s'kam qenë trime. Por s'mund të them se kam pa-

sur frikë. Frikë s'kisha. Luftoja kur ishte për të luftuar, flija ku të më zinte nata, bëja rojë kur kisha radhën, tërhiqesha e sulmoja si gjithë të tjerët. Me një fjalë, bëja jetën partizane.... Vetëm në janarin e vitit 1944, kur gjermanët filluan Operacionin e Dimrit, e pata pisk. Një javë rresht luftuam duke u tërhequr. Po ata djaj s'na ndaheshin, këmba-këmbës. Kishin vendosur të na shuanin nga faqia e dheut. Atëherë u ngjitëm lart, majave të maleve, te foletë tona, dhe, së bashku me ne, u ngjitën edhe fshatarët e atyre anëve. Po s'ishin pak muhaxhirë! Dy mijë të thuasht, janë pak, pleq, plaka, fëmijë, gra me barrë, ulokë, të sëmurë; të plagosur. U dërrmuan njerëzit nga luftimet e nga lodhja, u këputën nga gjumi, nga uria, nga ngricat. Të tetën ditë bëmë ca orë pushim në një pyll të dendur me pisha. Dhe ja, për çudinë time, aty, në pyll, takova babanë. Ishte tharë si eshkë, mjekra i qe rritur, dridhej nga të ftohtët. M'u dhimbs sa s'ta tregoj dot!

«— Po ti, kur paske dalë këtej? — e pyeta.

— Ka dy javë. Dëshën të më burgosnin zagarët, po u ika — m'u përgjigj dhe më përqafoi. E pyeta për nënën. E kishte çuar te dajallarët, në një fshat pranë qytetit.

— Mos ki merak, — më tha. — Ajo është mirë, është rehat, atje — dhe më vështroi me krenari, më vështroi i përvëlur nga malli e s'kishte të ngopur....

Këtu unë bëra gabimin më të madh në jetën time.

Kisha marrë vesh se të plagosurit e të sëmurët do t'i nisnin në një drejtim tjetër, më të sigurtë, kurse brigada do të çante qafat e maleve dhe do t'i godiste gjermanët aty ku ata s'e prisnin. Dhe unë i them timëti.

— Ti shko me të plagosurit, baba, ata janë të siguruar. Kur të mbarojë kjo furtunë, po deshe, mund të qëndrosh në brigadë.

Si u bind burri menjëherë?! Si nuk kundërshtoi?! Po si nuk tha jo! Të mos më kishte dëgjuar, ndoshta edhe sot e kësaj dite do të ishte gjallë.

Mirë, po shkoj me të plagosurit, — më tha. Dhe shkoi, dhe nuk e dëgjova më... dhe nuk e pashë më.

Dy ditë më vonë e mora vesh ngjarjen. Të plagosurit ishin ndeshur me gjermanët në rrugë e sipër. Ata që shpë-

tuan, na arritën. Njëri prej tyre kishte hipur mbi një mu-  
shkë dhe, sa më pa, thirri:

— Ervehe!

Tak, më bëri zemra. Çudi e madhe! Nga zëri e kupto-  
va që deshi të më thoshte. Fatkeqësinë e ndien njeriu dhe e  
mërr vesh, pa ia treguar kush.

— Babai! — belbëzova dhe nuk desha që të më flisnin  
më.

Plagosuri m'u afrua, më vështroi me dhembje dhe  
më pyeti me gjysmë zëri:

— A e more vesh si ngjau?

Unë s'dija gjë prej gjëje, po sepse i thashë:

— E di, e di, — dhe atëherë prita me ankth të më  
thoshtë jo atë që parandjeva, po ndonjë gjë tjetër pa rën-  
dësi.

— Ishtë burrë i mirë... Luftoi si trimat... Epo luftë;  
moj Ervehe! Të rrosh vetë!... E varrosëm në një përrua  
të Tomoricës.

— M'u prenë këmbët kur dëgjova këto fjalë dhe do të  
kisha rënë, po të mos më kishte zënë për krahu komisar i  
batalionit që u ndodh aty.

— Mbahu, Ervehe! — më tha ai. Dhe unë u mbajta e  
nuk qava. Nuk desha të më shihnin njerëzit të përletur!  
Atyre që po hiqnin të zitë e ullirit, edhe lotët e mi u duhe-  
shin! Shtrengova buzët përbrenda me dhëmbë që të mos  
më dridheshin dhe bëra përpara me ballin lart, sikur s'ki-  
shte ndodhur gjë me mua. Sa e fortë kam qenë atëherë! E  
treta hidhërimin në shpirt, pa ia shfaqur njeriu. Dhe, gjer-  
sa ra nata, e mbajta veten, durova. Por, kur rashë të flija  
në një kasolle stani, mbulova kokën me pallto dhe s'u për-  
mbajta dot më. Megjithëse nganjëherë më thoshte men-  
dja se ato që dëgjova s'ishin të vërteta, u binda që babanë  
nuk do ta shihja më. Dhe, atëherë, shtrirë mbi kashtë, në  
qoshe të kasolles, me kokën të mbuluar, qava me lotë e pa  
zë, duke shtrënguar fort tërë muskujt e trupit dhe duke  
mbajtur frymën për një kohë të gjatë, që të mos më merr-  
nin vesh shokët se ç'bëja. Dhe, si qava mirë e mirë, sikur u  
lehtësova. Po gjumë, s'vura në sy atë natë. Mallëkoja ven-  
ten: «Përse e dërgova andej babanë? Ku vajta e i thashë



të shkonte, o m'u thaftë goja!» Dhe një zë i huaj më pëshpëriste në vesh: «Ti e vrave tët atë, moj e zezë, ti!...»

Po s'pata shumë kohë të mendoja për babanë e vrarë. Na ngritën pas mesit të natës, se, si të thashë, gjermanët na ndiqnin këmba-këmbës. Një batalion i brigadës ishte nisur me kohë pararojë. U nisën edhe muhaxhirët, të plagosurit e të sëmurët dhe, pas tyre, dy batalione të tjera të brigadës. Ne mbetëm te stanet, pa ditur se ç'do të bënim e ku do të venim. Kur na vjen komisari e na thotë:

«— Dëgjoni shokë! Gjendja është shumë e rëndë dhe e vështirë! Ju e shikoni vetë dhe s'është nevoja t'juaj them unë. Gjermanët i kemi një orë larg. Shtabi i brigadës vendosi që batalioni ynë t'ua presë udhën e t'i japë mündësi brigadës të kapërcejë Qafën e Martës. Do të bëjmë një sulm të shpejtë e të befasishëm që t'i çorodisim. Nisuni!

Parulla e kundërparulla kaluan gojë më gojë e vesh më vesh.

— «Shqipëria!... Shtëpia!»

— «Shqipëria!... Shtëpia!»

U bëra gati të nisësja edhe unë me skuadrën time, kur m'u afrua komisari, më lëshoi çantën e tij në dorë dhe më tha:

— Ervehe! Ti shko të arrish brigadën! Në mos u kthefsha unë, çantën dorëzoje në shtab!»

E kuptova menjëherë qëllimin e tij. Nuk qe puna te çanta. Mua atë ditë më ishte vrarë babai dhe komisari më ruante se mos vritesha edhe unë. I kundërshtova, po urdhri ishte urdhër dhe iu binda. Më la edhe dy shokë që të më përcillnin, meqë brigada ishte larguar mjaft. U nisëm të tre, të dëshpëruar, po këmbët nuk na bënë për nga Qafa e Martës. Ecnim ngadalë të heshtur: qëndronim, vështronim poshtë nga kishte ikur batalioni ynë dhe përsëri qëndruam dhe pamë njëri-tjetrin në sy. Unë s'e përmbajta veten dhe thashë:

«— Po ne, ku shkojmë kështu?! Atje po na vriten shokët! — dhe, pa menduar hollë, zbrita tatëpjetë me hap të shpejtë andej nga kishte shkuar batalioni ynë.

— Ervehe! Ervehe! — dëgjova nga pas të më thërrisnin shokët.

— E cni, ecni shpejt! — u thashë pa qëndruar. Më arritën dhe ecëm të tre njëri pas tjetrit.

Nata ishte e errët, hënë s'kishte, yje s'kishte, po dallonim diçka, se na ndihmonte bora. Ramë në një përrua, çamë përmes ujërave të ngrira dhe bëmë përpjetë me një frymë. Ishim të rinj atëherë dhe e çanin borën që na vinte gjer në bel, si pa të keq. Kur dolëm mbi një shkëmb, krismat u rralluan shumë, po dëgjoheshin më mirë. Unë shikoja flakët e armëve. Më dukeshin fare afër. Mirëpo zjarri natën të gënjen. Të duket sikur është aty, kurse në të vërtetë ai mund të jetë njëqind herë më larg sesa ke menduar ti.

— O burrani, se arritëm! — u bëra zë shokëve.

Nga të ecurit shpejt kisha dërsirë. Isha lodhur sa s'bëhet. Merrja frymë me gojë hapur e s'ngopesha dot me ajër, po përsëri ecja sa më hanin këmbët.

«Ç'do të thotë kjo! — mendoja. — Shokët atje po vriten, kurse unë qenkam lodhur. Pa hë, jepu këmbëve dhe arri sa më parë!»

Sa më shumë afroheshim ne, aq më rrallë dëgjoheshin krismat e armëve, bile, nganjëherë, për një kohë të gjatë s'pipëtinte asgjë, veç fishkëllimës së erës, që frynte majave të pishave. Po ne edhe atëherë nuk qëndronim, ecnim e ecnim pa pushim dhe, si bëmë nja dy a tri orë të mira rrugë, dolëm në një pllajë të zhveshur, mbuluar me borë, ku s'kishte shkelur këmbë njeriu. Dhe tamam tek ajo pllajë na ndodhi një gjë e papritur, që s'na e kishte marrë mendja. Si isha duke ecur, kur shoh nja dhjetë a pesëmbëdhjetë hapa para meje dy hije njerëzish që u ngritën nga një dëllinjë.

«Shokët!» — mendova. E megjithëkëtë u shtriva barkazi, sikur më tërhoqi toka.

— Parullën! — thirra dhe dëgjova zërin tim të thatë që e rrëmbeu gryka e malit.

Po në vend të parullës dëgjova breshëri automati-kësh. Plumbat fishkëllyen duke çarë ajrin rreth meje. Fishkëllimat ishin shumë të mprehta dhe, kur janë të tilla, domethënë se plumbat të kanë kaluar shumë pranë kokës: Pranë më kaluan edhe mua, se m'u duk sikur ndjeva edhe përcëllimin e tyre... Shtiva flakë më flakë në drejtim të

dëllinjës. I pashë mirë gjermanët. Njëri bëri një hark, si ata notarët kur hidhen në det nga lart dhe ra mbi kaçubën. e dëllinjës kù ishte fshehur pak më parë. Tjetrit i fluturoi automatiku nga dorà, sikur e hodhi vetë, ra në gjunjë, u përku! prapa me sa fuqi pati, sikur do të thyhej dhe pastaj u përmbys në një krah e s'levizi. Kjo ndodhi sa të hapësh e të mbyllësh sytë.

— S'jemi mirë këtu, tërhiqemi! — u bëra zë shokëve, por, sa luajta nga vendi, më theri këmba e djathtë. Isha plagosur ndonjë pëllëmbë nën gju, në koskë. Po ku kishte kohë aty të mendoja për plagën! Njëri nga shokët u ngrit dhe vrapoi si vetëtimë. E pashë që zuri vend rrëzë një shkëmbi të lartë, prapa ca gurëve, nja shtatëdhjetë a tetëdhjetë metra përtej. Po tjetri s'po lëvizte. U tërhoqa zvarë, se nuk qëndroja dot në këmbë dhe iu afrova.

— Tërhiqu, Ismail! — i thashë. Po ai kishte futur fytyrën thellë në borë dhe rënkonte. I vura dorën te flokët. Pëllëmba m'u bë qull me gjak. E kuptova që ishte plagosur në kokë. E ktheva me fytyrë nga vetja, i fola përsëri, po ai përpëlitte në krahët e mi e diç deshi të më thoshte, po nuk fliste dot. I mora krahun, e hodha në qafën time dhe u tërhoqa zvarë drejt shkëmbit! E si mund ta lija shokun e plagosur në duart e armikut! Ishte punë që s'bëhej ajo! Me të ke ngrënë bukë në një çanak, ke fjetur kushedi sa herë kurriz më kurriz për t'u ngrohur natën në pyll, të ka dhënë këpucët e veta kur ke mbetur zbathur, të është bërë në mal nënë e babà kur je sëmurrur, ka vënë kushedi sa herë gjoksin e tij për të të shpëtuar nga plumbi, dhe ti ta lësh të plagosur në borë? Jo, kjo s'mund të ndodhte kurrën e kurrës, prandaj e tërhoqa zvarë, me shpirt ndër dhëmbë, se edhe mua po më përvëlonte plaga. Po, kur arrita te një kaçubë, dora i ngriu në qafën time. E shkunda, e rrotullova nëpër duar, i zbërtheva jakën, i vura dorën në zemër.

— Ismail! Ismail!

M'u ftoh në duar pa thënë fjalën e fundit. Dhe deshi të më thoshte diçka, po s'e kuptova që s'e kuptova. Më mbeti peng. Ia mora kokën e gjakosur dhe ia vura në prehrin tim. Ah, moj vajzë, sa gjë e dhimbshme është kur

të vdes shoku në krahët e tu! Atë çast nuk e ndjeva dhembjen e plagës dhe as që mendova të shpëtoja lëkurën time. M'u mbloodh një lëmsh në grykë dhe sytë më dogjën nga lotët. Ja, sikur e kam përpara syve, i kishte a s'i kishte të tetëmbëdhjetat. Në lulen e rinisë ishte, i bukur ishte dhe shkoi e vate pa thënë fjalën e fundit! . . . Kushedi sa do të kisha ndenjur ashtu me kokën e tij të përgjakur në prehrin tim, po të mos më kishin përmendur krismat e automatikëve. Plumbat u shuan në borë përreth meje. Gjermanët nuk i shihja, se ishin veshur me pelerina të bardha, po nga flakët që dilnin prej tytave të automatikëve, e mora me mend se ishin mbi tridhjetë shpirt.

«Kaq e pata», — thashë. Mirëpo në këtë kohë shoku im hapi zjarr nga rrëza e shkëmbit dhe plumbat iu drejtuan atij. Unë lashë Ismailin dhe u tërhoqa drejt tij, zvarë-zvarë, duke lënë prapa mbi borë një brazë të thellë, të spërkatur vende-vende me gjak.

— Ku je, more Vasil? — e pyeta kur iu afrova shkëmbit.

— Ngjitu më lart, ngjitu, se të mbroj unë! — m'u përgjigj ai duke qëlluar vazhdimisht me maliher.

Unë e di si u ngjita. I vajta pranë me gjysmë shpirti, u ula prapa gurëve, pranë tij dhe fillova të shtija me automatik.

— Ervehe! Mos je plagosur? — më pyeti Vasili dhe vura re se zëri i tij shprehte më shumë frikë sesa shqetësim.

E gënjeva. E ç'do të fitoja, po t'i tregoja se isha plagosur? Do ta dëshpëroja, do t'i kallja frikë, do të humbte kohën kot pas meje dhe asgjë. Ja, njëherë, kur luftonim kundër italianëve, na erdhi një partizan drejt e në llogoret tona e thirri i lebetitur:

«— Shoookëë! U vra komandanti! Dhe unë jam plagosur në bark! Jemi të rrethuar, shoookëëë!»

Ne e dinim që komandanti na ishte vrarë, dhe që ishim të rrethuar e dinim. Po ai, me atë mënyrë si na e tha, na futi tmerrin. Mirë që u ndodh aty një babaxhan, i plagosur edhe ai, e i tha:

«E përse çirresh kështu, more lumëmadh! «Shokëëë! Shokëëë!» si ata qurravecët e rrugëve! E kush të ka rre-

thuar? Italianët. E ku të kanë rrethuar? Në vendin tënd. Po a mundet i huaji, që s'di asnjë shteg, të të rrethojë në vendin tënd? Na, të marrtë djalli, të marrtë! Shko të të lidhin plagën e na lër rehat! Po na u vra komandanti, shëndoshë ne që jemi gjallë e që kemi pushkët në dorë. Do të dimë ta marrim hakun. Apo jo, dhe shokë!»

Na dha zemër ai. Sulmuam dhe e çamë rrethimin. Po, prapëseprapë, ndonjë shok s'u bë burrë, kur ne sulmuam, mbeti në vend, gjoja për të na mbrojtur krahët! E kishte tmerruar i plagosuri me lebetitjen e tij. Ja, këtë mendova unë kur iu afrova Vasilit. Prandaj edhe e gënjeva. Dhe më duket se s'bëra keq.

Mirëpo Vasili më zuri ngushtë, kur më pyeti për të dytën herë:

— Ervehe! Po Ismaili ç'u bë?

Dhe unë përsëri e gënjeva.

— Ka zënë vend aty te kaçuba, — i thashë.

— Po përse nuk qëllon? — më pyeti ai për të tretën herë.

E si t'i thosha? T'i thosha: «A qëllon i vrari?» — Afrova fytyrën pranë tij. Ia pashë sytë, i kishte hapur shumë. Buza e poshtme i dridhej, i dridhej lehtë edhe dora e majtë që shtrëngonte fort tytën e pushkës. Dukej sheshit që Vasili ishte trembur. E përse t'ia kallja më shumë frikën?!

— Mirë bën që s'qëllon, — i thashë. — Le t'i lërë të afrohen.

Dhe a e di, moj vajzë, se ai nuk u drodh më? Ja ç'rëndësi ka fjala në kohën e luftës. Një fjalë e mirë e bën shokun më krahë...

Të kemi luftuar me Vasilin aty ndonjë orë a më shumë! Dhe nuk vramë pak gjermanë. Të thashë se në fillim unë dallova nja tridhjetë flakë që dilnin nga tytat e armëve. Po këto flakë ca nga ca erdhën e t'u rralluan dhe mbetën a s'mbetën nja dhjetë a dymbëdhjetë. Domethënë se i kishim grirë paq gjermanët. Po edhe pozicionin e kishim të mirë, më të lartë e gurë-gurë, kurse ata poshtë e në pllajën e zhveshur. Po luftuam edhe me mend. Të kishim qenë partizanë të rinj e pa përvojë, do të na kishin vrarë me kohë. Po unë kisha dy vjet e ca në mal. Edhe Vasili

po aq. Ishim të vjetër. Një herë qëllonte Vasili, ndërsa unë zvarishesha lart shkëmbit, gjersa gjeja një vend të përshatshëm dhe, kur filloja unë të shtija me automatik, tërhiqej Vasili dhe zinte vend njëzet-tridhjetë metra përmbi mua. Po ku venim, as ne s'e dinim. As ku do të dilnim, nuk e dinim. Vetëm i ishim mbërthyer shkëmbit dhe gjithnjë ngjiteshim lart, sa më lart, drejt majës së tij. As shokët nuk e dinin ku ishim. Më vonë mora vesh se batalioni, pasi kishte bërë sulmin e befasishëm e të shpejtë dhe pasi u kishte futur panik njërive gjermane, ishte tërhequr në rrëgull. Po ku ta dinim ne këtë punë? Dhe shkoni me shpresë se shokët do të na vinin në ndihmë! Mirëpo ata as që kishin si vinin dhe as që duhej të vinin. Ata ndoshta edhe i dëgjonin krismat e luftës sonë, po kujtonin se gjermanët qëllonin kot, si e kishin zakon shpeshherë natën. Batalioni ishte mbledhur përsëri matanë staneve, duke u tërhequr nga një rrugë tjetër dhe jo nga rruga që sulmuam. Ishin të gjithë dhe s'kishin lënë njeri që të shqetësoheshin. Mungoja vetëm unë me Ismailin e me Vasilin. Po për ne, shokët e kishin mendjen të fjetur. Na dinin në brigadë, në Qafën e Martës, kurse ne ishim aty, në mes të zjarrit. . .

Unë kisha hipur në majë të shkëmbit dhe s'kisha ku të veja më lart. Lart ishte qielli, përpara ishin gjermanët, prapa meje ishte një hon i zi, i thellë dhe, sa i thellë ishte, nuk mund ta merrje as me mend, se nuk i dukej fundi. Nga ai fund i errët vinte një gumëzhimë e heshtur. Si duket rridhte uji i ndonjë përroi. Duke qëlluar, herë pas here vrisja mendjen se nga të iknim, ç'udhë të merrnim dhe si të shpëtonim, kur Vasili u ngjit shpejt e shpejt lart. Më zuri për krahu e më tha:

— Ervehe! M'u mbaruan fishekët!

E pashë veten pisk, por nuk u dhashë. E kisha mësuar në mal dhe më ishte bërë si sëmundje: «Jepi zemër shokut gjer në pikën e fundit të gjakut!»

— Mos u bëj merak, — i thashë, — kam unë fishekë.

Ai vështroi maliherin, i ra kondakut me grusht i pikëlluar dhe më pyeti duke u munduar të më vështronte në sy:

— Po ky Ismaili ç'u bë? Si nuk u ndie? Si nuk qëlloi?

Ia prita aty për aty:

— Kush tha se nuk qëlloi?! Unë e vija re vetë, ai zbrazi një kollan me fishekë!

— Po përse nuk u ngjit lart? Përse nuk u tërhoq me ne?!

— Si duket ka marrë poshtë shkëmbit nga krahu i djathtë, ja, prite kur të vijë.

Pashë një gjerman që doli prapa një guri, qëlloi një breshëri të shkurtër dhe bëri përpara. Pesë-gjashtë plumba ranë dy gisht nën gurin ku isha unë. M'u duk sikur Vasili nxori një klithmë të heshtur dhe shtrëngoi supin e majtë me pëllëmbë.

— Ulu, Vasil! — i thashë.

— S'më zë plumbi mua! — m'u përgjigj ai me zë të mbytur.

Po unë vetë nuk u ula. Mora mirë në shenjë gjermanin që porsa qëlloi, mbajta frymën dhe tërhoqa këmbëzën. Dëgjova një «skrap» dhe asgjë tjetër. Më ishin mbaruar edhe mua fishekët. Hapa e mbylla kot automatikun, kontrollova karikatorin, bosh, kërkova nëpër xhepat; megjithëse e dija që s'kisha asnjë fishek. Atëherë s'kisha ç'të bëja më dhe iu drejtova Vasilit:

— Epo tani me se të luftojmë, o Vasil?

— S'kemi as nga të ikim, dreqi e mori! Do të na zënë të gjallë! — belbëzoi ai duke vështuar prapa në honin e zi.

U ula mirë prapa gurit që të mos më hante plumbi, u struka pranë tij dhe u mundova ta vështroja në fytyrë. Sytë i kishte të mekur, fare të mekur, sikur i qenë kapitur për gjumë. Nuk e di përse e pyeta:

— Ç'parullë kemi sonte?

— «Shqipëria!» — m'u përgjigj me një zë që mezi e dëgjova.

— Dhe kundërparullën e kemi «Shtëpia!» — i thashë unë dhe vrava mendjen për të gjetur një fjalë të mirë që të ishte si shkëndijë në atë errësirë që na kishte rrethuar. Dhe m'u duk sikur e gjeta: Sa mirë! «Shqipëria! — Shtëpia!» Ç'parullë e bukur! Sikur e kanë gjetur tamam për ne të dy sonte! Sikur vetëm për ne të dy kanë menduar sonte! A nuk e ndien se ta ngrohin zemrën këto fjalë?... «Shqipëria! — Shtëpia!»...

Shtinë përsëri, qëlluan majën e gurit dhe ciflat na ranë në trup. U afrova edhe më pranë shokut tim, u afrova aq shumë, sa ndjeva afshin e ngrohtë të frymës së tij. Dhe përnjëherësh vazhdova:

— Dëgjo këtu, Vasil! Në Shqipëri jemi, në shtëpinë tonë jemi. A nuk është marrëzi dhe poshtërsi që në tokën tonë t'u biem të gjallë të huajve? Ja, kur thonë, e hëngre turpin me bukë dhe u re në dorë i gjallë. Pandeh se do të shpëtosh? Do të të fusin një plumb dhe mbaroi. Pa edhe në paçin mëshirë, le që ku kanë mëshirë këta katilë, do të të dërgojnë në vendin e tyre, do të të detyrojnë të punosh për ta si buall, do t'i ushqesh me djersën e me krahun tënd dhe vetë do të jetosh me lëmoshë, si qen i zgjebosur. E përse të vete e të vdes në vend të huaj, kur mund ta bëj fare mirë këtë punë edhe në Shqipërinë time?! Dhe është toka ime, janë pemët e pyllit tonë, janë gurët e maleve tona që do të na mbajnë. A më dëgjon, Vasil?!

Kot i fola aq gjatë. Ai e kishte kuptuar që në fillim se ku i bija çekanit unë. Dhe u habita kur më tha:

— Mos e zgjat, Ervehe, se nuk na pret puna! Ke një orë që më gënjen. Dhe të kam besuar, se më ka ardhur mirë, dhe jo se nuk e dija që më gënjeje. Më the se Ismaili është gjallë e po lufton, kurse unë e pashë atë kur u plagos, të pashë edhe ty kur e tërhiqje, kur të mbeti në dorë e kur e le pranë kaçubës! Po unë e di përse më the që ai lufton. Më the ashtu për të më dhënë zemër. Dhe më dhe me të vërtetë. Megjithëse e dija që Ismaili ishte vrarë, kur më fole ti, m'u duk sikur lëvizi aje te kaçuba e sikur qëlloi me pushkë e me granata. Më the edhe se nuk je plagosur. Edhe këtë ma the që të më jepje zemër, o Ervehe! Dhe më dhe zemër me të vërtetë! Po tani u mor vesh, të gjallë nuk biem në duart e tyre! Do të hidhemi nga shkëmbi në hon! Veç shpejt, sa më shpejt, se jam plagosur në shpatull e s'kam fuqi. Sa më shpejt, Ervehe, se edhe gjermanët erdhën!...

Epo, ç'të të them, moj vajzë e dashur, si u bëra unë kur dëgjova këto fjalë nga Vasili! Ai kishte qenë shpirt njeriu, ai kishte qenë shok lufte me tërë kuptimin e fjalës. E dinte që e gënjeja dhe s'më kishte bërë zë. Më kishte be-



suar sa për sy e faqe, që të më jepte zemër mua, si vajzë që isha. Rraha ta gënjeja, t'i jepja zemër unë, po më gënjeu ai, më dha zemër ai...

U zbraz një automatik fare pranë nesh. E kuptova se gjermanët ishin prapa gurit tonë, na kishin ardhur te këmbët, sa të thuash, të ngriheshin, të zgjasnin krahët e na zinin me dorë.

— Epo, lamtumirë, Vasil! — i pëshpërita dhe ia hodha duart në qafë.

— Lamtumirë, Ervehe! — mezi tha ai duke më për-qafuar me një dorë.

Këto nuk ishin fjalë, po një si pëshpëritje që na dilte nga thellësia e shpirtit. Sikur i thamë jo vetëm njëri-tjetrit «lamtumirë», po sikur i thamë edhe jetës, edhe sho-këve, edhe Atdheut!...

Mezi rrëshqita nga dora e Vasilit, se më kishte shtrën-guar fort. Pashë njëherë honin e zi, të thellë e të tmerr-shëm, mbylla sytë dhe thashë me vete:

«Të dalë ku të dalë, veç gjallë në duart e tyre të mos bie, se jam partizane, pa jam edhe vajzë!»

Përnjëherësh, sikur më shtyu njeri me dorë, ndjeva se u shkëputa nga toka dhe fluturova si një shqiponjë, jo lart, po poshtë, gjithnjë poshtë, në honin e zi, në honin pa fund e të tmerrshëm!...

Gruaja mbylli sytë dhe mbeti si e ngrirë për një kohë të gjatë, sikur nuk deshë të shikonte vetëtimat e shumta që çanë qiellin pus të errët, retë e zeza sterrë, që i shtynte era e furishme drejt lindjes dhe detin e errët dhe me kreshta të bardha që rrapëllinte më shumë se më parë. M'u duk si-kur ajo nuk dëgjoi as krismën shurdhuese të rrufesë që ra prapa krähëve tanë, te plepat e kampionit të pionierëve, as bisedat e zjarrta të pesëqind e ca punonjësvë të filmit dhe as zhurmën e valës që erdhi e u shtri gjer te kërcuri i mo-çëm, ku ishim ulur. Unë u meka nga tregimi i saj; fshiva me pëllëmbë dy pika lotë, që kësaj radhe nuk më kishin dalë nga thëllimi i ngrohtë i erës, po nga fjalët e saj. E vështrova gruan me zemër të dridhur, doja t'i hidhesha në qafë, t'ia ledhatoja ato duar të thara që i kishte lëshuar si pa jetë mbi gjunjët. Po nuk munda. Ashtu, me sytë

mbyllur, me duar të lëshuara, me kokën përkulur pakëz përpara m'u duk si një shqiponjë e moçme, e lodhur, e rraskapitur, e dërrmuar nga lufta, por që ende nuk është gjunjëzuar dhe as që ka ndër mend të gjunjëzohet.

— E fortë paske qenë! — murmurita me vete duke psherëtirë, po ajo, si duket, më dëgjoi, u kthye nga unë dhe vazhdoi:

— E fortë the? Ah, ta dish ti, sa e butë dhe sa e dobët kam qenë! Çuditërisht edhe sot e kësaj dite se ku e gjeta atë forcë aq të madhe, sa të duroja gjithë ato që durova!... A e di se atje në fund të honit kam ndenjur shtrirë pa ndjënja njëmbëdhjetë orë? Dhe pas këtyre njëmbëdhjetë orëve mezi hapa sytë. Qielli ishte i kaltër atje lart dhe shkëlqimi i fortë m'i verboi sytë. Shikoja nëpërmjet qepallave vetëm një copë qiell dhe rënkoja. Nuk më kujtohet se ç'kishte ndodhur me mua dhe se ku isha. Nuk lëvizja dot as këmbë, as duar, as kokë, asnjë muskul, vetëm kapakët e syve i hapja nganjëherë, po edhe ata me zor, se më dukeshin të rëndë plumb. Pastaj më shkrepiti një si iskër në mendjen time të përgjumur:

«Qenkam gjallë!» — mendova dhe bëra të ngrihesha. Po më theri tërë trupi e sidomos më çanë këmbët, sikur m'i sharrnin. Sytë m'u veshën qielli m'u rrotullua, më erdhi për të vjellë, po nuk më ra të fikët. Kur, papritur, dëgjoi një të lehur qeni, në fillim larg, pastaj afër, gjithnjë më afër, gjersa e ndjeva që më erdhi rrotull duke më nuhatur. Dëgjova dhe hapa njerëzish që ngjishnin borën përreth meje.

«Tani mbarova, — thashë me vete. — Erdhën, të mallëkuarit, më gjetën. Prite kur të kërcasë automatiku». Dhe m'u duk sikur lëvizja duart e zura veshët për të mos dëgjuar krismën e armëve. Isha a s'isha gjysmë njeriu atë çast dhe prapë nuk doja të vdisja, doja, të jetoja. . . Ndjeva frymën e një njeriu te sytë e mi të mbyllur.

«Epo he, mor qen, qëllor! Ç'pret më? Merrma edhe atë çikë shpirt që më ka mbetur!» — i thashë pa zë atij që më lëshonte frymën te sytë, po në vend të krismës ndjeva një pëllëmbë të ashpër e të ftohtë, që më lëmoi ballin. Pastaj ajo dorë çau borën e ngrirë dhe u fut në qafën time. Ajo

dorë më ngrit kokën. Atëherë unë hapa pakëz sytë e nëpërmjet qepallave dallova shumë turbull një fytyrë të parruar njeriu, me mustaqe të mëdha e me një kapuç gune në kokë. . . Nuk ishte gjerman, po një bari mali. . .

— Ngrehu, moj bijë! — pëshpëriti.

Mua m'u mbushën sytë me lotë.

— Nuk ngrihem dot! — i thashë. — Po shiko. . . Vasilin, Vasilin! — dhe më ra të fikët e s'mora vesh ç'u bë. . .

Si më shpuri bariu në shtëpinë e tij, ai e di, po më shpuri, më mbështolli me lëkurë deleje e më solli në vete. Kur u përmenda mirë, e kuptova ç'kisha bërë e ç'kisha pësuar. Më ishin thyer këmbët, pesë gisht nën gju, kurse Vasilin e lashë përgjithnjë në honin e zi. E gjetën të vrarë dhe atje e mbuluan. . .

Fshatarët m'i mbështollën këmbët e thyera me lëkurën e trungut të fikut, m'i vunë në lëkurë, si në çizme, dhe, pas Operacionit të Dimrit, më nisën në brigadë. Po unë s'isha më për luftë. Dhjetë muaj ndenja shtrirë në spitalet partizane, në kasollet e fshatarëve, në lëndinat e pyjeve. Të njëmbëdhjetin, kur u çlirua Tirana, dola në rrugë me paterica. . .

— Dielli, po del dielli! — dëgjova një zë prapa kraheve. Gruaja e ndërpreu tregimin dhe të dyja vështruam qiellin. Midis reve të dendura dukej një copë qiell shumë i kaltër. Prapa një reje qumështore po dilte dielli me rrezet e tij të ngröhta. Njerëzit që ishin përhapur në bregun e detit, luajtën nga vendet dhe u grumbulluan tek aparatet. Buçiti një motor dhe projektorët lëshuan drita të forta. U ngrita edhe unë, se po më thërrisnin. E vështrova gruan me një dashuri të madhe në shpirt. Desha t'i thosha një fjalë. . . por i shtrëngova vetëm dorën me mirënjohje të thellë dhe shkova drejt aparateve. Dhe, duke ecur, se pse më tingëllonin në vesh këto fjalë:

«Shqipëria! — Shtëpia!»

1959

## RRUGË E VËSHTIRË

Sapo hyra në shtëpi, e ndjeva se pak kohë më parë atje duhej të kishte plasur ndonjë sherr. Im atë vente e vinte nëpër dhomë. Herë qëndronte me sy mbërthyer në tubin e sobës, herë kthehej e qëndronte me vështrim përpara kanistrës së bukës, mbi bufe. Dukej i tronditur. Nëna që ulur pranë tryezës dhe hera-herës, me cepin e përparësës, fshinte diçka poshtë syve të skuqur. Kurse mbi minder Suzana ishte mbledhur grusht dhe rrinte ashtu pa lëvizur, e ngrirë dhe e zbetë.

— Mirëmbërma! — thashë duke u përpjekur të tregohe-sha sikur s'kisha vënë re gjë.

Por s'mora asnjë përgjigje. Im atë hapi portën dhe doli duke e përplasur me forcë. Pashë ca leskra gëlqereje që zbardhën mbi dysHEME. Nëna u ngrit, rrëmbeu nga bufeja shishen e valerianës dhe e ndoqi babanë pas, kurse Suzana, që, me sa dukej, gjer atë kohë e kishte përmbajtur veten me vështirësi, tani fshehu fytyrën me duar dhe shpërtheu në lotë. Iu afrova ngadalë dhe i fola me zë të ulët:

— Ç'ka ngjarë, Suzi?

Ajo shtrëngoi sytë e tundi kokën e dëshpëruar. Nuk di nga më erdhi gjithë ai guxim që më shtyu të ulesha pranë saj dhe t'i flisja për herë të parë aq hapur:

— Unë e di... — i thashë ngadalë, por pa u tronditur aspak. — Unë e di... e kuptova!

Ajo ngriti kokën dhe më vështroi e mallëngjyer. M'u duk sikur deshi të thosh: «Shpirt i motrës, ti nuk mund të kuptosh asgjë.»

... Dera e dhomës u hap me vull. Hyri im atë dhe pas tij nëna, e cila e ndiqte pas duke i zgjatur gotën, ku lodronte një gisht lëng i verdhë.

— Lërmë rehat me gjithë të! — i shfryu babai, duke i shtyrë me zemërim dorën. Pashë gishtërinjtë e nënës që u lagën, dhe ajo u tërhoq duke mbushur sytë me lotë. — Po ta përsëris për të fundit herë, — iu kërcënua babai me gishtin në kokë, duke bërë dy-tre hapa drejt Suzanës. — Mbli-dhe këtë këtu! O hiq dorë prej tij, që të qëndrosh në shtëpi, ose ngrehu dhe zhdukmu nga sytë që këtë çast e të të heq vijë një herë e përgjithmonë! Zgjdh e merr!

— Dale, Petro... mos kështu... — u alarmua nëna, duke u zënë pas krahut të babait.

— Ti, Ilir, shko në dhomën tjetër! — urdhëroi babai me zë të prerë. Por unë atë kohë isha mpirë i tëri e nuk luaja dot nga vendi.

Ky kërcënim për një çast m'u duk aq i rreptë, sa që fillova të mendoja se, sado faj të kishte Suzana, përsëri ajo ishte motra ime, për të cilën unë lija kokën. Babai s'kishte të drejtë ta zhdukte nga shtëpia. E pse? Sepse... po, unë e dija arsyen, megjithëse asnjëherë s'i kisha rënë në sy.

Disa kohë më parë, një mbrëmje, më kujtohet, fqinja jonë më tërhoqi fshehurazi brenda korridorit të saj dhe më tregoi një kafaz të bukur zogjsh që kishte blerë. Pastaj më pyeti se kur do të fejohej Suzana me «atë mekanikun e oficinës këtu pranë».

— «Nuk e di, — i thashë. — Të shkoj e ta pyes?...» Fqinja nxori një klithmë alarmuese dhe më porositi një mijë herë që të mos e zija në gojë këtë bisedë.

Pak kohë më pas, inxhinieri i ri që banonte në një pallat me ne, më ndali në shkallë dhe më pa me një vështrim sikur më nguli dy gozhdë:

— Ruaje, mo, motrën, se i vete një bandill nga prapa! — më tha me një zë të trashë e të zvargur. Në çast u kujtova për nofkën «Syshponjësi», me të cilin talleshin hapur Suzi me shoqet e saj, por këtë herë nuk më dha asnjë fije gazi.

Ika pa i dhënë përgjigje, duke provuar diçka në vet-vete, sikur prisja që një gjë e papëlqyer do të ndodhte së

afërmi. Mezi prisja të shihja motrën time dhe më dukej që në vështrimin e parë do të qartësoja fjalët e errëta që kisha dëgjuar. Dhe u qetësova kur pashë që ajo, porsa erdhi, më zuri nga qafa si zakonisht dhe nxori nga çanta topin që më kishte premtuar. Atëherë, duke mos duruar më, i zura krahun dhe e pyeta duke e parë me kureshtje në sy:

— Të nget njeri rrugës ty, Suzi? A të shan ndonjë njeri?

— Të më shajë njeri?! — u habit ajo. — Përse të më ngasin e të më shajnë?!

— E, pra, — qesha unë i lehtësuar, — ashtu kot pyeta.

Por nuk kaloi shumë kohë dhe Bujari, shoku im që banon në pallatin përballë, më tha se Suzi takohej me «një» dhe kishte dëgjuar motrën që i thoshte prindërve se «ai i Suzanës» nuk qe me diplomë dhe se ajo, Suzana, që qe në institut të lartë, kishte rënë më poshtë se shoqet e saj. Unë u revoltova duke thënë se këto fjalë nuk qenë aspak të vërteta. Dhe i mbylla thellë në veten time. Desha t'i harroja.

Por ndodhi diçka e papritur. Unë u njoha me «atë». Po kthehesha nga kinemaja. Pak më larg, në errësirë, shqova fundin e saj të bardhë dhe flokët e verdhë e të gjatë. Po vinte ngadalë e pranë saj po ecte dikush. Për një çast zemra më rrahu fort: «Ç'do ai, përse nuk e lë ai rehat Suzanën?!» Bëra dy hapa të vendosur drejt tyre. Në këtë çast moshën e tij, që ishte dyfishi i moshës sime, as e përfilla fare. «Ai e ndjek këmba-këmbës dhe s'ka ndër mend të largohet fare. . . Mbase ajo ka frikë prej tij. . . Mbase. . .», mendova. Dhe, ndërsa rrahjet e zemrës sa vinin e më shtoheshin, befas shtanga në vend. Dëgjova të qeshurën e saj, një të qeshur të fortë e të gëzuar, dhe pas kësaj nuk u be-sova më syve. Ajo, ajo vetë, Suzana, e tërhoqi «atë» nga dora dhe të dy u futën në rrugicën tonë. U ktheva me vrull dhe desha të ikja nga sytë këmbët, por ajo më njohu e më thirri. Qëndrova në vend i hutuar. Ata u afruan që të dy. Ime motër më rroku për qafe e më shtrëngonte sikur nuk desh të largohesha prej saj.

— Ky është Iliri? — pyeti ai. — Toke këtu. Unë jam

Gjoni. Nuk të ka folur Suzana për mua? Jo? Suzana më ka shok. A pranon të jem edhe shoku yt? Unë e di që ti, si unë, lot menç pas topit.

E vështrova i hutuar. Të gjitha përfytyrimet e mia u përmbysën krejt. Ai më pëlqeu. Vështrova motrën. Ajo qeshte dhe sytë i shkëlqenin nga gëzimi.

— Me cilën skuadër je? — e pyeta.

— Me «Partizanin», — tha ai. — Po ti?

— Edhe unë.

— Oh, po ne qenkemi vetvetiu shokë! — qeshi ai, duke më shtrënguar pas vetes.

Të nesërmen dhe shumë herë të tjera ne u bëmë frekuentues të rregullt të ndeshjeve. Kur fitonte skuadra jonë, ne e «lagnim» atë fitore: Gjoni pinte birra, kurse unë limonadë. Kur ndodhte ndryshe, ecnim kokulur dhe ndaheshim duke shtrënguar duart në heshtje. Pastaj ai më thërriste që prapa e më thoshte:

— Mos u mërzit, Ilir. Finalja për kupën është jona!

— Patjetër! — përgjigjesha unë dhe dalngadalë e ndieja që lehtësohesha nga dëshpërimi.

U bëmë miq të mirë. Ndodhi që njëherë u zemërova me Gjoni. Me gazetë në dorë i shkova në uzinë. Sa më pa, fshiu duart me një leckë me benzinë e më shtrëngoi dorën fort.

— Përse ma ke fshehur shpikjen tënde? — e pyeta me ton të rreptë, duke e ndier veten të fyer. — Unë, shoku yt, ta marr vesh nga gazeta?!

Ai buzëqeshi i zënë në faj.

— Ke të drejtë, — tha. — Mendova se do të ta kishte thënë Suzana.

— E gjete! — ia prita. — Ajo akoma më quan «të vogël». Vetëm me ty kuptohem mirë. Dëgjoje? Vetëm me ty.

Që atëherë Gjoni filloi të bisedonte me mua seriozisht për çështje pune, librash, shfaqjesh dhe për çdo gjë që i përkiste moshës sime. Më hyri në zemër ky shoku ynë. Sa për botën, le të fliste ç'të donte. Suzana kishte ditur të zgjidhte një shok shumë të mirë.

Dhe ja, befas, këtë mbrëmje unë u ndodha përpara

një të papriture. Im atë kërkonte dy kushte: ose ime motër të largohej, ose të hiqte dorë nga ai. Ishte zgjedhje e vështirë. Edhe unë isha në gjendje ankthi kur babai më urdhëroi të shkoja në dhomën tjetër.

— E, përgjigju! — ngriti zërin me kërcënim babai.

Unë në çast përfytyrova motrën time të ngrihej dhe, e vendosur, të niste çapat drejt portës së hapur... Dhe u rrëqetha i tëri.

— Akoma këtu, ti?! — u kujtua babai papritur, — shko në dhomën tjetër, të thashë!

U ngrita me këmbë të mpira, duke mos ia ndarë sytë motrës sime. «Ajo do të ikë tani», mendoja dhe veshët më buçisnin. Por ajo nuk lëvizi nga vendi. Hapa derën dhe, si i hodha një vështrim për të fundit herë, dola.

Ishte çaste ankthi. Nuk e di sa kohë kaloi kur krisi dera dhe në dhomë hyri Suzana. Dukej e menduar. U zhvesh dhe ra në shtrat.

Një lëmsh m'u ngjit nga kraharori në grykë. Nuk e di nga më erdhi një forcë e çuditshme dhe më një të ngritur u gjenda pranë shtratit të saj.

— Frikacake! — i thirra me përbuzje e neveri.

Ajo u kthye dhe, me një lëvizje të shpejtë, hodhi tej çarçafin dhe më përqafoi fort.

— Xhani i motrës! — tha. — Ti tani i kupton të gjitha. Unë e dua atë siç ju dua dhe ju të gjithëve. Tek ai unë çmoj njeriun dhe jo pozitën, siç pëlqejnë prindërit tanë... Dëgjo, Ilir, do të vijë një kohë që ata do të lënë kokën për të. Ka ndodhur shpesh kështu. Ti u mërzite kot, shpirt i motrës! Të ikja nga shtëpia? Kjo është gjëja më e lehtë... Kurse unë vendosa të ri, gjersa t'i bind se unë kam të drejtë. E di që është rrugë e vështirë, por jam e sigurtë se do t'ia dal. Ti je me mua dhe kjo është gjysma e fitores, — shtoi ajo me buzën në gaz, duke treguar kështu, nëpërmjet syve të përlotur, një shkëndijë lumturie.

Mora frymë i lehtësuar. S'kishte si të ndodhte më mirë.

— Mos u mërzit, — i thashë me gjithë forcën e vullnetit tim, se kupa e finales është jona!...



NE ORET E VONA TE SE SHTUNES

Atë të shtunë mbrëma Andrea nuk e gjeti Lindën në shtëpi. Ishte hera e parë kjo gjatë një viti fejëse dhe atij se si iu duk kur nuk e pa të vraponte shkallëve e t'i rrëmbente çantën e rëndë, t'i shtrëngonte krahun e t'i thoshte, duke iu marrë fryma, ato fjalë aq shumë të përsëritura: «E dija që do të vije!»

Andrea, është inxhinier montator në qytetin e ri industrial N. Si të qëllonte, një herë në javë apo në dy javë, ai i hipte motorit e zbriste në qytet, ku kishte nënën dhe Lindën. Takonte të mos vinte dhe një muaj të tërë. Linda kishte kohë që ishte mësuar me këtë. Në ditët e para të njohjes kishte qëlluar që të priste minuta të tëra përpara bibliotekës e të kthehej e mërzhitur në shtëpi. Në takimin më të afërt kishte pritur që Andrea të shfajësohej, por ai, sikur të mos kishte ndodhur asgjë, i thoshte vetëm kaq: «Nuk erdha, kisha shumë punë». Dhe niste e i tregonte për oxhakun e lartë që po ngrinin. Ajo me kohë e ndjeu se i vinte mirë që ai ishte i tillë e, sa niste Andrea rrëfimin, i dukej se afronte pranë saj një botë të madhe me zhurmë të përsëritshme, me hekura që lëshonin xixa dhe shtylla që ingriheshin lart.

— Po ti? — e pyeste ai. — Si e ke kaluar?

— Asaj herë-herë i dukej sa një grimocë bota e saj.

— Bëj analiza.

— Ai vinte buzën në gaz ngaqë përgjigjja e saj ishte përherë e njëjtë dhe se e dinte që pas kësaj përgjigjeje ajo do

të shtonte: «Po ja, edhe mësoj». Shqiptonte këto fjalë dhe inatosej me vete që kishte folur si duke u shfajësuar. Përse të mos i tregonte për fijet e gëzimit që i ndizeshin thellë, sa herë inxhinier Pali i sillte analiza urgjente? Kishte kaluar çaste të tilla, por ato i dukeshin pikla përpara shtyllave të larta ku ngjitej Andrea. E ajo zhytej në rrëfimet e tij.

Të shtunat e tyre ishin të gëzuara, ishin plot e përplot me biseda nga më të ndryshmet që e bënin Andrean çdo herë e më të mirë në sytë e Lindës dhe Lindën çdo herë e më të gjithanshme në sytë e tij. Ai, tek vraponte me motor drejt qytetit të tij të gjelbër, provonte një ndjenjë të çuditshme që i zgjeronte kraharorin, i jepte më shumë frymë, më shumë gëzim. Kish dashur t'i fliste Lindës për këtë ndjenjë, por, sa herë bëhej gati, zëri nuk i diltë. Ishte diçka e brishtë ajo që duhej t'i thoshte, kurse fjalët që i kishte menduar disa herë, i dukeshin tepër të thata. Por këtë herë, ndërsa shtonte shpejtësinë e motorit, ai mendoi ta thyente heshtjen. «Gjithë rrugën e kam bërë me ty, Linda. Ti më buzëqeshje, kurse mua më dukej se s'të arrija dot». Kaq do t'i thoshte. Kurse ajo patjetër do të gajasej. «Se si je ti, Andrea», do të belbëzonte dhe sytë e gjelbër do t'i shkëlqenin.

Linda dëgjonte e hutuar inxhinier Palin. Kur e kishin thirrur në zyrën e tij, kishte hyrë fare e qetë, siç ndodhte gjithmonë sa herë e kërkonin për ndonjë punë. Hutimi kishte ndodhur më vonë, sapo inxhinier Pali, me ton serioz, i kishte thënë se dhe ajo atë pasdite nuk do të largohej nga puna. Bashkë me një grup shokësh do të bënin ca analiza urgjente. Linda ndjeu zemrën t'i rrihte fort; një emocion i pakuptueshëm po e pushtonte, ndërsa hidhte vështrimin sa nga inxhinier Pali, te Dhurata e Nesti. Ajo do të punonte me ta. Dyshohej për një mineral të rëndësishëm. Një grup fshatarësh kishin sjellë kampionin në ekspeditën gjeolo-

gjike. Inxhinier Pali fliste, Linda shihte sytë e tij të shqetësuar e iu duk se shihte para vetes atë botë të madhe, që sa herë ia kishte sjellë pranë Andrea. Inxhinieri vazhonte të fliste. Ajo këtë herë vështronte thinjat e tij të bardha. Në laborator të gjithë thoshin, se Pali ishte thinjur ekspeditave, se ai nuk mund ta kuptonte jetën pa ekspedita. Thoshin se ishte një laborator më vete. Me një të parë, ta jepte vlerën e mineralit. Ja, tashti ai e mbante në duar kampionin e përsëriste se ndoshta do t'u duhej të rrinin me orë të tera mbi të.

Lindës i dukej vetja e vogël në atë dhomë të madhe e plot dritë. Ndeshte vështrimin e Dhuratës, të Nestit e i bëhej se ata nuk e dallonin fare. As Pali nuk po e vështronte. Iu duk se qëndronte jashtë asaj dhome, se gjithçka që thoshte Pali, u përkiste atyre të treve. Ata sot, në mbrëmje apo më vonë, do të jepnin një lajm të gëzuar, ose... do të ulnin kokat e do të ndiznin cigaren. Përmes tymit që do të ngrihej në dhomë, do të arrinin deri te Linda fjalët e tyre: «E pësove dhe ti me ne». Kështu iu duk Lindës për një çast dhe e ndjeu veten si diçka të jashtëme në këtë ngjarje.

Zëri i Palit ia zhduku këto mendime. Ai shtoi: «Ti, Linda, domethënë, duhej të ishte e kujdesshme, e vëmendshme, duhej të harronte gjithçka... edhe që ishte e shtunë. Pali qeshi kur e tha këtë fjalë. Qeshi dhe Linda...

Ishte e shtuna e parë që Linda mendoi se do të qe më mirë sikur Andrea të mos vinte. Një natë më parë kishte folur në telefon dhe ajo kishte prerë bileta për në koncert. E kishte porositur Andrean të vinte në kohë. Ai do ta priste atë mbrëmje siç kishte pritur dhe Linda sa herë me librin në dorë, pranë dritares së kuzhinës apo me vështrim te agrepi i orës së varur në mur, që me aq mospëfillje kalonte nga shifra në shifër.

Ajo rregulloi shpejt e shpejt vendin e punës. Pranë saj qëndroi Pali. Sytë gri ishin akoma të shqetësuar dhe Linda ndjeu të ftohtë në duar. Domethënë ajo do të punonte në prani të tij. Dhe ai do të peshonte çdo lëvizje të

saj, do të dallonte ndonjë ngathtësi, dyshim. Iu duk se edhe në provimin më të zorshëm e kishte pasur më lehtë. Inxhinieri shënoi diçka mbi një letër të bardhë e filloi të bënte llogaritje. Ajo i hodhi një vështrim shifrave që shtoheshin. Lëvizi peshoren e u mundua të mposhte atë ndjenjë të çuditshme që i ishte ngjitur.

— Peshoje dhe një herë! — Toni i zërit të Palit ishte më tepër se një urdhër. Linda u step.

— Shifra është e saktë, — foli ajo e përqëndruar si asnjëherë.

Pali e vështroi ngultas.

— Është e saktë! — përsëriti Linda.

Ai vazhdoi punën, ndërsa Linda provoi një qetësi të çuditshme.

Sikur ai të kishte pasur një vështrim tjetër dhe ashtu siç është ai, në disa raste, inatçi, të ishte ngritur e t'i kishte thënë «Dal ta shikoj vetë», ajo nuk do të ishte në gjendje për asgjë.

— Vazhdo! — i tha ai.

Linda mori frymë e lehtësuar dhe vështroi nga Dhurata që edhe ajo ishte tepër e përqëndruar në punën e saj.

Dhurata ishte rritur në laborator, siç thoshin shoqet. Kishte ardhur 15-vjeçe. Pali i kishte qëndruar mbi kokë, derisa ishte bërë inxhinier. Ai jo rrallë thoshte se tashti ia kalonte dhe atij. Dhurata buzëqeshte tek e dëgjonte e, duke tundur kokën, me zë të ulët i thoshte:

— Sa lotë kam derdhur unë nga tilla gjëra!

Se nuk pyeste inxhinier Pali. Këtë e kishte zakon. Le të ishte punëtore e mirë, gabove, ai të binte në kokë. Derisa gabove, duhet ta kuptosh gabimin; pa ë kuptuar, nuk ecet përpara. Këtë e përsëriti shpesh inxhinier Pali. Ndaj Linda në ato minuta tërë tension me ngurrim hedh sytë nga ai. Vështrimi i inxhinierit, edhe pse lehtëson, edhe pse vret, kurdoherë është i drejtë, kurse Linda mendon se është shpejt për të marrë çmimin e gjithë atij shqetësimi që i erdhi aq i papritur. Linda u habit kur pa se kishin kaluar orët. Kurse inxhinier Pali u nervozua. Por edhe pse u nervozua, ai vuri buzën në gaz e tha se këto punë nuk duhen

bërë rrëmbimthi, se ato duhet të verifikohen mirë. Një herë, dy herë, edhe tri herë. Nuk është shaka. Një «po» ose «jo» e tyre ishte baraz ose me miliona, ose me zero. Kështu tha inxhinier Pali. Linda, tek e dëgjonte, i kuptonte më mirë rrahjet joritmike që ndiente në kraharor. Jo, ato nuk kishin të bënin fare me shkathtësinë ose ngathtësinë e saj. Ishin diçka më shumë. A mund të qëndronte vallë Linda indiferente ndaj asaj fjale: «po» ose «jo»? Ajo i dha të drejtë inxhinierit, që nuk i la t'u gëzoheshin rezultateve të para.

— Prisni! Është shpejt për të buzëqeshur, — i kishte thënë ai. E ndërsa Linda peshonte, ndiente përsëri të ftohtë në duar.

«Po» ose «jo». Mos vallë në të gjithë llogaritjet kishte ndonjë gabim e ai fillonte nga ajo peshore metalike, ku Linda me aq kujdes vendoste kampionin?

Nesti diçka i tha inxhinier Palit dhe Linda pa një dritë si zjarr në sytë gri. U ul dhe ai pranë tyre e që të tre, të përqëndruar si asnjëherë, diçka vështronin mbi tavolinë. Linda asgjë s'dallonte. Mori epruvetën dhe ndjeu një këputje në gjithë trupin. Iu dukën përpjekjet e saj nga më të zakonshmet, që s'kishin të bënin fare me atë «po» ose «jo», që do të shqiptohej së shpejti. Iu duk vetja si diçka e jashtëme në tërë këtë histori.

— Filloje dhe një herë nga e para! Dëgjo, Linda.

Duhej filluar nga e para. Mos vallë kishte gabuar?

— ... Do t'i bëjmë edhe një provë. — Zëri i Palit këtë herë ishte shumë i qetë.

Nga e para. Dhe duhej ta fillonte ajo, Linda. Vështroi me bisht të syrit në drejtim të atyre të treve. I kishte rënë epruveta nga dora dhe s'donte që ata ta shihnin. Inxhinier Pali iu afrua.

— Ç'ke Linda?

Ajo vuri buzën në gaz. Nuk vështroi nga ai. Iu duk se ishte gati të shpërthente.

Inxhinier Pali i vuri dorën në sup.

— Po shqetësohesh? S'ka si të ndodhë ndryshe! Pa shqetësim asgjë nuk vjen! Ja, e shikon? — Ai vuri dorën

dhe fshiu bulzat e djersës në ballë. Buzëqeshi. Në sy kishte po atë dritë si zjarr. Buzëqeshi dhe Linda dhe ndjeu se kishte humbur gjithë fjalët dhe i ngjau se kishte bërë një hap të madh.

— Ne pas pak do të themi «po», do të provojmë dhe një herë, Linda! — Inxhinier Pali përsëri i rrahu krahët. Ajo fshiu dy pika djerse në ballë.

— Veçse nuk u lodhëm kot! Dëgjon, nuk u lodhëm kot. Domethënë dhe ajo bashkë me ta. Në ato orë të asaj mbremjeje bashkë me të ajo kishte kryer diçka të rëndësishme. Le të jetë puna e saj më e thjeshtë. Dhe ajo gjendej brenda asaj fjale «po», që do të fluturonte radiogrameve. Çdo gjë fillonte nga e thjeshta.

Inxhinier Pali shtroi flokët e thinjur mbi ballin e ngritur e diçka tha për fshatarët.

Peshorja lëvizte, ndërsa Linda mendonte se edhe fshatarët që kishin ecur aq orë në këmbë dhe i kishin mbështjellë në ca letra ato copa gurë, edhe ata bënë pjesë në atë lajm të gëzuar që do të jepej pas disa orësh.

Duart e saj këtë herë fluturonin, fytyra i qeshte. Ajo tashmë e dinte se çdo gjë ishte në rregull, dhe pse po e përsëriste provën. I ndiente këmbët tepër të rënda dhe kishte dëshirë të ulej. Por aty pranë qëndronte inxhinier Pali. Mbikëqyrte duart që lëviznin me shkathtësi. Linda përsëri fshiu djersët.

— Kështu e kanë këto punë, do të mësohesh, — i tha ai.

Kishte vetëm një vit që punonte në këtë laborator. Ajo e dinte se duhej akoma shumë kohë sa të mësohej me të gjitha.

\*  
\*   \*  
\*

Të dielën Andrea erdhi si zakonisht në orën 10. Nuk e hoqi pardesynë, i tha Lindës se jashtë qe kohë e mirë.

— Jam gati për të dalë, — iu përgjigj ajo. Sytë jeshilë shkëlqenin.

Këtë Andrea e vuri re qysh në çastin e parë, kur Linda

buzagaz ia hapi derën e ia shtrëngoi dorën me të dyja pëllëmbët e buta.

Kishte diçka të veçantë edhe në shkathtësinë e saj këtë ditë, edhe në mënyrën si e hidhte konjakun në gotë apo në përgjigjet e shpejta e plot humor, që i jepte t'et. Andrea vetëm dëgjonte. Ndonjëherë vinte buzën në gaz.

— U mërzite mbrëmë? — e pyeti ajo.

— Lojta shah me babanë. Prita deri në dhjetë, pastaj ika.

— E, di, Andrea?

Si t'ia thoshte atë që kishte provuar në orët e vona të së shtunës? Gjithçka mund të shprehej vetëm me një fjalë, por Linda donte të fillonte nga e para, nga më pak e rëndësishmja e pastaj të mbërrinte aty, në atë çast të paharruar, kur ndjeu rrahjet e çuditshme në kraharor, kur inxhinier Pali i tha: «Patjetër duhet shqetësuar, pa shqetësim asgjë nuk vjen!» Dontë t'i fliste për djersët, për fjalën «po», që kaloi radiogrameve, për...

Si t'ia shpjegonte se diçka e re kishte hyrë thellë në qenien e saj edhe i kishte dhënë aq shumë gëzim?! Ajo, Linda, s'rrinte kot. Dhe ajo përfshihej në atë fjalë të rëndësishme «po». Dhe ajo, bashkë me të tjerët. Le të kryente punën më të thjeshtë. Djersa e saj bashkohej me të inxhinier Palit e të qindra të tjerëve. E kishte kapur këtë të vërtetë dhe ndiente një ngazëllim. Ajo vështroi si e mahnitur nga Andrea. Pas kësaj, sa herë që Andrea do të pyeste: «Po ti, si ia ke kaluar?», ajo s'do t'i përgjigjej më me shfajësim: «Bëj analiza». Përgjigjet e saj këtej e tutje do të ishin ndryshe. Ajo kryente një detyrë, ndër qindra mijëra detyra, që përbëjnë gjithçka tonën.

— Kishte punë të mëdha Linda jonë mbrëmë, — tha duke qeshur babai.

Sytë jeshilë vështronin vetëm Andrenë. Ajo filloi t'i fliste për atë çast, kur inxhinier Pali kishte thënë: «S'u lodhëm kot». Filloi t'i tregonte se si i kishin shtrënguar duart njëri-tjetrit, ajo kishte menduar se sa do të gëzohej Andrea kur të mësonte këtë ngjarje të rëndësishme në jetën e saj. Apo s'kishte ndodhur asgjë e rëndësishme, kurse

ajo vetë i zmadhonte. Sytë e saj të turbulluar u ndalën të Andrea. Ajo s'desh të këputej nga ai fill që e kishte çuar në atë ngazëllim e që i kishte zbuluar një të vërtetë: Edhe ajo bashkë me ta. Ajo tashmë e kishte të qartë se ai çast s'mund të vinte pa mikroskop, pa vlimin në epruvetë, pa djersën e të gjithëve. Për këtë ajo po i fliste Andresë. Ai dëgjonte i përqëndruar i tëri në atë rrëfim plot ndjenjë dhe i vinte mirë për atë flakë të befasishme që ishte ndezur në sytë jeshilë.

Babai i ra krahëve Lindës e i qeshur doli nga kuzhina. Kur dolën në rrugë, Andrea e zuri për krahu Lindën e fare ngadalë shqiptoi: «Vërtet dita është tepër e bukur sot, po ti je më e mirë se dita».

A ia kishte thënë vallë gjithçka kishte menduar, ndër- sa i afrohej qytetit mbi motoçikletën blu?! Kaloj një copë rrugë në heshtje, pastaj tregoi se si në darkë, në çastin e parë kur babai i kishte thënë se Linda do të kthehej të nesërmen, atë e kishte pushtuar një valë e fortë inati. Dhe kishte menduar se Linda shumë mirë mund të kishte kërkuar ta zëvendësonin. Aq më tepër që kishin vendosur të shkonin në shfaqje. Por kjo valë zemërimi i kishte kaluar shpejt.

— Shiko, dhe Linda jonë ka punë të rëndësishme, — i kish thënë në një mënyrë të veçantë babai, si me të qeshur, por në gjithë atë thënie ndiheshin dhe nota krenarie.

Linda dëgjonte dhe e vështronte me bisht të syrit. Ai e pikasi atë vështrim të mprehtë.

— E mbyta, Linda, atë grimcë zemërimi. Dhe unë sot jam i gëzuar si ti, jam shumë i gëzuar.

1975



NËNË SABRIJA

Gjermanët e ballistët kishin dymbëdhjetë ditë që e kishin pushtuar Zharanin dhe po bënë si mundnin. Të dymbëdhjetën ditë, shumica e gjermanëve dhe e ballistëve u larguan nga Zharani që herët në mëngjes, duke hapur fjalë se gjoja kishin zbuluar një depo të madhe të partizanëve e do të venin të ngrinin mallin. Por, në të vërtetë, puna ishte ndryshe: armiqtë kishin diktuar forcat partizane që po vinin drejt Zharanit, e dolën t'u prisnin rrugën. Në Zharan mbeti vetëm një nga komandantët ballistë, Hyskë Gjini, bashkë me njëzet vetë të tjerë.

Ditën e dymbëdhjetë, pasdreke, nënë Sabrija dhe nënë Shefikoja po rrinin njëra në një kënd, tjetra në këndin tjetër të ashefit përdhes dhe po mendoheshin. Nënë Shefikoja kishte zënë mashën me të dyja duart, kishte mbështetur ballin mbi të dhe rrinte përmbys, pa e ngritur kokën asnjëherë. Nënë Sabrija, me kokën mbështetur pas oxhakut e me sytë mbërthyer nga dritarja e vogël, vështronte malet përkundrejt. Dy rrudha të thella në ballë dhe vetullat e vrenjtura tregonin se në shpirtin e saj vlonte një urrejtje dhe një zemërim që nuk mundte ta përmbante dot.

Hyskë Gjini kishte kontrolluar përsëri edhe atë mëngjes që me natë në shtëpinë e nënë Sabrijes duke thirrur e bërtitur:

— Kush u shpie bukë partizanëve? Ku janë fshehur partizanët, se ju thera të gjalla, do t'ju përvëloj si miun brenda... Tregoni!...

Ai nuk kishte lënë vrimë pa u futur e nuk kishte lënë

gjë në këmbë. I kishte rënë erë se në pyllin përtej Zharanit kishte ca partizanë të fshehur dhe se buka u vente nga zharanakët, po, se kush ua çonte, nuk e dinte. Dyshimin e tij më të madh e kishte te shtëpia e nënë Sabrijes. Në pyll, ose në shtëpinë e nënë Sabrijes, kishte thënë spiuni, gjendej i fshehur edhe Koci Papa, komisar i Komandës së vendit, të cilin Hyska, edhe pjekur ta shihte, nuk ngopej. «Komisarët janë komunistë, — thoshte ai, — dhe ata e kanë ngritur popullin. Pa zhdukur ata, nuk shkulet fara e komunizmit. . . »

Nga kontrolli i Hyskë Gjinit me shokë, ashefi i nënë Sabrijes qe bërë rrëmujë. Ngado që të hidhje sytë, shikoje qypa me turshi të thyer, kade e talëra të përmbysura, enë të flakura: ku ishte tigani nuk ishte tepsia, dhe magjes i kishin thyer këmbëzat e qe shtrembëruar.

Të dyja kunatave nuk u bënë duart as për të rregulluar, as për të fshirë e as për të spërndritur. Ç'të rregullonin! Gjermanët e ballistët do të vinin përsëri, do të kërkohin, do të kontrollonin, do të thyenin dhe do të rrëmbenin ç'u kishte mbetur ndonjë gjë e vyer, se të shumtat e plaçkave, qilima, jorganë, gjyma bakri. . . ua kishin plaçkitur që ditët e para.

Verija, një vajzë e vogël nja shtatë-a-tetëvjeçe, e zbetë në fytyrë e me sy të mufatur, kishte vënë kokën në gju të nënë Sabrijes dhe dukej sikur flinte. Një bukë misri, që nënë Sabrija e kishte shtënë gjysmë ore më parë, po piquej në vatër nën saçin, dhe jamakja me fasule po ziente në zjarr.

Më në fund, nënë Shefikoja e theu heshtjen e para. Ajo ngriti kokën dhe, duke shtrënguar gjithnjë mashën ndër duar, sikur të mbahej në të nga një lodhje e madhe që ndiente, i tha së kunatës:

— Të zezat ne, Sabrije, o motër, na u mbyll dera, mbetëm kërcure pa një mashkull në shtëpi! — Pastaj vështroi të bijën, Verijen, dhe vazhdoi: — Mbetëm me një copë çupë në shtëpi ne, të zezat!

Verija i hapi sytë dhe, me buzët vesh më vesh, zuri të qante përsëri e llahtaritur.

— Mjaft, de, mjaft me këtë kob që po i ndjell shtëpisë! Mjaft të thonë, se zvetëtove edhe këtë foshnje! — i foli nënë Sabrija. — Nuk të vjen keq për të?! — Pastaj vazhdoi: — Mos ki merak, se si petrita i kemi djemtë; ja, atje janë, — dhe ia bëri me dorë nga malet përkarshi dritares, nga ndihej gjëmimi i luftës. — Atje janë. Edhe në qoftë vrarë ndonjëri, vdekja për burrat është, të gjithë nuk do të shuhen. Me nder po vriten e jo me turp. Pa, edhe në qofshin shuar ata, ne pse jemi? Një plumb do të dimë ta zbrazim, sa t'u marrim hakun. Po unë nuk ua kam merakun atyre që janë të shëndoshë, sa ua kam merakun këtyre që kemi këtu, — dhe tregoi me dorë pyllin përkarshi Zharanit. — Se këta janë të plagosur, të sëmurë e nuk luajnë dot as këtu e aty. Ia kam merakun atij të ziu Koci, që i ka mushkëritë byk, që ka dymbëdhjetë ditë në dëborë; është me një vatër fëmijë, korbi! . . .

Duke folur kështu, nënë Sabrija ngriti saçin, pa bukën në qe pjekur apo jo dhe i hodhi edhe një herë prush nën të e mbi të, duke mallëkuar me vete:

— E shkretë, piqu edhe ti, mos u pjeksh kurrë, se ja, u ngrys, dhe ata të zinj kanë tridhjetë e gjashtë orë pa futur erën e gjësë në gojë!

Atë bukë nënë Sabrija e kishte hedhur për t'ia shpurë Koci Papës, që ndodhej i fshehur në pyll vetë i shtatë, që të gjithë të plagosur e të sëmurë e që ishin shkëputur nga shokët e spitalit partizan të qarkut në një përpjekje që patën një natë me gjermanët e me ballistët. Në tërë atë të keqe, në tërë atë frikë e sori, nënë Sabrija, nëpër këmbët e gjermanëve e të ballistëve, u pati shpurë tri a katër herë bukë gjatë atyre ditëve, duke vajtur natën e me qefin nën sqetull. «Sot, — mendonte ajo, — nuk do ta kem aq zor, sepse gjermanët e ballistët janë tërhequr që në mëngjes. Në fshat ka mbetur vetëm Hyskë Gjini me nja njëzet ballistë nga ata larot që ai i mban pranë». Prandaj ajo po nxitonte që të piquej buka e t'ua çonte herët, sapo të zinte të errej.

Nënë Shefikoja, tek e vuri re të kunatën që nxitohej

ta piqte bukën sa më shpejt, i tha edhe atë mbremje si gjithmonë:

— Do të na marrësh në qafë, Sabrije, o motër. Tërë ditën Hyska sot ka ndenjtur me dylbi në dorë gërmadhave dhe ka ruajtur. Edhe tani kushedi se ku do të jetë futur mëndonjë ferrë e rri e përgjon.

— Si me shaka, si me të vërtetë, nënë Sabrija iu përgjigj:

— Rri ti rehat. A po të kërkon njeri gjë ty? Jo. Rri ti, se unë as të kam thënë as të them ty për t'ua shpënë, jam gjallë vetë unë, dhe sytë i kam në ballë. — E, duke i shërbyer bukës që të piquej sa më parë, vazhdoi të fjalosej me vetë, por që ta dëgjonte edhe nënë Shefikoja: — Nuk kam parë unë sa frikë ka ky rob! (e kishte fjalën për nënë Shefikon). Kur nuk vdiq kjo këtë radhë nga frika, ta dini që nuk ka për të vdekur kurrë.

Shefikoja, që e dëgjoi, iu përgjigj:

— Eeeee, ashtu thua ti, po të vrasin ata, nuk ta bëjnë të gjatë. Dhe si të vrasin se, ti e ke parë, ta nxjerrin shpirtin me thika. Nuk janë njerëz ata!

Dymbëdhjetë ditë e dymbëdhjetë net nënë Shefikoja nuk qe shtruar një herë në sofër.

— Ha, moj, ha, — i thoshte nënë Sabrija, — nga inati ha, dhe mos e bëj qejfin qeder; ç'të dinë, le të bëjnë, se nga frika vetëm një në Durrës ka vdekur. Të gjithë popullin nuk do ta shuajnë dot, sikur qiellin të zënë me dorë.

Një ditë, gjatë atyre dymbëdhjetë ditëve, kur binte një dëborë e madhe me flokë, si atë dimër e jo më, dhe bënte një të ftohtë i madh, një ballist i veshur me brekushe, si dukej, që këtej nga Sulova, kishte vajtur të ngrohte duart pas zjarrit në ashef të nënë Sabrijes. Duke u ngrohur me rrëmbim në bisht, se mos e pikasin dhe e qortonin, se ishte rojë, e kishte kërcënuar edhe ai nënë Sabrijen.

— Ku i keni burrat ju?!

Nënë Sabrija, që i kishte ardhur shpirti në majë të hundës nga të zezat që u kishin punuar e nga merakun që kishte për meshkujt e shtëpisë, i ishte përgjigjur pa e shikuar në sy:

— Ja, atje janë! — Dhe ia kishte bërë me dorë duke i

treguar malet. — Ç'na pyet ne ti! Ju e dini më mirë nga ne se ku janë, se me ju po luftojnë ata!

Ballisti kishte tundur kokën, sikur të donte të thoshte:

«Kam parë e s'kam parë, por të tillë grua nuk më kanë zënë sytë».

Ndërsa nënë Shefikoja i lutej me zë të ulët:

— Mos, moj Sabrije, o motër, mos, se kushedi ç'të zeza të tjera do të na punojnë!

Por ajo i shkruhej:

— Rri ti, se e di unë si më nginjet barku me këta katala. Po dale, dale sa të mbushet ena mirë.

Duke folur kështu, zbehej nga zemërimi. Fytyra e saj dukej e egërsuar dhe, e mbyllur ashtu në atë qilar me rojë te dera, ajo ngjante si luan në kafaz. I shoqi i qe vërrarë gjashtë muaj më parë në një përpjekje me ballistët. Djalë e vetëm e kishte partizan. I kunati, Mazllëm Gjatollari, i shoqi i Shefikos; më gjithë dy djemtë, edhe ata ishin partizanë. Katër meshkuj kishte shtëpia, po të katër kishin një muaj e ca që nuk i dinin se ku ishin, asnjë lajm nuk kishin prej tyre. Operacioni i Dimrit kushedi se nga i kishte zënë.

Ballistët ditë për ditë mblidheshin te lëmi, përpara ashefit, nga njëzet e tridhjetë vetë dhe fjaloseshin me zë, të lartë, me qëllim që t'i dëgjonin të dyja gratë:

«Partizanët u shuan të gjithë, nuk ka mbetur këmbë prej tyre. Filan komandant partizan e zunë të gjallë dhe e varën në mes të Tiranës, përpara bashkisë. Filan komandant brigade e ndau gjylja e topit gjerman më dysh...»

Ndonjë tjetër hidhej e thoshte:

«Sot u gjetën shtatë partizanë lart në mal. Kishin vdekur».

«Ehe, me të vërtetë i pashë edhe unë, — hidhej shoku i tij, — dy prej tyre kishin pasur guna të dhirta. Nga dy gjerdanë fishekë kishin pasur secili...»

Nënë Sabrija dëgjonte dhe nuk e bënte veten, por përbrenda shpirti i saj e dinte sa vuante. Po sikur të ishin të vërteta ato që thoshin ballistët? Atëherë, edhe i jepte të

drejtë Shefikos. Nënë Shefikoja, përkundrazi, kur dëgjon-te ato fjalë, rrihej e përpiquej më keq:

— E zeza, djemtë tanë kanë guna, ata kanë maliherë të gjatë dhe nga dy gjerdanë fishekë!

Zharani ishte mes vendi në atë krahinë, prandaj edhe gjermanët e ballistët e kishin bërë qendër të tyre. Ditë e natë atje kishte lëvizje të madhe, një palë vinin, një palë iknin. Shkarkonin karvanët me fishekë, ngarkonin mallin e plaçkitur në popull. Natën — asnjë herë ditën — sillnin të plagosurit e tyre, çirreshin e ulërinin si çakej. Nganjëherë zinin ndonjë partizan të sëmure ose të plagosur dhe e pushkatonin në mes të fshatit, duke u mburrur sikur kishin bërë ndonjë trimëri të madhe.

Këto mizori të gjermanëve e të reaksionarëve kishin ngjallur te nënë Sabrija një urrejtje të atillë për armiqtë, sa që i rëndeshin sytë e nuk i shikonte dot. Nga Koci e nga shokët e tij nuk i hiqej mendja për asnjë çast dhe mendonte: «Mos o zot, po sikur t'i gjejnë? Po sikur t'i zënë të gjallë e t'i pushkatojnë?» I ngjetej mishtë, zinte sytë me dorë, si për të larguar këto mendime të kobshme dhe thoshte me vete: «O zot, merrna hakun!»

Buka donte edhe pak të piquej. Nënë Sabrija u ngrit, gjeti një copë rrobë të zezë, mbështolli veshët me të, si në vend të sharpit e po mendohej çfarë të merrte si gjellë për partizanët. Po ata të mallëkuar gjermanë e ballistë nuk i patën lënë gjë në shtëpi, as gjizë, as djathë, gjë prej gjëje, se edhe ato që nuk i hëngrën, i derdhën kantonjve e rrugëve.

Dielli që ulur fare dhe që gati në të perënduar. Horizonti skuqte. Një copë diell, në formë katrori, binte në mes të ashefit, duke kaluar nga baxhaja, që ishte nën faqen e çatisë, nga perëndimi. Në këtë kohë hyri në derë Koci, me maliher në dorë, i gjatë, i thatë, me sy të zhgabërryer e qëndroi në mes të ashefit. Fytyra e tij e myrrëtyer, kur i ra dielli që vinte nga baxhaja, iu duk shumë e lahtarshme nënë Sabrijes.

— Koci! — thirri ajo dhe ngriu në këmbë, sepse dyshoi për një çast nëse ishte Koci me të vërtetë ai, apo di-

kush tjetër, mbasi edhe zëri iu duk sikur i ishte ndërruar. Po pastaj e njohu, u lëshua drejt tij, i hodhi duart dhe e puthi. Pa ia hequr duart nga qafa, e pyeste duke u dridhur e tëra nga malli e nga gëzimi:

— A jeni mirë? A jeni gjallë të gjithë?

— Të gjithë jemi, të gjithë. Gjallë jemi.

Nënë Shefikoja ngriu në këndin e vet, u shastis dhe më s'dinte ç'të bënte. Më në fund, kur u ulën rreth vatrës, ajo pyeti:

— Po djemtë tanë, o Koci, ku do të jenë? A do të jenë gjallë? Të më thuash të drejtën, për kokën e fëmijëve!

— Kur të qaj djemtë, gjallë janë, — iu betua Koci, tek e pa aq të trishtuar. — Sot, — vazhdoi Koci, — morëm një letër nga Mazllëmi. Na lajmëron që nesër pa gdhirë t'u bëmë prapa krahëve ballistëve. Do t'i fusim në këto gryka, mes dy zjarreve, dhe do t'i bëjmë të ngrënë duart përpjetë. Nesër në mëngjes do të shikosh se ç'do të bëhet në këtë pellgun tonë këtu. Ne, të komandës së vendit, jemi mbledhur të gjithë në mal, te kasollet e barinjve. Kemi lajmëruar edhe të gjithë fshatrat e këshillat. Me t'u dhënë shenja në Qafën e Pelës, lufta do të ndizet në të katër anët, A e dëgjoni luftën? A e kuptoni dot sa janë afruar tanët? Vetëm shenjën tonë presin fshatrat përçark.

Si u dha lajmet mbi gjendjen e luftës, Koci pyeti të dyja gratë:

— A ka më ballistë në Zharan, se na erdhi lajmi që nuk ka mbetur njeri prej tyre, dhe unë erdha të kontrolloj e të marr ca bukë.

Ato i treguan për Hyskë Gjinin dhe të njëzet «trimat» e tij, që ishin në shtëpinë e Hekuran Çepelës, në krye të fshatit.

Koci kishte ardhur deri këtu me mendje të fjetur se nuk kishte më ballistë në Zharan, po tani mori shpejt e shpejt një gjysmë buke dhe u ngrit e iku.

Nënë Sabrija me nënë Shefikon, duke i dhënë bukën, e porositën një mijë herë të hapte sytë se mos përpiqte me Hyskën, se më s'dihej, mund të ishte aty përçark. Pastaj e nxorën nga dera e prasme e qilarit, e përcollën pra-

pa kasolleve, e hoqën nëpër një ledh, gjer në fund të selishtës dhe e porositën edhe një herë:

— Koci, hap sytë, vëlla!

Koci mori buzën e përroit. Do të hidhej përtej e pastaj do të ngjitej sipër në mal, mbi fshat, te shokët.

Nuk kishin shkuar as pesë minuta që kur qenë kthyer nënë Sabrija me nënë Shefikon në ashef, kur dëgjuan të çirrura:

— Ndal! Ndal!

Dhe, pa sosur mirë këto fjalë, u dëgjuan dy krişma maliherësh që ranë këmbyerazi.

— Korba, mos vranë Kocin! — thirri nënë Sabrija dhe fluturoi në gjurmët e tij. E gjithë bota iu duk sterrë dhe nuk pa përpara as ledhe, as gërmadha, as ferra, as gjemba.

Nënë Shefikoja dërgoi Verijen të shikonte nëpër fshat se ku ishin ballistët.

Kur vajti nënë Sabrija, Kocin e gjeti akoma me gojë:

— Më vrau Hyskë Gjini, o motër Sabrije, — i tha. — Amanet fëmijët! — dhe mbaroi në kraharorin e saj.

Me atë llahtar dhe me atë zemërim, nënë Sabrija u kthye në shtëpi. Sapo arriti, erdhi në shtëpi edhe Verija, e tmerruar, me sy të zgurdulluar e duke bërtitur:

— Moke moj! Moke moj! (kështu i thërriste nënë Sabrijes). Hyskë Gjini, me një gjysmë buke në dorë, po hyn-te shtëpi më shtëpi, në lagjen tonë.

Komandanti ballist, sapo e pa që ra Koci i vrarë, shkoi dhe e kontrolloi. I mori gjysmën e bukës dhe, si i marrosur, më shumë edhe nga thyerja e ballistëve, që sa vinte po afroheshin, shkoi që të krahasonte bukën për të gjetur se në cilën shtëpi ia kishin dhënë, dhe do t'i vinte zjarrin asaj shtëpie duke e djegur me gjithë njerëz brenda. Kështu vendosi. Vajti në një shtëpi të lagjes së Gjatollarëve, nuk gjeti të atillë miell e të atillë bukë. Vajti në një tjetër, i krahasoi, prapë nuk e gjeti, edhe në të tretën po ashtu. Nga inati bërtiste e çirrej:

— Jo, jo, nuk ia kemi ngjitur kot emrin Qendra e Vogël e komunizmit Zharanit. Si? Si?! Ne të jemi këtu e ju nëpër këmbët tona t'u jepni bukë komunistëve! Ah, veç në e gjeça atë shtëpi që u ka dhënë bukë!



Shpejt e shpejt iu kujtua Hyskës shtëpia e Mazllëmit. «Atje do t'ua kenë dhënë këtë bukë, ato shtrigat kanë bluar në mokra këto ditë, se nuk i linin të dilnin. Duket kjo bukë, është gatuar me miell të ashpër». Kështu mendoi dhe u nis i etur për gjak. Aq iu prish mendja nga urrejtja, sa që harroi se «trimat» nuk i kishte me vete:

Nënë Sabrija, me të dëgjuar Verijen që tha se ç'po bënte Hyskë Gjini në lagjen e tyre, e kuptoi për se bridhte ai shtëpi më shtëpi. Prandaj u prish në fytyrë, po në sytë e saj dukej që kishte vendosur të bënte diçka.

— Merr çupën dhe ik, — i tha shkurt nënë Shefikos.

— Ku të vete?! — iu përgjigj e kunata. — Ku të të lëmë ty?

— Merr çupën dhe ik, të them! — iu kërcënua nënë Sabrija përsëri.

Mollëzat e faqeve po i dridheshin vetëvetiu papushim.

— Po do të na gjejë bukën.

— Ik, — i tha më në fund dhe e shtyu për krahu.

Nënë Sabrija, si mbeti vetëm në ashef, u kërrus, diçka mori në fund të qilarit, pasi ngriti një pllakë të gurtë, hodhi kraheve një triko të gjatë, të bërë me shtiza dhe u ul në kënd. Duke i vënë shpatullat murit, si e kapitur, mbështeti kokën pas oxhakut dhe po vështronte nga dera. Të gjitha shkresat që i dha Koci, kur dha shpirt, i kishte futur në gji.

Hyskë Gjini hyri me gjysmën e bukës në dorë, të lyer me gjakun e Kocit. Nuk shikoi tej as këtej, por shkoi drejt e në magje. Sapo krahasoi bukën, iu kthye nënë Sabrijes dhe ulëriti duke u dridhur i tëri:

— E kujt është kjo buuuukë?!

Ajo u ngrit në këmbë, ashtu e gjatë siç ishte, me duart prapa, mbuluar me trikon, me sytë të ftohtë si xham, dhe hodhi dy-tri hapa, u afrua para tij e i tha:

— Imja është.

— Bushtë, ndaj të thonë partizanët: «Nënë Sabrija» ty, ndaj të thonë! — dhe u bë gati t'i hidhte thonjtë ta mbyste:

— Po, ndaj më thonë, — iu përgjigj ajo e qetë e plot

urrejtje. — Ndaj më thonë, se nënë më kanë, dhe mos më thëncin nëna e tyre, po nuk ua mora hakun. Dhe «fap» ia bëri nagantit të të shoqit, që e kishte ruajtur si kujtim të tij pas vrasjes. «Tak», «tak», «tak», ia shkrepë tri herë në gjoks.

Hyska ngriu për disa sekonda në këmbë, iu prish mendja, ca ngaqë nuk e priste atë që bëri nënë Sabrija, ca nga ajo që e gjeti, por pastaj e mblodhi dhe e ndoqi me revole në dorë.

Nënë Sabrija mban mend nga ajo skenë vetëm gjakun që i rridhte atij në gjoks, mbi xhaketën e re ushtarake, dhe veten e saj me nagantin që e shtrëngonte në dorë e që mallëkonte vazhdimisht pushtuesit hitlerianë:

— Mallëkuar qofshi, se morët botën më qafë!

Kur doli në lëmë, Shefikoja iu dha përpara me sy të shqyer.

— Ç'bëre? — e pyeti.

— E vrava! — iu përgjigj ajo prerë.

Morën çupën për dore dhe u nisën.

Hyskë Gjini nuk mundi të hidhte veçse dy-tre hapa tej pragut të derës së ashefit dhe u këput e ra përmbys sa gjatë-gjerë.

— Hidh një shami përdhe, që mos të të zërë gjaku! — i tha Shefikoja, sipas zakonit, tek ishin duke bredhur për të vajtur te shokët e Kocit.

— Jo, jo, nuk më zë gjaku i tradhtarëve mua, — iu përgjigj nënë Sabrija, së cilës i rrinte përpara fytyra e Kocit të vrarë, që i bëhej sikur i thoshte gjithnjë: «Amanet...»

1948

## NJË LEGJENDË E KOHËS SONE

Natën e parë ajo na u duk mjaft e druajtur, ndonëse në të shtëpisë përpiqeshim të tregoheshim të përzemërt dhe të lirë. Pothuajse nuk e hapi gojën fare, rrinte ulur buzë minderit, me shikim të shpërndarë dhe ngatërronte gishtat në gërshetin e gjatë. Ndoshta dhe emrin e saj, Diella, nuk do ta kishim mësuar aq shpejt, po qe se nuk do të kishte hyrë në bisedë vajza jonë pesëvjeçare, Edita. Kjo e lehtësoi mysafiren e re dhe me fjalë të kursyera na kallëzoi se mësonte në qytetin tonë në një kurs për mami, ardhur nga një fshat i thellë i malësisë. Më pas, me gjysmë zëri na pyeti dhe ajo, siç është zakoni, për emrin dhe punën që kryenim, po biseda mbeti me aq dhe në, si hëngrëm darkë, ramë të flinim shpejt.

Të nesërmen nuk u pamë gjithë ditën. Vetëm në darkë u mblodhëm prapë në kuzhinë. Ajo prapë kishte ndenjtur buzë minderit, gishtat i ngatërronte nëpër gërshetin e gjatë, po shikimin kësaj here e kishte të përmbledhur dhe dukej më pak e druajtur. Vajza jonë rrinte gjithë kohën pranë saj dhe jepte e merrte me të sikur të ishte njohur qyshkur. Unë e gruaja i vështronim tek luanin dhe herë pas here qeshnim tok me to. Fytyra e mysafires shkëlqente nga një gaz i përmbajtur. Ajo kishte një fytyrë çuditërisht të pastër e të bardhë, thuajse nuk e zinin fare rrezet e diellit. Nga trupi vinte e gjatë dhe e brishtë, si pishë e re. Flokët e zinj e të drejtë i lëshoheshin në të dyja anët dhe nga larg ngjanin të ashpër, po vetullat e holla i bënin një vijë të hijshme e delikate sipër syve të larmë.

Rrobat i vinin pak të lira në trup dhe kjo sikur ndikonte në qëndrimin e saj. Në fillim ne nuk e kuptuam arsyen, po më vonë morëm vesh se Diella, gjer pa ardhur në kurs, mbante veshjen e rëndë malësore. Ishte hera e parë që vishesh si qytetare. Kështu mund të shpjegohej deri në një farë mase dhe shqetësimi që manifestonte ajo herë pas here, pasiguria dhe drojtja që rrethonte qenien e saj. Dhe neve të shtëpisë, tek e shihnim mysafiren ashtu, nuk na vinte mirë dhe donim si e, si ta shpërndanim atë mjegull që ishte nderë në mes nesh dhe të afroheshim. Për këtë, deri diku na ndihmoi prapë vajza, e cila ia nxori, si të thuash, Diellës turpin me zor, herë duke i kënduar e recituar, herë duke i treguar lojërat e saj apo duke i thënë «sekretet» e shtëpisë. Nga kjo Diella tani e ndiente veten më mirë dhe filloi dhe ajo të kallëzonte për fshatin e saj të largët, për malet dhe pyjet, për kafshët e shpendët që jetonin atyre anëve. Edita sa nuk fluturonte nga gëzimi dhe, po të mos e çonim ne me zor për të fjetur, mund të rrinte gjithë natën me mysafiren. Kur binte ajo në gjumë, ne mbeteshim vetëm dhe atëherë na duhej të bisedonim vetë. Më shumë, natyrisht, fliste gruaja. Me të ajo bisedonte më lirshëm. Pastaj, ime shoqe e ndiente për detyrë ta ndihmonte Diellën për gjëra që ajo s'i dinte. Bile ky ishte dhe qëllimi që organizata e gruas i kishte shpërndarë vajzat e kursit nëpër lagjen tonë.

Ime shoqe çdo natë pregatiste gjellën për të nesërmen dhe me këtë rast i shpjegonte mënyrën e gatimit, ose i tregonte për rregullimin e shtëpisë, po më gjatë ato u morën me të qepura. Diella e mësoi shpejt zanatin e të preurit e të qepurit. Gruaja i bleu dhe një basmë të bukur dhe i preu një fustan të ri. Diella u prek aq shumë nga kjo gjë, sa që nuk dinte si ta tregonte mirënjohjen e saj. Bëri ç'bëri dhe natën e fundit, para se të largohej prej nesh, i sollu Editës një kukull dhe ca ëmbëlsira. Dhe pikërisht natën e fundit ne hapëm një bisedë, që nuk e kishim hapur ndonjëherë. Dinim vetëm që Diella ishte e pamartuar dhe, meqenëse nga natyra vinte e turpshme, nuk shtyheshim më gjatë. Po, për çudinë tonë të madhe, këtë muhabet ajo e hapte vetë dhe shkak u bë emisioni i muzikës së kërkuar. Rri-

nim atë natë si zakonisht në kuzhinë, bisedonim e dëgjo-  
nim muzikë, kur papritur Diella u çua me vrull nga min-  
deri dhe ngriti zërin e radios. Kuzhina u mbush me tin-  
gujt e gëzuar të një këngë të re popullore. Bisëda që ki-  
shim nisur u pre menjëherë në mes. Vajza mbeti në këmbë  
dhe padashur lëshoi një thirrje të lehtë që nuk di si ta ci-  
lësoj. Ishte kjo një thirrje krejt e vetvetishme, që nuk e  
kishim dëgjuar ndonjëherë. Ajo në mënyrë të pavetëdij-  
shme po na zbulonte një anë të panjohur. Muzika po bën-  
te atë që ne s'do ta kishim bërë dot. Gjithë kohën sa vazh-  
doi kënga, neve na dukej sikur ajo nuk merrte frymë. Sytë  
e kishin ndërruar ngjyrë dhe shkëlqenin nga një dritë  
e hareshme. Unë e ime shoqe bënim sikur dëgjonim kën-  
gën, po në të vërtetë vështronim Diellën e hutuar nga  
muzika. Ajo kishte harruar se ku ndodhej, na kishte har-  
ruar ne, me siguri kishte harruar çdo gjë. Gjithë jeta atë  
çast për malësoren e re ishte përmbledhur në atë këngë të  
thjeshtë, kuptimplote. Ajo bënte fjalë për një vajzë që nuk  
mori burrin që i kishin zgjedhur prindërit, po atë që ki-  
shte dashur vetë.

Ndërkaq, ne s'i hiqnim sytë nga Diella dhe erdhi një  
çast që dhe ne kënga na preku aq shumë, sa është vështi-  
rë të thuash se ç'bënim atë kohë; vështronim fytyrën e  
vajzës, apo dëgjonim këngën. Dhe nuk e teproj po të them  
se ato qenë shkrirë në një të vetme, sepse si pamja e saj  
ashtu dhe tingujt shprehnin të njëjtën gjë: gëzim, brengë  
e shpresë bashkë.

Kur kënga mbaroi, dhe kjo na u duk se erdhi krejt pa-  
pritur, Diellës prapë i shpëtoi një thirrje e lehtë që për-  
sëri nuk di si ta cilësoj. Ajo u kthye nga ne me një pamje  
të hutuar e plot turp, aq sa harroi të ulej. Ne i buzëqesh-  
ëm, po prapë nuk ndiheshim të lirë si më parë.

Ime shoqe tha:

— Ulu, Diella, mos rri në këmbë.

Ajo u ul e bindur si fëmijë, ndërsa unë shtova:

— Këngë e bukur!

— Shumë e bukur! — ia priti vajza menjëherë, sikur  
ta priste fjalën time.

Papritur ra heshtja dhe të gjithëve na mbërtheu një

ngathtësi e çuditshme. Vështirë ta them se nga erdhi kjo. Ndoshta që efekti i këngës, ndoshta për shkak të mirësjelljes sonë që prisnim vajzën të merrte veten.

Dhe vërtet, Diella dalngadalë sikur erdhi e u qetësua. Ngriti kokën, vështroi nga ime shoqe dhe buzëqeshi. Sytë i morën pamjen e parë. Ajo shikonte tani pa ndonjë gajle, sado që ne tërthorazi e ndienim brengën që e shqetësonte përbrenda.

Për herë të parë prita në heshtje të fliste Diella vetë. Ajo diçka donte të thoshte dhe kisha bindjen se do ta thoshte domosdo.

Nuk kaloi shumë dhe ajo, me një zë të pasigurtë, tha:

— Thonë se janë të vërteta këto...

— Si?... — pyeti ime shoqe, që ishte tërhequr shumë pas Diellës.

— Ja, këto që tregojnë këngët, — tha vajza.

— Ka shumë të ngjarë, — thashë unë. — Me këto mundësira që u janë krijuar vajzave sot, çdo gjë mund të ndodhë.

Diella mori zemër dhe, sikur deshi të kundërshtonte një mendim që nuk ekzistonte, tha:

— Jo, jo, është e vërtetë. Unë e kam dëgjuar vetë sa herë.

— Çfarë ke dëgjuar? — u bë kureshtarë gruaja ime dhe vajti e u ul pranë vajzës.

Atë kohë mbaroi muzika dhe unë mbylla radion. Diella nuk e priste, si duket, interesimin tonë, prandaj u step njëherë, po shpejt e ndjeu veten të çlirët, dhe tha:

«Kjo që do t'ju them, ka ndodhur me gjithë mend. Në fshatin tonë e kanë marrë vesh të gjitha vajzat. Nuk tallem, për besë. Thonë se kjo ka bërë vaki në një nga fshatrat e fushës. Në fillim nuk e besuam, sepse aq e bukur është, sa nuk të besohet, po, kur e tregoi dhe Qibrija (kjo është një vajzë nga qyteti, që ka ardhur vullnetare në fshatin tonë), atëherë thamë se është e vërtetë. Lum ato që e jetuan dhe e gëzuan këtë histori, se ç'nuk bëhet sot për të mirën e vajzave!...»

Diella mori frymë thellë dhe vështroi nga ne, me sytë që i vetëtinin. Ajo ishte me tërë mend e tronditur, po kjo

qe një tronditje gazmore, që shfaqej jo vetëm në sytë e shkëlqyer, në zërin e butë, në lëvizjet e hirshme, po në tërë qenien e saj.

«Si ta tregoj unë historinë e atyre të dyve. Andej nga anët tona, kur shohim një thëllëzë që fluturon, themi: «Sa bukur!» Po vetëm kaq themi, po hë, tregoj, po deshe! Kështu dhe puna e atyre të dyve. Ai ishte ushtar dhe kishte ardhur me lejë në shtëpi për t'u martuar. Ajo ishte në fshat, punonte në kooperativë. Thonë se i kishin fejuar sipas zakoneve të vjetra. Ishin nga një fshat, po s'kishin të drejtë të takoheshin e as të flisnin. U bënë kësosoj dy vjet dhe gjithë bota kujtonin se kjo krushqi ishte lidhur me tërë mend si sa e sa krushqi të tjera. Po puna e tyre nuk u thur si e gjithë të tjerëve. Ajo në të vërtetë u shtur dhe u bë shumë mirë, sepse secili thuri fatin e vet, ashtu siç ia donte zemra. Po dasma u bë, si i thonë fjalës, me krushq e me aheng. Gëzuan prindërit, gëzoi fshati, vetëm të zotët e punës nuk u gëzuan. Të them që ua di emrin atyre, nuk ua di. Po prapë, ne të rejat e fshatit u kemi vënë emër të ri, djalit Reshat e vajzës Merushe. Merushja thonë ishte e bukur shumë, e gjatë, me sy të mëdhenj sa një filxhan, disa duan të thonë se ishte dhe brigadiere në kooperativë. Reshati s'ishte i keq në të parë, po zemrën ama e kishte xhevahir. Kishte një shpirt, nuk di si të them, edhe vëllai s't'u gjendka si të gjendet ai!

Thashë se u bë dasmë e madhe e këtë s'e them unë nga vetja, po e kam me të dëgjuar. Reshati na ishte djalë i vetëm, po ca të tjerë duan të thonë se i vetëm nuk ishte, po ishte më i madhi i fëmijëve. Nejse... kjo s'do të thotë gjë, se fjalën e kisha gjetkë. Dasma zgjati nuk di se sa, pastaj erdhi vakti t'i mbyllnin ata në një konak. Nusen e futën përpara, dhëndri vajti më pas. Njerëzia jashtë konakut bënë qejf.

Kur hyri ai brenda në konak, nusja rrinte ulur në fund të krevatit. Sipas zakonisht, ajo duhej të ngrihej në këmbë, po ajo s'u ngrit. Atij kjo s'i pëlqeu hiç, po bëri sikur nuk e vuri re. Tha me vete: «Mbase e ka nga turpi», dhe ndenji në këmbë para saj. Rrinte, rrinte e priste, po ajo jo vetëm që nuk u ngrit, po as kokën nuk e çoi. Atëhe-

rë, duan të thonë se ai e kuptoi se ajo diç kishte një hall, pa rrinte ashtu. I thotë ai:

— Ç'ke, moj, që rri kështu?!

Ajo flet sa po flisni ju tani. Rri dhe ai një kohë e i flet, pret e pret po ajo e mban gojën kyçur. I thotë prapë ai:

— Ti, a ke gojë, ta marrim vesh? Thuaj një fjalë, se nuk u bë kiameti!

Po përsëri ajo nuk flet, veç kur, papritur, ia jep vajit. Qan e qan si fëmijë. Atëherë ai fillon t'i bjerë më të. Kish-te një hall të madh në këtë mes. Mendon e mendon, po gjë nuk nxjerr me kokë të tij. I vete afër dhe, pa e prekur me dorë, i thërret në emër:

— Merushe, — i thotë. Ajo çon kokën, po në sy nuk e shikon. Ndenji kështu pa folur nuk di se sa, pastaj fshiu lotët dhe, si e mori pak veten, thotë me pak zë:

— Më kanë marrë më qafë.

Kaq tha ajo, se e mbytën lotët.

— Si, si?! — çuditet ai. — Të kanë marrë më qafë?! Po kush të ka marrë më qafë?! Unë?!

— Jo, jo, — thotë ajo, — ti nuk ke faj. Fajin e kam vetë.

Ai atëherë e merr vesh se ku donte të dilte ajo e nuk priti më gjatë dhe i tha:

— Ma thuaj, si e ke hallin?

Ajo nuk duroi më, se mjaft kishte duruar, ndaj i hapet:

— Unë dua një tjetër. Tani ti bëj ç'të duash!

Atij, thonë, sikur i ra shtëpia mbi kokë kur dëgjoji këto fjalë.

— Po kush është ai tjetri, a mund të ma thuash?

— Ta them, po të më japësh fjalën se nuk do t'i bësh gjë.

— E ç'do t'i bëj? — thotë ai. — Unë jam ushtar!

— Ti ke pushkë, — i thotë ajo me zë të vogël.

Ai zemërohet nga këto fjalë dhe i thotë:

— Pushkën nuk e kam për ato budallallëqe që të shkon mendja ty, po për armiqtë. E more vesh? Po hajt, më thuaj, kush është ai që do?

Ajo, deshi s'deshi, ia tha:



— Është Hasani i Kamber. Calës në Zall-Drer.

Kështu duan të thonë se i thoshin atij. Reshati, sapo e dëgjoi, nuk pyeti më gjatë, po i tha vajzës të mbathte këpucët. Ajo nuk po e merrte vesh, atëherë ai ia thotë shqip:

— Ngrehu të shkujmë në shtëpinë e Hasanit.

As ajo nuk e mori vesh se si u bë gati, si u hodhën nga dritarja e konakut, si kapërcyen gardhin e morën rrugën për në Zall-Drer. Dasma s'kishte sosur, sazet binin akoma.

Fshati i Hasanit thonë nuk ishte afër. Do të kapërcejë gjer një mal, pa të arrije gjer atje. Disa thonë se ai ecte përpara e ajo i shkonte pas, po të tjerë tregojnë se ata nuk e kishin për gjë t'i jepnin dorën njëri-tjetrit kur u dilnin pengesa përpara. Thonë se atë natë hëna ishte e plotë. Merushja e shikonte hënën dhe i vinte t'i fliste. Zemra për-brenda i qe bërë lëmsh. Si do t'i vente filli kësaj pune që kishte nisur? Si do ta priste ai tjetri?

Kur vajtën në Zall-Drer, mezi e gjetën shtëpinë e Hasanit. Ajo e dinte, po i vinte turp t'ia thoshte. Ai s'e dinte, po s'e kishte kollaj ta pyeste. Ia kishte treguar bariu i kooperativës që po nxirrte bagëtinë. Nata atë kohë ishte në të thyer. Shtëpia e Hasanit kishte qenë fare afër dhe ata i binin rrotull si kali në lëmë.

Ai kishte vajtur te gardhi dhe i kishte thirrur të zotit të shtëpisë. Thirr e thirr, gjersa kishte dëgjuar dhe kishte dalë në dritare. Pastaj kishte zbritur me kandil në oborr. U kishte dhënë dorën, po, për t'i njohur, s'i kishte njohur. Merushja mezi rrinte në këmbë, dridhej si fletë plepi. Reshati, thonë, nuk e kishte bërë veten fare. As kur kishte dalë Hasani. Bile Hasani s'u kishte besuar syve, kur kishte parë Merushen në dritën e kandilit. Aq shumë e kishte humbur pusullën, sa nuk kishte folur asnjë fjalë për be.

— Hë, — thotë xha Kamberi, — ç'e mirë ju solli në këtë orë?

Ushtari, thonë, ishte treguar prapë burrë e s'kishte dashur fare t'ia dinte.

— Na fal, o xha Kamber, — thotë ai, — që ta prishëm gjumin, po gëzimi na pruri gjer këtu.

— Gëzim paçi, mor bir! — thotë plaku.

Ai ia kishte thënë bram menjëherë:

— Të kam sjellë nusen e Hasanit!

Plaku kishte luajtur nga vendi e sa s'i kishte rënë kandili nga dora.

— Po, po, nusen e Hasanit, — i thotë prapë ai dhe ia tregon pastaj historinë pikë për pikë.

Plaku e dëgjon dhe s'u beson veshëve dhe syve. Dëgjon dhe Hasanin aty pranë dhe i ngjan vetja si në ëndërr.

Merushja rri kokulur dhe ku nuk i vete mendja. Po sikur të mos dojë plaku? Po sikur të mos pranojë Hasani, se nusja vinte nga shtëpia e dhëndrit dhe jo nga shtëpia e vet?

Si e dëgjon deri në fund tërë historinë, xha Kamberi e pyet të birin:

— E vërtetë është kjo që thotë ky miku?

— E vërtetë, — thotë Hasani.

Xha Kamberi shikon vajzën në sy, shikon dhe mikun dhe, sado që nuk i pëlqen tërë ajo që i dëgjojnë veshët, thotë:

— Kur qenka kështu, nuk kemi ç'bëjmë. Se këto punë e kanë ndryshe. Po këtë punë që ke bërë ti, nuk e ka bërë njeri, mor bir. Unë për vete s'e bëja dot.

Reshati nuk flet, vetëm sa i qesh pak buza. Ata të dy aty pranë rrinë në mes të oborrit si pisha të ngrira.

Po historia nuk mbaroi me kaq. Plakut s'i hiqet nga mendja ajo që bëri ai ushtari dhe duan të thonë se, pas muhabetit në oborr, e kishte futur brenda, kishte zgjuar gjithë njerëzit e shtëpisë dhe, si që gdhirë mirë, kishte shtruar rakinë e kishin ardhur pastaj dhe fqinjët. Xha Kamberi kishte ngritur dollinë i pari:

— Dëgjo, more djalë, — dhe kishte përsëritur atë që i kishte thënë në oborr, — këtë që bëre ti, nuk e ka bërë njeri. Ne, pleqtë, nuk i honepsim kollaj këto, po rinia fiton sot dhe fitoftë gjithmonë.

Dhe, si e kishte përqafuar ushtarin, i kishte thënë një fjalë që ai s'e kishte pritur:

— Ti, mor djalë, më fute në një borxh të madh, që nuk di si të ta laj. Kam tri vajza, të tria për te burri. Ti shikoi dhe zgjidh një! Si thua?

Ushtari kishte qeshur. Kishin qeshur dhe Hasani me Merushen.

— Faleminderit, xha Kamber, po nuk ta plotësoj dot se u dogja një herë e kam frikë se mos më ngjasë prapë si me nusen e parë.

— Këtu s'fole drejt, o baba, — qe hedhur Hasani, dhe për herë të parë qe shikuar në sy me Reshatin.

Plaku nuk qe ndier më, po derisa kishte ndenjtur mi-ku, dorën s'ia kishte hequr nga krahët.

Thonë se, kur kishte marrë të ikte Reshati, Merushes, tek i kishte dhënë dorën, i kishin shpëtuar lotë nga sytë. Hasani e kishte përqaftuar si vëlla dhe e kishte përcjellë deri në të dalë të fshatit të tij.

Kështu është historia e atij ushtari. Dhe kjo është e vërtetë, po, se ku ka ndodhur tamam, nuk di t'ju them, as vajzat e kursit tonë, që e kanë dëgjuar të gjithë këtë histori, nuk e dinë vendin.

Sa herë them, ah, sikur të nxjerrin për këtë një këngë të bukur! Pse, a nuk e meriton një këngë si ajo që dëgjuam, ai ushtar?»

Ne atë natë fjetëm vonë, biseduam e diskutuam gjatë dhe nuk na u hoq nga mendja ngjarja që na tregoi Diella.

Të nesërmen, kur u gdhi, mysafirja na u duk edhe më e afërt, po kjo nuk zgjati shumë, sepse atë ditë ajo u largua për në fshatin e saj dhe që atëherë nuk jemi takuar më. Po megjithatë, mund të them se nuk e kemi harruar, as unë, as gruaja, as vajza. Dhe për këtë na ndihmon ai kujtimi i bukur që ajo na la natën e fundit. Na duket se në tregimin e saj janë përmbledhur shumë nga ato ëndrra e dëshira të zjarrta që zgjon te vajzat e reja jeta jonë.

Prej asaj nate kanë kaluar shumë kohë, e megjithatë mua e sime shoqeje, sa herë flitet për vajzat e fshatit, na vete mendja përnjëherë te Diella. Na pëlqen të mendojmë, dhe jo pa arsye, se edhe ajo do t'i ketë hyrë me guxim rru-gës së jetës, për ta ngritur lumturinë e saj, ashtu si njerëzit për të cilët na tregoi.

VAJZA E UZINËS

Lira u nda nga shoqet e punës dhe mori rrugicën e shtëpisë. Në ajër ndihej kundërmimi i vakët i pranverës. Ky kundërmim i lehtë nuk merrej vesh nga vinte; ai sikur buronte njëkohësisht nga toka, nga drurët dhe nga qielli, duke e mbështjellë gjithçka me një vello të hollë ngrohtësie e kapitjeje. Në kopshtet e rrugicës së Lirës vetëm bajamet kishin lulëzuar. Lulet e tyre dukeshin si të vëna me dorë mbi degët pa fletë, si yje të kuqe me zemër të bardhë në një sfond të errët. Kur lulëzojnë bajamet, gonxhet e pemëve të tjera janë akoma të përgjumura e të mbështjella me luspa të errëta, sepse ato i druhen të ftohtit e ngricës që mund të fillojë papritur.

Lira u mat të këpuste një degë të lulëzuar që varej në rrugë, ashtu siç bënte çdo vit, kur kthehej kësaj rruge me çantën e librave në dorë, po pastaj ndërroi mendje.

«Tani nuk jam nxënëse dhe s'më ka hije të mbaj lule», — tha me vete. Shtyu derën e shtëpisë dhe u fut në oborr. Mamanë e gjeti pranë pusit duke shpupluar me ujë të valuar një pulë me cirka të kuqe.

Nëna nuk e kishte zakon t'i therte pulat kot dhe Lira e mori me mend se në shtëpi kishte ardhur ndonjë mysafir, ose pritej të vinte. Ajo qëndroi përballë govatës dhe e përshëndeti mamanë me kokë.

— Ka ardhur yt vëlla, — tha ajo.

Fytyra e Lirës e pasqyroi menjëherë gëzimin e brendshëm. Po bëheshin disa muaj qëkurse nuk ishte takuar me Polon. Vëllai banonte në Tiranë, ishte futur në punë në

një ndërmarrje ekonomike, pasi kishte mbaruar shkollën e mesme dhe rrallë e tek vinte në shtëpi. Edhe kur vinte, nuk qëndronte më shumë se dy-tri ditë. Gjithmonë kishte diçka që e bënte të nxitohej, ndonjë punë urgjente, shërbim, një mbledhje në ministri, mbyllje bilanci, pregatitje raporti dhe punë të tjera të këtij lloji. Ardhja e tij e thyente rrjedhjen e qetë të jetës së familjes dhe ato ditë ishin si një festë e gjatë. Babai, që kishte dalë para kohe në pension për shkak të zemrës, vishej si për festë dhe ia kishte qejfi të bënte disa vizita nëpër miq, ose të shkonte së bashku me djalin në klub. Nëna vraponte nga kuzhina në pazar dhe anasjelltas, kurse Lira e mbyste me pyetje për filmat e rinj.

Në shtëpi kishin filluar të mendonin se Poloja po bëhej njeri me rëndësi, sado që s'ia kishin parë emrin në ndonjë gazetë.

— Ku është? — e pyeti Lira mamanë.

— Në dhomën e pritjes.

Lira u sul me rrëmbim drejt shkallëve, siç e kishte zakon duke i kapërcyer dy e nga dy.

— ... Është me një shok, — i tha e ëma prapa krahëve, si për ta lajmëruar.

Zëri e arriti Lirën kur ishte në krye të shkallëve dhe ajo qëndroi në vend me njëren këmbë pak të ngritur, sikur e ëma ta kishte qëlluar me shigjetë e shigjeta t'i kishte prerë frymën.

U kthye ngadalë dhe i zbriti shkallët një nga një me hap të rëndë. Fytyra e saj kishte marrë ngjyrën e errët të tutave.

— Nuk vete fare ta takoj, — tha e vendosur.

— Mos je e marrë? — e pyeti e ëma.

— Pse e solli në shtëpi?

Çdo njeri mund të sjellë në shtëpi një shok për vizitë, po, kur për këtë qëllim duhen bërë në mënyrë të posaçme dyqind kilometra rrugë e kur i ardhuri është beqar, atëherë as fqinjëve nuk u mbushet mendja se kjo vizitë bëhet thjesht për qëllime turistike. Aq më tepër Lira, që e dinte si qëndronte çështja.

E ëma u mundua ta qetësonte:

— Edhe yt vëlla ka vajtur kushedi sa herë në shtëpinë e tyre, edhe ata do të vijnë në shtëpinë tonë.

— Për vizitë! — përdrodi buzët Lira.

Traktativat për atë çështje kishin filluar tre muaj përpara.

Lirës i kujtohej mirë ajo ditë, kur mamaja që kthyer nga Tirana me fytyrë të çelur dhe me sy që digjeshin nga padurimi për t'i thënë diçka. Sapo kishte gjetur rastin, e kishte hequr mënjanë dhe me një solemnitet naiv i kishte thënë:

— Të ka kërkuar një djalë nga Tirana.

Nëna mendohej ta fshihte disi gëzimin që ndiente, por nuk arrinte në asnjë mënyrë.

— Është një shok i Polos. Punojnë bashkë në një zyrë. Ka mbaruar universitetin.

Nuk mund të thuash se Lira s'e dëgjoi me vëmendje mamanë. Ajo ndjeu atë që ndien çdo vajzë, kur interesimi i çdo djali i ngjall një shqetësim të ëmbël, një ndjenjë gëzimi, vetësigurie dhe epërsie, se ajo është diçka në këtë botë dhe se vlera dhe bukuria e saj janë gjëra që tërheqin vëmendjen. Kjo ndjenjë është e vjetër dhe e natyrshme. Por, nga ana tjetër, i vinte të qeshte dhe nuk i besohej se mund të martohej njeriu në atë mënyrë.

E ëma i kishte përmendur me radhë gjithë cilësitë e çmuara të kandidatit, që nga pozita, rroga, pamja fizike e deri te gjendja familjare aq me pasion, sa para saj do të kishin turp disa aktorë teatri.

Disa vjet përpara, atëherë kur sapo kishte mbaruar gjimnazin dhe kishte plot mendime të vagëta për jetën e lumturinë e pritshme, këto që dëgjoi do ta kishin tunduar, kurse tani, përshkrimin e mamasë e priti me një buzëqeshje të lehtë mospërfillëse e të ftohtë.

Mamaja, që priste tjetër gjë, u habit nga ai qëndrim dhe intuita i tha se e bija do të ishte pleksur me ndonjë nga ata të uzinës.

Duke hetuar me kujdes e larg e larg, ajo arriti të zbulonte se Lira kishte shoqëri me një djalë, po se gjer ku kishte arritur ajo shoqëri, nuk e dinte dhe nuk deshë ta mësonte.

Çështja u diskutua në nivel familjar. E pyetën babanë se si i dukej kjo gjë e ai tha me qetësi:

— Bardhi është djalë i mirë. Do bëhet mjeshtër i zoti.

Mamaja rrudhi buzët. «Do të bëhet mjeshtër i zoti! Shih se ç'thotë». Dhe, si të gjitha grave që nuk u pëlqen mjeshtëria e burrit të tyre, dëshironte që e bija të shpëronte nga rrobat me njolla grasoje e vaji e të mos merrte burrë mekanik.

— Mos pandeh që është më i mirë nga ai i Tiranës? — e provokoi e shoqja.

Babai u kollit e pastaj tha:

— Nuk ia kam parë surratin ndonjëherë.

Ai çmonte vetëm ata që njihte dhe përgjithësisht vetëm njerëzit e punës. Ishte mësuar të nderonte vetëm ata që nxirrnin nga duart punë që dukeshin e që prekeshin.

— Ja, edhe yt bir, që kur u bë nëpunës, një herë në vit mezi na vjen. Të kihte qëndruar këtu... Nuk më dëgjoi... Fytyra e tij u vrenjt.

— Lëre atë çështje. Tani kemi tjetër hall.

— Më pyete, t'u përgjigja, tani ç'do më?

Babai u ngrit e doli nga dhoma. Ai i kishte fjalët të kursyera, dhe s'kishte dëshirë të diskutonte.

Mamaja i kishte shkruar një raport të hollësishëm Polos, po pastaj qe penduar dhe e kishte grisur letrën. Nuk iu duk e hijshme t'i shkruante se e motra po bënte gjëra të pabëra.

Edhe babanë e la mënjanë, si njeri që s'merrte vesh nga këto punë dhe s'kishte pse të përzihej. Ai le të shikonte shëndetin dhe të pinte ato ilaçet me pika.

Iu përvesh punës me zell, duke dashur me gjithë zemër që ta përfundonte atë punë sa më parë.

Dhe ja, tani vëllai kishte sjellë kunatin e ardhshëm në shtëpi, me shpresë se çdo gjë do të shkonte për bukuri. Lira s'kishte pse të mos e pëlqente një djalë si Jovanin. Dhe, nëse Poloja e kishte vënë veten në një pozitë pak të vështirë, këtë e kishte bërë vetëm për të mirën e saj, që t'i siguronte një të ardhme të lumtur.

Lira s'qe ndonjë vajzë torollake dhe ata s'kishin si ta

detyronin të pranonte kundër dëshirës së saj. Po vallë a kishte arsye të kundërshtonte?

Lira ende s'po vendoste t'u ngjitej shkallëve. Kureshtja e shtynte të njihej me kandidatin e ri, kurse sedra e mbante. Sjellja e të vëllait dhe e mamasë i dukej e çuditshme.

— Ec, — i tha e ëma, — se është turp.

— Pse silleni kështu me mua?

— Ec ta shikosh, — i tha ajo, — t'i rrëmbesh kokën. Ai është më i mirë nga ti. Unë kam frikë se s'do t'i pëlqesh.

— As që dua t'i pëlqej.

— Shko vish trikon tjetër dhe lëri fjalët!

— Pse, e paskeni vendosur ju? — u zemërua Lira.

E ëma nuk iu përgjigj.

— Mirë, — tha ajo me zë të lartë. Dhe nga mënyra si i mbërtheu vetullat, dha të kuptohej se kishte marrë një vendim të rëndësishëm. Kishte po atë shprehje që ka njeriu kur thotë me mendje:

«Ama, kështu ma punuat? Atëherë prisni të shikoni fundin».

\*  
\* \* \*

Te dera u mendua një çast, nëse duhej të trokiste para se ta hapte. Zemra i rrihte fort. Nuk dinte si ishte më e përshtatshme nga ana e edukatës: po të mos trokiste, kishte frikë se do të tregonte mungesë kulture, e, po të trokiste, dyshonte se mos bëhej qesharake.

«Nuk do të trokas», — tha e i mëshoi dorezës.

Vëllait nuk iu hodh në qafë si herët e tjera, i zgjati dorën me dinjitet, por pa u munduar të dukej serioze, e pastaj u kthye nga Jovani, i cili, pasi i kishte hedhur një vështrim në tërësi, kishte mbetur i mahnitur. Ndoshta nuk e priste ta gjente aq të hirshme. Ajo ndryshonte shumë nga fotografia që kishte parë. Në fotografi çdo tipar ishte ngjeshur në një plan të vetëm, ndërsa fytyra e saj kishte një relief të harmonishëm, ku qenë shkrirë shëndeti i rinisë dhe një bukuri plastike. Sytë e saj shkëlqenin dhe vështrimi i



tyre qe i guximshëm. Ai e kishte menduar më të druajtur e më të turpshme, jo aq të çlirët.

Para se të përgjigjej, Jovani kapërceu pështymën, si t'i qe tharë gryka. Lira e vuri re dhe një buzëqeshje e lehtë iu formua në cepat e syve.

Biseda qe e shkurtër dhe e zakonshme. Thoshin diçka sa për të mos lënë pauza të ndjeshme dhe kapërcenin nga një subjekt në tjetrin.

Jovani rrinte pak i ngrehur. Deshi të dukej në të njëjtën kohë edhe simpatik, edhe serioz, edhe i zgjuar, edhe shakaxhi. Dhe në fytyrë mendohej të mbante një buzëqeshje të shtirur prej ashiku, por jo aq sa të dukej budalla. Lirës, tek e shikonte ashtu të ngrehur, i ngjitej një gaz si një valë e brendshme dhe, që të mos ia pëlçiste së qeshurës, sa të bëhej me turp, dy herë me radhë shtrëngoi nofullat.

Më së fundi, kur ai tha: «Më mbeti peronë që nuk e përfunduam bilancin para afatit», Lira kërkoi lejë dhe u ngrit. Me të dalë, vuri të dyja duart mbi fytyrë që të mbyste të qeshurën, iku në dhomën tjetër dhe atje u shemb mbi minder duke qeshur me lotë.

\* \* \*

— Si t'u duk? — e pyeti e ëma gjithë merak.

— Shumë i mirë, mama.

— Të thashë unë e shkreta, — i tha ajo sikur të desh ta qortonte që e bija s'e kishte çmuar gjykimin e saj, — xhevahir, — shtoi ajo së dyti, meqë s'gjeti fjalë tjetër më të përshtatshme. — Ku e pate këtë fat...

— Unë, apo ai? — e thumboi ajo, siç e kishte zakon.

— Ti? ku bën ti përpara atij?!

— Pse, e keqe jam unë?

— Jo, nuk je e keqe, por ai është më i mirë. Tani gjithë shoqet do të ta kerë zilinë.

— E pse? — u habit Lira.

— Pse, e paktë të duket, djalë i mirë, me punë të mirë, në mes të qytetit.

— Oh, mama, si mendon ti!

— Do jetosh si s'ka më mirë.

— E nga e di ti?

Mamaja i hodhi Lirës një vështrim, si t'i qante hallin që ishte aq e papjekur. Atë çast nuk e dinte se ç'ndiente për të bijën, dhimbsuri apo përbuzje.

— Thuaj po, dhe ta mbarojmë këtë punë.

— Nesër do të jap përgjigje. Nesër, kur të kthehem nga uzina.

— Shiko, mos bësh ndonjë budallallëk dhe i tregon njeriu për këtë gjë, se bota s'të duan të mirën, — e këshilloi e ëma.

— Jo, mama, unë dua të pyes për diçka, por ajo s'ka të bëjë shumë me këtë çështje.

Pyetja që e mundonte Lirën prej disa kohësh ishte edhe naife, edhe interesante. Ajo kishte dëgjuar shpesh në mbledhjet e uzinës për ndërgjegjen e klasës punëtore, për moralin e saj, po nuk arrinte dot ta kapte në mënyrë të saktë se çfarë shprehte ai koncept e si dallohej.

Lira ishte punëtore e re, s'kishte mbushur veçse dy vjet që kur kishte filluar të punonte në uzinë dhe nuk i ndiente hapat që kishte bërë. Shpesh mundohej të gjente atë dallim që duhej të vihej re midis saj dhe shoqeve të maturës, të cilat kishin zënë punë të lehta, dhe s'e gjente dot ndryshimin. Dësh i zbulonte atë epërsi të klasës, për të cilën flitej kudo me respekt dhe s'e gjente. I dukej se ishte krejt njëlloj. I vetmi ndryshim që se shoqet e saj shkonin në punë të veshura mirë, kurse Lira shkonte me kominoshe. Pas punës edhe ajo vishej mirë, si të tjerat.

Ndryshimet që kishte pësuar, s'kish si t'i vinte re. Ajo ecte pa naze, me një hap burri dhe e sigurtë, ndihej e çlirët në shoqëri, ishte mësuar me shaka dhe qeshte atëherë kur i qeshej. Ndërgjegjja e klasës punëtore ca nga ca po e brumoste dhe po pushtonte çdo cep të mendimeve të saj.

Po ajo e kishte vështirë t'i vinte re ndryshimet, se këto s'dukeshin në pasqyrë si flokët e si ngjyra e trikos.

Tani prindërit e kishin vënë para një pozite që duhej ta zgjidhte vetë. Nuk dëshonte se i vëllai ishte nisur nga qëlli-

me të mira; ajo e kuptonte se, si Poloja ashtu edhe mamaja, nuk mund ta detyronin të pranonte fejesën kundër dëshirës së saj.

Ajo e kishte vetë në dorë. Mund të thoshte «po» ose «jo», si t'i mbushej mendja.

Këto mendonte tek punonte me autotransportierin.

Në pushimet e drekës iu afrua mjeshtrit të uzinës, Sotir Bojaxhiut, që ishte edhe sekretar i organizatës së partisë dhe si rastësisht u ul pranë tij. Kur mbaroi drekën, e pyeti:

— Ç'do të thotë moral i klasës punëtore, ndërgjegje e klasës? Pse, për shembull, thonë se ne jemi një çikë më ndryshe nga të tjerët?

Mjeshtri e lëshoi lugën në sefertas dhe u kthye ngadalë nga krahu i Lirës. Një pyetje të tillë s'ia kishte bërë askush.

— Pse, s'e ke dëgjuar nëpër konferenca?

— Lëri konferencat mënjane. Unë dua të di si e kupton ti, të ma thuash me fjalët e tua.

Mjeshtri hoqi syzet e filloi t'i fshinte me kujdes. Nuk e kishte të lehtë të jepte shpjegime teorike. Ai ktheu edhe një herë kokën nga Lira, për të vënë re në e kishte me gjithë mend. Ajo priste.

— Do ta them, ashtu siç e kuptoj unë. Klasa punëtore i bje shkurt, atë që ka për të thënë, ta thotë copë, frikë s'ka, turp jo, dhe i shfaq mendimet hapur. Pastaj klasa punëtore kap shpejt të renë dhe ngre zërin e para kundër çdo gjëje të vjetër.

Fytyra e Lirës u prarua nga një buzëqeshje plot hir. Po thoshte me vete: «Ama kjo genka?» Sepse iu duk shumë e thjeshtë dhe shumë e lehtë të thoshte ato që mendonte. Zaten ajo ashtu kishte vepruar deri tani dhe nuk e merrte me mend të ndodhte ndryshe. Shpjegimi i mjeshtrit iu duk bindës dhe i kapshëm si një detal makine.

— Sa mirë, — tha, — kështu duhet të jetë. — Ndihej e gëzuar. Tani ai koncept, nga diçka e papërcaktuar që kishte qenë përpara, i ishte bërë menjëherë i qartë dhe konkret.

— Tani ka edhe fjalë të tjera.... — i tha mjeshtri, i kë-

naqur nga qëndrimi që vinte re te Lira, — nuk është kaq e thjeshtë, sa ta thashë unë. Që ta kuptosh këtë, duhet...

— Jo, jo, e kuptova mirë, — i tha Lira duke vënë dorën e saj sipër dorës së tij.

I kënaqur që ia kishte dalë mbanë aq bukur, mjeshtri iu kthye me shije sefertasit.

\* \* \*

— Sot Jovani na solli një turtë për drekë, — i tha e ëma, sapo shkeli në shtëpi, — 40 — lekëshe, nga ato të turizmit. Gjithë krem e shkurë.

— Mama! — i tha Lira sikur të mos kishte dëgjuar asnjë prej fjalëve të s'ëmës.

— Ç'ke? — e pyeti ajo gjithë merak e frikë.

— Pse më do mua ai?

— Ç'është kjo pyetje? — Fytyra e mamasë ndryshoi për së treti.

— Jo, e kam me gjithë mend. Ai s'më njeh mua, atëherë si është e mundur të më dojë?

— Si s'të njeh?! — u habit e ëma.

— Nga më njeh?

— Po ja, ka pyetur për ty, yt vëlla i ka folur, tani të pa vetë. Ç'do më tepër?

— Beson ti se ai më njohu mua aq sa të martohet?

— Ja, kështu njihen. Bota shikohen së largu në bulevard dhe e përfundojnë punën. E jo ti...

— Mama, unë nuk e njoh fare atë.

— Si kërkon ta njohësh? — u skandalizua e ëma. — Të të lë unë të bredhësh me të, të shëtisësh e të shkosh kinemave?

— E pse jo?

— Mojt, ti ke luajtur më duket.

— Ti thua është i mirë...

— Po të mos ishte i mirë, yt vëlla nuk ta sillte në shtëpi.

— Po në qoftë se e solli, s'domethënë se unë duhet të fejojhem patjetër me të.

— O perëndi, edhe këtë turp do të na e bësh? — Mamaja psherëtiu e lodhur dhe pastaj u ul në karrige. Lirës i erdhi keq dhe i vajti mamasë pranë. I zgjati dorën t'ia vinte në sup, po në çastin e fundit e mbështeti mbi karrige. As vetë nuk e kuptoi pse.

— Unë nuk e njoh, — tha ajo.

— Po s'pranove, atëherë duhet të mendosh shumë gjëra të tjera. Yt vëlla s'ka si të punojë në një zyrë me të pastaj. Këtë e ke menduar? Bota do të thonë se ai s'të pëlqen dhe të la në derë. Kështu do të na bësh me turp.

— Ju e paskeni vendosur dhe kot më thoni që e keni lënë në dorën time. Nga unë prisni të them «po».

— Është i mirë, mój Lirë.... — e përgjeroi e ëma. — Nuk ke për të pasur rast si ky. Një herë të vjen zogu në dorë. S'duam të të urdhërojmë, por të të hapim sytë.

— Mirë, mamë, — tha Lira, me sytë mbushur, — ju thoni është i mirë dhe unë e besoj. Më lini të bisedoj me të, që të bindem edhe unë. Kaq gjë besoj se mund ta bëni.

— Do bisedoj me tët vëlla, kur të kthehen nga spitali, — i tha e ëma.

\* \* \*

Poloja së bashku me Jovanin kishin shkuar t'i bënin një vizitë babait, që ishte shtruar në spital. Kohët e fundit ai qe dobësuar edhe më tepër dhe dy javë përpara kishte pësuar një krizë të rëndë. Tani rrinte shtrirë në shtrat, lexonte nga pak gazetën dhe bisedonte me shokët për uzinën mekanike që do të ngrihej në qytetin e tyre! Thuhej se do të ishte krejt moderne dhe ai kishte qejf të punonte atje disa kohë.

Vizita e Polos e gëzoi si asnjëherë tjetër, sepse pandehte se ai kishte ardhur kastile për të. Nga ky shkak Poloja nuk ia prezantoi Jovanin, por ia paraqiti si një shok, me të cilin po shkonte me shërbim. E la plakun të gënjehej e të gëzohej, pasi kjo iu duk më e arsyeshme.

— Le të bisedojë, — tha Poloja, — s'ka asgjë të keqe në këtë mes.

Sikur Lira të mos e kishte menduar me kohë fjalën e parë që do t'i thoshte, do ta kishte shumë vështirë ta niste bisedën me Jovanin.

Në fytyrën e tij shprehej një farë nervozizmi, sepse kishte pritur që gështja e fejesës të përfundonte qysh ditën e parë. Zvarisja nuk po i dukej premtuese dhe një shqetësim i përzier me dyshim i sillej nëpër mendje. Megjithatë vazhdonte ta ruante atë buzëqeshje prej ashiku e atë ndjenjë të lumturisë së pritshme, tek mendonte se shpejt do ta fitonte të drejtën t'i afrohej, ta prekte, ta puthte.

Qëkurse hyri Lira në dhomë, ai e ndjeu se biseda do të qe vendimtare. Përfundimi do të qe fitore e plotë ose humbje e plotë.

— Ju keni kërkuar të fejohehi me mua... — tha Lira duke u skuqur. Ajo kishte dashur ta pyeste, por s'kishte arritur ta shprehte fjalinë në mënyrë pyetëse dhe ato që kishte thënë tani tingëllonin si diçka e vërtetë, për të cilën askush nuk mund të dyshonte.

— Po, — tha Jovani, i qetë.

— A më njihni aq mirë, sa të kërkonti të martoheni me mua?

— Besoj se ju njoh.

— Po sikur nesër e pasnesër t'ju thoshin se ajo, para se të fejohej me ju, ka dashur një tjetër, si do të vepronit? Ç'do të bënit?

Pyetja e saj e vuri në mendime. Sidomos ai pohimi se ajo kishte dashur një tjetër e sëmboi në zemër.

«Po më provokon, — mendoj ai, — në këtë përgjigje duhet të kem kujdes. Apo mos vallë ka pasur vërtetë ndonjë dashnor?».

— Asgjë — tha ai. — Edhe unë mund të kem dashur ndonjë tjetër përpara. Puna është që të shikojmë të ardhmen.

Ai u tregua i sinqertë. Megjithatë Lira nuk i kuptonte

ata djem, të cilët, sa ishin të rinj, dashuronin, pastaj, kur vinte koha të fejojeshin, kërkonin të gjenin ndonjë vajzë me mblesëri. Pse vallë? Sepse në kokë kanë një mendim anadollak. Vajzat që dashurojnë, s'janë të ndershme, për shkak se dashurojnë. Kurse martesë është diçka e shenjtë, e lartë, madhështore. Dhe atëherë rendin të gjejnë vajza me mblesëri, vajza të mbyllura brenda, «të ndershme», që s'i ka prekur dorë djali.

Një nga këta tipa iu duk edhe Jovani. Ishte e pamundur që ky djalë qyteti të mos kishte dashuruar. Kur marthoen, këta njerëz nuk duan një shok jete, por thjesht një grua. Dhe pastaj fillojnë të bëhen burra të ndershëm, të shesin parime për moralin, të kritikojnë shoqërinë, të shkojnë vizita nëpër farë e fis, pasi i kanë blerë gruas një palë çorape naylon, e t'u shkelin syrin tinës të dashurave të tjera që hasin rrugës. Disa të tjerë shkojnë të gjejnë nuse nëpër fshatrat, vetëm që t'i kenë nën urdhër e të nënshtruara. Dhe pastaj këta njerëz të pamoralshëm mendojnë se janë në gjendje të bëhen kryefamiljarë idealë.

Lirës i erdhi të pështirë.

— Po sikur, — e pyeti, — pas martesës gruaja juaj të vazhdonte të donte një tjetër, si do t'ju vinte?

Jovani u hutua nga kjo pyetje e çuditshme dhe s'kuptonte se ku kërkonte të dilte. Çfarë donte kjo vajzë? Mos dëshironte të ishte e lirë edhe pas martesës?

— Kjo s'duhet të ngjasë kurrë, — tha ai në mënyrë të prerë, — Atëherë, ç'kuptim ka martesë?

— Ashtu mendoj edhe unë. Por unë... — i tha Lira dhe heshti, pasi i vinte rëndë të pohonte, — unë kam shoqëri me një djalë dhe do ta dua gjithmonë. Gjithmonë, — shtoi ajo e vendosur, — gjersa të jem gjallë. Atëherë, ç'kuptim ka të marthohem me një tjetër? Mamaja dhe vëllai duan të më fejojnë me ju, por unë nuk mundem. Prandaj... ju e kuptoni vetë.

Pastaj një heshtje e shkurtër, e rëndë, e padurueshme.

— Më falni, — tha ajo, — vëllai më ka thënë fjalë të mira për ju dhe besoj se jeni vërtet ashtu. Si shok të vëllait do t'ju respektoj, do t'ju flas, më shumë nuk mundem.

— A e dinin ata më përpara këtë gjë? — pyeti Jovani. Buzëqeshja prej ashiku i qe zhdukur krejt prej fytyrës e vështrimin e kishte të zymtë.

— Diçka dinin. Por ata mendonin se ju jeni më i përshatshëm sesa Bardhi. Po ta shikosh me sytë e tyre, mbase kanë të drejtë, por unë nuk mendoj ashtu.

— Mirë, — i tha Jovani, — derisa qenka puna kështu. — Dhe i hapej goja jo nga mërzia, jo se i vinte gjumë, por nga angushtia. Lira i dukej larg, si ta shikonte me anën e prapme të dyllisë.

Atmosfera në familje u rëndua dhe u ftoh. Bisedat s'ecnin dhe i shtynin me pahir. Po atë pasdite Jovani e Poloja dolën në agjenci për të gjetur ndonjë makinë. Pinin cigare duke ndenjur larg njëri-tjetrit dhe rrallë e tek këmbenin ndonjë fjalë.

1970



## RUZHDI PULAHA

### PLEQËRI E BARDHË

— Shtëpia ishte e vjetër dhe qaba. Muret e rjepura prej qerpici, krimbat që brenin trarët e nxirë nga një pyllthi tërë që ishte djegur në atë vatër të gurtë, pllakat e çatisë, të gërryera nga shirat, tregonin se kjo gërmadhë kishte rritur shumë breza Zenellarësh të njohur në tërë krahinë, si burra të gishtit e të besës.

— Nëpër mazgallat e çatisë ulërinin erërat e dëborës me ca zëra të çuditshëm. Luftë! Njerëzit sikur kishin harruar të gjitha zhurmat e tjera dhe përgjonin vetëm krismat e armëve. Me krismat përcaktonin distancat, stinët, sulmin dhe tërheqjen, fitoren dhe humbjen. Atë ditë era i sillte ato të deformuara, me ca valë të mbytura.

— Xha Danoja kishte dalë nëpër fshat. Batoja ishte i vetmi mashkull në shtëpi dhe të tjerët flisnin pothuaj vetëm për të. Por ai s'kuptonte asgjë nga gjithë ky pushtet prej burri, rrinte i shkujdesur e hijerëndë, aty pranë zjarrit. Batoja donte dhe tri ditë të mbushte muajin.

— Qenka i urtë! — i thashë nuses.  
— Selvia s'pati kohë të më përgjigjej, se hyri me vull e vjehrra.

— Ç'më shikon ashtu? — i tha së resë, pa hapur akoma mirë derën. Vëri gjinë djalit. Gjerman ziu ka dalë në Gur të Baxhos. Për një sahat, të shumtën dy, na kumbis këtu. Do të ikim. Dobarem jepi djalit të pijë. Të jetë i ngopur një copë herë.

Plaka zuri të kërkonte poshtë e lart ca plaçkurina që i mbliidhte në një bohçe të vjetër.

— Do të ikim, — më tha mua. — S'ia japim shpirtin dushmanit. Po ti mos ki dert, djalë, se do të të nxjerrim shëndoshë e mirë e do të të marrin të keqen.

— Tërë fshati do të ikë, teze Rabo?

— Ç'qenë me këmbë e me dorë kanë ikur që me sabah me territorialin. Ata ia prenë sillën gjermanit, se kishte ardhur me vakt. Në fshat kanë mbetur një pjesë e grarisë e nja tre a katër pleq si ne, që e kanë grisur gunën. Ata do shkojnë nga shpellat. Ne do të dalim më të sipërm. — Kështu tha plaka.

Ajo doli kushedi ç'të merrte në dhomën tjetër. Nusja mundahej të ngopte fëmijën, por Batoja hiqte dy-tri herë dhe e zinte gjumi në gj.

— Është shumë ftohtë, — thashë unë, — Erë e çmendur! Maleve ka rënë dëborë. Kur të pritet era, do të fillojë prapë. Foshnja është e vogël.

— Ç'të bësh!? — tha nusja, e qetë, — Luftë!

— Ca më i fortë do të bëhet, — tha plaku, që hyri atë gast. — Le që ky në pyll ka lindur. Zgjoje, moj, zgjoje... Jepi të ngopet, se s'dihet kur i bie të pijë prapë.

S'më mbante vendi. Isha nisur nga Qarkori me një porosi urgjente dhe shumë të rëndësishme për komandën e batalionit të Malit të Bardhë. Një javë më parë batalioni kishte rënë në kurth e, sikur të mos e kishte profitasur me kohë, rrezik të ishte shuar gjysma. Dhe ne morëm vesh se në batalion ishte një farë Dalip Verrishta, spiun i gjermanëve, që i mbante lidhjet me dervishët e teqesë së Jazit. Unë po shpija vendimin që të pushkatohej Dalipi, dhe batalioni të largohej ca kohë nga ato anë. Po rrugët e luftës janë si rrugët e luftës. Sado i kujdesshëm që u mundova të tregohesha, rashë në përpjekje dhe u plagosa në kofshën e majtë. Vendin e njihja mirë dhe munda të shpëtoja, por, gjersa arrita në shtëpinë e xha Danos, herë zvarë e herë bjerë e ngrehu, humba shumë gjak e s'bëja dot çap më tutje. Teze Raboja ma lau plagën me raki, plaku ma pllakosi me një grusht duhan dhe ma lidhi me një copë çarçaf.

— Plagë e hidhur! — thoshte plaku me vete — Të ka marrë keq.

Provova të ecja, por këmbët s'më mbanin, këllku i majtë më therte e më dukej sikur një sharrë e madhe sharronte pareshtur koskat e mia. I tregova xha Danos si e kisha punën dhe ai doli nëpër fshat të gjente një njeri të saktë që të çonte letrën, por njerëzit që kishin këmbë për të shkuar gjer në Mal të Bardhë, patën ikur të gjithë me territoria-lin. Dhe unë rrija aty me mendje të ngritur dhe prisja.

— Ngruhuni! — urdhëroi xha Danoja, sapo u dha në derë. — Ngruhuni të ikim!

— Xha Dano.... — desha ta kujtoja dhe u ngrita duke u mbajtur pas murit.

— Lërja xhaxhait atë punë... Ka menduar plaku për të gjitha. Vërtet ju jeni balli i luftës, po m'u zbardh qimja e kokës e çoç kam mësuar edhe unë nga kjo qerrata jetë.

Gratë po merreshin me djalin. Ashtu në shpërgëj, siç ishte, e futën në një bashkë lesh deleje dhe e mbështollën me një kuvertë të vjetër ngjyrë gruri.

— Rrangullina shumë mos na merrni, se s'do vemi në kurbet, — tha plaku, duke hedhur dy-tri grushte duhan në një shami të lerosur. — Hë, o burrani, të zëmë korijen pa dalë gjermani në fshat. Janë një dynja. Krismat vijnë edhe për matanë. Edhe nga zhurigat më duket se janë futur, — dhe doli duke lënë pas derën e hapur.

Kur dolëm në, ai po priste në oborr. Ishte mbështetur me të dyja duart në shkopin e thanës dhe hiqte pa pushim çibukun, që mbante midis dhëmbëve të rrallë e të zverdhur.

— Mua më trego ndonjë rrugë që pret shkurt për në Mal të Bardhë, dhe ju ikni, — thashë unë, por plaku s'më ktheu përgjigje.

Zgjidhi nga gardhi një mushkë koskë e lëkurë, me lesh të gjatë, që i kishte rënë vende-vende e dukej si e zgjebosur.

— Edhe hajvanët i ka marrë lufta. Vetëm këtë gërdallë gjeta. Ndaj dhe u vonova. Hajde, kapedan, — përkuli gjurin dhe vuri mbi të të dyja pëllëmbët. — Vëre këmbën

këtu. Hë, moj, ju! Selvi! Jepja Baton plakës dhe ndihmo djalin këtu!

Zëri i tij ishte urdhërues dhe qe e kotë ta kundërshtoje. Veç kur u ndodha sipër samarit.

— Shkoni përpara! — u tha xha Danoja grave dhe vetë tërhiqte mushkën për kapistre.

Era ulërinte pareshtur. Krismat herë i sillte të qarta e të forta, sikur luftohej aty pas kurrizit tonë, herë të largëta e të përmbytura, sikur dilnin nga shpellat.

«Prapë ai djall Dalip do ta ketë kurdisur këtë», — mendova dhe mallëkova plagën. Gjersa kaluam bokërinat mbi fshat s'këmbyem një fjalë, veç plaku shante gjermanin me ç'i vinte në gojë, nga e ëma e nga i ati, dhe mallëkonte mushkën shalëngjitur. Si bëmë një copë rrugë nëpër korijen e dushkut, ai u tha grave të qëndronin e të merrnin një firomë. Ato gulçonin dhe avullonin nga djersa.

— Hë, djalë, si e ke plagën? — më pyeti dhe më shkurttoi shkallën e litarit që të mos më varej shumë këmba e plagosur.

Foshnja filloi të qante.

— Nisuni! — tha prerë Danoja.

Faqja e malit sa vinte e bëhej më e përpjetë. Ecnim nëpër një shteg të ngushtë dhe mushkës i kruheshin barqet nëpër boriga. Në të dy krahët pylli ishte i pashkelur.

— Lesh arapi, — thoshte plaku. — S'çan dot gjermani këtej: Vetëm ky shteg është. Hafije ndoshta dhe dërgon, po ushtrinë s'e fut dot se i mbeten brekët në borigë.

Plaku kishte të drejtë, po mua më punonte mendja tek ajo copë letër që më kishte nisur kësaj udhe. Duhej të kisha arritur në Mal të Bardhë që në mëngjes, kurse po ngrysej e unë kolovitesha akoma mbi samar të mushkës, pas dy pleqve që mbaheshin përtej mundësive të tyre e që mundoheshin të mbysnin gulçimat për të mos më shqetësuar.

— Xha Dano, mbaje mushkën. Duhet të shkoj patjetër në batalion. Janë në rrezik, xha Dano!

— Ja, sa të dalim te Pusi i Pashës, — ma ktheu i qetë plaku.

Me siguri diçka kishte menduar dhe kjo më qetësonte disi. Dhe unë ndiqja këta njerëz të mirë, mes të cilëve s'ngopesh së jetuari. E kur ndahesh me ta, nëpër atë dashuri të madhe një dhembje njerëzore të ndjek për një kohë të gjatë. Njerëz që të shërojnë plagët me fjalën e tyre, që të shuajnë urinë me buzëqeshjen e tyre, që s'e kursejnë jetën për tënden, që të përtërijnë me madhështinë e thjeshtësisë së tyre.

Nishanlli që të këpuste fijen e barit njëqind metra larg, xha Danoja syrin e kishte prapë të fortë. Shikimi i tij dinte të shihte gjer në fund luftës e përtej saj. Ndaj u kishte dhënë uratën të tre fëmijëve. Vajza e vetme, Sania, i qe vrrarë në betejën e Leqeve. Patriun, djalin e vogël, e kishin futur në burg e s'i dihej filli. I madhi ishte komandant i batalionit në Malin e Bardhë. Plaku kishte mbetur komandant shtëpie. Nuk e linte plakën të qante, kur mbushej ndonjëherë, i jepte zemër nuses dhe i këndonte Batos duke e ngrohur aty pas vatrës. Njeri që e kishte dashur e çmuar mikun tërë jetën, tani ua kishte hapur portat e shtëpisë djemve të Partisë.

Një batore krismash u dëgjua më të djathtë të korijes.  
— Dyfek gjermani, — tha plaku. — I hidhur shafuran. E njoh nga zëri.

Por edhe kur humbisnin krismat, ai e nuhaste luftën. Mblidhte hundën e vogël nën mustaqet çile, kthente kokën herë andej, herë këtej dhe thoshte i sigurtë:

— Luftojnë te Gryka e Buallit. Veriu fryn përroit dhe e sjell erën e barutit këtu.

— Xha Dano... — desha ta kujtoja përsëri.

— Ja vamë te pusi... I ka menduar plaku të gjitha. Mos u mërzit.

Atij që i thoshin Pusi i Pashës ishte një gropë e thellë pranë një pishë cunge të këputur nga rrufeja. Shtegu aty ndahej si një bigaçë. Njëri krah zbriste poshtë, nga lindja, kurse tjetri vazhdonte përpjetë malit, pasi bënte një dredhë të vogël aty pas pusit.

— Të marrim edhe një firomë, — tha plaku.

Mua më zbritën nga mushka dhe më mbështetën pas

pishës. Hodha një gur në pus e, si kaloi një kohë, dëgjova ca jehona të çuditshme nga thellësitë e tij.

— Është i thellë shumë, — tha xha Danoja. — Do një javë guri që të bjerë në fund. Në kohë të Turqisë, siç tregonin pleqtë, komitet zunë një pasha dhe e hodhën këtu. Një javë u dëgjuan ulërimat e tij, gjersa ra në taban. Tërë ushtrinë që ka sjellë gjermani, ta hedhësh këtu, e merr e do të mbetet edhe ca vend për ata zgharhanat e Ballit... Të vejë qeni me të zonë...

Nusja i jepte fëmijës të pinte, duke i përkëdhelur kokën e mbështjellë me kuvertën e leshtë. Raboja, si ndenji një çast ashtu, me duar në kryqe, erdhi të më shihte plagën.

Xha Danoja u ngjit mbi një sop për të hedhur një sy nga lugina. I kishte vënë të dyja duart si strehë dhe sytë e vegjël i kishte picërruar edhe më për të ngushtuar këndin e pamjes. Era u pre dhe nisi të qëmtonte dëborë. Raboja i mori fëmijën së resë dhe i tha të çmpinte krahët.

Plaku zbriti i mërzhitur nga sopi.

— Keq e kemi! — tha nëpër hundë. — Paskan dalë edhe këtij krahu farëshuarit. Malit s'ua mban të ngjiten e ia kanë marrë luginës. Dashkan ta rrethojnë Malin e Bardhë.

— Sidoqoftë, unë duhet të nisem, — dhe po mbërtheja pallton. — Do të mundohem të çaj. Puna është që, po dola gjallë, të arrij para tyre. Nga ç'anë pret më shkurt?

U ngrita duke u kapur pas cungut të pishës dhe u shkunda një herë fort për të hequr lodhjen dhe dhembjen e plagës. Por këllku më theri e mezi u mbajta.

— Do t'i bëjmë derman, — tha xha Danoja. — Ku e ke atë letrën?

— Letrën?

— A s'më the se ke një letër për në batalion? Nxirre!

E nxora, pa kuptuar ç'kishte ndër mend të bënte plaku. Ai zgjati dorën, ma mori dhe ia dha plakës.

— Fute në qemer të çitjaneve.

— Do të shkoj vetë, — u hodha unë dhe desha t'i rrëmbeja letrën Rabos. Nema!

Por ajo po e rregullonte me nge mirë e mirë dhe as më

ktheu përgjigje. Ishte i prerë urdhri i komandantit të saj.

— Ka një kufi çdo gjë... — u nxeha unë, — xha Dano, të dua si babanë tim e të falemnderit për të gjitha, por këtë nuk ta lejoj. Kjo detyrë m'u ngarkua mua dhe gjallë a vdekur do të mundohem t'i dal mbanë. Ka një kufi...

— Sh...sh...t! Mos thirr! — tha plaku, i qetë. — Era ia shpie zërat gjermanit në vesh. Dëgjo këtu, djalë! E dimë që je trim, po ti s'ke për të nxjerrë gjë, dëgjo xhaxhanë! E kanë zënë luginën tejmbanë e nuk çan dot, sikur edhe mi-zë të bëhesh. Plagën e ke të keqe.

— Po kjo trimëri që doni të bëni ju, e kujt është?

Ai më shikonte në bebëz të syrit me një buzëqeshje të lehtë që i dilte nga kindat e buzëve të rreshkura dhe unë e kuptova që fjalët e mia s'i bënë asnjë përshtypje.

— Dëgjo, djalë, dëgjo! Këto që më thua ti, i di unë. Ju njoh mirë unë ju të Partisë e të Çlirimtares, se ju kam nxjerrë nga gjiri, por puna është të vejë letra në batalion. E ja ku ta them prapë, që ti nuk e shpie dot. Ja, kështu! Kurse unë ndryshe. Çoç më ka pjellë kjo, — dhe i ra kokës me shkopin e thanës. — Do të hipi plakën në mushkë e i di unë shtigjet nga dilet. Për dy sahat më ke në Mal të Bardhë. Ata as për katër nuk arrijnë dot.

Një dhembje e madhe më gërryente përbrenda, por s'kisha si të mos i bindesha logjikës së tij.

— Letra të vejë, kjo është meseleja, — tha plaku e më ra supeve. — Luftën e bëjmë të gjithë. Edhe ne përpiqemi me këtë takat që kemi.

U ndamë me përqafime e me të puthura, siç ndahen njerëzit në luftë. Pleqve s'u bënte syri tërr, kurse unë mbe-ta me zemër të thyer. Xha Danos nuk i shpëtonte asgjë. Më zuri për krahu e më tundi, duke zbrazur mbi mua tërë dashurinë e babait të mirë.

— Më besove letrën e unë të besova Baton, dritën e syrit. Për ne merak mos ki.

E hipëm plakën mbi mushkë dhe ata u varën shtegut më të poshtë. Ne i ndoqëm një copë herë me sy, gjersa humbën nëpër dushk dhe vazhduan përpjetë. Me gjithë përpjekjet e mia, këmbën e plagosur s'e urdhëroja dot, dhe Selvia nën njërin krah kishte futur djalin e me tjetrin më

ndihmonte mua. Ecnim në heshtje nëpër shtegun e ngushtë që s'na merrte të dy për krah dhe degët e dushkut na fshikullonin fytyrën. Dëbora kishte pushuar dhe frynte përsëri ajo era e ftohtë, pickuese. Foshnja zuri të qante. Ashtu si e kishte marrë e ëma, me siguri e ndiente veten keq.

— Lëshomë mua. Shiko Baton, — i thashë si me të lutur dhe u shkëputa prej saj.

— Ku e gjëti tani! — tha gruaja, e mërzhitur. — Qëndrojmë ca, sa të pushojë?

— Jo, jo! Lëshomë mua dhe ecim.

Ajo s'më kundërshtoi dhe u nis përpara. Foshnjën e kishte vënë në gjë dhe e mbante me të dy krahët. Unë tërhiqja këmbën zvarë pas saj, duke u mbajtur pas degëve. Kafshoja buzën prej dhembjes e, megjithatë, mundohesha ta harroja fare veten e të mendoja për pleqtë që u nisën me letren e Qarkorit, për nusen e re dhe Baton e vogël, që pinde qumësht nga gjiri i s'ëmës.

Selvia qëndroi dhe më futi prapë krahun. Nuk kundërshtova më dhe ajo s'më lëshoi, derisa arritëm aty ku na kishte thënë xha Danoja.

— Këtu do të qëndrojmë, — tha nusja.

Ishte një shesh i vogël, katër-pesë rrogözë vend, jo më shumë. Një shkëmb i zi, i madh kishte hyrë si një gjë e huaj aty, midis drurëve. Nga njëra anë shkëmbi dilte si strehë dhe ne hymë aty që të mos na priste era. Batoja filloi të grindej prapë. Unë hoqa pallton dhe ia dhashë Selvisë të mbështilte fëmijën.

— Ti je sëmurë, do të ftohesh. Mos e hiq, — më tha ajo.

Nuk iu përgjigja. Baton e zuri gjumi përsëri.

— Në bohçe ka ca bukë. Merr e ha, — më tha ngadalë e si me drojtje.

Mora bohçen dhe i dhashë asaj një copë bukë me djathë.

— Po ti? — më tha, kur pa që e lidha prapë bohçen, pa marrë për vete.

— Nuk më hahet.

Ajo përsëri nuk kundërshtoi dhe filloi të përtypej ngadalë.

Të papriturat e luftës. Rreziku i plumbit na ishte bërë



diçka e zakonshme, siç bëhen të gjitha punët e përditshme. E kishim pranë kudo dhe kurdoherë dhe ishim mësuar me të. Kurse më ngjarjet e asaj dite nuk po mësohesha dot. Pleqtë ikën me letrën time, fare të qetë dhe me një gaz që s'e tregonin, si ata fëmijët që shpërndajnë ftesat e dasmave. Selvia rrinte e patrazuar dhe më shihte me një sy të larë, si të ishim motër e vëllë, që ishim nisur për të bujtur të daja dhe kishim qëndruar të çlodheshim pak, aty pas shkëmbit të zi. Lufta i kishte fisnikëruar njërezit e mirë, që s'kursenin për ne bukën, fjalën e mirë, as kokën e tyre.

Batoja zgjohej, qante, pinte dhe flinte prapë me kokën në gji të s'ëmës.

— Si thua ti, a do të kenë kaluar? — më pyeti Selvia befas dhe më këputi fillin e mendimeve.

— Ngrita supet, pa ditur ç'ti thösha.

— Që kur s'e ke parë Veselin? — e pyeta, sa për të thënë edhe unë një fjalë.

— Ka dy muaj e ca që s'ka dalë këtej.

— As për djalin nuk erdhi?

— Jo. S'e ka parë.

— E ke trim.

Ajo qeshi me turp dhe uli kokën. E donte shumë burrin dhe iu bë qejfi që ia lëvdova.

— E kishë njohur më parë?

— Ai vinte e bënte mbledhje në fshatin tonë. Në një mbledhje ke qenë edhe ti, po s'më mban mend.

U mundova të kujtoja të gjitha mbledhjet që kisha bërë asaj ane, por fytyra e saj s'më shfaqej gjëkund.

Ishte errur. Diku ndriçoi një raketë e kuqe dhe u këmbyen batore pushkësh. Pas disa minutash zjarri u ndërpre. Më vonë krismat u dëgjuan përsëri, por vinin nga larg. Ishte ftohtë dhe binte një dëborë e hollë si oriz i bluar. Selvia e mbajti djalin me një dorë dhe me tjetrën po hiqte pallton. Unë s'e lashë.

— U lodhe, — i thashë. — Ma jep ta mbaj ca djalin.

— Ku lodhet nëna duke mbajtur foshnjën, — qeshi lehtë ajo dhe ma lëshoi me kujdes në duar.

Ishte hera e parë që mbaja një foshnje në duar. E ngri-

ta ngadalë, e afrova pranë fytyrës dhe dëgjoja frymëmarrjen e tij, një regëtitje e lehtë dehëse.

— Fle! — i thashë Selvisë, sikur të kisha bërë një zbulim.

Ajo qeshi me zë.

Më fërfëllonte trupi. Etheve të zjarrmisë e të plagës iu shtua dhe ajo ndjenjë e çuditshme që më ushqente. Batoja: Lufta më kishte dhënë në duar, në mes të pyllit e të natës, djalin e shokut që kishin shkuar ta rrethonin gjer-manët, nipin e dy pleqve që ma lanë amanet, dritën e syrit të asaj nuseje.

Dicka kisha murmuritur me vete.

— Nuk je mirë, vëlla, jo...o! Mbështetu e merr një sy gjumë, — tha Selvia dhe ma mori djalin nga duart. Batoja u zgjua dhe ajo i vuri përsëri gjirin. Ktheva kokën matanë dhe, duke dëgjuar krismat, rashë përsëri në ato mendime të mundimshme që s'më ishin ndarë tërë kohën. Batalioni po luftonte, kjo ishte e qartë, po a kishin arritur pleqtë dhe a kishte vajtur letra në kohë?!

Kushedi sa gjatë blojta këto mendime, duke mallëkuar atë plagë që më la në mes të udhës e u ngatërruan këto punë kështu. Veç kur u kujtova se pranë kisha Selvinë e duhej t'i thosha një fjalë. Por atë e kishte zënë gjumi. Fli-nte me foshnjën në gj. Desha ta mbuloja mirë, që të mos ftohej, por kisha frikë mos zgjohej. Rrija pa lëvizur, madje edhe frymë mundohesha të mos merrja thellë. Mund që ajo fjeti një orë a dy, gjer aty nga mesnata, kur dëgjova disa zëra të largët që thërrisnin e dikë kërkonin nëpër natë. Nxora revolverin dhe mbajta vesh. Zërat po afroheshin dhe munda të dalloja fjalët e tyre.

— O Sel-vi...!

— O sho-kooo!

E luajta lehtë dhe ajo u zgjua.

— Ua, paskam fjetur? — tha e turpëruar dhe shtrëngoi djalin në gjoks.

— Dëgjo, po thërresin... — i thashë dhe i hoqa sigurecën revolverit.

Zërat ishin afruar dhe më e dëgjoheshin qartë.

— Janë të batalionit, — tha e lehtësuar ajo.

— S'dihet ç'janë. Nata është e pabesë. Shko prapa shkëmbit e ruaj fëmijën.

— I njoh mirë. Ai me zë të trashë është Sadiku, djali i xhaxhait të Veselit.

Dhe u ngrit ashtu si qe, me gjithë djalë.

— O Sadik, ore... O Di-keee!

— Ku je, more? — u përgjigj zëri.

— Lart, o, lart! Te shkëmbi lart, o Di-keee!

Zërat s'u ndien më dhe pas pak dëgjova zhurmën e shkurreve aty te këmbët tona, po njerëzit s'i dalloja dot.

— Gjallë jeni, more?

— Gjallë, o Dike, gjallë, po andej si dolët?

— Mirë vajti, mirë, jo keq!

— Si e ke plagën, shok? — më pyeti partizani tjetër, që vinte më i shkurtër se Sadiku. Më dukej se e njihja atë zë.

— Unë s'kam gjë, po ju si dolët? — pyeta me padurim se s'dija si t'i merrja fjalët e Sadikut «Mirë vajti, mirë, jo keq!»

— Bejko, ulu të marrim një frymë, — i tha Sadiku shokut dhe mua më dha një cigare. — Të është çarë hunda. Kushedi që kur s'ke pirë. Njëpër prita unë vdekje vetëm punën e duhanit kam. E di ç'bëra njëherë?! Ndenjëm në pritë nja tri orë të shëndosha. Plasa! Po ishte gjë me zarar e s'mund ta ndizja. E kemi nga një huq... Po djalin mirë e ke, moj? — iu drejtua nuses. — Se na vrau xha Danoja. «O jep urdhër të bëhen erë e të shkojnë te Batoja nja dy djem të shëndoshë, o ika vetë kështu me gjysmë shpirti siç jam». — Kështu i tha komandantit plaku.

Më në fund Sadiku kishte nxjerrë një fjalë për së mbari e sikur u lehtësova disi. Gjersa pimë ato cigaret e trasha, Sadiku na i tregoi të gjitha ç'kishte parë.

Xha Danoja e kishte shpurë letrën me kohë, dhe unë sot e gjithë ditën habitem, ku i kishte gjetur tërë ato forca ai plak koskalli e i kërrusur si drapri. Me gjermanët e luginës e kishin pasur pisk. Mënt i patën diktuar dhe xha Danoja tërhoqi mushkën nëpër një grykë. Kafsha u azdis e, ndërsa po muntohej ta fuste në një ulluk përroi, ia tërhoqi kapistallin me forcë dhe e hodhi Rabihanën keqas në ca gurë. Mbeti e shkreta pa ndjenja. Xha Danoja u hoq gjer

tek ajo dhe u mundua ta përmendte, po s'qe punë që bëhej. Ishte goditur keq. E tërhoqi zvarë dhe e futi në një zgërbor një. Ajo rënkoj në agoni dhe plaku e tundi nja dy herë lehtë. Po Raboja s'u ndie më.

— S'je më për rrugë ti, jo! Do të të lë këtu. Dëgjon, apo jo? Ty të them Rabihan? Do të vij të të marr pastaj. Mba-hu edhe këtë radhë.

Danoja hoqi qelesheën e ia vuri poshtë kokës dhe trupin ia mbështolli me xhokën e shajaktë. Nxori letrën nga rrethi i çitjaneve të saj dhe u nis nëpër pyll me një brengë të madhe në zemër. Eci si eci, vetëm ai e di, por, kur kishte hasur në rojet e batalionit, fuqitë iu prenë njëherësh e s'bënte dot çap. E shpunë në krahë te i biri, të cilit, pa i thënë asnjë fjalë, i dha letrën. Veseli e lexoi në dritën e çakmakut dhe seç u tha dy partizanëve që kishte pranë. Pas pak, plaku me kokën mbështetur në gjurin e të birit, i pa përsëri ata të dy që sollën një partizan tjetër, të cilit i kishin vënë grykën e pushkës në mes të shpatullave.

— Bir bushtre! — shfryu Veseli.

U ngrit ngadalë dhe pa si dridhej ai që kishte grykën e pushkës në kurriz.

— Jepni alarmin, — urdhëroi Veseli, — Po na rrethojnë. Kurthet e këtij qeni.

— Plumbin! — tha plaku.

— Pushkatojeni! — tha Veseli. — Vendim i Qarkorit.

— U qërua dhe një hale, — tha xha Danoja, kur dëgjoj krismat, dhe, ndërsa i biri përgatitej e jepte urdhra, i tregoi për shokun e Qarkorit, për Baton, për nusen, dhe për plakën që e la te zgërbonja.

Kur do të niseshin, i tha të birit të dërgonte njerëz për tek ata.

— Ti do të vish me ne! — i tha i biri dhe iku duke e lënë me një djalë të ri që i futi duart dhe e ngriti si një fëmijë.

— Shkoj vetë, — tha plaku, i fyer.

Djali e lëshoi pa fjalë dhe e ndoqi pas.

Batalioni u doli gjermanëve përpara. Veseli la një skuadër që i tërhoqi nëpër një grykë, kurse forcat e tjera zunë të dy shpatet. Dhe, kur e pa se frerët e luftës i kishte në

dorë, urdhëroi që katër vetë të niseshin dy për te Raboja e dy për te shoku i Qarkorit. Plakut i kishte ardhur fuqia prapë e më të poshtë këmbët i hanin mirë.

«E sikur ta arrij me shpirt! — thoshte me vete. — Pa s' do ta lë të vdesë, jo! Trime grua! Më ka nderuar tërë jetën! E mora në mushkë se mos ndeshja papritmas më gjermanë e t'u thosha se e shpie në derë të t'et, pasi i ka vdekur vëllai».

E gjeti ashtu si e pat lënë, po trupi i saj që ftohur e bërë kallkan. Danoja nuk deshi të besonte dhe i futi duart në gjoks. Vdekja kishte lëshuar tërë ftohtësinë dhe hidhtësinë e saj mbi trupin e drobitur të Rabos.

«Si s'më prite dhe ca, moj e gjorë! — tha plakut me duf.

Partizanët s'flisnin. Edhe ai s'foli një copë hërë. Një lëmsh i madh iu mbloodh në fyt e mjekra, po i dridhej.

«Shyqyr që është natë dhe s'më shohin lotët djemtë, — mendoj plaku. — S'e paskam ditur që të desha kaq!».

Tradhtari ankohej e lutej me ca gjysma fjalësh si në të qarë. Dy partizanët, që e shoqëronin, e tërhoqën në errësirë.

Njëri nga partizanët, që mbante dorën mbi ballin e ftohtë të plakës, e ndjeu si u këput e ra një pikë lot nga sytë e xha Danos. U ngjeth, mori qëndrim gatitu dhe hoqi kapelen. Kështu bënë edhe të tjerët. Dhe rrinin të heshur me kokën varur, gjersa plaku të thoshte një fjalë.

«Kështu ja... Na iku edhe Raboja, bashi i grave. — Veg të ishit aty e të shikonit xhaxhanë! Mbeti ashtu i ngri-rë një hop të gjatë dhe ne dëgjonim si i rrihte lukthi. Pas-taj u kthye papritur e na bërtiti neve të dyve:»

«Po ju ç'më rrini akoma këtu? Kjo iku. Ata të gjallët po presin atje.»

Dhe ne erdhëm këtu. E lamë që t'i presim ata te Pusi i Pashës.»

Si e mbaroi tregimin, Sadiku u ngrit. Pas tij edhe tjetri. Bëra dhe unë të ngrihesha, por nuk lëvizja dot. Selvia po qante, duke u munduar të mbyste dënesat. Partizanët këputën ca degë e bënë një vig. Sadiku shtroi mbi të pallton e tij. Sipër më hodhën timen. Dhe u nisëm prapë nëpër atë shteg të ngushtë. Selvia diku u pengua dhe mezi mbajti fëmijën.

— Nema mua djalin, — i thashë.

Ajo s'foli.

— Jepja, — tha Sadiku, — Vigun e bëmë të gjerë.

Unë bëra pak mënjanë dhe ajo ma lëshoi djalin në gjoks me kokën mbështetur mbi krahun tim. Arritëm te pusi i Pashës dhe pritëm në heshtje, gjersa erdhën të tjerët.

— Hë, si dukeni? — pyeti xha Danoja.

— Mirë jemi, mirë! — tha Sadiku.

Plaku m'u afrua mua.

— Mbahu, djalë, mbahu! Ja, vamë në fshat, — dhe pu-  
thi kapotën time aty ku mendonte se duhej të ishte balli i  
të nipit.

Selvia s'e mbajti dot veten, kur i vjehri po mbulonte me kujdes, me xhokën e tij trupin pa jetë të Rabos, aty mbi vigun që partizanët s'e kishin hequr nga supet. Lëshoi një ngashërimë të mbytur, therëse.

— Mos qaj! — tha plaku. — Ti je lehonë e të ikën qumështi. Batoja do të pijë.

Dhe u nis.

Pas tij shkante vigu me trupin e ftohtë të Rabos. Nusja ecte në më.

Kur iu afruam fshatit, po fekste. Xha Danoja u hoq mënjanë, u bëri shënjë të tjerëve të kalonin dhe më priti mua. Duart i kishte lidhur prapa. Gishtërinjtë, që ishin regjur duke thyer plisa e duke hedhur farë, shtrëngonin qelshen e tij që kur e mori nën kokën e gruas atje te zgërbonja.

— Ja, vamë, djalë, vamë...

— Xha Dano... Të rroni vetë!... — nuk dija t'i thosha një fjalë ngushëlluese për Rabon.

— Të më rroni ju, — tha plaku. — Pa edhe vetë dua të rroj akoma. Vërtet e grisa gunën nëpër ferrat e kësaj palojete, po s'do ta hedh, pa i dalë mbanë edhe kësaj lufte.

1974

FATA

Ajo ishte plakë dhe rronte fare e vetme, në një shtëpi në të dalë të fshatit. Shtëpia ishte e vjetër, në ahure kakarishnin pulat dhe te dera flinte një qen që muntohej të kapte miza. Po mizat ishin të shpejta dhe qeni kuiste me dëshpërim, duke futur turinj të midis putrave të ndo- tura.

— Të hanë, o i zi? — murmuriste plaka, kur dëgjonte qenin që kuiste. Dikur ai kishte qenë i fortë dhe i shkathët, po tani që e kishte thyer pleqëria, strukej ahureve dhe flinte gjithë ditën.

Dhe plaka dikur kishte qenë një grua e shkathët dhe e bukur, po tani ishte plakë, këmbët i dhembnin nga reumatizmi dhe sytë i kishte të përlotur. Ajo mezi ngrihej dhe dilte çalë-çalë në oborr, për të hapur çarçafin e misrit në diell. Pulat rendnin pranë çarçafit dhe ajo muntohej t'i përzinte me plisa.

— Ah, ju preftë një flamë, moj të mallëkuara!

Po pulat e dinin që plaka ishte zemërmirë, ndaj nuk ia kishin frikën. Ato bënin ka-ka-ka, shkonin gjer te gardhi, ku harliseshin lastarët e kungujve të fryrë nga lëngu dhe ktheheshin prapë te misri.

Prapa shtëpisë plaka kishte një kopsht dhe një arë të vogël zhurigë, që e mbillte me thekër. Thekra vinte e mbarë dhe asaj i gëzohej syri, kur shikonte kallinj të e blertë që i lëkundte era. Tokën ia punonin fqinjët, ata ishin njerëz të mirë dhe e donin këtë grua kërcure. I bënin dru, i korrnin arën dhe i bluanin në mulli. Bile kishin dashur ta

merrnin në shtëpitë e tyre, po ajo s'kishte dëgjuar të ikte nga ajo vjetërsirë që mezi rrinte në këmbë dhe nga ara e saj e thekrës.

Gjithë ditën kjo plakë vërtitej nëpër oborr si hije, duke folur në më të shumtën e herës me vete. Atë e merrte malli të bisedonte me njeri; kështu që herë fliste me vete, herë me lopën, Murgjinën, kur e nxirrte nëpër mezhda për ta kullotur, herë me pulat që i vardiseshin misrit dhe herë-herë i hakërrohej atij çarriarokut të vogël, viçit të Murgjinës, që shpëtonte nga kapistalli dhe rendte si i tërbuar nëpër oborr, duke trembur pulat e duke i rënë me kokë qenit plak. Ajo e kapte nga turinjtë, viçi zgurdullonte sytë e i lëshonte frymën në fytyrë, pastaj i lëpinte duart me atë gjuhën e gjatë e të ashpër.

Ishte një plakë që rronte fare e vëme dhe të hënave pasdite vinte një shall të zi në kokë e ulej buzë rrugës, duke shikuar matanë kaptirave nga ktheheshin ata që shkonin për pazar. Shkarraviste në tokë me majën e shkopit dhe mendohej me sytë e ngulur mbi të. Ajo priste të kthehej Banushi nga pazari, hipur në atë gomarin e tij të vogël me këmbë të shtrembra e me një torbë leshi në shpinë. Banushi vinte, një herë i thoshte se s'kishte marrë vesh gjë, herë i thoshte se Lifka kishte bërë ca zullumë andej nga fshatrat e bregut. I kishte dalë një fshatari në rrugë dhe i kishte marrë paratë e qeve. Plaka rrudhte buzët dhe tundte kokën me dëshpërim:

— Si u bërë, mor i zi, si u bërë!

Kishin kaluar 12 vjet që atëherë, kur të plaka nisi të vinte dendur e më dendur Lifka. Ai ishte një çunak dhjetëvjeç, me ca flokë të trashë ngjyrë kërpi e hundën e kishte me quka. Ata të Lifkës e kishin shtëpinë në faqen tjetër të kodrës, kishin një tufë fëmijë dhe ishin fare të këputur. Plakës i gëzohej zemra kur shihte këtë çunak që zbriste faqes së kodrës, që kapërcente pastaj gëmushat e rrodheve në kopsht dhe vinte tek ajo. Plaka i jepte një grusht me arra, ai ulej në një shkëmb druri e niste t'i çante, duke tundur gjurin.

Lifka ishte një çunak i prapë, që s'linte dy gurë bashkë. Kur plaka shkonte prapa shtëpisë, ai rendte te koçeku,



merrte një kallam, bërë apostafat për ta futur nëpër të çarat e dërrasave dhe i pinte qumështin nga tava. Po plaka nuk i thoshtë gjë, sepsë s'dontë ta zemëronte dhe ta përzinte këtë djalë. Ajo ishte fare kërcure, fëmijë nuk kishte, dhe ai sikur ia mbushte shtëpinë plot.

Një natë ajo e mbajti për të fjetur. I bëri një përsesh me qumësht, i dha arra e bajame dhe pastaj e vuri të flihte. Atë e zuri gjumi si shqerrë e plaka i rrinte mbi kokë, duke i murmuritur fjalë që i rridhin si mjaltë. Fytyra e Lifkës sikur ëmbëlsohej nga kjo dashuri që përgjonte mbi të, buzëqeshte e zbukurohej. Plaka i lëmonte flokët, e mbulonte me kujdes dhe e puthte në ballë.

Një ditë ajo i tha të atit të Lifkës:  
— Jepma mua atë djalë, o Sulo! Ti ke një vater e zoti të t'i falë! Jepma, ta rrit unë! Bukë kam, ca bulmët kam, do ta mbaj si djalin tim. Pastaj, ja ku e ke. Vjen dhe e sheh dhe ai do të vijë e do t'ju shohë.

Sulos i vinte keq ta nxirrte nga shtëpia, por fundja plaka ja ku ishte dhe ia dha.

Kështu që kjo grua kërcure u bë me djalë. Dhe mbrëmjeve, teksa e vinte në gjumë, nisi t'i këndonte një këngë që e kishte blamburitur kaq e kaq herë me veten e saj:

*Prit, o Dalan bej, prit të rritet djali,  
pa plumb do të të derdhë në lule të ballit!*

Një dhembje dhe një urrejtje e egër ia shtrembëronte buzën, kur sillte ndër mend Dalan beun. I gjori Memë, burri i saj, shkoi e u ngatërrua me beun e sarajit për të ngrënë kokën e vet. I dha paratë për të blerë një livadh të nxirosur, po paratë beu i hëngri dhe livadhin nuk e lëshoi. Prit sa të korr barin, prit sa të ndaj sinorët dhe, më në fund, e bëri fjalën hasha. Atëherë Mema, levend burrë, sa dilte një kokë mbi shokët, i drejtë dhe gjaknxehhtë, ia përplasi beut në fytyrë këtë maskarallëk atje në mes të pazarit:  
«Qëkur, o bej, paske zënë të hash fjalën dhe paratë kështu?»

Beu, hipur në majë të kalit, qe nxirë e qe vrenjtur dhe u kishte thënë qehajallarëve:

«Hiqmani sysh këtë pizeveng, se flet përçart!»  
Tri javë pas kësaj grindjeje në pazar, beu, që qe zemëruar këq, futi Mesun Qorrin dhe e vrau Memën të livadhet e Sopokut.

Atëherë plaka ishte grua e re dhe, kur i thanë se burrin ia vranë të livadhet e Sopokut, hodhi një shami të zezë në kokë dhe shkoi dhe e ngriti vetë. Gratë e mëhallës shkullnin faqet dhe qanin me dënësë për Memën e shkretë, ndërsa ajo rrudhte buzët, tundte kokën me një pikëllim të thellë, po nuk derdhi një pikë lot.

Mema i la një djalë, Mevlanin, që rritej i gjatë e syrin pishë, gjallë i ati. Atë vit që u vra Mema, Mevlani ishte nëntëvjeç dhe pat qarë me ca britma të çuditshme, sa u këputi zemrën të gjithëve. Qe përplasur mbi sënduk dhe nuk lëshonte lotë, po sokëllinte me gjithë gjoksin: «Aj, aj, aj!»

Mevlani, megjithëse fëmijë, kishte vështrim prej të rrituri. Atëherë bënte klasën e dytë në Eret dhe vetë shkollonte, vetë vinte dy orë rrugë me çantën në shpinë, i heshtur, i dashur, po serioz e me ata sytë e errët, që të vështronin si një i madh. Ditën që i vranë të atin, shkroi në një fletore që e mbante në sënduk: «Sot, më 30 të marsit 192...», më vranë babanë njerëzit e Dalan beut. E shkruaj për të mos e harruar sa të jetë bota.»

E ëma u rropat ta rriste këtë djalë mirë e më mirë. I shoqi kishte dashur që të birin ta bënte me shkollë, dhe ajo hëngri dynjanë me vuajtje, për ta rritur e mësuar atë. Si mbaroi klasën e tretë në Eret, ajo e dërgoi te ca miq në Korçë, që të vazhdonte shkollën atje. Po miqtë qëlluan njerëz të ftohtë dhe s'ia patën trajtuar mirë të birin. Mevlani e ndiente këtë dhe, pa mbaruar klasën e pestë, një ditë dimri të ftohtë me shi u kthye vetëm nga Korça, i lagur e i përballtur, përplasi librat në një qoshe dhe u ul pranë zjarrit me sy të myrrëtyer nga një mërzi e madhe. Nuk i tha asgjë s'ëmës, vetëm vonë në darkë, kur ranë të flinin, i puthi duart dhe për herë të parë u ngashërye në prehrin e saj.

Kur u bë gjashtëmbëdhjetëvjeç djalë, Mevlani i doli në pusi Dalan beut, po ai ishte ende një ferishte e njomë, plu-mbi dredhoi dhe trimat e beut e grinë me thika.

Brenda një jave u plak e u fishk kjo grua nga vdekja

e të birit. «Si i duron zemra që s'i plas, së nxirosurës!» — qanin gratë në hështje, pasi u hap varri i ri i Mevlanit, atje, pranë Memës që qe tretur e po harrohej. Kurse kjo grua e mbetur kërcure kishte rënë në gjunjë dhe kishte murmuritur në një pikëllim të thellë: «Marrtë zoti hak për të gjitha këto!»

Po u tha bari i vjeshtës mbi varrin e Mevlanit, mbiu bari i ri i pranverës dhe Dalan beun s'po e dënonte as zoti, as rob.

Dhe ja, shpresa e vjetër për të marrë hak iu ngjall përsëri kësaj plake kërcure, kur mori pranë gjirit të saj atë djalë me flokë të ashpër bojë kërpi dhe me quka te hunda:

*Prit, o Dalan bej, prit të rritet djali,  
pa plumb do të të derdhë në lule të ballit...*

Po Lifka, kur u bë 17-vjeç, krisi e iku me karvanin e qymyrxhinjve. U kthyen qymyrxhinjtë në pranverë, po Lifka nuk erdhi. I thanë se kishte zbritur andej nga Tirana, kishte hyrë në punë te një bej dhe i dërgonte ca sheqer kokël në një qese të vogël dhe nja dy kausha kafe. Më vonë mori vesh se beu i Tiranës e kishte nisur në Korçë për të vrarë një hasmin e vet dhe që nga ajo kohë Lifka vërtitej si kaçak. Koburja s'i kishte ndezur në mes të kafes dhe ai s'mund të kthehej as te beu në Tiranë, as tek ajo në fshat, se punës i kishte dalë era dhe e kërkonin kudo. Vërtitej maleve dhe kishte zënë t'u bënte zullume njerëzve që ktheheshin nga pazari.

Kur mori vesh të gjitha këto, plaka hyri brenda dhe i hodhi në katua gjithë plaçkat e tij. Dhe u bë e heshtur dhe nuk i hidhte më sytë andej nga sarajet e beut. «Kështu pas-ka qenë e thënë, — murmuriste, — Tashti rro, or pusht, kur ai që rrita unë u bë pusht».

Po Dalan beu e paskësh pasur mortjen nga tjetërkush. Qe krijuar Partia. Malit dilte djemuria për të luftuar. Doli djali i Xhevos, djali i Myrtos. Doli më vonë vajza e madhe e Selimit, pastaj djali i dytë i Xhevos. Dilnin malit dhe kudo ngrihej rrapëllima e madhe e luftës për çlirim.

Një mëngjes shtëpia e Xhevos u gdhi shkru mb. Tho-

shin se ra zjarri nga mullarët, po kjo ishte puna e Dalan beut bashkë me njerëzit e tij të Ballit. Një javë më vonë plasi flaka në sarajet e Dalan beut. Xhevoja me të tijtë iku nga fshati dhe beu, për hakmarrje, çoi dhe vrau një të nipin e Xhevos në arë duke ngarë qetë. Dalan beu, pas kësaj, zbriti në qytet bashkë me njerëzit e tij të Ballit dhe sarajeve u mbetën në këmbë vetëm muret e nxira nga tymi.

Dhe atë që donte ajo plakë, e kishte bërë djali i Myrtos, Zaloja. Erdhën dhe i thanë se Dalan beut ia kishte numëruar djali i Myrtos mu në mes të kasabasë dhe kështu qeni i kishte larë haqet që kishte në këtë botë. Kishte lëshuar duart kjo plakë dhe, duke parë nga shtëpia e Myrtos, që nxirrte çatinë mbi pemët e kopshtit, kishte murmuritur: «Kurban nënia ty, more Zalo! Ditët një mijë t'u bëfshin!»

Këtë gëzim ia farmakosi një lajm që i erdhi për Lifkën. I thanë se ai kishte shkuar me Ballin. Plakës i rëndoi plumb në zemër. Plaçkat që ia kishte hedhur në katua, i nxori prapa shtëpisë dhe ia dogji.

«Si të ma nxish faqen, mor i zi?»

Kjo plakë deshi ta shihte si ai, kapedani i Myrtos, kurse Lifka që bërë një këlysh i Ballit kundër partizanëve.

«Si të më nxish faqen, or i zi? Të më ishte bërë djallë i Partisë e të ma gëzoje zemrën në pleqëri, mor i zi!» — murmuriste ajo me dëshpërim.

Në pranverën e dyzetekatrës, partizanët i ranë një autokolone gjermane në rrugën e Leskovikut dhe pastaj u tërhoqën për në male. Gjermanët dhe Balli u ngjitën nëpër fshatra. Ata morën rrugën e madhe të Drebeshës, dolën në fshatrat matanë Kilbit dhe më pastaj u ngjitën përkëtej.

Në ndajnatë plaka dëgjoi në oborr zëra dhe hapi katinin e dritares; një tufë burash me qeleshe të bardha e me shqiponjë në qeleshe ishte dyndur në atë buzë muzgu. Njëri nga ata kishte hipur në këmbët e shkallës dhe shikonte nga ajo, duke qeshur si njeri i njohur. «Lifka?!» Ajo e njohu nga sytë dhe nga një e çarë që kishte mbi vetull. Lifka, kur ishte i vogël, që rrëzuar te gurët prapa shtëpisë dhe e kishte çarë vetullën si me thikë.

— S'më njeh, a? — ia bëri ai dhe plaka vuri re se zëri i qe trashur e i qe ngjirur.

Ajo tundi kokën, mblodhi buzët si me pikëllim dhe doli në krye të shkallëve.

— A erdhe, a? — ia bëri pa lëvizur nga vendi.

Lifka u bëri me shenjë shokëve dhe ata nisën të ngjiteshin grrap e grup nëpër shkallë me ato këpucë të rënda. Ai e qafoi plakën, pastaj hynë në konak, hoqën armët dhe shvënë kapicë pranë derës.

— O nënë! — tha Lifka. — Çfarë ka për të ngrënë? Kemi bërë gjithë ditën rrugë dhe s'kemi vënë gjë në gojë.

— Ku ka plaka për të ngrënë? — tha ajo. — Grua pa burrë e pa njeri, e kam a s'e kam një kothere për vete.

Lifka qeshi me të madhe.

— Më ke mua, mos u mërzit! Ja, sa ta bëjmë Shqipërinë dhe të gjitha të mirat do t'i kesh. Po unë e di, dy pula i ke ti dhe mos i kurse për mua. Më kishte marrë malli që q'të të them:

— Dy pula i kam, — tha plaka, — po s'më bën zemra t'i ther. Më duhen për ndonjë vezë.

— E, moj nënë Fata dhe ti!

Ai zbriti në katua me vetulla të rrudhura nga zemërimi, kapi një gjel dhe i këputi kokën te kreu i shkallëve. Pastaj vuri dy ballistë ta ripnin e ta piqnin.

Ndërkohë krisi lebetia në fshat. Bastisnin shtëpitë e njerëzve të Luftës, merrnin çdo mashkull që gjënin dhe e mbyllnin në shtëpinë e Mesun Qorrit. Mallëkimi i grave dhe kuja e kalamajve të ndillnin lëmeri.

Si u shtruan të hanin, brenda erdhi një ballist që kishte rendur me të katra.

— Hë? — ia bëri Lifka, pa e ngritur kokën nga tepsia me mish gjeli.

— Është në stane, — tha i porsaardhuri. — Kthehet në sabah.

— Sakën se del njeri nga fshati, — tha Lifka dhe ballisti bëri temena e doli.

«Qenke bërë dhe për temena!» — mendoi plaka.

Ata hëngrën e pinë gjer në mes të natës, pastaj morën pushkët e ikën. Plaka s'vuri dot gjumë në sy.

E nesërmja pò gdhinte e heshtur dhe e zyntë. Në male nisi të mugullonte drita e mekur e agimit, që merrte poshtë honeve dhe përrenjve, duke shtyrë togje muzgu. Ishte një mëngjes i thellë dhe i heshtur, në pyje s'frynte grimë ere dhe në qiell ende s'kishte nisur fluturimi i zogjve. Vetëm qyqja atje në pyll kishte nisur të kërkonte që në ag diçka që s'e gjente kurrë: Ku-ku, ku-ku...

Në rrugën e ngushtë, që shkonte poshtë arës së thekrës, u dëgjuan hapat e një mushke dhe pas kësaj ca britmë të ngjirura, vringëllima armësh dhe një tufë burrash që hidheshin mbi dikë në befasi. Plaka hapi derën e ashefit, që binte prapa shtëpisë, dhe atje matanë gomradave të arës një grumbull burrash përlesheshin dhe nxirrnin britma të mbytura. Një tufë qeleshesh të bardha hakërroreshin dhe i hidhnin litarin dikujt. Kë lidhnin ata ashtu?

Hodhi një sharp të zi në kokë dhe doli me ngarendje. I zihej fryma në atë vrap, këmbët i ngatërroheshin në thekrishtë, po rendte dhe ndiente zemrën që i rëndonte në gjoks. Cilin bir lidhnin atje, poshtë gomradave? Në mesnatë ata patën dalë nga shtëpia, ajo kishte kujtuar se thyen qafën andej nga Mesun Qorri, kurse paskëshin zënë pusi në thekrishtë!

Tufa e tyre tani qe egërsuar më shumë; shtyheshin e britnin duke lëvizur krahët, hakërroheshin e hungronin si ujçër. Ajo kapërceu thekrën e doli te shtegu. Në atë kohë një gërdallë me nofulla të dala u shkëput nga turma dhe iu shkreh me egërsi:

— Po ti, ku shkon? Hajde, kthehu!

Ai zgjati duart ta kthente, po plaka i dha një të shtyrë dhe bëri për nga grumbulli.

— Jazëk ju qoftë! — briti ajo. — A me këtë ferishte po kapeni!?

Pranë një gorrice të re, që sapo i pat plasur gjethi, kishin vënë djalin e vogël të Myrtos dhe i kishin lidhur duart. Lifka qe bërë si një bishë dhe kishte nxjerrë revolverin nga këllëfi. Djali i Myrtos qe një çunak 14-vjeç, me flokë të bardhë, me sy të vegjël e të egër. E kishin kapur tek kthehej nga stanet. Atij i hidhej gjoksi përtpjetë dhe shikonte i hakërryer atë tufë burrash.

— Jazëk ju qoftë! — thirri prapë plaka dhe u lëshua drejt tij.

Lifka i zgjati krahun përpara që ta mbante:

— Po ti, pse përzihesh këtu? — u ngjir ai. — Hajde, ik!

— Lëreni, — bërtiti plaka. — Me këtë ferishte merreni, që ju rëntë pika?

Një ballist mbante vetullën me dorë dhe që andej i rridhte gjak.

— Ta lëmë thua këtë këlysh komunistësh, a? — dhe shkoi e i ra me shqelm djalit të Myrtos, Nazifit. — Di dhe të çjerrësh, jezit!

— Lërma mua! — u ngjir Lifka, me dhëmbë të shtrënguar. — Këta qenër njëlloj janë!

Ai e shtyu Nazifin drejt hendekut dhe ngriti revolvërin. Nazifi rrudhi vetullat e njoma, ngriti duart e lidhura, i çoi anës dhe ia ngjeshi hundëve, sa i hanin krahët. «Gjallë i vëllai, që ia numëroi Dalan beut», — mendoi plaka dhe u lëshua drejt Lifkës.

— Lëshoje atë! — i bërtiti dhe iu hodh në krahë. — Lëshoje, të rëntë pika!

Po Lifka e shtyu me dorezën e revolverit në gjoks, i dha krahut me sa fuqi kishte përpara dhe ajo u rrëzua te çizmet e tij.

— Hajde, lart! — bërtiti ai.

Plaka pa si kaluan me nxitim hapat e tyre mbi kokën e saj, e vunë përpara, me të shtyra, djalin e Myrtos dhe shkuan drejt pyllit. Zërat e hakërryer u larguan e u larguan derisa nuk u ndien më.

Në lëndinën me bar të ri, në fund të arës së thekrës, zotëroi përnjëherësh një qetësi e thellë. Po lindte dielli. Plaka dëgjonte frymëmarrjen e vet të rëndë dhe fëshfëritjen e tufëzave të barit, që i përziente era. Mushka e Nazifit kishte kapërcyer mezhdën dhe po kulloste pranë gardhit. Ndiente dhembje në kryqe dhe mezi u ngrit.

Po përse i qenë prerë gjunjët kështu, përnjëherësh, zemra përse i hidhej si zog në kraharror dhe, ndërsa i kalonin mornica në trup, përse shikonte tutje nga pylli me gjak të ngrirë? «Ferishtja e Myrtos, bir, o bir, partizani i

vogël i nënës, që mbeti me torbën në krah e mblidhte bukë për shokët e malit». Plakës si hiqej nga sytë fytyra e tij e njomë, por e vrenjtur si e një të madhi, vetullat e bardha të mbledhura shuk nga urrejtja dhe ata krahët e ve gjël e të lidhur, që i ngriti në ajër e goditi Lifkën. «Ferish-tja e Myrtyos!» Një tufë qensh i ishin hedhur në shpinë, sikur trupi i tij i njomë e i përkulshëm të ishte burrëruar e shkuar burrërimin. Pështyma i qe tharë në grykë kësaj plake dhe gjunjët i qenë mbërthyer në vend nga ajo pritje gjithë ankth.

«Krau, krau, krau», u dëgjuan tri krisma të thata dhe pas kësaj heshtja sikur u bë dhe më e thellë. Vetëm një gulsh ere fryu pas tyre, erë që zbriste nga Kilbi ende i mbuluar me borë, dhe trazoi me fëshfërimë të shurdhët gjethet e reja të goricës. Heshtja sikur pushtoi gjithë qenien e saj dhe plakës i ngjante sikur zemra nuk i punonte më, sikur era që zbriste nga Kilbi u mek e mbeti prapa gjerdheve, sikur tufëzat e reja të barit mbetën mënjanë e nuk frushullonin më, sikur dhe qyqja, që kishte zënë që në mëngjes të numëronte vitet e dikujt, heshti e u nemit atje në pyll. Në atë mëngjes herët, mbi luadhet e mbi rru-gët, mbi varoshet e mbi hapësirat e largëta sikur ra një muzg ngjyrë hiri, pa zhurmë e pa jetë.

«Njerëz janë apo hije ata që dolën tek ara e gjatë rrzëzë pyllit? Plaka ktheu fytyrën e rrudhur andej dhe e pa grumbullin me qeleshe të bardha që hapnin shalët me nxitim dhe shkonin drejt shtëpisë së saj. Ata kapërcyen arën, dolën te burimi i Meços dhe hynë në oborr.

Plaka shkoi drejt pyllit. Nuk e ndiente më dhembjen e kryqeve dhe gjunjët i ndiente hekur të fortë. Ngjitej nëpër bokërrima, po nuk i dhembte më poshtë lukthit të kraharorit dhe fryma nuk i zihej më. Kishte mbledhur buzët, sytë i zgjeronte e i zgjeronte për të parë mirë, sepse një perde lotësh i rridhte vetvetiu nga qepallat kësaj plake dhe ajo s'kishte kohë t'i fshinte. I ngrinte zemra sa herë shihte ndonjë kërcu të kalbur, rrëzuar mbi gjethet e vjetme, që po mbi to kishte zënë të mbinte bari i ri i gjelbër dhe i hollë si push. Shikonte majtas e djathtas nëpër lirishtat e nëpër brigjet pas drurëve e pas gëmushave, rrugëve të



pyllit, mbushur plot me gjurmë dhish e gjurmë dhensh. Shikonte majtas e djathtas me buzë të mbledhura shuk, sikur donte të përmbante një ngashërim të madh e me sy të shqyer për habi e me perde lotësh që i mjegullonte gjithçka. «Ferishtja e Myrtos, bir, o bir!»

Plaka mbajti hapat. Në një lirishtë buzë rrugës, Nazifi kishte rënë në kurriz dhe sytë, me atë vështrim të ngrirë, i kishin mbetur hapur. Të ngjante sikur shikonte qiellin matanë majave të larta të drurëve, sikur sodiste një re të madhe e të ngathët që ngjitej drejt kupës së qiellit.

U përkul mbi të, i futi dorën nën kokë dhe e tërhoqi drejt një vendi të sheshtë. I shtriu duart dhe këmbët, i mbylli qepallat dhe e mbuloi me sharpin e saj të zi. Pastaj drejtoi trupin, lidhi duart në majë të kokës dhe nguli mjekrën në gjoks, duke parë trupin pa jetë të Nazifit. Sa ndënjji ashtu? Kishte zënë të frynte erë e fortë dhe degëzat përplaseshin me njëra-tjetrën, kishte plasur shiu në pyll, në fillim me pika të rralla, pastaj si një tufë harabelash që fluturon me turr, pat shpërthyer poterja e tij nëpër gjethë, kishin zënë të zbrisnin rrëkeza uji nga monopatet, kur ajo u lëshua mbi trupin e Nazifit me logori.

«Bir, o bir! Si i bëri dora atj katilit të të bëjë kështu, o bir!» Një vetëtimë e madhe ndriti pyllin, dhe gjemimi u rrokullis i vrazhdë e i rëndë nëpër hapësirat e mbytura në shi. Plaka u ngrit dhe nisi të nxitonte nëpër shkarrëzima. Rrëketë e shiut e lagnin, degët i vrisnin fytyrën, ku i qenë shpërndarë thinxat, po ajo, duke gulshuar, zbriste rrëpirat dhe monopatet. «Si të bëri dora, mor katil, si të bëri dora?!»

Kurrë nuk kishte qenë kaq e gjallë fytyra e kësaj plake, kurrë sytë e saj nuk e kishin pasur atë shkëlqim të egër e të zjarhtë. Në rrugë qenë sajuar pellgje, atje përpara nisi të shquhej shtëpia e saj, e vjetër dhe gjithë mazgalla. Pranë shkallëve dukeshin dy ballistë, që patën ngritur jakat e setrave dhe rrinin nëpër strehë. Ajo do ta thërriste Lifkën në ashef dhe sëpatën do ta linte pas derës. Kur ai të dilte, atëherë... Dikush vraponte në rrugë drejt saj dhe lebetitej. Ishte e Zikut, që shkulte faqet, rendte dhe bërtiste:

— Po i vrasin, moj korba, po i vrasin!

Bënte me dorë nga lëmenjtë e Mesun Qorrit, ku dukej një grumbull njerëzish dhe thërriste:

— Po na i vrasin gjermanët, moj korba!...

E Zikut mori rrugën nga çesma dhe nëpër oborre plasi poterja.

Plaka hyri në oborr. Ajo ngjiti shkallët dhe njëri nga ballistët i tha:

— Mengadalë! Tërë natën kanë qenë pa gjumë dhe tashti po flenë.

Ajo e vështroi ballistin si e përhumbur. «Po flenë?» Sytë iu hapën si ta kishte goditur vala e një mendimi. Ngjiti shkallarët ngadalë dhe hyri në odën e madhe. Ata ishin shtrirë dhe po flinin. Lifka kishte shtruar një poste dhe ishte mbuluar me velenxë. Mjekra e plakës dridhej dhe vetullat i kishte mbledhur mbi sytë e vegjël me një dritë të çuditshme. Shkoi në sobalkë, ndezi zjarrin dhe vuri një tigan me vaj.

— Do të na bësh petulla, nënë? — i tha një nga ballistët që rrinte përjashta, duke zgjatur kokën nga dritarja. — Mirë de, se gjeç na mbyte sot. — Ai u zgërdhi dhe u mblodh përsëri nën strehë.

Plaka e dogji vajin mirë dhe me tigan në dorë shkoi në odën ku flinin ata. Kapërceu nja dy që ishin shtrirë në mes të dyshemesë dhe shkoi te Lifka. Hoqi thinjat që i qenë ngjitur në fytyrë e që se linin të shihte mirë, u ul në bisht dhe ia derdhi të gjithë vajin në vesh. U dëgjua një ulërimë e përbindshme, njerëzit që flinin u hodhën vrik përpjetë dhe ia mbajtën për nga dalja, kurse plaka la tiganin përdhe dhe shkoi drejt sobalkës. Nën vetullat e rruadhura i vetëtinin sytë nga një dritë e çuditshme.

«Qeni!» — shfryu me një duf që i ziente përbrenda.

1972

## PASQYRA E LËNDËS

1. Vishnja pikonte gjak AGIM CERGA .....	3
2. Gruaja me nishan në mjekër ALI ABDIHOXHA .....	9
3. Heroina ALQI KRISTO .....	22
4. Gratë e fshatit ANASTAS KONDO .....	41
5. Dera troket DALAN SHAPLLO .....	53
6. Pashakoja dhe bijtë e saj DRITËRO AGOLLI .....	65
7. Dispeçerja DHIMITËR S. SHUTERIQI .....	74
8. Bishtuku DHIMITËR XHUVANI .....	104
9. Vëllai i vogël ELENË KADARE .....	114
10. Rinia e prindërve FATMIR GJATA .....	120
11. Rrugë e vështirë IVONI RESO .....	140
12. Në orët e vona të së shtunës LAVDIE LEKA .....	145
13. Nënë Sabrija MOISI ZALOSHINJA .....	153
14. Një legjendë e kohës sonë NASHO JORGAQI .....	163
15. Vajza e uzinës NAUM PRIFTI .....	172
16. Pleqëri e bardhë RUZHDI PULAHA .....	185
17. Fata VATH KORESHI .....	199